

KOMENTAR

LIGJI “PËR NDIHMËN JURIDIKE TË GARANTUAR NGA SHTETI” DHE “PËR TARIFAT GJYQËSORE”



TIRANË 2020

Punuan për Komentarin:

Av. Ardjana Shehi për Nenet (1-17)

Av. Viktor Gumi për Nenet (18-36)

Publikuar, Gusht 2020

Varianti elektronik: <http://www.tlas.org.al/sq/studime>

Copyright:

© Shërbimi Ligjor Falas Tiranë

© Tirana Legal Aid Society, TLAS



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

Ky publikim u realizua me mbështetje financiare nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC. Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura janë te autor-it/ve dhe nuk përfaqesojnë domosdoshmërisht ato të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC.

KOMENTAR

LIGJI “PËR NDIHMËN JURIDIKE TË

GARANTUAR NGA SHTETI”

DHE “PËR TARIFAT GJYQËSORE”



Përgatitur nga:

Shërbimi Ligjor Falas, Tiranë
Tirana Legal Aid Society, TLAS
www.tlas.org.al
tlas@tlas.org.al

Tiranë 2020

PËRMBAJTJA

HYRJE.....	f 3
VËSHTRIM HISTORIK MBI KUADRIN LIGJOR MBI NDIHMËN JURIDIKE FALAS NË SHQIPËRI.....	f 5
VËSHTRIM HISTORIK MBI LEGJISLACIONIN PËR TARIFAT GJYQËSORE.....	f 7
LIGJ nr. 111/2017 “PËR NDIHMËN JURIDIKE TË GARANTUAR NGA SHTETI”	f 8
TARIFAT GJYQËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË.....	f 63
SHTOJCA 1.....	f 64
SHTOJCA 2.....	f 66
SHTOJCA 3.....	f 70
SHTOJCA 4.....	f 71
SHTOJCA 5.....	f 73
SHTOJCA 6.....	f 75
SHTOJCA 7.....	f 76
SHTOJCA 8.....	f 77
KONTRATË PËR OFRIMIN E SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE DYTËSORE.....	f 79
SHTOJCA 9.....	f 82
FORMULAR APLIKIMI PËR PËRFITIMIN E NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE.....	f 83
FORMULAR APLIKIMI PËR PËRFITIMIN E NDIHMËS JURIDIKE DYTËSORE.....	f 87
FORMULAR APLIKIMI PËR PËRJASHTIMIN NGA PAGIMI I TARIFAVE DHE SHPENZIMEVE GJYQËSORE....	f 92
FORMULAR VETËDEKLARIMI PËR TË ARDHURAT DHE PASURITË PËR PËRFITIMIN E NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE DHE DYTËSORE.....	f 95
ANKIM KUNDËR VENDIMIT TË GJYKATËS PËR RRËZIMIN E KËRKESËS PËR NDIHMË JURIDIKE DYTËSORE.....	f 100
FORMULAR VETËDEKLARIMI PËR KATEGORITË E VEÇANTA TË PËRFITUESVE.....	f 104
SHTOJCA 10 dhe 11.....	f 107

HYRJE

Hartimi i këtij komentari është ndërmarrë në kuadër të projektit të Shërbimit Ligjor Falas (TLAS) “Akses në Drejtësi për të Gjithë”.

Ndihma ligjore është një nga objektivat strategjike të reformës në drejtësi 2017-2020 të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.773 datë 02.11.2016 “Për Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2017-2020 dhe të Planit të saj të Veprimit”, dhe konkretisht, i objektivit specifik të strategjisë nr.3, në lidhje me reformën në drejtësi “Përmirësimi i Funksionimit të Sistemit Gjyqësor duke Forcuar Efikasitetin, Trasparençën dhe Qasjen në Pajtim me Standardet Evropiane”.

Në lidhje me këtë objektiv, është synuar që në një kohë afatgjatë të arrihet krijimi i një sistemi të drejtë dhe funksional të ndihmës juridike për individët dhe grupet në nevojë dhe krijimi i një sistemi të arsyeshëm dhe proporcional të tarifave gjyqësore për të siguruar financimin e shërbimeve të drejtësisë, si dhe garantimin e qasjen në gjykatë. Sipas planit të veprimit përkatës është parashikuar miratimi i akteve nënligjore në zbatim të Ligjit nr.111/2017 “Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti” dhe fillimi i zbatimit të këtij legjislacioni. Ky komentari i shërben zbatimit efektiv të legjislacionit për ndihmën juridike.

Objekt i Komentarit do të jenë këto dy ligje:

- Ligji nr.111/2017 “Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti”, i cili është miratuar në 14.12.2017 dhe ka hyrë në fuqi në datën 01.06.2018, dhe

- Ligji nr.98/2017 “Për Tarifat Gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”, i miratuar në 02.11.2017.

» Pavarësisht nga fokusi kryesor i këtij Komentari, ai do të mbështetet dhe përfshijë jo vetëm këto dy ligje bazë të mësipërme, por do të bazohet dhe do të komentojë edhe aktet nënligjore të hartuara e miratuara deri në datën e dorëzimit të këtij Komentari si produkt elektronik për përdorim, veçanërisht, nga grupet e synuara përkatëse. Aktet nënligjore të miratuara deri në datën e këtij Komentari janë më poshtë:

1. Vendim i Këshillit të Ministrave nr.55 datë 06.02.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti”.

2. Vendim i Këshillit të Ministrave nr.110 datë 06.03.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”.

3. Udhëzim i Këshillit të Ministrave nr.1 datë 06.03.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.4, datë 12.12.2012 “Për përcaktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor”.

4. Urdhër i Kryeministrit nr.59 datë 25.03.2019 për “Miratimin e strukturës dhe tëorganiqës së drejtorisë së ndihmës juridike falas”.

5. Udhëzim i Ministrit të Drejtësisë nr.1 datë 08.03.2019 për “Miratimin e rregullave dhe procedurave për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave të regjistrave”.

6. Udhëzim i Ministrit të Drejtësisë nr.2 datë 25.03.2019 “Për procedurat, periodicitetin dhe rregullat për verifikimin e rrethanave për kthimin e përfitimeve”.

7. Udhëzim i Ministrit të Drejtësisë nr.6 datë 20.08.2019 “Për rregullat dhe procedurat ekzyerjes së pagesave të shpenzimeve gjyqësore, për të cilat është vendosur përjashtimi në rastin e dhënies së ndihmës juridike”.

8. Urdhër i Ministrit të Drejtësisë nr.225 datë 25.03.2019 “Për miratimin e formularëve tëndihmës juridike të garantuar nga shteti”.

9. Urdhër i Ministrit të Drejtësisë nr.226 datë 25.03.2019 “Për miratimin e kontratave tëndihmës juridike të garantuar nga shteti”.

10. Vendim i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr.231 datë 12.11.2019 për “Rregullat e garantimit të mbrojtjes së detyrueshme dhe caktimin mbi bazën e parimit të rotacionit të avokatit mbrojtës nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore në procesin penal”

11. Urdhër i Ministrit të Drejtësisë nr.531 datë 25.11.2019 “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjinë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga drejtoria e ndihmës juridike falas të shërbimeve të ndihmës juridike”

Në datën e këtij Komentari, vendimi i përbashkët “Për rregullat e zbatimit të parimit të rotacionit në caktimin e

avokatëve që do të ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore” dhe udhëzimi i përbashkët për miratimin e kriterëve të përfitimit të pagesave dhe tarifat e shpërblimit të avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore”, janë ende për t’u miratuar në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Avokatisë. Po kështu, për qëllime të përgatitjes së këtij Komentari është marrë parasysh edhe legjislacioni që për qëllime zbatueshmërie ka lidhje të ngushtë me Ligjin e Ndhmës Juridike dhe Ligjin për Tarifat Gjyqësore, si Kodi për Procedurën Civile, Kodi për Procedurën Penale, Ligji për Profesionin e Avokatit, etj. Ashtu si hartimi i çdo Komentari mbi aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse, edhe ky Komentar synon qartësimin e dispozitave ligjore përkatëse, si për njësitë zbatuese të ligjit dhe përfituesve potencialë ose realë të ndihmës juridike, ashtu edhe për çdo palë të interesuar për njohjen dhe zbatimin e këtij legjislacioni, për t’i shërbyer kuptimit dhe, mbi të gjitha, zbatimit më të mirë të legjislacionit përkatës.

Në lidhje me qartësimin e dispozitave ligjore, gjejmë me vend ta përmbledhim si më poshtë:

- » Komentari hedh dritë në synimet e organeve të nismës ligjore përkatëse por, edhe të ligjvënësit për miratimin e Ligjit të Ndhmës Juridike dhe të Ligjit mbi Tarifat Gjyqësore. Kjo do të bëhet me synimin për të lexuar saktë dispozitat përkatëse të ligjit edhe kur nuk ka dispozita të shprehura dhe interpretimi vetëm i dispozitave ligjore bëhet i vështirë. Komentari synon qartësimin e parimeve bazë që drejtojnë leximin, interpretimin dhe zbatimin e Ligjit të Ndhmës Ligjore dhe Ligjit për Tarifat Gjyqësore. Komentari qartëson kufijtë midis ndihmës juridike parësore dhe ndihmës juridike dytësore, duke shpjeguar edhe kufijtë e ndihmës parësore që jepet nga administrata gjyqësore e punonjësit e administratës publike.
- » Komentari qartëson kuptimin mbi strukturat e dhënies së ndihmës juridike të garantuar nga shteti dhe, lidhur me këtë, edhe ndarjen më të qartë të detyrave midis strukturave përkatëse. Puna e klinikave ligjore fokusohet në veçanti në Komentar, bazuar në përvojën e deritanishme me këto klinika nisur nga viti 2000. Në veçanti, Komentari i kushton vëmendje procedurës së aplikimit për përfitimin e ndihmës juridike, por edhe për përjashtimin nga tarifat gjyqësore, duke e konsideruar si një informacion të domosdoshëm për maksimizimin e aksesit të barabartë të individëve me të ardhura të pamjaftueshme.
- » Komentari përfshin dhe dhënien e ndihmës juridike dytësore në çështjet penale, vazhdimësinë e përfaqësimit të tyre, kategoritë e përfituesve të ndihmës juridike së bashku me kriteret e përzgjedhshmërisë,

duke theksuar situatat kur ato janë të zbatueshme, etj. Komentari bën qartësimin e rasteve të konfliktit të interesit, mënyrat e shmages së këtij konflikti kur shërbimi jepet brenda të njëjtës qendër, strukturë, etj. Gjithashtu qartëson ndarjet dhe pikëtakimet e rolit të secilit prej organeve përgjegjëse për zbatimin e këtyre ligjeve, strukturën e tarifave gjyqësore, rastet e përjashtimit nga këto tarifa, dhe mënyrën e përjashtimit nga këto tarifa, të parashikuara në Ligjin e Ndhmës Juridike dhe në Ligjin për Tarifat Gjyqësore, si edhe synon të qartësojë edhe çështje të tjera përkatëse.

- » Për përgatitjen e Komentarit janë shfrytëzuar burimet e mëposhtme: dy ligjet, aktet nënligjore përkatëse dhe dispozita të tjera ligjore të zbatueshme, relacionet shoqëruese të miratimit të ligjeve, një vështrim krahasues midis Ligjit të Ndhmës Juridike 10039/2008 (tashmë të shfuqizuar) dhe Ligjit të Ndhmës Juridike të garantuar nga shteti 111/2017 (tashmë në fuqi), gjetjet e deritanishme mbi zbatimin e këtyre ligjeve të formalizuara në raporte të ndryshme të Komisionit / Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, operatorëve të ndihmës juridike publike apo private, organeve dhe organizatave mbikqyrëse dhe monitoruese, praktika e deritanishme gjyqësore apo administrative e ndihmës juridike, praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me ndihmën ligjore dhe përjashtimet nga tarifat gjyqësore, jurisprudenca e GJEDNJ në lidhje me ndihmën juridike dhe standardet përkatëse, gjetjet nga komunikimi i drejtpërdrejtë me punonjësit e strukturave të ndihmës juridike, si edhe me përfituesit e ndihmës juridike, Dhomën e Avokatisë, përvojat në punën me ndihmën juridike si dhe në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore dhe të raporteve të ndryshme të vlerësimit ligjor apo krahasuese të kryera nga vetë ekspertët përkatës të cilët kanë punuar për hartimin e Komentarit.
- » Duke mbuluar sa më sipër, Komentari synon të jetë një mjet pune në tavolinat e punonjësve të strukturave të ndihmës juridike parësore dhe dytësore dhe në duart e avokatëve të përfshirë në dhënien e ndihmës juridike, të studentëve të Klinikave Ligjore pranë universiteteve, të shërbejë si doktrinë ligjore në dispozicion të gjyqtarëve për krijimin e praktikave gjyqësore të unifikuara, organeve përgjegjëse për zbatimin e këtyre ligjeve, dhe mbi të gjitha, t’ju vijë në ndihmë përfituesve të drejtpërdrejtë nga zbatimi i këtyre dy ligjeve.
- » Duke realizuar sa më sipër, Komentari është një mjet për të përmirësuar aksesin e barabartë të individëve me të ardhura të pamjaftueshme në organet e administratës publike dhe në gjyqësor. Aksesit i barabartë jo vetëm që do të mundësohet formalisht, por do të maksimizohet edhe efektiviteti i këtij aksesit për shkak të zbatimit të Ligjit për Ndhmën Juridike dhe Ligjit për Tarifat Gjyqësore.

» Ai do të shërbejë edhe si manual procedurash për të përfituar ndihmën juridike dhe për të patur akses në organet e administratës publike dhe gjyqësore. Përmirësimi i penetrimit të teknologjisë së infomacionit në popullatën shqiptare të çdo kategorie ka qenë një premisë e rëndësishme për të paramenduar shkallën e përdorimit të Komentarit nga individët me të ardhura të pamjaftueshme.

» Komentari ka pjesë përshkimore për çdo kre të ligjit, koment për çdo nen, si për ato me natyrë procedurale ashtu edhe ato materiale. Duke qenë se Komentari do të jetë edhe elektronik, është synuar që të identifikohen me kujdes ‘fjalët çelës’ për të lundruar në kohë të shkurtër dhe efektive në këtë Komentar elektronik. Po kështu, është synuar që gjuha të jetë një kombinim midis gjuhës profesionale dhe gjuhës së thjeshtë, në mënyrë që të jetë i kuptueshëm për çdo përdorues.

Shprehim kënaqësinë që na u besua hartimi i këtij Komentari dhe njëkohësisht ndiejmë përgjegjësinë e veçantë për të reflektuar sa më qartë procesin e gjatë të vlerësimit të nevojës për formalizim me ligj të veçantë të ndihmës ligjore të garantuar nga shteti që në vitin 2003 deri sot me kompletimin e tij përmes mbështetjes së plotë nga ana e shtetit. Vlerësojmë gjithashtu ndihmesën e pandërprerë dhe përvojën e praktike të Shërbimit Ligjor Falas Tiranë, TLAS, gjatë hartimit të këtij dokumenti të rëndësishëm.

Autorë:

Av. Ardjana Shehi Kalo (autore për nenet 1-17)

Av. Viktor Gumi (autor për nenet 18-36)

VËSHTRIM HISTORIK MBI KUADRIN LIGJOR MBI NDIHMËN JURIDIKE FALAS NË SHQIPËRI

Në legjislacionin shqiptar, për herë të parë, një ligj i posaçëm për ndihmën juridike është miratuar në vitin 2008, specifikisht, Ligji nr.10039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”. Ky ligj ishte rrjedhojë dhe produkt i punës dhe përvojës së pasur gati dhjetë vjeçare të operatorëve joqeveritarë të ndihmës ligjore, por edhe i funksionimit prej disa vitesh i sistemit të mbrojtjes kryesisht në Shqipëri.

Para miratimit në vitin 2008 të ligjit të posaçëm, ofrohej ndihmë ligjore falas në fushën penale për shkak të parashikimit kushtetues dhe të kodit të procedurës penale, pavarësisht problemeve të efektivitetit të mbrojtjes. Operatorët joqeveritarë të ndihmës ligjore që ushtruan aktivitetin para dhe pas vitit 2008, Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS), Klinika e Grave, Klinika e të miturve, etj., u përfshinë në dhënien e ndihmës juridike parësore dhe dytësore duke përdorur forma dhe mënyra të ndryshme të dhënies së ndihmës juridike, përfshirë edhe shërbimet *clinics* për të aftësuar individët në nevojë për të mbrojtur vetë të drejtat e tyre, si dhe shërbimin e këshillimit ligjor online nëpërmjet telefonit. Në këtë mënyrë, këta operatorë dhanë në mënyrë efektive ndihmë ligjore për individët në nevojë, por edhe ndihmuan grupe në nevojë edhe duke identifikuar dhe ndjekur edhe raste strategjike, si për shembull iniciativa e sukseshme disa vjeçare për regjistrimin e qindra lindjeve të fëmijëve romë të parregjistruar. Ishin këta operatorë joqeveritarë të cilët të mbështetur nga donatorë të huaj, si CAFOD UK, OSFA, UNICEF, disa ambasada të huaja në Tiranë, etj., jo vetëm hodhën themelin e shërbimeve cilësore dhe të sektorit të ndihmës juridike në Shqipëri, duke punësuar edhe personel cilësor dhe me përvojë në funksion të ndihmës juridike efektive, por edhe hodhën bazat e hartimit të strategjisë për zhvillimin e ardhshëm të ndihmës juridike në Shqipëri sipas standardeve europiane, mbështetur në legjislacion të posaçëm dhe insitucione të specializuara për ndihmën ligjore.

Ligjii vitit 2008 parashikonte kushtet dhe procedurat për dhënien e ndihmës juridike nga shteti për personat në nevojë për ndihmë juridike në çështjet civile ose administrative, por të cilët nuk kishin mjete të mjaftueshme për të paguar këtë ndihmë juridike. Për zbatimin e këtij ligji ishin miratuar edhe disa akte të Komisionit Shtetëror të Ndihmës Juridike, të cilat jetësonin zbatimin e detajuar të ligjit. Kërkesa për dhënien e ndihmës juridike, në formën e përfaqësimit në gjykatë, për një çështje civile ose administrative, duhet

të paraqitej personalisht nga kërkuesi apo përfaqësuesi i tij, i autorizuar me prokurë. Formulari i kërkesës dhe dokumentet shoqëruese përcaktohen me vendim të Komisionit Shtetëror për Ndhmën Juridike.

Lidhur me zbatimin e këtij ligji, Komisioni Evropian në Progres-Raportin për Shqipërinë për vitin 2012, ka diagnostikuar dhe ka shprehur shqetësim për gjendjen mbi të drejtën për akses në gjykatë, duke theksuar: *“Pak përparim është bërë në lidhje me aksesin në drejtësi. Zbatimi i ligjit “Për ndihmën juridike falas” ka qenë i ngadaltë për shkak të buxhetit të pamjaftueshëm dhe mungesës së koordinimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse. Gjithashtu, nuk zbatohen me efektivitet as aktet nënligjore për rekrutimin e avokatëve të ndihmës juridike falas dhe as procedurat për kërkimin e ndihmës juridike falas. Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike ka trajtuar disa çështje, por ndërgjegjësimi për ligjin dhe shërbimet e Komisionit mbeten të pamjaftueshme, përfshi edhe rangun e nëpunësve shtetërorë që merren me kategoritë e cënueshme. Aksesin në drejtësi për kategoritë e cënueshme nuk është i garantuar, kryesisht për shkak të tarifave të larta të administrimit gjyqësor”.*

Këto lloj konstatimesh kanë vazhduar me të njëjtin ritëm edhe me Progres-Raportet e viteve në vazhdim. Edhe Analiza e Sistemit të Drejtësisë e miratuar nga Komisioni i Posaçëm “Për reformën në Sistemin e Drejtësisë” me vendimin nr.14 datë 30.7.2015, evidentoi një sërë problematikash sa i takon ofrimit të ndihmës juridike në Shqipëri, të cilat përmbledhen si vijon: *“Konfuzion në aplikimin e “ndihmës juridike në fushën penale” lidhur me përgjegjësitë e Komisionit Shtetëror të Ndhmës Juridike dhe Prokurorisë dhe gjykatave në financimin e kësaj skeme; për individët në nevojë nuk parashikohet siguri dhe ofrimi falas i “ekspertimeve”, ekspertizave, përkthimeve, përmes koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional me struktura që i kanë kapacitetet apo laboratorët përkatës; është konstatuar mungesë transparence e Komisionit Shtetëror për Ndhmën Juridike lidhur me financimin e rasteve të ndihmës juridike; mangësi në legjislacion për sa i përket shmangies së pengimit të aksesit në gjykata (në drejtësi) të personave që janë në vështirësi ekonomike të cilët nuk përballojnë dot shpenzimet gjyqësore, veçanërisht “shpenzimet për ekspert” apo “psikolog” (në çështjet familjare); mungesë veprimi efektiv i gjykatave për të vetëmenaxhuar fondet me përgjegjësinë e “institucionit të pavarur”. Gjithashtu, ky sistem ka rezultuar të jetë tepër problematik për shkak të përzgjedhjes pa kriter të avokatëve nga lista në çështje të caktuara nga ana e gjyqtarëve apo prokurorëve.*

Ligji nr.10039/2008 u shfuqizua, sepse mekanizmat shtetërorë për përjashtimin ose lehtësimin për ndihmën

juridike falas, ishin të pamjaftueshme dhe në praktikë ai nuk po funksiononte siç duhej. Në këto kushte, u ndje e nevojshme hartimi i një ligji të ri mbi ndihmën juridike i cili, në thelb, krijon siguri ligjore për mbështetjen financiare të plotë nga shteti të çdo nevojë juridike nga shtresat në nevojë dhe grupe të caktuara individësh, por edhe siguron që ndihma juridike dytësore të jepet vetëm nga avokatë të licencuar për të ushtruar profesionin në Shqipëri.

Sipas Raportit Vjetor të Avokatit të Popullit 1 janar-31 dhjetor 2017, për shkak të problemeve në zbatimin e këtij ligji dhe disa mangësive në legjislacion për sa i përket shmangies së pengimit të aksesit në gjykata (në drejtësi) të personave që janë në vështirësi ekonomike të cilët nuk përballojnë dot shpenzimet gjyqësore, si dhe me qëllim garantimin e një aksesit të shpejtë, të drejtë dhe të rregullt në drejtësi, gjatë vitit 2017, nisi procesi i hartimit të një ligji në përputhje me standardet europiane në këtë fushë. Gjatë këtij procesi, institucioni i Avokatit të Popullit dhe mendime konkrete për përmirësimin e tij, të cilat gjetën pasqyrim në dispozitat ligjore të Ligjit nr.111/2017 “Për Ndhmën Juridike të Garantuar nga Shteti”, të miratuar më datë 14.12.2017 nga Kuvendi i Shqipërisë¹.

¹ Botuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë nr.241 datë 31.12.2017.

VËSHTRIM HISTORIK MBI LEGJISLACIONIN PËR TARIFAT GJYQËSORE

Krahas Ligjit 111/2017 në datën 1 qershor 2018 hyri në fuqi edhe Ligji nr.98/2017 “Për Tarifën Gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”¹. Ky ligj i posaçëm në lidhje me tarifën gjyqësore, plotëson dispozitat në Ligjin nr.9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, neni 11 ‘Tarifën e shërbimit’ ku në pikën ‘c’ parashikohet “tarifa për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, prokurorisë dhe noterisë”. Para hyrjes në fuqi të Ligjit të nr.98/2017 “Për tarifën gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”, në zbatim të nenit 11, pika ‘c’ të sipërcituar ka dalë Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave nr.33, datë 29.12.2014 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të Administratës Gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë dhe Noterisë”, i cili rregullonte tarifën gjyqësore.

Ligji 98/2017 “Për Tarifën Gjyqësore në RSH” ka si qëllim përcaktimin e tarifave për çështjet gjyqësore dhe shërbimet që ofrohen nga sistemi gjyqësor dhe ka si prioritet rritjen e efikasitetit të sistemit gjyqësor, përmirësimin e shërbimit dhe të financimit të sistemit gjyqësor.

Ky ligj është pjesë e një pakete ligjore që synon përmirësimin e aksesit në gjykatë për çështje të bazuara në ligj, uljen e mbingarkesës së gjykatave, si dhe ofrimin e një shërbimi më të mirë për përdoruesit e gjykatës. Gjithashtu, një efekt i pritshëm nga zbatimi i këtij ligji është edhe rritja e të ardhurave nga shërbimet ofruara nga gjykata, si dhe promovimi i zgjidhjes së konflikteve gjyqësore nëpërmjet formave alternative, si ndërmjetësimi apo arbitrazhi.

Duke qenë se sistemi i tarifave gjyqësore aktuale nuk reflekton shpenzimet për funksionimin e sistemit të gjykatave dhe taksapaguesit ngarkohen me barrën e mbajtjes së këtij shërbimi, ky ligj ka për synim zbutje, për sa të jetë e mundur, të kësaj barre, fillimisht, te palët ndërgjyqëse të cilët iniciojnë procesin gjyqësor. Në të njëjtën kohë, me qëllimin që t’i jepet vëmendje individëve të cilët kërkojnë drejtësi, por që nuk mund të përballojnë tarifën gjyqësore të larta, kategori të caktuara gjyqësore ose shërbimi janë të përjashtuara nga tarifën gjyqësore ose kanë vlerë të pranueshme.

Si një përjashtim nga parimi i përgjithshëm, neni 9² i Ligjit për Tarifën Gjyqësore i referohet dhënies së ndihmës juridike, meqënëse rritja e parashikuar e tarifave gjyqësore duhet të shoqërohet me një masë ligjore lehtësuese e cila siguron që individët me probleme sociale nuk përjashtohen nga aksesit në drejtësi. Po kështu, edhe institucionet e financuara nga buxheti i shtetit me funksione administrative, si dhe prokuroria dhe gjykatat, përjashtohen nga detyrimi për të paguar tarifë gjyqësore, përveç rasteve kur humbasin çështjen gjyqësore dhe ligji procedural parashikon detyrimin e tyre për të paguar shpenzimet e palës tjetër, pasi aktiviteti i këtyre institucioneve është i lidhur ngushtë me institucionet gjyqësore dhe pagesa e tarifave gjyqësore do të sillte një mbingarkesë të panevojshme për buxhetin e shtetit dhe burokraci të panevojshme³.

¹ Botuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë nr.225 datë 22.12.2017.

² Neni 9: “Përjashtime nga pagesa e tarifës gjyqësore. 1. Palët ndërgjyqëse mund të përjashtohen nga detyrimi për të paguar tarifë gjyqësore ose shpenzimet e tjera gjyqësore kur është bërë kërkesë prej tyre, sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për ndihmën juridike. 2. Çdo organ publik buxhetor që kryen funksione administrative, gjykatat ose prokuroria, përjashtohen nga detyrimi për të paguar tarifë gjyqësore, përveç rasteve kur humbasin çështjen gjyqësore dhe ligji procedural parashikon detyrimin e tyre për të paguar shpenzimet e palës tjetër. 3. Rregulli i parashikuar në pikën 2 të këtij neni, nuk zbatohet për Avokaturën e Shtetit, e cila përjashtohet edhe nga pagesa e shpenzimeve gjyqësore”.

³ Relacioni i projektligjit “Për Tarifën Gjyqësore”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

LIGJ
nr. 111/2017 “PËR NDIHMËN JURIDIKE TË
GARANTUAR NGA SHTETI”

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Në Kreun e I-rë të Ligjit nr.111/2017, parashikohen dispozitat e përgjithshme, ku përcaktohen objekti i ligjit, përkufizimi i termave, si dhe parimet themelore për dhënien e ndihmës juridike, siç janë: aksesit efektiv dhe i barabartë në gjykatë, mosdiskriminimi i individëve, profesionalizmi i personave që japin ndihmën juridike, efektiviteti i shërbimit të ndihmës juridike, ruajtja e konfidencialitetit dhe mbrojtja e të dhënave personale, dhe shmangia e konfliktit të interesit.

Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj përcakton format, kushtet, procedurën dhe rregullat për organizimin dhe administrimin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, me qëllim mbrojtjen e të drejtave themelore të individit dhe të interesave të ligjshëm të tij.

Në përmbajtjen e Ligjit nr. 111/2017 fokusohen format, kushtet, procedurat dhe rregullat për organizimin dhe administrimin e ndihmës juridike, në funksion të mbrojtjes jo vetëm të të drejtave themelore të individit dhe të interesave të ligjshme të tij që burojnë nga Kushtetuta e Shqipërisë, Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut¹ dhe jurisprudenca e GJEDNJ, akte të tjera ndërkombëtare² të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, kodet e procedurave, ligjet, etj., por, edhe në interes të drejtësisë.

Nevoja për një ligj me këtë objekt është rrjedhojë edhe e kërkesave përkatëse kushtetuese dhe ligjore për investimin e shtetit për një sistem efektiv të ndihmës juridike, të përcaktuara këto edhe në vendime të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë: “Detyrimi për të

garantuar të drejtën efektive të aksesit në gjykatë nuk nënkupton thjesht mungesën e një ndërhyrjeje, por mund të kërkojë edhe ndërmarrjen e veprimeve pozitive nga ana e shtetit. Në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet jo i rregullt, sepse aksesit në gjykatë është para së gjithash një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t’iu drejtuar gjykatës.”³

E drejta për ndihmë juridike të garantuar nga shteti është parashikuar shprehimisht në shumë akte në fuqi në Republikën e Shqipërisë të cilat kanë paraqitur detyrimin ndaj shtetit shqiptar për të miratuar Ligjin nr. 111/2017 me objektin përkatës të përcaktuar në nenin 1 të tij. Kështu, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 31 dhe nenin 15, pika 2, parashikon respektivisht: “Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë: ... c) të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën shqipe; ç) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij; të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t’i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme; ...” dhe “Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre”. Po kështu, Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.7 datë 27.02.2013 parashikon: “Mohimi i të drejtës për t’iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor”.

Me tej, Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) në nenin 6 të saj që ka të bëjë me “Të drejtën për një proces të rregullt ligjor”, në pikën 3, parashikon: “3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme: ...c. të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t’i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë; e. të ndihmohet falas nga një përkthyes në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq”. Bazuar në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ),

¹ Konventa për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (‘KED-NJ’) ratifikuar me Ligjin nr.8137 datë 31.7.1996, shtuar me Ligjin nr.8641, datë 13.7.2000 (protokoll shtesë), me Ligjin nr.9264, datë 29.7.2004 (protokoll shtesë), ndryshuar me Ligjin nr.9453, datë 15.12.2005 (protokoll shtesë).

² LEGAL AID IN EUROPE: Minimum requirements under international law - Open Society, Justice Initiative.

³ Vendime të Gjykatës Kushtetuese nr. 84 datë 30.12.2016, nr. 67 datë 17.11.2015, nr. 65 datë 16.10.2017.

në çështjen Savitsky kunder Ukrainës, vendoset një standard të ri: GJEDNJ mund të detyrojë shtetin kur është e nevojshme të ofrojë ndihme juridike falas. I njëjti standard parashikohet edhe në çështjen *Airey kunder Irlandës*.

PAKTI NDËRKOMBËTAR PËR TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE⁴, neni 14, pika 3, parashikon: “3. *Secili person i akuzuar për një vepër penale ka të drejtë plotësisht të barabartë të ketë këto garanci minimale: ... (ç) Të jetë i pranishëm gjatë procesit dhe të mbrohet vetë ose nëpërmjet një mbrojtësi të zgjedhur prej tij; në qoftë se nuk ka mbrojtje, duhet të informohet për të drejtën e tij që të ketë një të tillë dhe, kurdoherë që e kërkon interesi i drejtësisë, atij duhet t’i caktohet një mbrojtje falas në cilindo rast të tillë nëse ai nuk ka mjete për të paguar;...*”

Kodi i Procedurës Penale, në nenin 1 dhe në nenin 6, parashikon: “Neni 6 Sigurimi i mbrojtjes. 1. *I pandehuri ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën e mbrojtësit. Kur nuk ka mjete të mjaftueshme i sigurohet mbrojtja falas me avokat në rastet e parashikuara nga ky Kod. 2. Mbrojtësi ndihmon të pandehurin që t’i garantohen të drejtat procedurale dhe t’i ruhen interesat e tij ligjore*”. Kodi i Procedurës Civile, neni 23, parashikon: “*Palët janë të lira të ndërtojnë mbrojtjen e interesave të tyre në gjykim, nëpërmjet përfaqësimit ose të çdo ndihme tjetër juridike, në përputhje me dispozitat në fuqi*”.

Bazuar në kërkesat e mësipërme të parashikuara nga legjislacioni shqiptar në lidhje me ndihmën juridike, nga data 1 qershor 2018, ka hyrë në fuqi Ligji nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”. Ky ligj sanksionon procedurat për përfitimin e ndihmës juridike falas dhe të garantuar nga shteti, në formën e ndihmës juridike parësore (dhënia e informacioneve dhe këshillimit ligjor), ose të ndihmës juridike dytësore (dhënia e ndihmës juridike dhe ofrimi i mbrojtjes para gjykatës). Ky ligj, gjithashtu, ka parashikuar krijimin e një strukture të posaçme brenda Ministrisë së Drejtësisë, që është Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, strukturë e cila administron, koordinon dhe identifikon nevojat për ndryshime dhe përmirësime në sistemin e ofrimit të ndihmës juridike falas⁵.

Në kushtet që objekti i ligjit është përcaktuar me qëllim mbrojtjen e interesave themelore dhe ligjore të individëve dhe interesit të drejtësisë, vlen të përmendet se GJEDNJ ka pasuruar me vendimet e saj kuptimin dhe interpretimin e ‘interesit të drejtësisë’, dhe për qëllime të zbatimit të Ligjit të Ndhmës Juridike është e rëndësishme që ligji të zbatohet në lidhje dhe

në përputhje me këtë jurisprudencë. Pa kaluar në shumë hollësi, këtu përmendim se interesi i drejtësisë përmendet dhe në çështjen Krylov kundër Rusisë, në të cilën GJEDNJ citon “... për qëllime të procesit të rregullt, interesi i drejtësisë do t’i nënshtrohet një testi i cili konsiston nëtre pika: 1-kompetencat e gjykatave; 2-serioziteti i akuzave; dhe 3-ashpërsia e dënimit...”

Organizimi dhe administrimi i ndihmës juridike të garantuar nga shteti është në objektin e Ligjit nr.111/2017, ndërkohë që deri tani “shumica dërmuese e çështjeve të ndihmës juridike që përfshijnë grupe të cënueshme ende trajtohen nga grupe të shoqërisë civile me mbështetje të donatorëve”⁶ dhe “Pavarësisht të drejtës ligjore për ndihmë ligjore falas në çështje civile, organizatat jofitimprurese raportuan se shumë pak individë përfituan prej saj gjatë vitit”⁷.

Për qëllime të analizës së objektit të Ligjit nr. 111/2017, referuar në përkufizimin e “Ndhmës juridike dytësore” është e rëndësishme të mbahet në vëmendje se ky ligj mbulon shërbimin juridik që ofrohet në çështjet penale, për të cilat zbatohet mbrojtja e detyrueshme, sipas përcaktimeve të legjislacionit procedural penal. “Mbrojtja kryesisht” duhet të shihet si aspekt i ndihmës juridike, veçanërisht, në fushën e organizimit, kushteve që duhet të plotësojë mbrojtësi, specializimet, etj.

Neni 2 Qëllimi i ligjit

Ky ligj ka si qëllim:

a) të krijojë një sistem për organizimin dhe ofrimin e ndihmës juridike falas për të siguruar akses të barabartë të të gjithë individëve në sistemin e drejtësisë;

b) të sigurojë mirorganizimin, miradministrimin dhe mirëfunksionimin e institucioneve shtetërore përgjegjëse për administrimin e ndihmës juridike;

⁶ Progres-Raporti i vitit 2019 i Komisionit Evropian (faqja 30): “Zbatimi efektiv i sistemit të ndihmës juridike falas dhe promovimi i vetëdijes ligjore dhe fuqizimi do të jetë thelbësore për të siguruar qasjen e grave në drejtësi. Për të drejtat procedurale, Ligji i ri për Ndhmën Juridike zgjeron kategorinë e personave që përfitojnë ndihmë juridike dhe prezanton konceptet e ndihmës juridike parësore dhe dytësore. Të drejtat e viktimave u forcuan përmes ndryshimeve në Kodin e Procedurës Penale në maj 2017. Sidoqoftë, skema e ndihmës juridike ende ka nevojë për të zhvilluar një mekanizëm shtrirjeje dhe të promovojë qasjen në shërbimet e tij. Një drejtori për ndihmë juridike falas brenda Ministrisë së Drejtësisë ishte dashur të themelohej deri në fund të tetorit 2018 por kjo nuk është materializuar. Vazhdojnë të raportojnë për pengesa në qasjen në drejtësi dhe mungesë të qasjes në ndihmë juridike për grupet e cënueshme, përfshirë romët, egjiptianët, personat me aftësi të kufizuara dhe personat me vështirësi ekonomike. Shumica dërmuese e çështjeve që përfshijnë grupe të cënueshme ende trajtohen nga grupe të shoqërisë civile me mbështetje të donatorëve”.

⁷ Shqipëria 2018, Raporti i vitit 2019 i Departamentit Amerikan të Shtetit për të drejtat e njeriut.

⁴ Republika e Shqipërisë ka aderuar në këtë Akt Ndërkombëtar me Ligjin nr.7510, date 8.08.1991, Fletore Zyrtare nr.6/29.08.1991.

⁵ Raporti i Avokatit të Popullit, viti 2018

c) të sigurojë ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike në mënyrë profesionale, cilësore, eficiente dhe efektive.

Ndihma juridike është një nga objektivat strategjike të reformës në drejtësi 2017-2020 të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.773 datë 2.11.2016 “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të drejtësisë 2017-2020 dhe të planit të saj të veprimit”, konkretisht, i objektivit specifik të strategjisë nr.3 në lidhje me reformën në drejtësi “Përmirësimi i funksionimit të sistemit gjyqësor duke forcuar efikasitetin, transparencën dhe qasjen në pajtim me standardet evropiane”. Në lidhje me këtë objektiv, është synuar që në afatgjatë të arrihet krijimi i një sistemi të drejtë dhe funksional të ndihmës juridike për individët dhe grupet në nevojë dhe krijimi i një sistemi të arsyeshëm dhe proporcional të tarifave gjyqësore për të siguruar financimin e shërbimeve të drejtësisë, si dhe garantimin e aksesin në gjykatë. Sipas Planit të Veprimit përkatës është parashikuar miratimi i akteve nënligjore në zbatim të Ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” dhe fillimi i zbatimit të këtij legjislacioni.

Ligji nr. 111/2017 synon veçanërisht të garantojë një akses të shpejtë, të drejtë dhe të rregullt në drejtësi për të përmbushur kriterin e Kopenhagen për të garantuar shtetin ligjor dhe të drejtat e njeriut në Republikën e Shqipërisë. Ligji është pjesë e një pakete ligjore që synon përmirësimin e aksesit në drejtësi, dhe në gjykata në veçanti. Qëllimi kryesor i Ligjit është që kategoritë në nevojë dhe që janë më të diskriminuara të përfitojnë nga shërbimet falas të ndihmës juridike të ofruara nga shteti. Gjithashtu, një qëllim tjetër shumë i rëndësishëm i këtij ligji është që nëpërmjet mënyrës së organizimit dhe ofrimit të shërbimit, është që ky shërbim të jetë sa më profesional dhe i specializuar në bazë të fushës në të cilët ofrohet dhe shumë e rëndësishme është që edhe të eliminohen lidhjet dhe rastet e mos transparencës midis avokatëve dhe gjyqtarëve/prokurorëve gjatë caktimit të avokatëve të ndihmës juridike nga këta të fundit. Këtë problem ky ligj e zgjidh nëpërmjet zgjedhjes së drejtëpërdrejtë të avokatit në listë nga vetë përfituesi i ndihmës juridike falas⁸.

Më tej, bazuar në sa më sipër, Ligji nr. 111/2017 ka si qëllim zbatimin efektiv dhe të barabartë të legjislacionit për ndihmën juridike në Shqipëri, duke respektuar parimet e dhënies së ndihmës juridike falas të parashikuar në këtë ligj dhe në aktet tjera ligjore e nënligjore, përfshirë por pa u kufizuar edhe në KEDNJ dhe jurisprudencën e GJEDNJ. Për të realizuar këtë qëllim madhor, ligji përmban dispozita në lidhje me organizimin dhe administrimin e ndihmës juridike, duke parashikuar institucionet përgjegjëse dhe operatorët

përkatës, detyrat, funksionet dhe përgjegjësitë e tyre, etj. Po kështu, Ligji nr.111/2017 ka si qëllim të mundësojë ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike në mënyrë profesionale, cilësore, eficiente dhe efektive, e cila krahas mbrojtjes efektive të të drejtave themelore kushtetuese dhe ligjore, siguron dhe eficientë të të gjitha burimeve në dispozicion për të maksimizuar aksesin në ndihmë juridike të sa më shumë individëve të cilët plotësojnë kriteret e përzgjedhshmërisë përkatëse. Në kuadër të organizimit dhe mirëadministrimit të ndihmës juridike, duhet kuptuar që Ligji nr. 111/2017 ka për qëllim edhe mbrojtjen dhe garantimin e ushtrimit të profesionit të avokatit të ndihmës juridike falas në Republikën e Shqipërisë.

Ligji nr. 111/2017 është përcaktuar me qëllimin e mësipërm edhe bazuar në dispozitat përkatëse të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, i cili në nenin 2 parashikon: “Çdo shtet palë i këtij Pakti zotohet: (a) Të sigurojë që çdo person, kur t’i shkelen të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Pakt, të ketë të drejtën e një mjeti juridik efektiv, edhe atëherë kur shkeljen e kryejnë personat me rastin e ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare; (b) Të sigurojë që autoriteti kompetent gjyqësor, administrativ ose legjislativ, ose çdo autoritet tjetër që është kompetent në bazë të legjislacionit të shtetit, do t’i përcaktojë të drejtat e këtij personi që paraqet mjetin juridik si dhe të zhvillojë mundësitë e paraqitjes së mjetit juridik; (c) Të sigurojë që autoritetet kompetente do të veprojnë sipas çdo mjeti juridik që do të njihet si i përligjur”.

Ligji nr. 111/2017 ka qëllimin sipas nenit 2 edhe bazuar në orientimet që jep legjislacioni përkatës i BE. Neni 3 i Direktivës 2002/8/EC datë 27.01.2003, parashikon pothuaj të njëjtën qasje si neni 2 i Ligjit 111/2017: “E drejta për ndihmë juridike. Personat fizikë të përfshirë në një mosmarrëveshje të mbuluar nga kjo Direktivë ka të drejtë të marrë ndihmë juridike të përshtatshme në mënyrë që të sigurohet qasja e tyre efektive në drejtësi në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë Direktivë”. Me tej, Direktiva 2016/1919 datë 26.10.2016, në nenin 7 ‘Cilësia e shërbimeve dhe trajnimeve të ndihmës juridike’, parashikon: “1. Shtetet Anëtare marrin masat e nevojshme, përfshirë përsa i përket financimit, për të siguruar që: (a) ekziston një sistem efektiv i ndihmës juridike që është i një cilësie të përshtatshme; dhe (b) shërbimet e ndihmës juridike janë të një cilësie të përshtatshme për të mbrojtur ndershmërinë e procedurave, me respektimin e duhur të pavarësisë të profesionit juridik”.

Objekti i Ligjit nr. 111/2017 i përcaktuar në nenin 2 të tij, duhet lexuar edhe me aktet nënligjore të dala në bazë dhe në përputhje me përmbajtjen e këtij neni. Kështu, deri në

⁸ Sipas relacionitshoqëruestëLigjit 111/2017

datën e daljes së këtij Komentari, në zbatim të pikës ‘b’ dhe ‘c’ të nenit 2 të Ligjit 111/2017, kanë dalë dhe akte të tjera nënligjore të cilat mundësojnë mirëadministrimin, mirëfunksionimin, etj., të institucioneve përgjegjëse, por edhe ofrimin e ndihmës juridike me efektivitet, efikasitet, cilësi e profesionalizëm: (i) Vendim nr.55 datë 6.2.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionin për autorizimin e organizatave jofitimprurëse, që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti”; (ii) Vendimi nr.110, datë 06.03.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”; (iii) Urdhri i Kryeministrit nr.59 datë 25.03.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas”; dhe aktet e tjera përkatëse.

Neni 3 Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Ndihmë juridike” është shërbimi juridik falas dhe shërbimet e tjera të parashikuara në këtë ligj, për personat që përmbushin kriteret e këtij ligji, të cilat garantohen dhe financohen nga shteti.

b) “Ndihmë juridike parësore” është:

i) dhënia e informacioneve në lidhje me sistemin ligjor të Republikës së Shqipërisë, aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor;

ii) dhënia e këshillimit;

iii) dhënia e këshillimit mbi procedurat e ndërmjetësimit dhe zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve;

iv) dhënia e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore;

v) përfaqësimi përpara organeve administrative; dhe

vi) dhënia e të gjitha formave të tjera të mbështetjes së nevojshme juridike që nuk përbëjnë ndihmë juridike dytësore.

c) “Ndihmë juridike dytësore” është shërbimi juridik që ofrohet për përpilimin e akteve të nevojshme për të vënë në lëvizje gjykatën; ofrimi i këshillimit, përfaqësimit dhe

mbrojtjes para gjykatës në çështjet administrative, civile dhe në çështjet penale, për të cilat nuk zbatohet mbrojtja e detyrueshme, sipas përcaktimeve të legjislacionit procedural penal.

ç) “Këshillim” është dhënia e informacionit mbi mënyrat dhe mundësitë e zgjidhjes së një çështjeje konkrete juridike.

d) “Qendër shërbimi e ndihmës juridike parësore” është një njësi e specializuar për dhënien e ndihmës juridike parësore, e organizuar si “njësi e drejtpërdrejtë e ofrimit të shërbimeve”, sipas legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

dh) “Punonjës me trajnim të posaçëm” është punonjësi, i diplomuar nga një program i ciklit të dytë të studimeve në drejtësi, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë dhe që i është nënshtruar një trajnimit të posaçëm, i cili ofron ndihmë juridike parësore në qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore.

e) “Trajnim i posaçëm” është programi i trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm, i miratuar nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, për punonjësit që ofrojnë ndihmë juridike parësore në qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore.

ë) “Klinikë ligjore” është njësi përbërëse e një institucioni të arsimit të lartë, e organizuar dhe që funksionon sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë dhe që ofron ndihmë juridike parësore pa qëllim fitimi, sipas përcaktimeve në statutin e institucionit të arsimit të lartë.

f) “Të ardhura”, në kuptim të këtij ligji, janë të ardhurat mujore që sigurohen nga pagat, veprimtaria ekonomike, interesat e depozitave bankare, të ardhurat nga pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme. Në këto të ardhura nuk përfshihet ndihma ekonomike, pensioni social, pagesat e papunësisë, përfitimet e invalidëve, sipas statusit të invalidit të punës ose të luftës, pagesat që marrin pjesëtarët e familjes që kujdesen për personin me aftësi të kufizuara, rimbursimi i shpenzimeve për energji, rimbursimet për ilaçe e mjekime për të sëmurët kronikë dhe paketa higjieno-shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara.

g) “Familje”, në kuptim të këtij ligji, është një grup individësh, që lidhen në marrëdhënie bashkëshortore ose bashkëjetese, si dhe marrëdhëniet prindër-fëmijë, marrëdhëniet ndërmjet anëtarëve të familjes dhe ato të kujdestarisë, që jetojnë në të njëjtën shtëpi dhe që kontribuojnë bashkërisht, financiarisht ose në mënyra

të tjera për përballimin e kostos së jetesës.

gj) “Pasuri”, në kuptim të këtij ligji, është pasuria e çdo lloji, e luajtshme ose e paluajtshme, si dhe të drejtat reale pasurore. Pasuria e paluajtshme e përdorur nga pronari ose bashkëpronari si banesë e tij parësore për jetesën familjare dhe sendet e përjashtuara nga sekuestrimi, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile, nuk konsiderohen pasuri, sipas kuptimit të këtij ligji.

h) “Përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore” është një formë e ndihmës juridike falas për përjashtimin nga pagesa e tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore, me vendim të gjykatës kompetente, nëse plotësohen kriteret e vendosura nga ky ligj.

i) “Tarifa gjyqësore” është tarifa, sipas kuptimit të dhënë nga legjislacioni në fuqi për tarifat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë.

j) “Shpenzimet gjyqësore” janë shpenzimet e kryera në kuadër të procesit gjyqësor, të nevojshme për gjykimin, sipas kuptimit të dhënë në legjislacionin procedural, përveç tarifës gjyqësore.

k) “Tarifa për vënien në ekzekutim të urdhrat të ekzekutimit” është tarifa që i parapaguhet shërbimit përmbartimor gjyqësor shtetëror, për vënien në ekzekutim të një titulli ekzekutiv, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Neni 3 ‘Përkufizime’ i Ligjit nr. 111/2017 parashikon përkufizimet bazë për qëllime të leximit, kuptimit dhe zbatimit të këtij ligji. Në këtë seksion do të bëjmë disa shpjegime të disa prej përkufizimeve, ndërkohë që shpjegimi i përkufizimeve të tjera do të bëhet në seksione të tjera të këtij Komentari, së bashku me komentet për nenet e tjera përkatëse.

Përkufizimi bazë i këtij ligji është përkufizimi i termit ‘ndihmë juridike’. Sipas gërmës ‘a’ të këtij neni “Ndhmë juridike është shërbimi juridik falas dhe shërbimet e tjera të parashikuara në këtë ligj, për personat që përmbushin kriteret e këtij ligji, të cilat garantojnë dhe financohen nga shteti”. Bazuar në këtë përkufizim dhe në përkufizimet e tjera përkatëse, ndihma juridike duhet kuptuar si tërësia e shërbimeve që jepen në kuadrin e ndihmës juridike parësore dhe ndihmës juridike dytësore të përkufizuara shprehimisht në nenin 3 të Ligjit nr. 111/2017. Por, për të qartësuar shumëllojshmërinë e shërbimeve të ndihmës juridike parësore dhe dytësore, referohemi edhe në nenin 4 ‘Shërbimi i avokatisë’ i Ligjit nr. 55/2018 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”: “Avokati ushtron veprimtarinë e tij nëpërmjet: a) këshillimit ligjor të personave fizikë

dhe juridikë; b) përfaqësimit në procesin penal, civil, administrativ, ose të ndonjë natyre tjetër që mund të mos përfshihet në këto tri kategori, në çdo shkallë të gjyqësorit, brenda ose jashtë vendit, pranë gjykatave ndërkombëtare ose çdo organizmi tjetër, pranë të cilit Republika e Shqipërisë ka aderuar, si dhe përfaqësimit në procedurat e ndërmjetësimit ose të arbitrazhit; c) hartimit të akteve juridike dhe çdo akti tjetër, sipas kërkesave të personave fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë; ç) veprimeve të tjera të parashikuara në legjislacionin shqiptar ose në legjislacionin e huaj, kur veprimtaria kryhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.”

Pa kundërshtuar komentet përkatëse në pjesë të tjera të këtij Komentari, në lidhje me përkufizimet e mëposhtme: “c) “Qendër shërbimi e ndihmës juridike parësore” është një njësi e specializuar për dhënien e ndihmës juridike parësore, e organizuar si “njësi e drejtpërdrejtë e ofrimit të shërbimeve”, sipas legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore. dh) “Punonjës me trajnim të posaçëm” është punonjësi, i diplomuar nga një program i ciklit të dytë të studimeve në drejtësi, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë dhe që i është nënshtruar një trajnimit të posaçëm, i cili ofron ndihmë juridike parësore në qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore. e) “Trajnim i posaçëm” është programi i trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm, i miratuar nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, për punonjësit që ofrojnë ndihmë juridike parësore në qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore”, këto tre përkufizime duhen lexuar në lidhje me njëra-tjetrën pasi plotësojnë elemente të këtyre përkufizimeve përkatëse, si dhe në lidhje me detyrat e përgjegjësitë e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas të parashikuara në nenin 8 të këtij ligji. Kështu, punonjësit me trajnim të veçantë nga programi i trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm të zhvilluar dhe miratuar nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas dhe me ofrues trajnimit Qendrën e Trajnimit të Administratës Publike përgatiten dhe ofrojnë vetëm shërbime të ndihmës juridike parësore në qendrat shtetërore të shërbimit të ndihmës juridike falas.

Gjatë leximit të Ligjit nr. 111/2017, duhet bërë kujdes për të dalluar që përkufizimi ‘të ardhurat’ është një përkufizim vetëm për qëllime të këtij ligji dhe i ndryshëm nga përkufizimi ‘të ardhurat personale’ i parashikuar nga Ligji nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

“Familje”, në kuptim të Ligjit 111/2017 është një grup individësh, që lidhen në marrëdhënie bashkëshortore ose bashkëjetese, si dhe marrëdhëniet prindër-fëmijë, marrëdhëniet ndërmjet anëtarëve të familjes dhe ato

të kujdestarisë, që jetojnë në të njëjtën strehë dhe që kontribuojnë bashkërisht, financiarisht ose në mënyra të tjera për përballimin e kostos së jetesës. Për qëllime të zgjidhjes së skenarëve të shumëllojshëm praktikë në lidhje me identifikimin e njësive ‘familje’, gjatë zbatimit të Ligjit nr. 111/2017, referencë mund të bëhet edhe në dispozita të caktuara të Kodit të Familjes, dispozita të tjera të legjislacionit shqiptar apo edhe të akteve ndërkombëtare përkatëse të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

“Pasuri”, në kuptim të Ligjit nr.111/2017, është pasuria e çdo lloji, e luajtshme ose e paluajtshme, si dhe të drejtat reale pasurore. Pasuria e paluajtshme e përdorur nga pronari ose bashkëpronari si banesë e tij parësore për jetesën familjare dhe sendet e përjashtuara nga sekuestrimi, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile, nuk konsiderohen pasuri për qëllime të Ligjit nr. 111/2017. Në kushtet që termat dhe konceptet në lidhje me pasuritë e paluajtshme janë më të qarta në legjislacionin shqiptar dhe gjatë zbatimit praktik të tij, për qëllime të zbatimit të Ligjit nr. 111/2017 është e rëndësishme që për efekte të kriterëve të përzgjedhshmërisë së përfituesve të ndihmës juridike kur ata nuk i përkasin kategorive të veçanta, të mbahen parasysh përkufizimi i pasurisë së luajtshme i Kodit Civil, por edhe hollësi të tjera përkatëse që qartësojnë konceptin e pasurive të luajtshme në dispozita të tjera të legjislacionit shqiptar.

Pa kundërshtuar komentet përkatëse në pjesë të tjera të këtij Komentari, në lidhje me përkufizimet e mëposhtme të parashikuara nga gërmat ‘i’, ‘j’ dhe ‘h’ të nenit 3 të Ligjit nr. 111/2017, këto tre përkufizime duhen lexuar në lidhje me njëra-tjetrën pasi plotësojnë elemente të këtyre përkufizimeve përkatëse.

Sipas gërmës ‘i’ të nenit 3 të Ligjit nr. 111/2017, “Tarifa gjyqësore” është përkufizuar si “tarifa, sipas kuptimit të dhënë nga legjislacioni në fuqi për tarifat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”. Ligji nr.98/2017 “Për tarifat gjyqësore në RSH” ka këtë përkufizim për ‘tarifat gjyqësore’: “Tarifat gjyqësore, sipas këtij ligji, janë: a) tarifa gjyqësore të përgjithshme, për paraqitjen e çështjeve në gjykata; b) tarifa gjyqësore të veçanta, për kryerjen e veprimeve procedurale në gjykata dhe shërbimet e administratës gjyqësore; dhe c) tarifa gjyqësore shitesë, në funksion të administrimit korrekt të procesit gjyqësor.”

“Shpenzimet gjyqësore” janë shpenzimet e kryera në kuadër të procesit gjyqësor, të nevojshme për gjykimin, sipas kuptimit të dhënë në legjislacionin procedural, përveç tarifës gjyqësore.

Ligji nr. 111/2017 përkufizon në mënyrë të veçantë edhe “Përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore” si një formë të ndihmës juridike falas për përjashtimin nga pagesa e tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore, me vendim të gjykatës kompetente, nëse plotësohen kriteret e vendosura nga ky ligj. Në lidhje me përjashtimet si formë të ndihmës juridike falas, lutem lexoni komentet në seksionin përkatës të këtij Komentari në lidhje me nenin 5 të Ligjit nr. 111/2017.

Neni 4

Parimet e ndihmës juridike

Dhënia e ndihmës juridike bazohet në parimet e mëposhtme:

a) aksesit të barabartë të individëve në ndihmën juridike;

b) barazisë dhe mosdiskriminimit të individëve që gëzojnë të drejtën për ndihmë juridike;

c) profesionalizmit në dhënien e shërbimit të ndihmës juridike;

ç) cilësisë, efikasitetit dhe efikasitetit në kosto për shërbimet e ofruara të ndihmës juridike;

d) ruajtjes së konfidencialitetit;

dh) shmangies dhe parandalimit të konfliktit të interesit;

e) mbrojtjes së të drejtave të personave vulnerabël.

Parimet e parashikuara në këtë nen përbëjnë boshtin e të gjitha dispozitave të Ligjit nr. 111/2017 por, edhe të akteve nënligjore përkatëse të cilat janë miratuar tashmë. Respektimi i këtyre parimeve është i rëndësishëm për zbatimin e dispozitave të shprehura por, respektimi i tyre është i rëndësishëm edhe për qëllime të interpretimit dhe zbatimit të neneve të këtij ligji të cilat gjatë zbatimit praktik do të rezultojnë që nuk janë të shprehura në mënyrë literale qëndrime apo zgjidhje të ndryshme ligjore.

Në lidhje me parimet e parashikuara në këtë nen dhe për qëllime të ndihmës juridike dytësore, i referohemi edhe dispozitave përkatëse të Ligjit nr.55/2018 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë” i cili në nenin 8 ‘Detyrat e avokatit’, ndër të tjera, parashikon se avokati, gjatë ushtrimit të profesionit, “... d) ofron shërbime ndaj personave përfitues të ndihmës juridike falas, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”. Ky parashikim krijon bazën ligjore për detyrueshmërinë e vënies në dispozicion të avokatëve për ndihmën juridike falas dhe

të zbatimit të parimeve përkatëse, etj., të parashikuara në legjislacionin përkatës. E njëjta frymë ligjore rezulton edhe nga përmbajtja e nenit 14 të Ligjit nr. 55/2018 “Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit, një nga kushtet e ushtrimit të profesionit të avokatit është që avokati të zbatojë dispozitat ligjore dhe ato të parashikuara në Statutin e Dhomës së Avokatisë dhe në Kodin Etik të Avokatit.

Parimet e ndihmës juridike të radhitura në këtë nen janë në përputhje edhe me kërkesat përkatëse që burojnë nga KEDNJ dhe jurisprudenca e GJEDNJ, si dhe nga Direktivat përkatëse të BE.

a) Parimi i aksesit të barabartë të individëve në ndihmën juridike

Si duhet kuptuar aksesit i barabartë i individëve në ndihmën juridike? Aksesit i barabartë i individëve në ndihmën juridike do të thotë që nëse plotësohen kriteret objektive dhe kërkesat përkatëse të parashikuara në këtë ligj dhe në aktet përkatëse nënligjore, asnjë individ nuk mund t'i mohohet dhënia e ndihmës juridike përkatëse. Ky parim është i ndryshëm nga parimi i aksesit të barabartë në drejtësi por, është premisë themelore për aksesin e barabartë efektiv të individëve në drejtësi. Detyrimi i zbatimit të këtij parimi vjen edhe si detyrë e avokatit e parashikuar shprehimisht nga neni 8 germa ‘b’ e Ligjit për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë⁹. Në lidhje me këtë, është përkatëse të kujtojmë se Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 18, pika 1, parashikon: “1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit”. Për të qënë të barabartë përpara ligjit do të thotë edhe të kesh mundësi të barabarta për të aksesuar sistemin e drejtësisë.

b) Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit

Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit gjatë dhënies së ndihmës juridike bazohet dhe është në përputhje me parimin përkatës të parashikuar nga neni 18 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë: “2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore”. Leximi i këtij neni kushtetues orienton edhe për të kuptuar çfarë kupton dhënia e ndihmës juridike duke zbatuar parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit. Pra, askush nuk mund të diskriminohet në dhënien e ndihmës juridike, pavarësisht nga forma e saj, për shkak të gjinisë, racës, fesë, bindjeve politike, fetare a filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore, sociale apo përkatësia prindërore e kërkuesit të ndihmës. Në

⁹ Neni 8 germa ‘b’ e Ligjit nr.55/2018: “b) i ofron çdo klienti shërbim ligjor të barabartë, duke i garantuar mbrojtje pa asnjë diskriminim të çdo forme, sipas kuptimit të dhënë nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi”.

lidhje me gjendjen ekonomike të kërkuesit të ndihmës juridike, sigurisht parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit zbatohet bazuar në kriteret e përzgjedhshmërisë mbi gjendjen ekonomike të kërkuesit, në rastet kur përfituesi nuk i takon grupeve të veçanta dhe përzgjedhshmëria bëhet vetëm mbi bazën e kriterëve objektive të lidhura me gjendjen ekonomike të kërkuesit.

Bazuar në nenin 18, pika 3, e Kushtetutës e cila parashikon se askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2 të nenit 18 nëse nuk ekziston një për ligje e arsyeshme dhe objektive, duket përkatëse të kujtohet se ndërsa ky nen shpreh në mënyrë absolute që askush nuk mund të diskriminohet për asnjë nga arsyet e përmendura në pikën 2 të nenit 18, ai legjitimon devijimin nga ky parim për shkaqe të ligjshme dhe objektive. Ky devijim për këto shkaqe legjitimohet edhe gjatë dhënies së ndihmës juridike, nëse me shkaqe objektive kuptojmë zbatimin me përpikmëri të kriterëve të përzgjedhshmërisë, dhe arsye të përligjshme ne konsiderojmë interesin publik sipas përkufizimeve përkatëse, gjendje të jashtëzakonshme, si dhe lejimin e ushtrimit të funksioneve ligjore të organeve shtetërore përkatëse.

Jurisprudenca e GJEDNJ në çështjen *Tawalib kundër Greqisë* orienton në lidhje me domosdoshmërinë e respektimit të parimit të mosdiskriminimit gjatë dhënies së ndihmës juridike. Ndërkohë, në çështjen *Biba kundër Greqisë*, GJEDNJ në vendimin përkatës shprehet se GJEDNJ ka konstatuar shkelje të KEDNJ kur shteti nuk i ka ofruar ndihmë juridike një të huaji dhe një emigranti, në kushtet kur të dy këta kërkues kishin mungesë të të ardhurave.

Në lidhje me parimin e mosdiskriminimit, vlen të përmendet që Direktiva 2002/8/EC në nenin 1 ‘Qëllimet dhe objektivat’ parashikon: “Qëllimi i kësaj direktive është të përmirësojë aksesin në drejtësi në mosmarrëveshjet ndërkufitare duke vendosur minimumin e rregullave të përbashkëta në lidhje me ndihmën juridike në mosmarrëveshje të tilla”. Po kështu, në lidhje me këtë parim, kujtojmë përmbajtjen edhe të nenit 4 ‘Mosdiskriminimi’: “Shtetet Anëtare do të japin ndihmë juridike pa diskriminim në Qytetarët e Unionit dhe shtetasit e vendeve të treta që banojnë në mënyrë të ligjshme në një shtet anëtar”.

c) Parimi i profesionalizmit në dhënien e shërbimit të ndihmës juridike

Në lidhje me këtë parim, është e rëndësishme të konsiderojmë edhe dallimin midis ndihmës juridike parësore dhe ndihmës juridike dytësore. Në kushtet që kërkesa për profesionalizëm për ndihmën juridike

dytësore që ofrohet nga avokatët e licencuar rrjedhin, mbi të gjitha, nga Ligji për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë¹⁰ (neni 8, gërma ‘a’ dhe ‘c’) dhe Kodi Etik i Avokatëve (neni 8, pika ‘c’), ky nen mund të lexohet si theksim për rëndësinë e zbatimit të këtij parimi, veçanërisht në lidhje me ndihmën juridike parësore. Sipas Ligjit nr. 55/2018, parimi i profesionalizmit kërkon që avokati të kryejë detyrën e tij të ndarë nga besimet apo paragjykimet e tij personale, të bëjë të gjitha përpjekjet e mundshme për të mbrojtur me efektivitet të drejtat dhe interesat e klientëve të tij.

Pa kundërshtuar sa më sipër, profesionalizëm është edhe ofrimi i ndihmës juridike në përputhje me ligjin material dhe procedural dhe standardet përkatëse sipas KEDNJ dhe jurisprudencës përkatëse të GJEDNJ. Specializimi i avokatëve dhe ofruesve të tjerë i shërben zbatimit të parimit të profesionalizmit në fushën e ndihmës juridike. Të gjithë operatorët e ofrimit të ndihmës juridike parësore, pa përjashtuar edhe avokatët, duhet të maksimizojnë përpjekjet për profesionalizëm në dhënien e ndihmës juridike, pra, të njohjes së ligjit material e procedural, të të drejtave përkatëse ligjore e kushtetuese, etj., në funksion të aksesit efektiv në drejtësi të kërkuesve të ndihmës juridike.

Në lidhje me këtë, është e rëndësishme të mbahet parasysh se neni 39, gërma ‘c’ e Ligjit për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë parashikon shprehimisht se: “c) *Mosofrimi i shërbimeve të ndihmës juridike të garantuar nga shteti*”, ku përfshihet mosofrimi në mënyrën e duhur i shërbimeve të ndihmës juridike për përfituesit e ndihmës juridike dytësore, sipas legjislacionit në fuqi për ndihmën juridike të garantuara nga shteti”, është shkak për fillimin e procedimit disiplinor të avokatit të përzgjedhur dhe të listuar për të dhënë ndihmë juridike falas.

ç) Parimi i cilësisë, efijencës dhe efikasitetit në kosto për shërbimet e ofruara të ndihmës juridike

Në lidhje me parimin e parashikuar në nenin 4 pika ç) mbi cilësinë, efijencën dhe efikasitetin në kosto për shërbimet e ofruara të ndihmës juridike, kujtojmë që Direktiva 2002/8/EC parashikon në nenin 3 ‘E drejta për ndihmë juridike’: “1. *Personat fizikë të përfshirë në një mosmarrëveshje të mbuluar nga kjo Direktivë kanë të drejtë të marrin ndihmë juridike të përshtatshme në mënyrë që të sigurohet akses efektiv në drejtësi në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë Direktivë. 2. Ndhimja juridike konsiderohet e përshtatshme kur garanton: (a) këshilla paragjyqësore me qëllim arritjen e një zgjidhje para ngritjes së procedurave ligjore;*

(b) *ndihma juridike dhe përfaqësimi në gjykatë, dhe përjashtimi nga, ose ndihma me, koston e procedurave të marrësit të ndihmës, përfshirë koston e përmendura në nenin 7 dhe tarifat për personat e ngarkuar nga gjykata për të kryer akte gjatë procedurës*”. Në lidhje me këtë, është e rëndësishme të mbahet parasysh se neni 39, gërma ‘c’, e Ligjit për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë parashikon shprehimisht se: “c) *Mosofrimi i shërbimeve të ndihmës juridike të garantuara nga shteti*”, ku përfshihet mosofrimi në mënyrën e duhur i shërbimeve të ndihmës juridike për përfituesit e ndihmës juridike dytësore, sipas legjislacionit në fuqi për ndihmën juridike të garantuara nga shteti”, është shkak për fillimin e procedimit disiplinor të avokatit të përzgjedhur dhe të listuar për të dhënë ndihmë juridike falas.

d) Parimi i ruajtjes së konfidencialitetit

Parimi i ruajtjes së konfidencialitetit buron nga interesi më i mirë i personit që kërkon ndihmë juridike falas, është parim i rëndësishëm i shërbimeve të avokatëve (neni 10 i Ligjit për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë), si dhe buron nga dispozita të tjera ligjore përkatëse, si p.sh. Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale”, neni 28 ‘Konfidencialiteti i të dhënave’: “*Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj*”. Parimi i konfidencialitetit, mbi të gjitha, detyron avokatin të mos shpërndajë të dhënat personale të klientit të tij.

dh) Parimi i shmangies dhe parandalimit të konfliktit të interesit

Parimi i shmangies dhe parandalimit të konfliktit të interesit orientohet nga interesi më i mirë i kërkuesit të ndihmës juridike dhe është detyrim për t’u respektuar edhe në bazë të kërkesës përkatëse të parashikuar shprehimisht në Ligjin për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë (neni 9). Edhe neni 8 ‘Detyrat e Avokatit’, gërma ‘ç’, e këtij ligji, parashikon shprehimisht se avokati “ç) *garanton mbrojtje ose përfaqësim transparent, në interesin më të mirë të klientit që përfaqëson, nëpërmjet parandalimit të konfliktit të interesit;...*”.

e) Parimi i mbrojtjes së të drejtave të personave në nevojë

Ky parim i rëndësishëm duhet kuptuar që dhënia e ndihmës juridike, pavarësisht nga forma e ndihmës

¹⁰ Ligji nr.55/2018 “Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë”

juridike, duhet të udhëhiqet vetëm nga mbrojtja e të drejtave të personave vulnerabël, kërkues të ndihmës juridike falas. Ky parim duhet lexuar në mënyrë të lidhur, veçanërisht, me parimin e besnikërisë ndaj klientit të parashikuar si parim i detyrueshëm për zbatim nga Ligji për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë¹¹ (neni 3). Edhe neni 8 ‘Detyrat e Avokatit’ gërma ‘ç’ e këtij ligji, parashikon shprehimisht se avokati “ç) *garanton mbrojtje ose përfaqësim transparent, në interesin më të mirë të klientit që përfaqëson, nëpërmjet parandalimit të konfliktit të interesit;...*”. Parimi i besnikërisë i kërkon avokatit që në çdo shkallë të çështjes së tij të bëjë përpjekje vetëm në interes të klientit të tij, dhe nuk e lejon atë që në të ardhmen të mbrojë të drejtat dhe interesat e palës kundërshtare.

Në lidhje me këtë parim, përmendim orientimin përkatës të GJEDNJ mbi mundësinë e zgjedhjes nga përfituesi të avokatit të ndihmës juridike. Neni 6 (3) (c) i KEDNJ përcakton shprehimisht se: “Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme: c. Të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, **ose** në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t’i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë”. Leximi literal të orienton që avokati mund të zgjidhet në rastet kur nuk ofrohet ndihmë juridike. Pavarësisht nga kjo, GJEDNJ ka vendosur që personat të cilëve u jepet ndihmë juridike falas jo gjithmonë mund të zgjedhin avokatin. E drejta për t’u mbrojtur nga një avokat i zgjedhur mund të jetë subjekt i kufizimeve kur e kërkon Ligji. Në çështjen *Croissant kundër Gjermanisë*, GJEDNJ vlerësoi se dëshirat e aplikantit nuk duhet të injorohen por, duke marrë parasysh interesat e drejtësisë, zgjedhja e avokatit është e drejtë për shtetin¹². Bazuar në sa më sipër, edhe në rastet kur përfituesi i ndihmës juridike nuk e ka zgjedhur vetë avokatin, parimi i ruajtjes së konfidencialitetit, i mbrojtjes së të drejtave të personave në nevojë, dhe të gjitha parimet e tjera, janë të zbatueshme me të njëjtën kërkesë si në rastin kur avokati zgjidhet sipas dëshirës së kërkuesit të ndihmës juridike.

Parimi i etikës detyron avokatin që gjatë veprimtarisë së tij të mos bëjë veprime ose mosveprime të cilat ulin figurën e avokatit dhe besimin e publikut në këtë

profesion. Parimi i integritetit thërret që avokatët në detyrën e tyre të jenë të ndershëm dhe të vërtetë me klientët e tyre.

Kodi Etik i Avokatit është një tërësi rregullash të detyrueshme për avokatin, i cili miratohet me Vendim të Këshillit të Përgjithshëm të Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë. Rëndësia e tij si një burim normash të detyrueshme për avokatin rezulton nga pëmbajtja e nenit 8 të ligjit “Për Avokatinë” në të cilën parashikohet se Avokati, gjatë ushtrimit të profesionit, vepron në respekt të legjislacionit në fuqi, Statutit të Dhomës së Avokatisë të Shqipërisë, si dhe rregullave të Kodit Etik të Avokatit. Pra, Kodi Etik i Avokatit i miratuar me vendimin nr.31 datë 12.11.2005¹³ të Këshillit Kombëtar të Avokatisë, vendoset përkrah ligjit në fuqi dhe Statutit të Dhomës së Avokatëve të Shqipërisë, duke i dhënë rregullave të tij fuqi detyruese të njëjtë me aktet e mëparshme, për sa kohë nuk vjen në kundërshtim me to. E njëjta frymë ligjore rezulton edhe nga pëmbajtja e nenit 14 të Ligjit 55/2018 “Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit, një nga kushtet e ushtrimit të profesionit të avokatit është që ky të zbatohet dispozitat ligjore dhe ato të parashikuara në statut dhe në Kodin Etik të Avokatit.

Neni 5 **Format e ndihmës juridike**

Ndihma juridike jepet në format e mëposhtme:

a) *ndihmë juridike parësore;*

b) *ndihmë juridike dytësore;*

c) *përrjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore, sipas ligjit, dhe përrjashtim nga detyrimi për të parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrat të ekzekutimit.*

Në lidhje me këtë nen, duket përkatëse referimi në jurisprudencën e GJEDNJ e cila orienton si më poshtë: “Të gjitha format e ndihmës juridike kanë një të përbashkët, ato duhet të jenë falas. Jurisprudenca e GJEDNJ ka qartësuar se çfarë do të thotë termi “falas”. Në çështjen *Gennadiy kundër Rusisë*, GJEDNJ është shprehur se kur kërkuesi nuk ka të paguajë, pra, kur nuk ka financa të mjaftueshme dhe nuk i ofrohet ndihmë juridike, kjo përbën shkelje të nenit 6/3 të KEDNJ por, nëse individ ka të ardhura dhe nuk i ofrohet ndihmë juridike, atëherë kjo nuk do të konsiderohet shkelje e KEDNJ.

¹¹ Ligji nr.55/2018

¹² Në çështjen *Croissant kundër Gjermanisë*, GJEDNJ është shprehur: “Pavarësisht rëndësisë së marrëdhënies së besimit ndërmjet avokatit dhe klientit, kjo e drejtë nuk mund të konsiderohet si absolute. Ajo domosdoshmërisht i nënshtrohet kufizimeve të caktuara kur bëhet fjalë për ndihmën juridike falas dhe gjithashtu ku, si në rastin konkret, gjykatat vendosin nëse interesat e drejtësisë kërkojnë që të akuzuarit të mbrohen nga mbrojtësi i caktuar nga ata. Me rastin e emërimit të mbrojtësit, gjykatat kombëtare me siguri duhet të kenë parasysh dëshirat e të pandehurit ... Sidoqoftë, ata mund të tejkalojnë ato dëshira kur ekzistojnë arsye përkatëse dhe të mjaftueshme për të gjykuar që kjo është e nevojshme në interes të drejtësisë”.

¹³ Kodit Etik i Avokatit ka hyrë në fuqi në 12.11.2005

Së pari, ky nen përcakton tre format e ndihmës juridike falas. Së dyti, të tre format e ndihmës juridike të parashikuara në këtë nen por, edhe në të gjithë Ligjin nr. 111/2017, duhen kuptuar që janë ndihmë juridike falas, përveç rasteve të formës së shtyrjes së detyrimit për pagesë të një tarife të caktuar (shih më poshtë komentet përkatëse në këtë seksion të Komentarit).

Për qëllime të leximit të pikave të këtij neni 5 të ligjit, duhen konsultuar përkufizimet përkatëse të ndihmës juridike parësore, ndihmës dytësore, dhe përjashtimet nga tarifat gjyqësore dhe shpenzimet të cilat parashikohen në nenin 3 të Ligjit nr. 111/2017.

Ndihmë juridike parësore

“Ndihmë juridike parësore” është: i) dhënia e informacioneve në lidhje me sistemin ligjor të Republikës së Shqipërisë, aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor; ii) dhënia e këshillimit; iii) dhënia e këshillimit mbi procedurat e ndërmjetësimit dhe zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve; iv) dhënia e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore; v) përfaqësimi përpara organeve administrative; dhe vi) dhënia e të gjitha formave të tjera të mbështetjes së nevojshme juridike që nuk përbëjnë ndihmë juridike dytësore.

Ndihma parësore falas, është faktor kyç lidhur me garantimin e aksesit në drejtësi të qytetarëve, sepse ajo mbulon ofrimin e informacionit të domosdoshëm mbi metodat dhe procedurat përkatëse të aksesit paragjyqësor të grupeve vulnerabël. Ndihma parësore ka një rëndësi të jashtëzakonshme, jo vetëm për garantimin e të drejtës për informim të qytetarit për të drejtat e tij lidhur me aksesin në shërbime publike dhe aksesin në institucionet publike, por edhe edukimin e tij me zgjidhjen e çështjeve në mënyra të tjera ndërmjetësimi paragjyqësore. Kjo zgjidhje, për rrjedhojë, sjell dhe përfitime të tjera të karakterit publik, si mosdërgimi i çështjeve në gjykatë, duke zvogëluar ngarkesën e tyre, zgjidhja në rrugë administrative me sa më pak kohë e energji, duke e bërë zgjidhjen juridike eficiente, etj¹⁴.

Ndihmë juridike dytësore

Veçanti për ndihmën juridike parësore që jepet në formën e këshillimeve specifike, apo edhe hartimit të dokumenteve përkatëse ligjore, është që ato kanë

lidhje me mbrojtjen edhe përfaqësimin e kërkuarve të ndihmës juridike në organet dhe institucionet e administratës shtetërore.

“Ndihmë juridike dytësore” është shërbimi juridik që ofrohet për përpilimin e akteve të nevojshme për të vënë në lëvizje gjykatën; ofrimi i këshillimit, përfaqësimit dhe mbrojtjes para gjykatës në çështjet administrative, civile dhe në çështjet penale, për të cilat nuk zbatohet mbrojtja e detyrueshme, sipas përcaktimeve të legjislacionit procedural penal. Ky përkufizim nuk duhet lexuar si shterues por, duhet interpretuar që përfshin edhe të gjitha format e ndihmës juridike dytësore të cilat maksimizojnë mbrojtjen efektive të interesave të përfituesve. Kështu, për shembull, shërbimet clinics për të aftësuar përfituesit të mbrojnë veten në gjykatat shqiptare, mund të ofrohen kur vlerësohet se përfituesi ka nivel mendor, arsimor dhe intelektual që mundëson mbrojtje efektive.

Ndihma juridike dytësore jepet për çështje konkrete në formën e këshillimeve specifike apo edhe hartimit të dokumenteve përkatëse ligjore, që kanë lidhje me mbrojtjen edhe përfaqësimin e kërkuarve të ndihmës juridike në gjykatat e sistemit gjyqësor të Republikës së Shqipërisë. Në lidhje me ndihmën juridike dytësore vlen të përmendet se Direktiva 2002/8/EC në nenin 10 ‘Procedurat jashtëgjyqësore’ parashikon: *“Ndihma juridike do të shtrihet edhe në procedurat jashtëgjyqësore, në kushtet e përcaktuara në këtë Direktivë, nëse ligji kërkon që palët t’i përdorin ato, ose nëse palët në mosmarrëveshje janë urdhëruar nga gjykata që t’u drejtohen atyre”*.

Ndihmë juridike si përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore, shpenzimeve gjyqësore dhe nga parapagimi i tarifës së vënies në ekzekutim të urdhrit për ekzekutim

Në lidhje me ndihmën juridike falas që jepet në formën e përjashtimit nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore, sipas ligjit, dhe përjashtim nga detyrimi për të parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrit të ekzekutimit, e rëndësishme është kuptimi i elementëve dhe mënyrave të përjashtimit të parashikuara në vetë Ligjin nr. 111/2017, si dhe përjashtimet e parashikuara nga neni 9 ‘Përjashtime nga pagesa e tarifës gjyqësore’ i Ligjit nr.98/2017 “Për tarifat gjyqësore”: *“1. Palët ndërgjyqëse mund të përjashtohen nga detyrimi për të paguar tarifë gjyqësore ose shpenzimet e tjera gjyqësore kur është bërë kërkesë prej tyre, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për ndihmën juridike. 2. Çdo organ publik buxhetor që kryen funksione administrative, gjykatat ose prokuroria, përjashtohen nga detyrimi për*

¹⁴ Raport monitorimi mbi ofrimin e ndihmës juridike parësore, Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe OSFA (viti 2019).

të paguar tarifë gjyqësore, përveç rasteve kur humbasin çështjen gjyqësore dhe ligji procedural parashikon detyrimin e tyre për paguar shpenzimet e palës tjetër. 3. Rregulli i parashikuar në pikën 2, të këtij neni, nuk zbatohet për Avokaturën e Shtetit, e cila përjashtohet edhe nga pagesa e shpenzimeve gjyqësore”.

Është i rëndësishëm të trajtohet dallimi midis tarifës gjyqësore dhe shpenzimeve të tjera gjyqësore, duke qenë se neni 5 pika ‘c’ e Ligjit nr. 111/2017 parashikon shprehimisht për ndihmën juridike në formën e “përrjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore, sipas ligjit, dhe përrjashtim nga detyrimi për të parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrat të ekzekutimit”.

Neni 102 i Kodit të Procedurës Civile përcakton se shpenzimet gjyqësore¹⁵ përbëhen nga tarifën dhe nga shpenzimet e tjera të nevojshme të gjykimit. Nga kjo kuptojmë që tarifën gjyqësore janë vetëm një nga kategoritë e shpenzimeve gjyqësore. Tarifën gjyqësore, llojet e tyre dhe të tjera çështje që lidhen me to, rregullohen me Ligjin nr.98/2017 “Për tarifën gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”. Neni 3 i këtij ligji, përkufizon se “Tarifa gjyqësore” është një pagesë që personi që ka vënë në lëvizje gjykatat e zakonshme ose Gjykatën Kushtetuese kryen nëpërmjet administratës gjyqësore në favor të administratës tatimore qëndrore. Nga ky përkufizim i nenit 3 kuptohet se tarifa gjyqësore është një detyrim për një shërbim publik që të mundëson aksesin në gjykatë, pra, për të vënë në lëvizje aparatin gjyqësor për të marrë shërbimin e drejtësisë. Shpenzimet e tjera gjyqësore si p.sh.tarifa për ekspertin ose tarifa për avokatin janë shpenzime që nuk përfshihen në konceptin e tarifës gjyqësore dhe të gjitha ato së bashku përbëjnë shpenzimet e përgjithshme gjyqësore të palëve në proces. Neni 4 i këtij ligji sqaron se tarifa gjyqësore zbatohet edhe për çështjet gjyqësore, por edhe për të marrë shërbimet administrative të ofruara nga gjykata. Për qëllime të zbatimit të Ligjit nr. 111/2017, duhet të mbajmë parasysh se tarifën gjyqësore, sipas këtij Ligjit për Tarifën Gjyqësore, ndahen në: a) tarifa gjyqësore të përgjithshme, për paraqitjen e çështjeve në gjykata; b) tarifa gjyqësore të veçanta, përkryerjen e veprimeve procedurale në gjykata dhe shërbimet e administratës gjyqësore; dhe c) tarifa gjyqësore shtesë, në funksion të administrimit korrekt të procesit gjyqësor.

Përkufizime të tarifës gjyqësore dhe të shpenzimeve gjyqësore parashikohen edhe nga neni 3 i vetë Ligjit nr.

¹⁵ Kodi i Procedurës Civile, neni 105/b, shtuar me Ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001, neni 23: “Personat që, sipas dispozitave për taksën mbi aktet, përjashtohen nga pagimi i taksës, përjashtohen edhe nga pagimi i shpenzimeve të tjera gjyqësore. Në këto raste, shpenzimet përballohen nga fondet përkatës të parashikuar në Buxhetin e Shtetit. Organet e pushtetit publik dhe personat e tjerë juridikë që, sipas dispozitave për taksën mbi aktet përjashtohen nga pagimi i taksës, paguajnë shpenzimet e tjera gjyqësore”.

111/2017: “Tarifa gjyqësore” është tarifa, sipas kuptimit të dhënë nga legjislacioni në fuqi për tarifën gjyqësore në Republikën e Shqipërisë. Përkufizimi i tarifës gjyqësore sipas Ligjit 98/2017 “Për tarifën gjyqësore në RSH” është dhënë në seksionin përkatës të këtij Komente në lidhje me nenin 3 “Përkufizime” të Ligjit nr. 111/2017. “Shpenzimet gjyqësore” janë shpenzimet e kryera në kuadër të procesit gjyqësor, të nevojshme për gjykimin, sipas kuptimit të dhënë në legjislacionin procedural, përveç tarifës gjyqësore.

Janë pikërisht këto përkufizime të cilat duhet të përdoren për qëllime të Ligjit nr. 111/2017 dhe, veçanërisht, për formën e ndihmës juridike si përrjashtim nga tarifën dhe shpenzimet gjyqësore.

Më tej, në lidhje me këtë formë të ndihmës juridike, dhe veçanërisht me formën e përrjashtimit nga shpenzimet gjyqësore, kujtojmë që Direktiva 2002/8/EC në nenin 8 ‘Kostot e mbuluara nga Shteti Anëtar i vendbanimit ose vendbanimi i zakonshëm’ parashikon: “Shteti Anëtar, në të cilin kërkuesi i ndihmës juridike është i vendosur ose ka vendbanimin e zakonshëm do të sigurojë ndihmë juridike, siç përmendet në Nenin 3 (2), i nevojshëm për të mbuluar: (a) kostot që lidhen me ndihmën e një avokati vendor ose ndonjë tjetër personi tjetër që ka të drejtë me ligj të japë këshilla juridike, të ndodhura në atë Shtet Anëtar deri në aplikimin për ligj ndihma është pranuar, në përputhje me këtë Direktivë, në shtet anëtar ku gjykata;...”.

Po kështu, në lidhje me këtë formë të ndihmës juridike falas duhet të mbahet parasysh se dispozitat ligjore përkatëse në fuqi parashikojnë përrjashtim nga tarifën gjyqësore, por edhe për raste të shtyrjes së pagesës dhe kthim të përfitimeve. Aktet nënligjore përkatëse të miratuara deri më tani janë si më poshtë:

(i) Udhëzim i Ministrit të Drejtësisë nr.6 datë 20.08.2019 “Për rregullat dhe procedurat e kryerjes së pagesave të shpenzimeve gjyqësore, për të cilat është vendosur përrjashtimi në rastin e dhënies së ndihmës juridike”;

(ii) Udhëzim i Ministrit të Drejtësisë nr.2 datë 25.03.2019 “Për procedurat, periodicitetin dhe rregullat për verifikimin e rrethanave për kthimin e përfitimeve”;

(iii) Udhëzim i Këshillit të Ministrave nr.1 datë 06.03.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.4, datë 12.12.2012 “Për përcaktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor”; dhe akte të tjera përkatëse.

Në këto kushte, për qëllime të rasteve të përjashtimit, mbajmë në vëmendje jo vetëm dispozitat përkatëse të Ligjit 111/2017, por edhe Udhëzimin e Ministrit të Drejtësisë nr. 6, datë 20.08.2019 “Për rregullat dhe procedurat e kryerjes së pagesave të shpenzimeve gjyqësore, për të cilat është vendosur përjashtim në rastin e dhënies së ndihmës juridike”.

Në lidhje me “*Tarifën për vënien në ekzekutim të urdhrat të ekzekutimit*”, ligji ka këtë përkufizim: “*është tarifa që i parapaguhet shërbimit përmbartimor gjyqësor shtetëror, për vënien në ekzekutim të një titulli ekzekutiv, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi*”. Duhet qartësuar se në lidhje me tarifën e zbatueshme për vënien në ekzekutim të urdhrave të ekzekutimit, ligji parashikon shprehimisht se konsiderohet ndihmë juridike përjashtimi nga parapagimi i tarifës përkatëse. Nëse ky përjashtim kompensohet pas ekzekutimit nga përfituesi i ndihmës juridike ose jo, kjo nuk është parashikuar në mënyrë të shprehur dhe të hollësishme në Ligjin nr. 111/2017, por nga formulimi i dispozitës duket që është një përjashtim vetëm në fazën e parapagimit dhe, në këto kushte, mund të konsiderohet si ‘shtyrje’ e pagimit të tarifës përkatëse.

Në lidhje me këtë formë të ndihmës juridike falas, në kushtet që tarifat gjyqësore përfshihen në përkufizimin e detyrimeve ndaj shtetit të parashikuar në Ligjin për Procedurat Tatimore¹⁶ mund të konsiderohen si detyrime tatimore, vlen të vëmë në vëmendje nenin 155 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili parashikon shprehimisht: “*Taksat, tatimet dhe detyrimet financiare kombëtare e vendore, lehtësimi ose përjashtimi prej tyre i kategorive të caktuara të paguesve, si dhe mënyra e mbledhjes së tyre caktohen me ligj. Në këto raste ligji nuk mund t’i jepet fuqi prapavepruese*”. Në praktikën disa vjeçare fiskale, ky nen kushtetues është interpretuar dhe është zbatuar duke ngarkuar detyrime fiskale, mundësuar lehtësi ose përjashtime fiskale, apo edhe shtyrje fiskale vetëm nëse këto janë parashikuar shprehimisht në një ligj të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë, dhe ato zbatohen në mënyrë shteruese dhe vetëm në mënyrën e parashikuar shprehimisht nga ligji përkatës. Në lidhje me përjashtimet ose shtyrjet e parashikuara shprehimisht për tarifat gjyqësore nga Ligji nr. 111/2017 dhe Ligji nr. 98/2017 “Për tarifat gjyqësore në RSH”, si një nga format e ndihmës juridike falas, është e rëndësishme të identifikohen qartë cilat tarifa gjyqësore përjashtohen dhe cilat shtyhen. Për këtë, gjithnjë duhet të mbahen në vëmendje përkufizimi i tarifave gjyqësore (shih më sipër në këtë seksion të Komentarit) si dhe nëse për secilën prej tyre është parashikuar regjim përjashtimi apo shtyrje.

¹⁶ Ligj nr.9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Duke iu referuar akteve nënligjore të miratuar tashmë në zbatim të Ligjit nr. 111/2017, identifikojmë edhe një formë tjetër të përjashtimit nga tarifat apo shpenzimet gjyqësore në formën e kthimit të pagesave të kryera, e zbatueshme kjo në rast të ndryshimit të rrethanave financiare ose për rastet kur përfituesit nuk dëshirojnë të ndjekin me tej rrugën gjyqësore, ose kanë paraqitur të dhëna të pavërteta ose të pasakta, duke pranuar kthimin vullnetar të shumës së përfituar për këtë qëllim. Kështu, për qëllime të rasteve të kthimit të tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore të paguara duhet të konsiderohen jo vetëm dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 111/2017, por edhe Udhëzim i Ministrit të Drejtësisë nr. 2 datë 25.3.2019 “Për procedurat, periodicitetin dhe rregullat për verifikimin e rrethanave për kthimin e përfitimeve” (shih Shtojca 6 e këtij Komentari).

Gjatë zbatimit të formës së ndihmës juridike nëpërmjet përjashtimit nga tarifat gjyqësore dhe shpenzimet gjyqësore, në mënyrë të veçantë, vëmë në vëmendje se neni 9 ‘Përjashtime nga pagesa e tarifës gjyqësore’ i Ligjit nr. 98/2017 “Për tarifat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”¹⁷ parashikon shprehimisht: “*1. Palët ndërgjyqëse mund të përjashtohen nga detyrimi për të paguar tarifat gjyqësore ose shpenzimet e tjera gjyqësore, kur është bërë kërkesë prej tyre sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për ndihmën juridike....*”

KREU II

ORGANIZIMI I NDIHMËS JURIDIKE TË GARANTUAR NGA SHTETI

Në Kreun II të Ligjit nr. 111/2017, rregullohet mënyra e administrimit të shërbimit të ndihmës juridike falas. Në këtë Kre përcaktohen institucionet përgjegjëse për administrimin e ndihmës juridike, siç janë gjykatat, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas dhe Dhoma Kombëtare e Avokatisë, si dhe detyrat e tyre përkatëse.

Gjykata shqyrton kërkesat për ndihmë juridike falas e cila përfshin ndihmën juridike dytësore, si dhe përjashtimin nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore, dhe shprehet me vendim për pranimin ose jo të kërkesës, të cilin ia vë në dispozicion Drejtorisë së Ndihmës Juridike.

¹⁷ Neni 9 ‘Përjashtime nga pagesa e tarifës gjyqësore’ i Ligjit 98/2017 “Për tarifat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë” parashikon shprehimisht: “*1. Palët ndërgjyqëse mund të përjashtohen nga detyrimi për të paguar tarifat gjyqësore ose shpenzimet e tjera gjyqësore kur është bërë kërkesë prej tyre, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për ndihmën juridike. 2. Çdo organ publik buxhetor që kryen funksione administrative, gjykatat ose prokuroria, përjashtohen nga detyrimi për të paguar tarifat gjyqësore, përveç rasteve kur humbasin çështjen gjyqësore dhe ligji procedural parashikon detyrimin e tyre për të paguar shpenzimet e palës tjetër. 3. Rregulli i parashikuar në pikën 2, të këtij neni, nuk zbatohet për Avokaturën e Shtetit, e cila përjashtohet edhe nga pagesa e shpenzimeve gjyqësore*”.

Ministria e Drejtësisë në fushën e shërbimit të ndihmës juridike zhvillon politikën shtetërore për të siguruar akses efektiv në sistemin e drejtësisë për shërbimin e ndihmës juridike, përgatit projektbuxhetin në përputhje me legjislacionin në fuqi, ngre Drejtorinë për Ndhmën Juridike Falas në varësi të saj, mbikëqyr zbatimin e dispozitave ligjore e nënligjore, dhe ndihmon në vlerësimin e cilësisë së ndihmës juridike të dhënë, si dhe i propozon Dhomës Kombëtare të Avokatisë, në rast të shkeljes së dispozitave të këtij ligji, fillimin e procedimit disiplinor për marrjen e masave të pezullimit ose heqjes së lejes së ushtrimit të profesionit të avokatit.

Dhoma Kombëtare e Avokatisë, merr pjesë në përcaktimin e kriterëve për përzgjedhjen e avokatëve, që japin ndihmën juridike falas dhe specializimin e tyre në fushat përkatëse sipas kërkesave ligjore, merr pjesë në përcaktimin e kriterëve për vlerësimin e cilësisë së shërbimit të dhënë nga avokatët, merr masa disiplinore ndaj avokatëve, që ofrojnë ndihmë juridike falas, etj.

Drejtoria për Ndhmën Juridike Falas administron dhe monitoron shpenzimet për ndihmën juridike që rrjedhin si detyrim nga vendimet gjyqësore, mban kontakte me drejtuesit e gjykatave të rretheve gjyqësore për evidentimin e të dhënave të vendimeve për ndihmën juridike falas, menaxhon buxhetin e dhënë për ofrimin e ndihmës juridike nga shteti për të cilin raporton tek Ministri në mënyrë të herëpashershme, lidh kontratat e shërbimit me avokatët për ndihmë juridike pas vendimit gjyqësor në konsultim me Dhomën Kombëtare të Avokatisë sipas përzgjedhjes së aplikuesit, asiston qytetarët për plotësimin e formularëve për t’ju drejtuar gjykatave për kërkesat për ndihmë juridike falas, informon qytetarët për parashikimet e ligjit lidhur me kriteret, procedurat, dokumentacionin dhe kushtet e përfitimit të ndihmës juridike falas nëpërmjet shërbimeve juridike ambulante, publikimeve, fushatave në TV dhe median e shkruar, si dhe nëpërmjet masave të tjera të ngjashme, etj.

Neni 6

Institucionet përgjegjëse për administrimin dhe funksionimin e sistemit të ndihmës juridike

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji janë:

- a) *Ministri i Drejtësisë;*
- b) *Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas;*
- c) *Dhoma Kombëtare e Avokatisë;*
- ç) *Gjykatat kompetente, sipas parashikimeve të këtij ligji.*

Neni 6 i Ligjit nr. 111/2017, i dedikohet rradhitjes së shprehur të institucioneve përgjegjëse për administrimin dhe funksionimin e sistemit të ndihmës juridike falas. Megjithatë, detyrat dhe përgjegjësitë përkatëse të secilit prej këtyre institucioneve janë të parashikuara dhe shprehura me hollësi në nene të tjera përkatëse të Ligjit nr. 111/2017.

Ministri i Drejtësisë, që në fushën e shërbimit të ndihmës juridike zhvillon politikën shtetërore për të siguruar akses efektiv në sistemin e drejtësisë për shërbimin e ndihmës juridike, përgatit projektbuxhetin, në përputhje me legjislacionin në fuqi, ngre Drejtorinë për Ndhmën Juridike Falas në varësi të saj, mbikëqyr zbatimin e dispozitave ligjore e nënligjore dhe ndihmon në vlerësimin e cilësisë së ndihmës juridike të dhënë, si dhe i propozon Dhomës Kombëtare të Avokatisë, në rast të shkeljes së dispozitave të ligjit, fillimin e procedimit disiplinor për marrjen e masave të pezullimit ose heqjes së lejes së ushtrimit të profesionit të avokatit.

Drejtoria për Ndhmën Juridike Falas, zbaton politikat e zhvilluara nga Ministri i Drejtësisë dhe të miratuara nga Këshilli i Ministrave, administron dhe monitoron shpenzimet për ndihmën juridike që rrjedhim si detyrim nga vendimet gjyqësore, mban kontakte me drejtuesit e gjykatave të rretheve gjyqësore për evidentimin e të dhënave të vendimeve për ndihmën juridike falas, menaxhon buxhetin e dhënë për ofrimin e ndihmës juridike nga shteti për të cilin raporton tek Ministri në mënyrë të herëpashershme, lidh kontratat e shërbimit me avokatët për ndihmë juridike pas vendimit gjyqësor në konsultim me Dhomën Kombëtare të Avokatisë sipas përzgjedhjes së aplikuesit, asiston qytetarët për plotësimin e formularëve për t’ju drejtuar gjykatave për kërkesat për ndihmë juridike falas, informon qytetarët për parashikimet e ligjit lidhur me kriteret, procedurat, dokumentacionin dhe kushtet e përfitimit të ndihmës juridike falas nëpërmjet shërbimeve juridike ambulante, publikimeve, fushatave në TV dhe median e shkruar, si dhe nëpërmjet masave të tjera të ngjashme, etj.

Neni 6 i Ligjit nr. 111/2017 përmend Dhomën e Avokatisë si një institucion përgjegjës për zbatimin e këtij ligji. **Dhoma Kombëtare e Avokatisë** merr pjesë në përcaktimin e kriterëve për përzgjedhjen e avokatëve, dhe në përgatitjen e listës sipas parimit të rotacionit për avokatët që japin ndihmën juridike falas dhe specializimin e tyre në fushat përkatëse sipas kërkesave ligjore të ndihmës juridike falas, merr pjesë në përcaktimin e kriterëve për vlerësimin e cilësisë së shërbimit të dhënë nga avokatët, merr masa disiplinore ndaj avokatëve që nuk ofrojnë ndihmë juridike falas sipas standardeve të kërkuara, etj.

Gjykata, në funksion të ndihmës juridike falas shqyrton kërkesat për ndihmë juridike falas e cila përfshin ndihmën juridike dytësore si dhe përjashtimin nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore, dhe shprehet me vendim për pranimin ose jo të kërkesës, të cilin ia vë në dispozicion Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas¹⁸. Jurisprudenca e GJEDNJ, në çështjen Gnahre kundër Francës, orienton se për të shmangur arbitraritetin shtetet duhet të parashikojnë një mekanizëm që zgjedh çështjet që mund të përfitojnë ndihmë juridike falas. Në Ligjin nr. 111/2017, në vendin tonë, ky organ është gjykata kompetente. Më tej, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në vendimin nr.35 datë 01.06.2016 është shprehur: “lidhur me të drejtën e mbrojtjes, ajo duhet të jetë reale dhe efektive e jo vetëm teorike, ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet por, përkundrazi, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të marrin të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të rregullt ligjor t’i japin mundësinë individit të bëjnë mbrojtje reale, duke respektuar parimin e barazisë së armëve”. Detyrat dhe përgjegjësitë specifike të gjykatave kompetente në lidhje me ndihmën juridike falas, janë komentuar më me hollësi më poshtë në këtë Komentar duke iu referuar neneve përkatëse të Ligjit nr. 111/2017.

Neni 7

Detyrat e Ministrit të Drejtësisë

Ministri i Drejtësisë ka përgjegjësitë dhe kryen detyrat e mëposhtme:

a) zhvillon politikën shtetërore në fushën e ndihmës juridike;

b) i propozon Ministrisë së Financave projektbuxhetin vjetor për ndihmën juridike, në përputhje me rregullat e parashikuara në legjislacionin për menaxhimin e sistemit buxhetor;

c) mbikëqyr mirëfunksionimin e sistemit të ndihmës juridike dhe zbatimin e buxhetit vjetor për ndihmën juridike;

ç) raporton çdo vit në Kuvend për gjendjen e sistemit të ndihmës juridike;

d) miraton aktet e mëposhtme:

- i) formularin e kërkesës për ndihmë juridike parësore;
- ii) formularin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore;
- iii) formularin e kërkesës për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe i shpenzimeve gjyqësore;
- iv) formularin e vetëdeklarimit për ndihmë juridike parësore;

v) formularin e vetëdeklarimit të të ardhurave dhe të pasurive, sipas këtij ligji;

vi) formularin e vetëdeklarimit për kategoritë e veçanta, sipas nenit 11 të këtij ligji;

vii) formatin e regjistrit për regjistrimin e kërkesave dhe vetëdeklarimeve të mësipërme;

viii) formatin e regjistrit të organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore;

ix) formularin e ankimit ndaj vendimit të rrëzimit të kërkesës për ndihmë juridike dytësore.

Ministria e Drejtësisë merr masat e nevojshme për publikimin e formularëve të parashikuar në këtë paragraf në format të aksesueshëm nga personat me aftësi të kufizuara;

dh) miraton krijimin e qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore, pasi të ketë marrë më parë mendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor;

e) miraton kontratën tip me organizatat jofitimprurëse për shërbimet e ndihmës juridike parësore, sipas parashikimeve të këtij ligji, pasi të ketë marrë më parë mendimin e ministrisë përgjegjëse për financat;

ë) miraton kontratën tip me avokatët për dhënien e shërbimeve të ndihmës juridike dytësore;

f) miraton, pasi të ketë marrë më parë mendimin e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas dhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë, kriteret dhe metodologjinë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike;

g) miraton me udhëzim të përbashkët me ministrin përgjegjës për financat, pasi të ketë marrë më parë mendimin e Dhomës Kombëtare të Avokatisë, kriteret e përfitimit të pagesave dhe tarifat përkatëse të shpërblyerit të avokatëve, të cilët ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore;

gj) miraton procedurat që ndiqen nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas në lidhje me pagesat për shpenzimet gjyqësore, sipas përcaktimeve të këtij ligji;

h) publikon listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore dhe listën e organizatave jofitimprurëse të autorizuara që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike parësore në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë;

i) miraton rregullat dhe procedurat për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave të regjistrit

¹⁸ Raporti i Komitetit Shqiptar të Helsinkit, shkurt 2019.

të kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve të këtij ligji dhe të regjistrit të organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore;

j) kryen të gjitha detyrat e tjera të përcaktuara me këtë ligj.

Ky nen parashikon shprehimisht detyrat dhe përgjegjësitë e Ministrit të Drejtësisë, të cilat janë bazuar dhe duhet të zbatohen duke respektuar dispozitat ligjore përkatëse të parashikuara në Kushtetutën e Shqipërisë¹⁹, Ligjin për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Ministrave²⁰, Ligj nr.8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar²¹, Ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe akte të tjera²². Veçanërisht, bazuar në nenin 6²³ të Ligjit nr. 9000/2003, në lidhje me ndihmën juridike, si detyra të Ministrit të Drejtësisë duhen kuptuar jo vetëm ato që parashikohen shprehimisht në Ligjin nr. 111/2017, por edhe ato që parashikohen në ligje të veçanta, si dhe ato që ngarkohen nga Këshilli i Ministrave dhe Kryeministri.

Në leximin e nenit 7 të Ligjit nr. 111/2017, duhen mbajtur parasysh edhe dallimi midis institucionit të Ministrit dhe Ministrisë përkatëse. Neni 7 i Ligjit “Për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Ministrave” parashikon se Ministria është personi juridik publik, që përfaqësohet dhe drejtohet nga Ministri dhe se Ministria mbështet, në aspektin teknik, veprimtarinë e Ministrit.

Në lidhje me detyrat që duhet të ushtrojë Ministri i Drejtësisë në fushën e ndihmës juridike edhe sipas nenit 7 të Ligjit nr. 111/2017, për qëllime të vlefshmërisë, hyrjes në fuqi dhe zbatueshmërisë të akteve përkatëse ligjore dhe nënligjore por edhe për qëllime të ndërhyrjeve përkatëse të Ministrit të Drejtësisë, duhet të zbatohen veçanërisht dispozitat përkatëse të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si neni 80²⁴, neni 100²⁵, neni

104²⁶, neni 116²⁷, neni 119²⁸.

Ky nen duhet të lexohet se ai përcakton jo vetëm detyrat dhe përgjegjësitë e Ministrit të Drejtësisë në fushën e ndihmës juridike, por edhe përcakton disa nga aktet nënligjore të cilat duhet të miratohen në zbatim të Ligjit nr. 111/2017.

Në bazë të nenit 7 të Ligjit nr. 111/2017, detyrat dhe përgjegjësitë e Ministrit të Drejtësisë në fushën e shërbimit të ndihmës juridike përmbledhen si vijon: zhvillon politikën shtetërore për të siguruar akses efektiv në sistemin e drejtësisë për shërbimin e ndihmës juridike, përgatit projektbuxhetin në përputhje me legjislacionin në fuqi, ngre Drejtorinë për Ndihmën Juridike Falas në varësi të saj, mbikëqyr zbatimin e dispozitave ligjore e nënligjore dhe ndihmon në vlerësimin e cilësisë së ndihmës juridike të dhënë, i propozon Dhomës Kombëtare të Avokatisë, në rast të shkeljes së dispozitave të ligjit, fillimin e procedimit disiplinor për marrjen e masave të pezullimit ose heqjes së lejes së ushtrimit të profesionit të avokatit²⁹.

Në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e Ministrit të Drejtësisë të përcaktuara në nenin 7 pika ‘a’, kjo dispozitë duhet lexuar jo vetëm si detyrim i Ministrit në lidhje me zhvillimin e politikave përkatëse, e përcaktuar kjo edhe në nenin 5 ‘Misioni i Ministrisë së Drejtësisë’ të Ligjit për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë, por edhe me hartimin e strategjive afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjatë që kanë të bëjnë me ndihmën juridike. Hartimi dhe më pas miratimi njëkohësisht i politikave dhe strategjive përkatëse nga Këshilli i Ministrave në lidhje me ndihmën juridike është një detyrim i cili është zbatuar tashmë në këtë mënyrë të njëkohëshme nga Ministri i Drejtësisë. Vetëm për qëllime të të kuptuarit të gërmës përkatëse ‘a’ të nenit në fjalë, vlen të përmendet edhe hartimi dhe miratimi i strategjisë ndërsektoriale të drejtësisë 2017-2020 dhe të planit të saj veprimi³⁰ i cili për qëllime të objektivit 3 të saj “Përmirësimi i funksionimit të sistemit gjyqësor duke forcuar efektivitetin, transparencën dhe qasjen në pajtim me standardet evropiane” ka miratuar edhe strategjinë dhe planin e veprimit në fushën e ndihmës juridike. Strategjia ndërsektoriale e drejtësisë që do të miratohet për vitet në vazhdim dhe planet e veprimit përkatës duhet të konsiderohen dhe zbatohen.

¹⁹ Ligji nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

²⁰ Ligj nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”.

²¹ Ligj nr.8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar me Ligjin nr.9112 datë 24.7.2003, Ligjin nr.9694 datë 19.3.2007, Ligjin nr.33/2012 datë 21.3.2012, Ligjin nr.40/2017 datë 30.3.2017.

²² Neni 2 i Ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar.

²³ Ligj nr.9000, datë 30.1.2003, Neni 6, ‘Ministri dhe zëvendësministri’: “1. Ministri, përveç kompetencave ose detyrave që parashikohen në Kushtetutë dhe në ligje të veçanta, ushtron edhe detyra të tjera, që i ngarkohen nga Këshilli i Ministrave ose nga Kryeministri”.

²⁴ Neni 80: “2. Anëtar i Këshillit të Ministrave ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Kuvendit ose të komisioneve të tij; atij i jepet fjala sa herë që e kërkon”.

²⁵ Neni 100: “2. Këshilli i Ministrave merr vendime me propozim të Kryeministrit ose të ministrit përkatës. 4. Aktet e Këshillit të Ministrave janë të vlefshme, kur nënshkruhen nga Kryeministri dhe ministri propozues”.

²⁶ Neni 104: “4. Ministri, brenda drejtimeve kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, drejton nën përgjegjësinë e tij veprimtarinë që ka në kompetencë. Ministri, në zbatim të kompetencave të tij, nxjerr urdhra dhe udhëzime”.

²⁷ Neni 116: “3. Aktet normative të ministrave dhe të organeve drejtuese të institucioneve të tjera qëndrore kanë fuqinë të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë brenda sferës së juridiksionit të tyre”.

²⁸ Neni 119: “1. Rregulloret e Këshillit të Ministrave, të ministrave e të institucioneve të tjera qëndrore, sidheurdhurat e Kryeministrit, të ministrave e të drejtuesve të institucioneve qëndrore kanë karakter të brendshëm dhe janë të detyrueshme vetëm për njësitë administrative që varen prej tyre”.

²⁹ Raporti i Komitetit Shqiptar të Helsinkit, shkurt 2019

³⁰ Vendim i Këshillit të Ministrave nr.773 datë 2.11.2016 “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të drejtësisë 2017-2020 dhe të planit të saj të veprimit”.

Në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e Ministrit të Drejtësisë të përcaktuara në nenin 7 pika 'b', buxheti për ndihmën juridike duhet të propozohet dhe të ndiqet deri në miratim në përputhje me legjislacionin përkatës për procedurën e buxhetimit shtetëror dhe, mbi të gjitha, në Ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë” dhe Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar³¹, veçanërisht nenet 22 deri 31 të këtij të fundit.

Zërat që duhen propozuar në buxhetim në lidhje me ndihmën juridike, duhet të kenë të bëjnë me zëra të tillë, si pagat, shpërblime, sigurime shoqërore e shëndetsore për punonjësit në strukturat përkatëse që japin ndihmë juridike parësore, personel administrativ në Drejtorinë e Ndhmës Juridike, qendrat, etj., por edhe shpenzime në lidhje me avokatët që do të kontraktohen në vite, të caktuar për dhënien e ndihmës juridike dytësore. Po kështu, kujdes duhet kushtuar gjatë buxhetimit për shpenzimet gjyqësore, përfshirë tarifat gjyqësore, që mundësojnë ofrimin e shërbimeve efektive të ndihmës juridike. Për aq sa mund të jetë a zbatueshme në lidhje me Ligjin nr. 111/2017, kujtojmë se neni 147/a i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se Ministri i Drejtësisë mund të marrë pjesë, pa të drejtë vote, në mbledhjet e Këshillit të Lartë Gjyqësor kur diskutohen çështje që lidhen me planifikimin strategjik dhe buxhetin e pushtetit gjyqësor.

Në lidhje me detyrimet e përcaktuar në nenin 7 pikat 'd' deri 'k' të Ligjit nr. 111/2017, Ministri duhet të miratojë aktet nënligjore sipas përcaktimeve përkatëse të Ligjit nr. 111/2017. Në zbatim të këtij neni, deri në datën e këtij Komentari, Ministri i Drejtësisë ka miratuar aktet e rradhitura shprehimisht në seksionin “Hyrje” të këtij Komentari.

Kryerja e detyrave sipas gërmës 'd' dhe të tjera përkatëse të këtij neni 7, duhet përmbushur nga Ministri i Drejtësisë duke konsideruar edhe udhëzimet përkatëse të parashikuara nga Direktiva 2002/8/EC, veçanërisht neni 13/2³² dhe 16: formularët duhet të jenë në gjuhën shqipe zyrtare dhe, në kushtet që ndihma juridike duhet të jepet edhe të huajve, formularët duhen të jenë të gatshme edhe në gjuhën angleze, si një nga gjuhët zyrtare të BE, formularët duhet të kenë kërkesa të qarta në lidhje me dokumentet e nevojshme që duhet t'i bashkëngjiten formulareve, kur është e zbatueshme, të mos kenë nevojë për legalizim ose

³¹ Ligji nr. 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin nr. 114/2012 datë 7.12.2012, Ligjin nr. 57/2016, datë 2.6.2016.

³² Neni 13/2 i Direktivës 2002/8/EC: “...2.Kërkesat për ndihmë juridike do të plotësohen në, dhe dokumente mbështetëse të përkthyer në: (a) gjuhën zyrtare ose njërin prej gjuhëve të autoritetit kompetent të shtetit anëtar pranues ... ; ...”

formalitete ekuivalent, dhe për të lehtësuar aplikimet dhe për transmetimin e këtyre aplikimeve duhet të krijohet një formë standarde për ndihmën juridike dhe një procedurë e mirëpërcaktuar. Pa kundërshtuar sa më sipër, detyrat e Ministrisë së Drejtësisë në lidhje me ndihmën juridike janë përcaktuar jo vetëm në Ligjin nr. 111/2017 dhe në aktet nënligjore përkatëse, por edhe në legjislacionin tjetër përkatës. Kështu, Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhënie familjare”, i ndryshuar, neni 7 ‘Detyrat e autoriteteve përgjegjëse të linjës’ parashikon shprehimisht “...3. Ministria përgjegjëse për drejtësinë ka këto detyra: ...c) mbikëqyr funksionimin e sistemit të ofrimit të ndihmës juridike për viktimat e dhunës në familje, sipas rregullave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti;...”. Në veçanti, këto akte të tjera duhen konsultuar veçanërisht në funksion të detyrës së Ministrit për të monitoruar cilësinë e ofrimit të ndihmës juridike, në kushtet që dispozitat përkatëse në ligje të tjera parashikojnë detyra specifike në lidhje me zbatimin e ligjit përkatës.

Neni 8

Detyrat e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas

1. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas është person juridik publik nën varësinë e Ministrit të Drejtësisë, në kuptimin e ligjit për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore. Organizimi i brendshëm i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas miratohet nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas rregullohen në bazë të legjislacionit në fuqi për nëpunësit civilë. Marrëdhëniet e punës të punonjësve me trajnim të posaçëm pranë qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe të personelit ndihmës të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas rregullohen sipas Kodit të Punës.

2. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas kryen këto detyra:

a) zbaton politikën shtetërore në fushën e ndihmës juridike;

b) i paraqet Ministrit të Drejtësisë raporte tremujore mbi zbatimin e këtij ligji dhe mbi përdorimin e mjeteve financiare buxhetore të alokuara për ofrimin e ndihmës juridike;

c) vlerëson kostot dhe planifikon shpenzimet e lidhura me dhënien e ndihmës juridike dhe ia paraqet Ministrit të Drejtësisë për t'u përfshirë në buxhetin e shtetit;

ç) menaxhon fondet buxhetore për dhënien e ndihmës juridike;

d) mbledh dhe analizon informacionin mbi dhënien e ndihmës juridike për të përmirësuar funksionimin e sistemit të ofrimit të ndihmës juridike dhe organizon fushatë për rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi ofrimin e ndihmës juridike dhe kushtet për përfitim të saj;

dh) harton raportet vjetore për veprimtarinë e saj në lidhje me zbatimin e këtij ligji dhe të politikës shtetërore në fushën e ndihmës juridike dhe ia paraqet Ministrit të Drejtësisë;

e) bashkëpunon me organizata ndërkombëtare, me klinika ligjore dhe me organizata jofitimprurëse vendase dhe të huaja në zhvillimin e sistemit të ndihmës juridike, nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit dhe edukimit ligjor të publikut;

ë) harton kontratën tip me organizatat jofitimprurëse për shërbimet e ndihmës juridike parësore, sipasparashikimeve të këtij ligji;

f) lidh kontratë me organizatat jofitimprurëse për shërbimet e ndihmës juridike parësore, sipasparashikimeve të këtij ligji dhe kryen pagesat përkatëse;

g) bashkëpunon me Departamentin e Administratës Publike për miratimin e programeve të trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm për punonjësit me trajnim të posaçëm, mbikëqyr zbatimin e tyre dhe rishqyrton periodikisht standardet për trajnimin dhe performancën profesionale të punonjësve me trajnim të posaçëm;

gj) administron, bazuar në urdhrin përkatës të Ministrit të Drejtësisë, qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore, në ambientet e gjykatave të rretheve gjyqësore ose në ambiente të tjera të përshtatshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi për administratën shtetërore;

h) publikon listën e avokatëve, të cilët ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore në faqen zyrtare të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas;

i) publikon kontratën tip me avokatët për dhënien e shërbimeve të ndihmës juridike dytësore, pas miratimit nga Ministri i Drejtësisë;

j) kryen pagesat, bazuar në tarifën përkatëse të shpërblyerit të avokatëve, të cilët ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore, sipas përcaktimeve të këtij ligji;

k) lidh, deri më 1 mars të çdo viti kalendarik, kontratat e përvitshme të shërbimit me avokatët e përfshirë në listën e miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë për ofrimin e ndihmës juridike dytësore;

l) zbaton sistemin e vlerësimit të cilësisë së dhënies së ndihmës juridike;

ll) mbikëqyr çdo vit standardet e ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore dhe dytësore nga organizatat jofitimprurëse dhe avokatët;

m) zbaton rregullat për rimbursimin e pagesave, sipasparashikimeve të këtij ligji dhe mbron interesat e buxhetit të shtetit;

n) harton dhe i propozon Ministrit të Drejtësisë aktet nënligjore, sipasparashikimeve të këtij ligji;

nj) mban, mbledh, plotëson dhe administron të dhënat e regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve të këtij ligji dhe të dhënat e regjistrit të organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore, sipas rregullave dhe procedurave të miratuara nga Ministri i Drejtësisë;

o) kryen të gjitha detyrat e tjera që i caktohen me këtë ligj.

Statusi i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas

Statusi i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas përcaktohet në nenin 8, pika 1, të Ligjit nr. 111/2017. Sipas përcaktimeve të kësaj dispozite, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas është një person publik në varësi të Ministrit të Drejtësisë. Bazuar në nenin 6 ‘Institucionet e varësisë’ të Ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, institucionet e varësisë “krijohen për të kryer ato funksione administrative, të përcaktuara, brenda fushës së përgjegjësisë së përgjithshme shtetërore, kryerja e të cilave kërkon shkallë të lartë specializimi në menaxhim apo drejtim, dhe kanë të bëjnë me zbatimin e drejtpërdrejtë të ligjit, ofrimin e shërbimeve publike për popullatën...”. Bazuar në këtë dispozitë, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas është krijuar për të kryer funksione administrative të përcaktuara në Ligjin nr. 111/2017 dhe që kërkojnë shkallë të lartë profesionalizmi që kanë të bëjnë me zbatimin e drejtpërdrejtë të Ligjit për Ndihmën Juridike Falas. Ky institucion është krijuar me ligj dhe ka personalitet juridik publik. Ministri përgjegjës për Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas është Ministri i Drejtësisë. Sipas nenit 18 ‘Institucionet e varësisë’ të Ligjit nr. 90/2012, si institucion varësie, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas drejtohet dhe përfaqësohet nga drejtori i cili i raporton Ministrit të Drejtësisë.

Sipas nenit 18 pika 4 të Ligjit nr. 90/2012, shërbimet e brendshme mbështetëse, funksionet e menaxhimit

financiar dhe të auditit të brendshëm, etj., në Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas, si një institucion varësie me një numër të madh punonjësish³³, kryhen nga strukturat administrative, që kryejnë shërbimet e brendshme mbështetëse, funksionet e menaxhimit financiar, si dhe auditimin e brendshëm, të cilat janë krijuar brenda institucionit dhe i raportojnë drejtpërdrejt Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas. Sipas Urdhrit të Kryeministrit nr.59 datë 25.03.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas”, struktura e kësaj drejtorie përfshin edhe Drejtorinë e Financës, Arkivit dhe Shërbimeve mbështetëse.

Si institucion publik, financimi i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas bazohet mbi të gjitha në buxhetin e shtetit, duke patur edhe mundësinë të arkëtojë fonde të tjera sipas përcaktimeve të nenit 9 ‘Arkëtimet’ të Ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku një nga të ardhurat është edhe të ardhurat nga grantet³⁴. Kjo i mundëson Drejtorisë në fjalë që, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, të rrisë kapacitetet në ngritje fondesh për të patur financim të mjaftueshëm për zbatimin me cilësi të detyrave dhe përgjegjësi të caktuara me ligj për Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas.


Me tej, sipas nenit 18 pika 6 e Ligjit 90/2012, drejtuesi i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas mund të krijojë, sipas nevojës, grupe pune. Pika 5 e nenit 16 të këtij ligji zbatohet edhe në këtë rast: “5. Për kryerjen e detyrave të përkohshme, komplekse, që kërkojnë një qasje ndërsektoriale, mund të krijohen grupe pune të përbëra nga nëpunës civilë të ministrisë dhe institucioneve të varësisë. Ato mund të përfshijnë edhe ekspertë të jashtëm. Grupet e punës krijohen me urdhr të ministrit apo të sekretarit të përgjithshëm. Nëse nuk parashikohet ndryshe në urdhrin përkatës të krijimit, grupi i punës kryesohet nga anëtarë që ka nivelin më të lartë të nëpunësit civil. Shpërblimi i ekspertëve të jashtëm rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe specifikohet në urdhrin që krijon grupin e punës”.

³³ “5. Në rastin e institucioneve të varësisë të mëdha dhe me veprimtari komplekse, strukturat administrative, që kryejnë shërbimet e brendshme mbështetëse, funksionet e menaxhimit financiar, si dhe auditimin e brendshëm, krijohen brenda institucionit dhe i raportojnë drejtpërdrejt drejtorit apo përkatësisht drejtorit të përgjithshëm të institucionit”.

³⁴ Neni 9 ‘Arkëtimet’ i Ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar: “Arkëtimet përfshijnë, por nuk kufizohen në: a) arkëtime, që lidhen me transaksione të ndërsjellta: i) të ardhurat nga shitja e mallrave dhe shërbimeve ii) të ardhurat nga shitja e aktiveve afatgjata; b) arkëtime, që lidhen me transaksione joreciproke: i) të ardhurat nga tatimet, taksat dhe tarifat ii) të ardhurat nga aktivet në pronësi iii) të ardhurat nga grantet iv) të ardhurat nga kontributet e detyrueshme; c) arkëtime, që lidhen me transaksionet financiare: i) të ardhura nga interesat ii) arkëtime nga huatë iii) të ardhura të tjera, nga ekzekutimi i sanksioneve administrative dhe penale; ç) arkëtimet e kujdestarisë, garancitë dhe mjete të tjera në ruajtje”.

Në lidhje me aspekte të organizimit të strukturës organizative dhe të personelit të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, tashmë është miratuar Urdhri i Kryeministrit nr.59 datë 25.03.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas”.

Sipas këtij Urdhri, struktura e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas është si në tabelën e mëposhtme dhe numri i punonjësve të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas duhet të jetë gjithsej 25 veta. Struktura është ndërtuar dhe miratuar në funksion të detyrave të përcaktuara nga Ligji nr. 111/2017 për këtë drejtori:



Detyrat e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas

Bazuar në nenin 8, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas duhet konceptuar si një organ me detyra rregullatore në sektorin e ndihmës juridike; funksionet operatore ushtrohen nga qendrat e shërbimit dhe operatorët e tjerë të ndihmës juridike parësore ose dytësore, përfshirë edhe avokatët.

Në lidhje me detyrat përkatëse, Drejtoria për Ndhmën Juridike Falas, administron dhe monitoron shpenzimet për ndihmën juridike që rrjedhin si detyrim nga vendimet gjyqësore, mban kontakte me drejtuesit e gjykatave të rretheve gjyqësore për evidentimin e të dhënave të vendimeve për ndihmën juridike falas, menaxhon buxhetin e dhënë për ofrimin e ndihmës juridike nga shteti për të cilën raporton tek Ministri në mënyrë të herëpashershme, lidh kontratat e shërbimit me avokatët për ndihmë juridike pas vendimit gjyqësor në konsultim me Dhomën Kombëtare të Avokatëve sipas përzgjedhjes së aplikuesit, asiston qytetarët për plotësimin e formularëve për t’ju drejtuar gjykatave për kërkesat për ndihmë juridike falas, informon qytetarët për parashikimet e ligjit lidhur me kriteret, procedurat, dokumentacionin dhe kushtet e përfitimit të ndihmës juridike falas nëpërmjet shërbimeve juridike ambulante, publikimeve, fushatave në TV dhe mediane të shkruara, si dhe nëpërmjet masave të tjera të ngjashme, etj³⁵.

Në lidhje me detyrat e përcaktuara nga neni 8, pika 2/a, të Ligjit nr. 111/2017, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas është njësi zbatuese e politikave dhe strategjive mbi

³⁵ Raporti i Komitetit Shqiptar të Helsinkit, shkurt 2019.

ndihmën juridike të zhvilluara nga Ministri i Drejtësisë dhe të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

Në lidhje me detyrat e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas sipas gërmave të mëposhtme të nenit 8 të Ligjit 111/2017 “b) i paraqet Ministrit të Drejtësisë raporte tre mujore mbi zbatimin e këtij ligji dhe mbi përdorimin e mjeteve financiare buxhetore të alokuara për ofrimin e ndihmës juridike; c) vlerëson kostot dhe planifikon shpenzimet e lidhura me dhënien e ndihmës juridike dhe ia paraqet Ministrit të Drejtësisë për t’u përfshirë në buxhetin e shtetit; ç) menaxhon fondet buxhetore për dhënien e ndihmës juridike;...”. Sipas Urdhrit të Kryeministrit nr. 59 datë 25.03.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas”, struktura e kësaj drejtorie përfshin edhe Drejtorinë e Financës, Arkivit dhe Shërbimeve mbështetëse, dhe është pikërisht kjo strukturë që kryen detyrat e përmendura në gërmat ‘b’, ‘c’ dhe ‘d’ të nenit 8 të Ligjit nr. 111/2017. Për më shumë, shih paragrafin përkatës më sipër në lidhje me burimet e financimit të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.

Në lidhje me detyrat e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas sipas gërmave të mëposhtme të nenit 8 të Ligjit nr. 111/2017 “e) bashkëpunon me organizata ndërkombëtare, me klinika ligjore dhe me organizata jofitimprurëse vendase dhe të huaja në zhvillimin e sistemit të ndihmës juridike, nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit dhe edukimit ligjor të publikut; ë) harton kontratën tip me organizatat jofitimprurëse për shërbimet e ndihmës juridike parësore, sipas parashikimeve të këtij ligji; f) lidh kontrata me organizatat jofitimprurëse për shërbimet e ndihmës juridike parësore, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe kryen pagesat përkatëse;...”, është miratuar Urdhri i Ministrit të Drejtësisë nr.226 datë 25.03.2019 “Për miratimin e kontratave të ndihmës juridike të garantuar nga shteti”, përfshirë edhe kontratën tip me avokatët që do të ofrojnë ndihmë juridike dytësore. Këto kontrata standard, pavarësisht se miratohen me akte të Ministrit të Drejtësisë, ato lidhen mes Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe operatorëve të ndihmës juridike parësore ose dytësore. Në thelb, kontrata midis Drejtorisë dhe operatorëve private të ndihmës juridike është një kontratë dypalëshe administrative sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Administrative³⁶.

Në lidhje me detyrat e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas sipas gërmës së mëposhtme të nenit 8 të Ligjit 111/2017 “dh) harton raportet vjetore për veprimtarinë e saj në lidhje me zbatimin e këtij ligji dhe të politikës shtetërore në fushën e ndihmës juridike dhe ia paraqet

Ministrit të Drejtësisë”, kjo është një detyrë funksionale e cila rrjedh edhe në bazë të Ligjit për Ministrinë e Drejtësisë.

Detyrat në lidhje me ndërgjegjësimin e publikut mbi disponueshmërinë e ndihmës juridike falas dhe kushtet e dhënies së saj (gërma ‘d’ dhe ‘e’ e nenit 8 të Ligjit nr. 111/2017) duhen kuptuar si një detyrë e rëndësishme e kësaj drejtorie që, mbi të gjitha, ndikon në rritjen e efikasitetit të dhënies së ndihmës juridike dhe, si pasojë, edhe të cilësisë së dhënies së ndihmës juridike.

Në lidhje me detyrën e kësaj drejtorie sipas gërmes ‘g’, duhet mbajtur parasysh edhe përkufizimi i “Trajnim i posaçëm” në nenin 3 të Ligjit nr. 111/2017 si “program i trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm, i miratuar nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, për punonjësit që ofrojnë ndihmë juridike parësore në qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore”. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas zhvillon dhe miraton programin e trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm, së bashku me Qendrën e Trajnimeve të Administratës Publike, dhe kjo e fundit është operatori i dhënies së trajnimeve³⁷ dhe certifikimeve përkatëse të punonjësve me trajnim të posaçëm të cilët punojmë në qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore.

Disa nga detyrat e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas bëhen më të qarta duke lexuar formulimet përkatëse të këtij neni me aktet nënligjore përkatëse. Sipas Udhëzimit të Ministrit të Drejtësisë nr.6 datë 25.03.2019, pika 2, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas kryen pagesat e shpenzimeve gjyqësore për dëshmitarët, ekspertët, përkthyesit dhe për këqyrjen e sendeve ose këqyrjen në vend, sipas përcaktimeve të legjislationit procedural, për të cilat gjykata ka vendosur përjashtimin nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore. Po sipas këtij Udhëzimi, pika 1 dhe 2, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas verifikon në mënyrë periodike, çdo vit, gjendjen ekonomike dhe financiare të subjekteve përfituese të ndihmës juridike, si dhe fazën në të cilën ndodhet gjykimi me palë subjektin përfitues, dhe Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas mund të kryejë verifikim në kohë në rast se ka të dhëna apo indicie për ndryshimin e rrethanave.

Hollësi të mëtejshme të detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuara në këtë nen të Ligjit nr. 111/2017 për Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas, parashikohen në aktet nënligjore të dala në zbatim të këtij ligji. Kështu, Udhëzimi nr.1 datë 08.03.2010 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave për mbledhjen, plotësimin dhe miratimin e rregullave dhe procedurave për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave të regjistrave”, është një akt nënligjor i rëndësishëm në këtë kuptim.

³⁷ Pra, është ‘training provider’.

³⁶ Ligji nr.44/2015, datë 30.4.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, neni 3, pika 4: “Kontrata administrative” është një marrëveshje, e cila krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie konkrete, sipas së drejtës publike dhe në të cilën të paktën njëra nga palët kontraktuese është një organ publik”.

Po kështu, Udhëzimi i Këshillit të Ministrave nr.1 datë 06.03.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.4, datë 12.12.2012 “Për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor”, parashikon se në fillim të çdo viti kalendarik, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas publikon listën e ekspertëve të cilët ofrojnë ekspertizë në një proces gjyqësor mbështetur në të dhënat e Regjistrit Elektronik të Ekspertëve që administron Ministria e Drejtësisë. Përfshirja e ekspertëve në listën e publikuar nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas bëhet bazuar në kërkesën dhe vullnetin e shprehur të ekspertit. Referuar parashikimeve të reja të Kodit të Procedurës Civile, të miratuara me Ligjin nr. 38/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8116 date 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ndryshimin e neneve 224 e vijuese që përcakton procedurën e thirrjes së ekspertëve në gjykatë është parashikuar, në rast se lista e publikuar nuk përmban ekspertë në fushën e kërkuar ose kur asnjë nga ekspertët që janë në listë nuk është i disponueshëm, gjykata thërret ekspertë të tjerë të përfshirë në Regjistrin Elektronik të Ekspertëve, në përputhje me veçantinë e fushës së kërkuar. Udhëzimi parashikon se gjykata, pa cënuar administrimin e drejtësisë, shpërndan çështjet gjyqësore për të njëjtën ekspertizë në mënyrë të drejtë ndërmjet ekspertëve të regjistruar në Regjistrin Elektronik të Ekspertëve, duke konsideruar që çdo eksperti nuk mund t’i caktohet për të ofruar ekspertizën e tij, më shumë se 30% e numrit të çështjeve gjyqësore për të cilat është kërkuar e njëjta lloj ekspertize. Në këtë rast, gjykata siguron transparencën e procesit të përzgjedhjes së ekspertit përmes mjeteve informatike.

Edhe akte të tjera nënligjore, si Udhëzimi i Ministrit të Drejtësisë nr.2 datë 25.3.2019 “Për procedurat, periodicitetin dhe rregullat për verifikimin e rrethanave për kthimin e përfitimeve”, etj., parashikojnë më shumë hollësi për detyrat dhe përgjegjësitë funksionale të parashikuara për këtë drejtori në nenin 8 të Ligjit nr. 111/2017 dhe, për këtë arsye, vetë Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas por, edhe çdo palë e interesuar për të kuptuar detyrat dhe përgjegjësitë e kësaj drejtorie, duhet të drejtohet në ligj dhe aktet nënligjore përkatëse.

Neni 9

Detyrat e Dhomës Kombëtare të Avokatisë

Dhoma Kombëtare e Avokatisë kryen këto detyra:

a) miraton me udhëzim të përbashkët me Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore;

b) miraton, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, rregullat për zbatimin e parimit të rotacionit në caktimin e avokatëve që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore, sipas parashikimeve të nenit 24, të këtij ligji, dhe mbikëqyr zbatimin e tyre nga dhomat vendore të avokatisë;

c) brenda datës 1 shkurt të çdo viti kalendarik, Dhoma Kombëtare e Avokatisë miraton listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore dhe ia përcjell këtë listë Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe dhomave vendore të avokatisë. Në hartimin e kësaj liste, Dhoma Kombëtare e Avokatisë mban parasysh, për aq sa është e mundur, përfshirjen e avokatëve të të gjitha specialiteteve dhe niveleve dhe respektimin e barazisë gjinore;

ç) publikon listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore në faqen zyrtare të Dhomës Kombëtare të Avokatisë;

d) përgatit dhe organizon programet e trajnimit të vazhdueshëm për avokatët e përfshirë në listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore, në bashkëpunim me Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas;

dh) kryen detyra të tjera që i caktohen nga ky ligj.

Parashikimet e këtij neni 9 të Ligjit nr. 111/2017 janë të qarta në lidhje me detyrimin e përfshirjes së Dhomës Kombëtare të Avokatisë në ndihmën juridike dytësore. Pra, ndihma juridike parësore nuk është në fokusin e detyrave të Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

Ky nen lexohet që, përcakton jo vetëm detyrat e Dhomës Kombëtare të Avokatisë në fushën e ndihmës juridike, por edhe përcakton disa nga aktet nënligjore të cilat duhet të miratohen në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë. Dhoma Kombëtare e Avokatisë, që merr pjesë në përcaktimin e kriterëve për përzgjedhjen e avokatëve, që japin ndihmën juridike falas dhe specializimin e tyre në fushat përkatëse sipas kërkesave ligjore, merr pjesë në përcaktimin e kriterëve për vlerësimin e cilësisë së shërbimit të dhënë nga avokatët, merr masa disiplinore ndaj avokatëve, që ofrojnë ndihmë juridike falas, etj³⁸.

Kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore, sipas gërmës ‘a’ të nenit 9 të Ligjit nr. 111/2017, duhet të orientohen mbi të gjitha nga parimi i cilësisë së shërbimit të ndihmës juridike dhe profesionalizmit të ofruesve të këtij shërbimi në funksion të aksesit efektiv të individit në drejtësi. Kriteret përkatëse duhet të jenë

³⁸ Raporti i Komitetit Shqiptar të Helsinkit, shkurt 2019.

objektive sa më shumë që të jetë e mundur, duhet të jenë të mirëpërcaktuara dhe shteruese, në mënyrë që gjatë procesit të përzgjedhjes së avokatëve të ketë sa më pak mundësi subjektivizmi. Pa anashkaluar kriteret e nenit 24 ‘Dhënia e ndihmës juridike dytësore nga avokatët’ pika 1 të Ligjit nr. 111/2017³⁹, kritere objektive, të tilla si, pasja e licencës së avokatit të lëshuar rregullisht nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, kohëzgjatja në profesionin e avokatit, kohëzgjatja në dhënien e ndihmës juridike falas, një numër i caktuar për çdo fushë të së drejtës por, gjithnjë duke mbajtur parasysh se në cilat fusha mund të jepet ndihma juridike falas, numër i përcaktuar duke zbatuar barazinë gjinore, duhet të drejtojnë përzgjedhjen e avokatëve të cilët do të kontraktohen për të dhënë ndihmë juridike falas. Duhet kuptuar që jo çdo avokat i licencuar për të ushtruar profesionin në Republikën e Shqipërisë mund të përzgjidhet për të dhënë ndihmë juridike falas; vetëm ata të cilët do të plotësojnë kriteret objektive të mirëpërcaktuara dhe shteruese në udhëzimin e përbashkët të parashikuar në nenin 9 gërma ‘a’ të Ligjit nr.111/2017, do të përzgjidhen të ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore. Në përzgjedhjen e avokatit për të dhënë ndihmë juridike falas, duhet konsideruar edhe nëse avokati ka përmbushur detyrën sipas neni 8 gërma ‘f’ të Ligjit për Ushtrimin e Profesionit të Avokatit në Republikën e Shqipërisë i cili parashikon shprehimisht se avokati “f) merr masat e nevojshme në lidhje me sigurimin e përgjegjësisë profesionale, sipas rregullave të përcaktuara në Statutin e Dhomës së Avokatisë të Shqipërisë”. Zbatimi i këtij kriteri do të ishte një garanci shtesë për sigurimin në mënyrë efektive të cilësisë dhe profesionalizmit gjatë dhënies së ndihmës juridike falas.

Në lidhje me këtë detyrë të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, udhëzimi i përbashkët të lexohet në mënyrë të tillë që të mundësohet që në vitet e para të zbatimit të Ligjit nr. 111/2017 e derisa të krijohen kapacitetet përkatëse, në rrethe të tjera avokatësh nëpërmjet trajnimeve të specializuara, etj., të përzgjidhen avokatë të cilët që nga viti 1990 kanë dhënë shërbimin e ndihmës juridike falas, përfshirë këtu si avokatët në profesion të lirë që kanë punuar me ndihmën juridike kryesisht, ashtu edhe avokatët të kontraktuar nga operatorët joqeveritarë të ndihmës juridike falas. Sa më sipër, është në funksion të cilësisë së dhënies së ndihmës juridike falas për akses efektiv.

Sipas përcaktimit përkatës të Ligjit nr. 111/2017, kriteret

³⁹ Neni 24 ‘Dhënia e ndihmës juridike dytësore nga avokatët’ “1. Avokatët që japin shërbimet e ndihmës juridike dytësore plotësojnë këto kushte: a) kanë aplikuar në Dhomën Kombëtare të Avokatisë dhe janë përfshirë në listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore; b) kanë lidhur një kontratë vjetore shërbimi me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas; c) janë caktuar për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike dytësore nga organi procedues ose dhoma vendore e avokatisë; ç) janë të specializuar në fushat e së drejtës, kur specializimi është i nevojshëm, si në rastin e përfaqësimit të të miturve, të viktimave dhe në raste të tjera të parashikuara me ligj”.

dhe procedurat për përzgjedhjen e avokatëve miratohen me udhëzim të përbashkët të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas dhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë⁴⁰.

Për sa ka të bëjë me detyrat e përcaktuara për Dhomën Kombëtare të Avokatisë në pikat ‘b’ dhe ‘c’ të këtij neni, në lidhje me emërimin e avokatëve në listën për dhënien e ndihmës juridike kemi konkurim të parimit të rotacionit me parimin e cilësisë dhe profesionalizmit në dhënien e ndihmës juridike falas. Parimi i rotacionit siguron transparencën dhe barazinë në kontraktimin e avokatëve të cilët paguhen me fonde shtetërore. Pavarësisht nga kjo, në kushtet që mbizotëron parimi i cilësisë dhe profesionalizmit në dhënien e ndihmës juridike në funksion të përmirësimit të funksionimit të sistemit të drejtësisë dhe mbrojtjes efektive të të drejtave ligjore dhe kushtetuese të individit, gjatë miratimit të listave vjetore, është e rëndësishme që Dhoma e Avokatisë të mbajë në vëmendje, si fushën e së drejtës për të cilën është i specializuar avokati përkatës, ashtu edhe cilësinë e formimit profesional të tij/saj.

Në lidhje me gërmën ‘d’ të nenit 9 të Ligjit nr. 111/2017, vëmendje duhet kushtuar në detyrën e dhomave vendore të avokatisë për të monitoruar zbatimin e parimit të rotacionit sipas parashikimeve të nenit 24 të Ligjit 111/2017⁴¹. Është e vetkuptueshme që kjo detyrë duhet lexuar në lidhje me të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e dhomave vendore të avokatisë të përcaktuara në Ligjin për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë. Legjitimimi i procedimit disiplinor mund të bazohet edhe në rastet e moszbatimit të detyrimeve për dhënien e ndihmës juridike kur avokati përcaktohet në bazë të parimit të rotacionit.

Detyrimi për përgatitjen e listës së avokatëve rrjedh edhe nga neni 28 gërma ‘e’ dhe ‘ë’ e Ligjit nr. 55/2018 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë” të cilat parashikojnë respektivisht dhe shprehimisht se Komiteti Drejtues i Dhomës Kombëtare të Avokatisë“, e) çdo fillim viti përgatit listën e mbrojtësve, në rastin e dhënies së mbrojtjes së detyrueshme, dhe ia vë në dispozicion organit procedues, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale, ë) përgatit listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore, sipas legjislacionit në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti; ...”. Parimi i rotacionit në përzgjedhjen e avokatëve është risia që sjell në këtë aspekt Ligji nr. 111/2017.

Në lidhje me gërmën ‘e’ të nenit 28 të Ligjit 111/2017, është e rëndësishme të kujtojmë që objekt i këtij ligji

⁴⁰ Në datën e këtij komentari, udhëzimi i përbashkët i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas dhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë mbi kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e avokatëve, është ende për t’u miratuar.

⁴¹ Ligji 111/2017, neni 24 ‘Dhënia e ndihmës juridike dytësore nga Avokatët’.

është “Ndihmë juridike dytësore”, pra, edhe shërbimi juridik që ofrohet në çështjet penale, për të cilat nuk zbatohet mbrojtja e detyrueshme, sipas përcaktimeve të legjislacionit procedural penal.

Procesi i emërimit të avokatëve, publikimi i listës përkatëse, mënyra dhe procedura se si individët kërkes të ndihmës juridike falas vihen në dijeni të listës dhe se si mund të vendosin marrëdhënien e drejtpërdrejtë avokat me klient, pavarësisht se avokatët financohen nga shteti dhe për klientet përkatës shërbimi i ndihmës ligjore është falas, e të tjera aspekte që ndikojnë në këtë marrëdhënie, etj., duhet të jenë të qarta, por edhe të krijojnë eficiencë kohore dhe financiare, si dhe potencialin për maksimizimin e cilësisë dhe profesionalizmit të shërbimit ligjor gjatë dhënies së ndihmës juridike falas⁴². Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas bën përpjekjet maksimale në kuadrin ligjor ekzistues që të përqëndrojë këtë proces para publikut mundësisht vetëm në një institucion të vetëm për të lehtësuar aksesin e kërkesve përkatës në ndihmën juridike falas. Parashikimet e Ligjit nr. 111/2017, kanë parashikuar detyrime të ndryshme për Ministrinë e Drejtësisë, gjykatat dhe Dhomën Kombëtare të Avokatisë (apo dhomat vendore të avokatisë)⁴³ në përbashkëtim me kërkuarët e ndihmës juridike falas dhe, në këto kushte, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, nëpërmjet portaleve online të integruara, të krijojë sistem të njëjtë ‘one stop shop’ për të shmangur vështirësitë në aksesin e kërkuarëve në ndihmën juridike falas, por edhe për të maksimizuar eficiencën financiare dhe kohore të proceseve përkatëse.

Detyra e Dhomës Kombëtare të Avokatisë sipas përcaktimit të nenit 9 germa ‘d’ të Ligjit nr. 111/2017, “d) përgatit dhe organizon programet e trajnimit të vazhdueshëm për avokatët e përfshirë në listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore, në bashkëpunim me Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas;...”, duhet parë e lidhur me detyrat e Dhomës Kombëtare të Avokatisë për trajnimin e vazhduar të avokatëve nëpërmjet Shkollës së Avokatisë. Shih neni 54 i Ligjit nr. 55/2018 “Për profesionin e avokatit” i cili parashikon: “3. Avokatët që do të përfshihen në listën e Dhomës së Avokatisë të Shqipërisë për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike dytësore, kryejnë trajnim specifik mbi fusha të së drejtës të lidhura me kategoritë përfituese të ndihmës juridike dytësore, sipas legjislacionit në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti.” Pra, neni 9 i Ligjit nr. 111/2017 ka të bëjë me trajnimin e vazhduar të specializuar në fushën e ndihmës juridike të atyre avokatëve të cilët përzgjidhen për të dhënë ndihmën juridike falas sipas udhëzimit

⁴² Raporti i Avokatit të Popullit në Kuvendin e Shqipërisë, datë 30.05.2019.

⁴³ Sipas nenit 9 të Ligjit 111/2017, Dhoma Kombëtare e Avokatisë “ç) publikon listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore në faqen zyrtare të Dhomës Kombëtare të Avokatisë”.

të përbashkët të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë, parashikuar në gërmën ‘a’ të nenit 9 të Ligjit nr. 111/2017.

KREU III

PËRFITUESIT E NDIHMËS JURIDIKE TË GARANTUAR NGA SHTETI

Në Kreun III të Ligjit nr. 111/2017, parashikohen llojet e shërbimeve të ndihmës juridike, përfituesit dhe kriteret për përfitimin e saj. Sipas ligjit shërbimet e ndihmës juridike të ofruara janë: ndihma juridike parësore, ndihma juridike dytësore, dhe përjashtimi nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore.

Subjektet përfituese të ndihmës juridike janë: shtetasit shqiptarë me vendbanim në territorin e Republikës së Shqipërisë, shtetasit e huaj që e përfitojnë atë mbi bazën e parimit të reciprocitetit, si dhe personat pa shtetësi.

Neni 10

Përfituesit e ndihmës juridike

1. Subjekte përfituese të ndihmës juridike janë:

a) shtetasit shqiptarë me vendbanim ose vendqëndrim në territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi, të cilët qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë për një periudhë të përkohshme ose të përhershme dhe janë të pajisur me leje qëndrimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të huajt;

c) shtetasit e huaj, ose personat pa shtetësi, që hyjnë në mënyrë të rregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që përfitojnë mbi bazën e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë ose bazuar në parimin e reciprocitetit;

ç) azilkërkuarët, personat që gëzojnë statusin e refugjatit dhe personat që janë në proces ankimi të vendimeve administrative dhe/ose gjyqësore për refuzimin e aplikimit për azil ose revokimin e vendimit të statusit të refugjatit, sipas legjislacionit në fuqi për azilin në Republikën e Shqipërisë.

2. Subjektet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, përfitojnë ndihmë juridike, nëse përmbushin kushtet e parashikuara nga ky ligj.

Së pari, ky nen është në përputhje me dispozitat përkatëse të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e cila në nenin 16 parashikon se: *“1. Të drejtat e liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë vlejnë njëlloj edhe për të huajt e për personat pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur Kushtetuta e lidh në mënyrë të posaçme me shtetësinë shqiptare ushtrimin e të drejtave e të lirive të caktuara”.*

Për qëllime të këtij neni, në lidhje me shtetasit shqiptarë si përfitues të ndihmës juridike, kujtojmë që Ligji nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare” duhet konsultuar në lidhje me përkufizimet se cilët quhen shtetas shqiptar sipas këtij ligji apo edhe për ata që kanë patur shtetësinë shqiptare para hyrjes në fuqi të këtij ligji. Po kështu, përmbatja e nenit 19 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë mund të shërbejë për qëllime të skenarëve të veçantë gjatë dhënies së ndihmës juridike *“1. Kushdo që lind duke pasur qoftë edhe njërin prej prindërve me shtetësi shqiptare, e fiton vetiu shtetësinë shqiptare. Shtetësia shqiptare fitohet edhe për shkaqe të tjera të parashikuara me ligj. 2. Shtetasi shqiptar nuk mund ta humbasë shtetësinë, përveçse kur ai heq dorë prej saj”.*

Për qëllime të pikës 1/a të këtij neni, kujtojmë që nenit 12 i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë parashikon se banimi është vendi ku personi, për shkak të punës apo të shërbimit të përhershëm, të ndodhjes së pasurisë apo të realizimit të interesave të veta, qëndron zakonisht ose të shumtën e kohës dhe se personi nuk mund të ketë njëkohësisht me shumë se një vendbanim. Më tej, kujtojmë edhe nenin 14 të këtij Kodit Civil i parashikon shprehimisht se vendqëndrimi i personit është vendi ku ai ndodhet për të kryer punë ose detyra të caktuara, për të vazhduar një shkollë ose kurs të caktuar, për t’u mjekuar, për të vuajtur një dënim penal, dhe për raste të tjera të kësaj natyre.

Në lidhje me përfituesit e ndihmës juridike të përcaktuar në nenin 10 pika 1/b, është e rëndësishme të referohemi mbi të gjitha në dispozitat e Ligjit nr.108/2013 “Për të huajt”, i ndryshuar me Ligjin nr.74/2016, datë 14.7.2016. Neni 3 përkufizon se “I huaj” është çdo person, me ose pa shtetësi, i cili, sipas legjislacionit shqiptar, nuk është shtetas shqiptar. Po kështu, ky nen përkufizon se “Person pa shtetësi” është personi, i cili nuk ka shtetësinë e asnjë shteti.

Për qëllime të kuptimit dhe zbatimit të nenit 10 pika 1/b, konsultojmë edhe dispozitat në lidhje me lejet e qëndrimit të përkohëshme dhe të përhershme sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Ligj nr.108/2013 parashikon se ‘Lejeqëndrimi’ është dokumenti i lëshuar nga autoritetet kompetente, i cili autorizon dhe lejon të

huajin të qëndrojë në Republikën e Shqipërisë më shumë se 90 ditë brenda 180 ditëve. Më tej, ky ligj në nenin 37 e vijues parashikon për ‘lejeqëndrimi e përkohëshme’: *“I huaji pajiset me leje të përkohëshme qëndrimi, e cila është e vlefshme për periudhën e përcaktuar në aplikim, por jo më shumë se një vit kur aplikohet përherë të parë, nëse nuk është e përcaktuar ndryshe në këtë ligj apo marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë. I huaji, i pajisur me leje të përkohëshme të qëndrimit me afat të paktën 1-vjeçar, quhet banor i përkohshëm në Republikën e Shqipërisë vetëm pasi regjistrohet në zyrat e gjendjes civile të njësive të qeverisjes vendore, ku ka vendqëndrimin e përkohshëm, si dhe duhet të njoftojë autoritetet përgjegjëse sa herë ndryshon vendqëndrimin, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Procedura dhe formulari i regjistrimit të të huajit në gjendjen civile miratohet me udhëzim të Ministrit të Brendshëm”.*

Në lidhje me lejen e qëndrimit të përhershëm, neni 61 e vijues i Ligjit nr. 108/2013 parashikon se *“I huaji bën kërkesë për pajisje me leje të përhershme qëndrimi të tipit “C” (Tipi C / Kartë Blu AL-C); Leja e qëndrimit e përhershme, qëndrim jashtë territorit jo më shumë se 12 muaj pa ndërprerje, pranë autoritetit përgjegjës rajonal për kufirin dhe migracionin ku ka vendqëndrimin, 60 ditë para mbarimit të afatit të lejes së qëndrimit në rast se rezultojnë të jenë përmbushur kushtet si më poshtë: a) ka qëndruar në mënyrë të ligjshme dhe të vazhdueshme si banor në Republikën e Shqipërisë, për të paktën 5 vite nga paraqitja e parë e kërkesës për leje qëndrimi, përjashtuar rastet kur përcaktohet ndryshe në këtë ligj, me marrëveshjen ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë apo vendim të Këshillit të Ministrave; b) provon se zotëron të ardhura dhe burime financiare të ligjshme, të cilat janë të mjaftueshme dhe garantojnë qëndrueshmëri dhe vazhdimësi për jetesën e tij/saj, si dhe anëtarë vetë familjes së tij/saj, pa pasur nevojë t’i drejtohen sistemit të asistencës sociale; c) provon se ka të mbuluar sigurimin shëndetësor, sipas sistemit të sigurimit shëndetësor për shtetasit shqiptarë në Republikën e Shqipërisë; ç) ka të garantuar strehim të përshtatshëm për vete dhe anëtarët e familjes së tij në Republikën e Shqipërisë; d) provon se ka paguar rregullisht të gjitha taksat dhe detyrimet në Republikën e Shqipërisë gjatë kohës së qëndrimit; dh) gëzon statusin ligjor të refugjatit në Republikën e Shqipërisë, të fituar në përputhje me legjislacionin në fuqi për azilin.”*

Është përkatëse të kujtojmë që në çështjen *Biba kundër Greqisë*, GJEDNJ në vendimin përkatës shkruan se GJEDNJ ka konstatuar shkelje të Konventës kur shteti përkatës nuk i ka ofruar ndihmë juridike një të huaj dhe një emigrant, në kushtet kur të dy këta kërkuar kishin mungesë të të ardhurave.

Më tej, e rëndësishme për efekte të kategorisë së përcaktuar në nenin 10 pika 1/b është që të merren në vlerësim edhe dispozitat e nenit 22, 44, 71 të Ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt” dhe të legjislacionit për nxitjen e punësimit⁴⁴, në të cilat parashikohen edhe disa devijime përkatëse nga rregullat e përgjithshme të parashikuara në Ligjin “Për të Huajt”, që kanë të bëjnë me përjashtimet nga leja e qëndrimit, llojet e veçanta të lejeve të qëndrimit, etj.

Në lidhje me përfituesit e ndihmës juridike të përcaktuar në nenin 10 pika 1/c, është e rëndësishme të referohemi në marrëveshjet përkatëse bilaterale apo multilaterale të bashkëpunimit reciprok apo të investimeve, ku parashikohen edhe përjashtime nga marrja e lejeve të përkohëshme apo të përhershme të qëndrimit sipas Ligjit “Për të huajt”, apo ku parashikohen edhe derogime të tjera.

Në lidhje me përfituesit e ndihmës juridike të përcaktuar në nenin 10 pika 1/d, duhet të referohemi edhe në dispozitat e Ligjit nr.121/2014 “Për azilkërkuarit në Republikën e Shqipërisë”. Neni 3 përcakton si “azilkërkuar” çdo të huaj apo persona pa shtetësi, që shprehin në çfarëdolloj mënyre se nuk dëshirojnë të kthehen në vendin e tij/saj, si dhe çdo i/e huaj apo person pa shtetësi që ka paraqitur një aplikim për azil në Republikën e Shqipërisë, për të cilin nuk është marrë ende një vendim përfundimtar. Pika 1/d e këtij neni duhet lexuar për të drejtën që kanë për ndihmë juridike edhe personat që janë në proces ankimi të vendimeve administrative dhe/ose gjyqësore për refuzimin e aplikimit për azil ose revokimin e vendimit të statusit të refugjatit, sipas legjislacionit në fuqi për azilin në Republikën e Shqipërisë.

E rëndësishme për të marrë parasysh për efekte të kategorive të përfituesve të ndihmës juridike është edhe parimi i mosdiskriminimit i përcaktuar në Kushtetutën e Shqipërisë, etj. Gjejmë me vend të kujtojmë që Direktiva 2002/8/EC, në nenin 4 *‘Mosdiskriminimi’ parashikon se “Shtetet Anëtare do të japin ndihmë juridike pa diskriminim në Qytetarët e Unionit dhe shtetasit e vendeve të treta që banojnë në mënyrë të ligjshme në një shtet anëtar”.*

Në pikën 2 të nenit 10, parashikohet shprehimisht se subjektet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, përfitojnë ndihmë juridike, nëse përmbushin kushtet e parashikuara nga ky ligj. Kjo dispozitë të orientojnë që gjatë zbatimit të ligjit të mbahet në vëmendje që e drejta e subjekteve të parashikuara në pikën 1 të nenit 10 duhet të testohet me kriteret e përzgjedhmërisë, etj., të parashikuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore përkatëse.

Në lidhje me provueshmërinë e faktit që personi aplikant për ndihmë juridike plotëson kushtet përkatëse (shih më sipër kushtet dhe kërkesat për përfituesit e ndihmës ligjore sipas këtij neni), kërkesa e ofruesit të ndihmës juridike për aktet përkatëse administrative, vendimet gjyqësore, dhe dokumentet e tjera përkatëse, legjitimohen nga nevoja për të provuar përmbushjen e kërkesave dhe kriterëve ligjore të përzgjedhmërisë, krahas plotësimit të formularëve, etj., përkatës.

Neni 11

Kategoritë e veçanta të përfituesve të ndihmës juridike

Ndihma juridike i ofrohet personave të mëposhtëm, pavarësisht të ardhurave dhe pasurisë së tyre:

- a) viktimave të dhunës në familje;
- b) viktimave të abuzuar seksualisht dhe viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, në çdo fazë të procedimit penal;
- c) viktimave të mitur dhe të miturve në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimit penal;
- ç) fëmijëve, të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoqërore;
- d) fëmijëve nën kujdestari, të cilët kërkojnë të nisin një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor;
- dh) personave që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, duke përfshirë edhe personat që përfitojnë nga statusi i të verbrit;
- e) personave, të cilët i nënshtrohen trajtimit të pavullnetshëm në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për shëndetin mendor;
- ë) personave, të cilët i nënshtrohen trajtimit vullnetar në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor për sëmundjet e rënda mendore;
- f) personave, ndaj të cilëve kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar, në çdo fazë të këtij procesi;
- g) personave, të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, që kërkojnë të nisin një proces kundër kujdestarit të tyre ligjor, për rifitimin e zotësisë për të vepruar, pa miratimin e kujdestarit ligjor;

⁴⁴ Ligji 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”

gj) personave, të cilët janë përfitues të skemave të mbrojtjes sociale;

h) personave, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

Për të drejtat procedurale, Ligji “Për Ndihmën Juridike” zgjeron kategorinë e personave që përfitojnë ndihmë juridike dhe prezanton konceptet e ndihmës juridike parësore dhe dytësore⁴⁵.

Ky nen përcakton përfituesit e ndihmës juridike, të cilët janë përfitues pavarësisht të ardhurave dhe pasurisë së tyre. Këta përfitues kategorizohen si kategori e veçantë për shkak të cilësisë së tyre. Nga pikëpamja e kategorisë përfituese, Ligji nr. 111/2017 sanksionon qartësisht dhe kodifikon kategoritë përfituese, duke e zgjeruar rrethin e tyre, me kategoritë e veçanta të përfituesve, pavarësisht të ardhurave dhe pasurive⁴⁶, si: viktimat të dhunës në familje, viktimat të abuzuar seksualisht, dhe viktimat të trafikimit të qenieve njerëzore në çdo fazë procedimi penal, viktimat të mitur dhe të miturve në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimit penal, fëmijët që jetojnë në institucione të përkujdesit shëndetësor, fëmijët nën kujdestari kur duan të nisin veprime kundër kujdestarit, ose pa pëlqimin e tij, personat që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar, personat që i nënshtrohen trajtimit të pavullnetshëm në institucionet e shërbimit mendor, personat të cilët i nënshtrohen vullnetarisht trajtimit për sëmundje të rënda mendore, personat ndaj të cilëve kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar, personat të cilët janë përfitues të skemave të mbrojtjes sociale, personat të cilat janë diskriminuar, i provuar ky cenim përmes vendimi të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Në lidhje me përfituesit e ndihmës juridike për kategorinë e veçantë të përfituesve të përcaktuar në nenin 11 pika ‘a’, pra, *viktimave të dhunës në familje*, është e rëndësishme të referohemi në përkufizimet e Ligjit nr. 9669⁴⁷ datë 18.12.2006 “Për masa kundër dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar me Ligjin nr. 47/2018. Sipas këtij ligji, “viktimë” është personi mbi të cilin është ushtruar dhuna e përcaktuar në pikën 1 të

nenit 3: “1. “Dhunë” është çdo veprim ose mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik”.

Përkufizimet dhe parashikimet e mëposhtme ndihmojnë për identifikimin me të saktë të kësaj kategorie të veçantë: Neni 3, pika 2: “Dhunë në familje” është çdo akt dhune, i përcaktuar si pas pikës 1, të këtij neni, që ndodh brenda familjes ose njësisë shtëpiake, e ushtruar ndërmjet pjesëtarëve të familjes, të përcaktuar në pikën 7, të këtij neni, që janë ose kanë qenë në marrëdhënie familjare, pavarësisht nga fakti nëse dhunuesin ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën”. Neni 3, pika 7, parashikon: “Pjesëtarë të familjes” janë: a) bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja apo ish-bashkëshorti/ja apo ish-partneri/ja bashkëjetues; b) vëllezërit, motrat, përfshirë, sipas rastit, edhe bashkëshortin/en ose bashkëjetuesin/en e tyre, si dhe nipin e mbesën, nëse këta të fundit janë anëtarë të njësisë shtëpiake; c) paraardhësit dhe pasardhësit në vijë të drejtë, pa kufizime, përfshirë edhe rastet kur kjo marrëdhënie krijohet nëpërmjet birësimi; ç) prindërit e bashkëshortit/es ose të bashkëjetuesit/es, përfshirë dhe thjeshtin/thjeshtren, edhe sikur kjo lidhje të burojë nga birësimi; d) gjinia në vijë të drejtë, përfshirë edhe prindërit, edhe fëmijët e birësuar të bashkëshortit/es ose bashkëjetuesit/es; dh) vëllezërit dhe motrat e bashkëshortit, bashkëshortes, bashkëjetuesit/es; e) fëmijët e bashkëshortëve ose partnerëve bashkëjetues; ë) personat, të cilët janë ose kanë qenë në marrëdhënie intime, jo domosdoshmërisht të shoqëruar me bashkëjetesë, gëzojnë të njëjtën mbrojtje; f) kujdestari dhe personi që ndodhet në kujdesin e tij gjatë kohës që vazhdon kujdestaria, sipas përcaktimeve të kujdestarisë mbi të miturit dhe kujdestarisë për personat me aftësi të kufizuar dhe personit që i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar sipas dispozitave të Kodit të Familjes”.

Në lidhje me përfituesit e ndihmës juridike për kategorinë e veçantë të përfituesve të përcaktuar në nenin 11 pika ‘b’, pra, viktimave të abuzuar seksualisht dhe viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, në çdo fazë të procedimit penal, është e rëndësishme që para së gjithash t’i referohemi neneve përkatëse të Kodit Penal (nenet në Kreun II, Seksioni VI ‘Krime seksuale’, dhe nenet 110/a dhe 128/b) dhe Kodit të Procedurës Penale (neni 58, 58/a, 58/b) ku lexohen elemente që mund të përdoren për të përkufizuar kategoritë e viktimës së abuzuar seksualisht dhe viktimës së trafikimit të qenies njerëzore. Për të identifikuar sa më mirë kategorinë e viktimave të trafikimit të qenies njerëzore është e rëndësishme t’i referohemi edhe nenit 4 të Konventës së Këshillit të Europës për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore, ratifikuar me Ligjin nr.9642, datë

⁴⁵ Progres Raporti i vitit 2019 i Komisionit Evropian (faqja 28).

⁴⁶ Raport i Komitetit Shqiptar të Helsinkit, shkurt 2019.

⁴⁷ Ligji nr.9669 datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar “Neni 2, Objekti: Ky ligj ka si objekt: a) krijimin e një rrjeti të koordinuar institucionesh përgjegjëse për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave, lehtësimin e pasojave dhe parandalimin e dhunës në familje; b) orientimin e punës për krijimin e strukturave dhe organeve përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor për mbështetjen e viktimave dhe parandalimin e dhunës në familje; c) fuqizimin e sistemit gjyqësor për marrjen e masave të mbrojtjes ndaj dhunës në familje; ç) sigurimin/garantimin për viktimat e dhunës në familje të shërbimit të shpejtë, të pakushtueshëm dhe të thjeshtë në përputhje me ligjin, pranë gjykatës apo organeve të tjera kompetente për zbatimin e ligjit”.

20.11.2006, ku lexojmë këtë përkufizim: “Viktimë” do të nënkuptojë çdo person fizik që është objekt i trafikimit të qenieve njerëzore, siç përcaktohet në këtë nen”. Konsultimi i sa më sipër do të lehtësojë identifikimin e këtyre grupeve për efekte të përfitimit të ndihmës juridike.

Në lidhje me përfutuesit e ndihmës juridike për kategorinë e veçantë të përfutuesve të përcaktuar në nenin 11 pika ‘c’, pra, *viktimave të mitur dhe të miturve në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimit penal*, duhet të referohemi në përkufizimin e Kodit Civil, neni 9: “I mituri me moshë katërbëdhjetë vjeç deri në tetëmbëdhjetë vjeç, i cili është i pazoti të kujdeset për punën e tij për shkak sëmundjesh psikike ose zhvillimi të metë mendor, mund t’i hiqet zotësia për të kryer veprime juridike me vendim të gjykatës. Këto veprime mund të kryhen vetëm nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor”. E rëndësishme është edhe konsultimi me Ligjin nr.37/2017 “Kodi i drejtësisë penale për të mitur”, ku neni 3 përkufizon termin “I mitur në konflikt me ligjin”⁴⁸ (shih më poshtë për përkufizimin përkatës).

Në lidhje me kategoritë e veçanta të përcaktuara në pikat a, b, c, të nenit 11 kur janë viktimave të veprave penale vlen të përmendet se e drejta për ndihmë juridike, krahas të drejtave të tjera, rrjedh edhe nga dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale: Neni 58 ‘Të drejtat e viktimës së veprës penale’ parashikon: “1. Viktimave të veprës penale ka të drejtë: ... b) të përfitojë kujdes mjekësor, ndihmë psikologjike, këshillim dhe shërbime të tjera të ofruara nga autoritetet, organizatat ose institucionet përgjegjëse për ndihmën ndaj viktimave të veprës penale; ... ç) të zgjedhë mbrojtës dhe, kur është rasti, të përfitojë ndihmë juridike falas, sipas legjislacionit në fuqi; ... gj) të përjashtohet, në kushte të caktuara me ligj, nga pagimi i çdo shpenzimi për marrjen e akteve dhe tarife gjyqësore për paraqitjen e kërkesë-padisë që lidhen me statusin e viktimës së veprës penale; ... i) të dëgjohet nga gjykata, edhe kur asnjëra nga palët nuk ka kërkuar thirrjen e saj si dëshmitar, etj.”

Në lidhje me përfutuesit e ndihmës juridike për kategorinë e veçantë të përfutuesve të përcaktuar në nenin 11, pika ‘g’ dhe ‘h’, pra, *personave, të cilët i nënshtrohen trajtimit të pavullnetshëm në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për shëndetin mendor, dhe personave të cilët i nënshtrohen*

⁴⁸ “Neni 20 Ndhma ligjore dhe psikologjike e të miturit 1. Në çdo fazë të drejtësisë penale për të mitur çdo i mitur në konflikt me ligjin ose viktimë ka të drejtë për ndihmë ligjore dhe psikologjike, pa pagesë, të garantuar nga shteti, sipas legjislacionit përkatës. 2. Dëshmitarët të mitur i garantohet ndihma psikologjike falas kur për këtë të fundit është e nevojshme.”

“Neni 36 Ndhma juridike për të miturin viktimë 1. I mituri viktimë ka të drejtë të mbrohet pa pagesë gjatë gjithë procesit të drejtësisë nga një avokat, të cilin e zgjedh nga lista përkatëse e hartuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatëve. 2. Për të miturin shtetas i huaj viktimë dhe dëshmitar zbatohen parashikimet e nenit 51 të këtij Kodi.”

trajtimit vullnetar në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor për sëmundjet e rënda mendore, duhet të referohemi në përkufizimet përkatëse të parashikuara në Ligj nr.44/2012 “Për shëndetin mendor” dhe Kodin e Procedurës Penale.

Ligj nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor”, neni 3 përkufizon si më poshtë: “... 10. “*Trajtim i vullnetshëm*” është trajtimi me kërkesë ose miratim të personit që vuan rregullime të shëndetit mendor ose me kërkesë të përfaqësuesit ligjor të të miturit nën moshën 14 vjeç⁴⁹. 11. “*Trajtim i pavullnetshëm*”⁵⁰ është trajtimi i një personi që vuan nga një çrregullim serioz i shëndetit mendor, që kryhet pa miratimin e tij dhe konfirmohet nëpërmjet një vendimi gjyqësor”.

Ligji nr.7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 46 ‘Masat mjekësore të detyrueshme’ parashikon: “1. Në çdo rast kur gjendja mendore e të pandehurit tregon se ai duhet të kurohet, gjykata, vendos, edhe kryesisht shtrimin e të pandehurit në një institucion psikiatrik. 2. Kur është vendosur ose duhet vendosur masa mjekësore e detyrueshme për të pandehurin, gjykata urdhëron që i pandehuri të ruhet në një institucion psikiatrik. 3. Gjatë hetimeve paraprake, prokurori i kërkon gjykatës të vendosë për shtrimin e të pandehurit në një institucion psikiatrik dhe kur vonesa paraqet rrezik, urdhëron shtrimin e përkohshëm deri në marrjen e vendimit nga gjykata”.

Në lidhje me përfutuesit e ndihmës juridike për kategorinë e veçantë të përfutuesve të përcaktuar në nenin 11 pika ‘i’, pra personave, ndaj të cilëve kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar, në çdo fazë të këtij procesi, duhet të referohemi në përkufizimin e Kodit Civil Neni 10 i cili parashikon se “Personit madhor, që për shkak sëmundje psikike ose zhvillimi të metë mendor, është tërësisht ose pjesërisht i pazoti të kujdeset për punën e tij, mund t’i hiqet ose kufizohet zotësia për të kryer veprime juridike me vendim të gjykatës”.

Në lidhje me përfutuesit e ndihmës juridike për kategorinë e veçantë të përfutuesve të përcaktuar në nenin 11, pika ‘c’, ‘d’, ‘e’, pra, *viktimave të mitur dhe të miturve në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimit penal; fëmijëve, të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoqërore; fëmijëve nën kujdestari, të cilët kërkojnë të*

⁴⁹ Neni 19 ‘Trajtim i vullnetshëm’ “1. Personi me çrregullime të shëndetit mendor merr trajtim të vullnetshëm në shërbimin e shëndetit mendor të specializuar me shtretër, pas lëshimit të miratimit me shkrim nga ana e tij, me kushtin formimi paraprak. Miratimin për të miturit ose personat me zotësi të kufizuar për të vepruar e lëshon kujdestari ose përfaqësuesi i tyre ligjor”.

⁵⁰ Neni 20 ‘Trajtim i pavullnetshëm’ “1. Subjekti i trajtimit të pavullnetshëm është personi, i cili shtrohet në mënyrë të pavullnetshme në shërbimet e shëndetit mendor të specializuar me shtretër, ose pasi është shtruar në mënyrë të vullnetshme mbahet në mënyrë të pavullnetshme, sipas përcaktimit të mjekut specialist”.

nisin një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor; duhet të referohemi në përkufizimet dhe parashikimet e Ligjit nr.37/2017 “Kodi i drejtësisë penale për të mitur”. Neni 3 parashikon se “I mitur në konflikt me ligjin” është çdo person që ka mbushur moshën e përgjegjësisë penale deri nën moshën 18 vjeç, ndaj të cilit ekziston një dyshim i arsyeshëm se ka kryer një vepër penale, është marrë si i pandehur dhe/ose është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale. Me tej, ky nen perkufizon “I mitur viktimë” është çdo person nën moshën 18 vjeç, të cilit i është shkaktuar dëm moral, fizik ose material, si pasojë e një vepre penale.

Në lidhje me përfituesit e ndihmës juridike për kategorinë e veçantë të përfituesve të përcaktuar në nenin 11 pika ‘f’, personave që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar⁵¹, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, duke përfshirë edhe personat që përfitojnë nga statusi i të verbrit, duhet të referohemi veçanërisht në përkufizimet dhe parashikimet e Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”⁵², Ligjit 57/2019 “Për asistencën sociale” dhe Ligjin nr.8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit”⁵³ për të identifikuar nga pikëpamja strikte ligjore grupet përkatëse për përfitim nga ndihma juridike falas:

- Ligji nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, neni 2 parashikon: “Sigurimi shoqëror i detyrueshëm është jofitimprurës, që mbron me të ardhura: a) Personat e punësuar në lidhje me: invaliditetin, aksidentin në punë dhe sëmundjet profesionale, ; b) personat e tjerë ekonomik aktivë (punëdhënësi dhe të vetëpunësuarit), në lidhje me ... invaliditetin dhe...

- Ligji 57/2019 “Për asistencën sociale”: Neni 2 “Ky ligj ka për qëllim: a) të përcaktojë ndihmën ekonomike

⁵¹ Ligji nr.93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar” “Neni 2. Qëllimi: Ky ligj ka për qëllim: a) të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundësuar autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të ndihmës e të mbështetjes; b) të përcaktojë përgjegjësinë e të gjitha strukturave publike dhe jopublike, përfshirë organet shtetërore, qendrore dhe vendore, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogëluar, deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim mundësimin e pjesëmarrjes së tyre të barabartë në shoqëri.”

⁵² Ligji nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjet dhe me Akt Normativ të Këshillit të Ministrave nr.7932, datë 17.05.1995; nr.8286, datë 16.02.1998; nr.8392, datë 02.09.1998; nr.8575, datë 03.02.2000; nr.8776, datë 26.04.2001; nr.8852, datë 27.12.2001; nr.8889, datë 25.04.2002; nr.9058, datë 20.03.2003; nr.9114, datë 24.07.2003; nr.9377, datë 21.04.2005; nr.9498, datë 03.04.2006; nr.9600, datë 27.07.2006; nr.9708, datë 05.04.2007; nr.9768, datë 09.07.2007; nr.10070, datë 05.02.2009; nr.10447, datë 14.07.2011; nr.13/2014, datë 13.02.2014; nr.104/2014, datë 31.07.2014; nr.144/2015, datë 17.12.2015; nr.111/2016, datë 3.11.2016; Akt Normativ i Këshillit të Ministrave nr.1, datë 25.1.2017; nr.25/2017, datë 9.3.2017.

⁵³ Ligji nr.8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit”, i ndryshuar me Ligjin nr.26/2012, datë 15.3.2012.

dhe përfitimet për shkak të aftësisë së kufizuar për individët dhe familjet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive e të mundësive personale, ruajtjen e integritetit dhe përfshirjen shoqërore për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore; b) të zbusë varfërinë dhe përjashtimin shoqëror për individët e familjet, si dhe të krijojnë mundësi për integrimin e tyre, nëpërmjet sigurimit të një sistemi ndërhyrjesh e shërbimesh për përmirësimin e jetesës së tyre; c) të garantojë asistencë sociale nëpërmjet ndihmës së menjëhershme financiare për foshnjat e porsalindura; ç) mirorganizimin dhe mirëfunksionimin e institucioneve shtetërore përgjegjëse për ofrimin dhe administrimin e asistencës sociale”. Neni 3 parashikon: “Fusha e zbatimit: Ky ligj zbatohet për individët, familjet në nevojë, personat me aftësi të kufizuara në Republikën e Shqipërisë dhe nënat me foshnja të porsalindura, për ofrimin dhe garantimin e asistencës sociale.”

- Ligji nr.8098 datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit”, neni 1, parashikon: “Përfitojnë nga ky ligj të gjithë personat me mungesë të plotë ose të pjesshëm shikimi, të lindur ose të fituar, të cilët sipas kritereve mjekësore janë të paafte për punë në kushte normale.”

Në lidhje me përfituesit e ndihmës juridike për kategorinë e veçantë të përfituesve të përcaktuar në nenin 11 pika ‘k’, pra, personave, të cilët janë përfitues të skemave të mbrojtjes sociale, duhet të referohemi në parashikimet përkatëse të Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”⁵⁴ dhe Ligji nr. 57/2019 “Për asistencën sociale”:

- Ligji nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, neni 2 parashikon: “Sigurimi shoqëror i detyrueshëm është jofitimprurës, që mbron me të ardhura: a) Personat e punësuar në lidhje me: paaftësinë e përkohëshme në punë për shkak të sëmundjes, barrëllindjen, pleqërinë, invaliditetin dhe humbjen e mbajtësit të familjes, aksidentin në punë dhe sëmundjet profesionale, papunësinë; b) personat e tjerë ekonomikisht aktivë (punëdhënësi dhe të vetëpunësuarit), në lidhje me barrëllindjen, pleqërinë, invaliditetin dhe humbjen e mbajtësit të familjes.

⁵⁴ Ligji nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjet dhe me Akt Normativ të Këshillit të Ministrave nr.7932, datë 17.05.1995; nr.8286, datë 16.02.1998; nr.8392, datë 02.09.1998; nr.8575, datë 03.02.2000; nr.8776, datë 26.04.2001; nr.8852, datë 27.12.2001; nr.8889, datë 25.04.2002; nr.9058, datë 20.03.2003; nr.9114, datë 24.07.2003; nr.9377, datë 21.04.2005; nr.9498, datë 03.04.2006; nr.9600, datë 27.07.2006; nr.9708, datë 05.04.2007; nr.9768, datë 09.07.2007; nr.10070, datë 05.02.2009; nr.10447, datë 14.07.2011; nr.13/2014, datë 13.02.2014; nr.104/2014, datë 31.07.2014; nr.144/2015, datë 17.12.2015; nr.111/2016, datë 3.11.2016; Akt Normativ i Këshillit të Ministrave nr.1, datë 25.1.2017; nr.25/2017, datë 9.3.2017.

- Ligji nr.57/2019 “Për asistencën sociale”: neni 2 “Ky ligj ka për qëllim: a) të përcaktojë ndihmën ekonomike dhe përfitimet për shkak të aftësisë së kufizuar për individët dhe familjet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive e të mundësive personale, ruajtjen e integritetit dhe përfshirjen shoqërore për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore; b) të zbusë varfërinë dhe përjashtimin shoqëror për individët e familjet, si dhe të krijojë mundësi për integrimin e tyre, nëpërmjet sigurimit të një sistemi ndërhyrjesh e shërbimesh për përmirësimin e jetesës së tyre; c) të garantojë asistencë sociale nëpërmjet ndihmës së menjëhershme financiare për foshnjat e porsalindura; ç) mirë organizimin dhe mirëfunksionimin e institucioneve shtetërore përgjegjëse për ofrimin dhe administrimin e asistencës sociale”. Neni 3 parashikon: “Fusha e zbatimit. Ky ligj zbatohet për individët, familjet në nevojë, personat me aftësi të kufizuara në Republikën e Shqipërisë dhe nënat me foshnja të porsalindura, për ofrimin dhe garantimin e asistencës sociale.”

Në lidhje me provueshmërinë e faktit që personi aplikant për ndihmë juridike plotëson kushtet përkatëse (shih më sipër kushtet dhe kërkesat për përfituesit e ndihmës ligjore sipas këtij neni), kërkesa e ofruesit të ndihmës juridike për aktet përkatëse administrative, vendimet gjyqësore, dhe dokumentet e tjera përkatëse, legjitimohen nga nevoja për të provuar përmbushjen e kërkesave dhe kriterëve ligjore të përzgjedhshmërisë, krahas plotësimit të formularëve, etj., përkatës.

Në lidhje me përfituesit e ndihmës juridike për kategorinë e veçantë të përfituesve të përcaktuar në nenin 11 pika 'l', pra, *personave, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi*, duhet të referohemi në parashikimet e Ligjit nr. 10221 datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe konventat përkatëse të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. Kështu, as Ligji nr. 10221, as Konventa ndërkombëtare për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racial (ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1994) dhe as Konventa mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave, nuk bëjnë përkufizim të personit subjekt i diskriminimit. Megjithatë, përkatësisht nga objekti dhe përmbajtja e Ligjit nr. 10221/2010 dhe e konventave përkatëse⁵⁵ identifikojmë

⁵⁵ 1. Deklarata universale e të drejtave të njeriut; 2. KEDNJ; 3. Konventa për të Drejtat e Fëmijës; 4. Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje; 5. Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave; 6. Direktivën e Parlamentit Europian dhe Këshillit 2006/54/KE datë 5.07.2006 për “Zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe marrëdhëniet gjatë punës”; 7. Direktivën e Këshillit 2000/78/KE datë 27.11.2000 për “Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës”; 8. Konventa Kuadër Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; 9. Pakti për të Drejtat Civile dhe

elementet e rëndësishëm për përkufizimin për qëllime të Ligjit nr. 111/2017 të personave të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim.

Në lidhje me provueshmërinë e faktit që personi ka qenë subjekt i diskriminuar, është e rëndësishme të marrim në vlerësim që pika 10 e nenit 33 të Ligjit nr. 10221/2010 parashikon se Komisioneri shprehet me vendim dhe se ky vendim është një akt administrativ që konstaton diskriminimin dhe vendos një masë gjobe për shkelësin. Neni 34 i këtij ligji parashikon se subjekti shkelës ka të drejtën e ankimit në gjykatën e shkallës së parë, por, pavarësisht nga kjo e drejtë, për qëllime të Ligjit nr. 111/2017, për të përfituar ndihmë juridike, personi kërkues mund të konsiderohet person që i është cenuar e drejta për shkak të një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, veçanërisht, pasi ka dalë një vendim nga Komisioneri përkatës. E rëndësishme për qëllim të kësaj kategorie është që konsiderohen si persona që plotësojnë kushtet e përzgjedhshmërisë ata të cilët janë të konfirmuar si viktimat të diskriminimit nga Komisioneri kundër Diskriminimit.

Neni 12

Përfituesit e ndihmës juridike me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme

1. *Të drejtën për të përfituar ndihmë juridike e ka çdokush që provon se ka të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme për të përballuar shpenzimet për këshillim, përfaqësim dhe/ose mbrojtje në çështjet penale, në çështjet administrative dhe në çështjet civile.*

2. *Të ardhurat e një personi, i cili jeton në një familje, konsiderohen të pamjaftueshme, sipas kuptimit të pikës 1, të këtij neni, nëse të ardhurat në total të të gjithë pjesëtarëve të familjes, të pjesëtuara për numrin e anëtarëve të familjes, janë më të ulëta se 50 për qind e pagës minimale mujore të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.*

3. *Të ardhurat e një personi, i cili nuk jeton në një familje, konsiderohen të pamjaftueshme, sipas kuptimit të pikës 1, të këtij neni, nëse janë më të ulëta se niveli i pagës minimale mujore të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.*

4. *Nëse një person, i cili jeton në një familje, kërkon ndihmë juridike dytësore për një çështje kundër një anëtar tjetër të së njëjtës familje, rregulli i parashikuar në pikën 2, të këtij neni, nuk do të zbatohet. Në këtë*

Politike; 10. Direktivën e Këshillit 2004/113/KE datë 13.12.2004 për “Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave në mundësinë për të pasur dhe për t'u furnizuar me mallra dhe shërbime”; 11. Direktivën e Këshillit 2004/43/KE datë 29.06.2000 për “Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht prej ardhjes racore apo etnike”; 12. Pakti për të Drejtat Ekonomike Sociale Kulturore.

rast, të ardhurat e këtij personi konsiderohen të pamjaftueshme, sipas pikës 1, të këtij neni, nëse janë më të ulëta se niveli i pagës minimale të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.

5. Pasuria e një personi konsiderohet e pamjaftueshme, sipas pikës 1, të këtij neni, nëse vlera e saj në total nuk tejkalon vlerën e 36 pagave minimale mujore sipas legjislacionit në fuqi.

Mbështetja me ndihmë juridike falas të përfituesve me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme është parashikuar për të përmbushur nevojat e tyre për ndihmë juridike parësore dhe dytësore në çështjet penale, në çështjet administrative dhe në çështjet civile.

Mbështetja falas me ndihmë juridike rrjedh edhe si kërkesë e standardeve përkatëse ndërkombëtare. Një person ka të drejtën e ndihmës juridike falas nëse përmbushen dy kushte: së pari, nëse ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të paguar ndihmën juridike dhe, së dyti, kur këtë gjë e kërkon Ligji. Këto dy kushte janë të përcaktuara në nenin 6 (3) (c) të KEDNJ-së⁵⁶ dhe nenin 14 (3) (d) të PNDKP⁵⁷.

Për të përcaktuar nëse një përfitues sipas këtij neni konsiderohet se plotëson kriterin objektiv të pamjaftueshmërisë së të ardhurave dhe të pasurive, skema e mbështetjes me ndihmë juridike ka marrë për referencë, pagën minimale mujore në shkallë vendi. Sipas legjislacionit përkatës në fuqi⁵⁸ në datën e publikimit të këtij Komentari, paga minimale mujore në shkallë vendi, sipas Vendimit nr. 809, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e pagesës minimale në shkallë vendi” është: “1. Paga bazë minimale mujore, për punonjësit, në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person, juridik a fizik, vendës ose i huaj, të jetë 26 000 (njëzet e gjashtë mijë) lekë. 2. Paga bazë minimale mujore jepet për 174 orë pune në muaj, të kryera gjatë kohës normale të punës.”

Duhet mbajtur parasysh se paga minimale mujore në shkallë vendi ndryshon herë pas here, me vendim të Këshillit të Ministrave⁵⁹. Llogaritja që bëhet nga ana e gjyqtarit, edhe nëpërmjet ekspertit, për të përkufizuar kërkuesin si “person me të ardhura të pakta ose të pamjaftueshme”, është llogaritje matematikore financiare.

⁵⁶ Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut

⁵⁷ Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike

⁵⁸ Neni 4 ‘Kompetencat e Këshillit të Ministrave’, Ligji nr.10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”: “1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe të Ministrit të Financave, miraton pagën minimale mujore, në shkallë vendi, e cila është e detyrueshme të zbatohet nga çdo punëdhënës, vendas ose i huaj.”

⁵⁹ Neni 4 ‘Kompetencat e Këshillit të Ministrave’ i Ligjit nr.10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat përcaktimin e pagave dhe të shpërblimeve”.

Në lidhje me standardet përkatëse, kujtojmë që sipas GJEDNJ, në parim, personave që u është mohuar ndihma falas, nuk u shkelet e drejta për akses sipas nenit 6, kur nuk bëjnë pjesë në kategoritë përfituese sipas skemës së përfitimit të sistemit ligjor vendas por, në raste përjashtimore, kjo lloj ndihme duhet të garantohet këtyre personave edhe jashtë skemës përfituese, kur thelbi i së drejtës për akses është cënuar (Miroslaw Orzechowski kundër Polonisë). Interesi i drejtësisë e kërkon që individit t’i garantohet ndihma juridike falas, nisur nga faktorë, si: rëndësia e çështjes për individin, kompleksiteti i çështjes, si dhe mungesa e kapacitetit të individit për të përfaqësuar veten e tij. Sipas detyrimit të zbatimit të drejtpërdrejtë të KEDNJ, gjyqtarët duhet të mbajnë në konsideratë, këtë jurisprudencë për interpretimin e së drejtës për akses, jo detyrimisht strictu sensu, sipas skemës financiare ligjore të sipërcituar. Fryma e interpretimit të skemës përfituese financiare ligjore, duhet të jetë që, e drejta për akses është dhënia e mundësisë faktike për akses, duke mos u cënuar thelbi i kësaj të drejte. Nëse vetë skema financiare e cënon thelbin e së drejtës për akses, atëherë interpretimi gjyqësor duhet të bëhet sa më në pajtim me standardet kushtetuese dhe konventore, mes disa interpretimeve që mund të parashtrohen para gjyqtarit për zgjidhjen e çështjes gjyqësore konkrete⁶⁰.

Më tej, jurisprudenca e GJEDNJ, na ndihmon me standarde të tjera përkatëse: Në çështjen *Zdravko Stanev kundër Bullgarisë*, Tsonyo kundër Bullgarisë dhe në çështjen *Gennadiy Medvedev kundër Rusisë*, GJEDNJ mbajti parasysh dy kushtet që duhet të ekzistojnë për të përfituar ndihmën juridike: Kushti i parë është pamundësia ekonomike për të paguar një mbrojtës dhe, kushti i dytë, është interesi i drejtësisë. Këto dy çështje janë të ngjashme me çështjen *Pham Hoang kundër Francës* dhe GJEDNJ është mbështetur në këtë çështje për të dhënë vendimin përkatës. Në çështjen *BONER kundër Mbretërisë së Bashkuar*, GJEDNJ shprehet se jo të gjithë ankuesit kualifikohen për të marrë ndihmë juridike. Arsyet financiare do ta kualifikojnë një person për ta marrë këtë ndihmë dhe për të do të vendosë një organ i pavarur i cili do ta shqyrtojë ankesën nëse marrja e ndihmës do të jetë në interesin më të lartë të drejtësisë. Në çështjen *Steel dhe Morris kundër Mbretërisë së Bashkuar*, ndër të tjera, GJEDNJ ka respektuar të njëjtin arsyetim, pra, që duhet të mbahet parasysh situata financiare e personave ndërgjyqës. Në çështjen *Mcvicar kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe Steel dhe Morris kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa për të kërkuar ndihmë juridike do të varet dhe nga kapaciteti i personave për ta përfaqësuar veten në mënyrë efektive në një proces gjyqësor.

⁶⁰ Raporti i Komitetit Shqiptar të Helsinkit, shkurt 2019.

Jurisprudenca përkatëse e GJEDNJ është në përputhje me përjashtimet që bën pika ‘f’ e këtij neni: Gjykata shprehet që ndihmat e shtetit nuk do të llogariten në të ardhurat e aplikantit, nëse aplikanti jeton vetëm me të ardhurat që i jep shteti; është detyrë e tij që t’i sigurojë ndihmë ligjore falas, përndryshe, do jetë shkelje e nenit 6/3 të KEDNJ.

Duke vazhduar me standardet ndërkombëtare përkatëse të cilat duhen zbatuar ose duhen ndjekur edhe për analogji gjatë krijimit të praktikave administrative apo gjyqësore përkatëse, vëmë në vëmendje se Direktiva 2002/8/EC, në nenin 5 ‘Kushtet në lidhje me burimet financiare’ parashikon se “1. Shtetet Anëtare u japin ndihmë juridike personave të përmendur në nenin 3 (1) të cilët nuk janë pjesërisht ose plotësisht të paaftë për të përmbushur shpenzimet e procedurave të përmendura në nenin 3 (2) si rezultat i situatës së tyre ekonomike, në mënyrë që të sigurohen aksesit në drejtësi. 2. Situata ekonomike e një personi vlerësohet nga autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar në të cilin ndodhet gjykata, në dritën e faktorëve të ndryshëm objektivë si psh të ardhurat, kapitali ose situata familjare, përfshirë një vlerësim të burimet e personave që varen financiarisht nga aplikanti. 3. Shtetet Anëtare mund të përcaktojnë kufijtë mbi të cilët parashtuesit e ndihmës juridike konsiderohen pjesërisht ose plotësisht në gjendje të përballojnë shpenzimet e procedurave të përcaktuara në nenin 3(2). Këto pragje përcaktohet në bazë të kriterëve të përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni. 4. Pragjet e përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni nuk mund të parandalojnë aplikantët e ndihmës juridike që janë mbi pragjet e pranimi të ndihmës juridike, nëse vërtetojnë se nuk janë në gjendje të paguajnë koston e procedurave të përmendura në neni 3(2) si rezultat i ndryshimeve në koston e jetesës ndërmjet Shteteve Anëtare të vendbanimit të banimit ose të zakonshëm dhe të forumit. 5. Ndihma juridike nuk ka nevojë t’u jepet aplikantëve për atë kohë sa ata gëzojnë, në rastin konkret, qasje efektive në mekanizma të tjerë që mbulojnë koston e procedurave të përmendura në nenin 3(2)”.

Po kështu, në nenin 9 ‘Personat Vulnerabël’ të Direktivës 2016/1919 parashikohet shprehimisht se “Shtetet anëtare duhet të sigurojnë që nevojat e personave vulnerabël, që janë persona të akuzuar ose të kërkuar, të merren parasysh gjatë zbatimit të kësaj direktive”.

Në lidhje me provueshmërinë e faktit që personi aplikant për ndihmë juridike plotëson kushtet përkatëse (shih më sipër kushtet dhe kërkesat për përfituesit e ndihmës ligjore sipas këtij neni), kërkesa e ofruesit të ndihmës juridike për aktet përkatëse administrative, vendimet gjyqësore, dhe dokumentet e tjera përkatëse,

legjitimohen nga nevoja për të provuar përmbushjen e kërkesave dhe kriterëve ligjore të përzgjedhshmërisë, krahas plotësisht të formularëve, etj., përkatës.

KREU IV

NDIHMA JURIDIKE PARËSORE

Në Kreun IV të Ligjit nr. 111/2017 parashikohet procedura për dhënien e të gjitha llojeve të shërbimeve të ndihmës juridike, rastet e procedurës së përshpejtuar, forma e vendimit për pranimin ose refuzimin e dhënies së ndihmës juridike. Rastet e kthimit të shpenzimeve për ndihmën juridike të dhënë, bashkëpunimi i përfituesve të ndihmës juridike dhe institucioneve shtetërore me gjykatat dhe Drejtorinë e Ndihmës Juridike, si dhe kontrolli i cilësisë së ndihmës juridike.

Neni 13

Dhënia e ndihmës juridike parësore

Ndihma juridike parësore jepet nga:

- a) punonjësit me trajnim të posaçëm;
- b) nga organizatat jofitimprurëse të autorizuar;
- c) nga klinikat ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë.

Në këtë nen lexohet edhe shprehimisht që bëhet fjalë për operatorët e ndihmës juridike parësore. Ndihma juridike parësore falas, është faktor kyç lidhur me garantimin e aksesit në drejtësi të qytetarëve, sepse ajo mbulon ofrimin e informacionit të domosdoshëm mbi metodat dhe procedurat përkatëse të aksesit paragjyqësor të grupeve vulnerabël. Ndihma parësore ka një rëndësi të jashtëzakonshme jo vetëm për garantimin e të drejtës për informim të qytetarit për të drejtat e tij lidhur me aksesin në shërbime publike dhe në institucionet publike, por edhe edukimin e tij me zgjidhjen e çështjeve në mënyra të tjera ndërmjetësimi paragjyqësore. Kjo zgjidhje, për rrjedhojë, sjell dhe përfitime të tjera të karakterit publik, si mosdërgimi i çështjeve në gjykatë, duke zvogëluar ngarkesën e tyre, zgjidhja në rrugë administrative me sa më pak kohë e energji, duke e bërë zgjidhjen juridike eficiente, etj⁶¹.

Sipas nenit në fjalë, operatorët e ndihmës parësore juridike rradhiten si më poshtë:

- a) punonjësit me trajnim të posaçëm;
- b) nga organizatat jofitimprurëse të autorizuar;

⁶¹ Raport monitorimi mbi ofrimin e ndihmës juridike parësore, Komiteti Shqipëtar i Helsinkit dhe OSFA (viti 2019).

c) nga klinikat ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë.

Për qëllime të analizës së këtij neni 13 dhe të neneve të tjera përkatëse (neni 14, 15, 16) të Ligjit nr. 111/2017, së pari, i referohemi përkufizimeve përkatëse të këtij ligji.

Punonjësit me trajnim të posaçëm

Kështu, neni 3 pika ‘dh’ e Ligjit nr. 111/2017 përkufizon se “Punonjës me trajnim të posaçëm” është punonjësi, i diplomuar nga një program i ciklit të dytë të studimeve në drejtësi, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë dhe që i është nënshtruar një trajnimit të posaçëm, i cili ofron ndihmë juridike parësore në qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore. Çfarë kuptojmë me trajnim të posaçëm? Edhe për këtë i referohemi përkufizimit përkatës të Ligjit nr. 111/2017 neni 3, pika ‘c’: *“Trajnim i posaçëm” është programi i trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm, i miratuar nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, për punonjësit që ofrojnë ndihmë juridike parësore në qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore.* Pa kundërshtuar sa më sipër, pika a) e këtij neni të Ligjit nr. 111/2017 duhet kuptuar që këta punonjës me trajnim të veçantë të zhvilluar nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas në bashkëpunim me Qendrën e Trajnimit të Administratës Publike punojnë në qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore shtetërore.

Në lidhje me nenin 13 ‘Dhënia e ndihmës juridike parësore’ të Ligjit nr. 111/2017, duhet të mbajmë parasysh se ky ligj në nene të tjera të tij (neni 3, etj.) parashikon si operatorë të ndihmës juridike parësore edhe qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore. Neni 3 gërma ‘d’ përkufizon si “Qendër shërbimi e ndihmës juridike parësore” një njësi të specializuar për dhënien e ndihmës juridike parësore, e organizuar si “njësi e drejtpërdrejtë e ofrimit të shërbimeve”, sipas legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore. Mospërfshirja shprehimisht në këtë nen e qendrës si operator i ndihmës juridike parësore është synuar të mbulohet me parashikimin e punonjësve me trajnim të posaçëm të cilët mund të punojnë vetëm në qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore.

Qendra, si strukturë e specializuar për dhënien e ndihmës juridike parësore, e organizuar si “njësi e drejtpërdrejtë e ofrimit të shërbimeve” që funksionon sipas legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore, punon bazuar në financimin nga buxheti shtetëror. Megjithatë, në kushtet që një nga burimet e të ardhurave të këtyre strukturave mund të jenë edhe arkëtimet në formën e granteve, ndihma

financiare dhe me ‘know how’ e donatorëve përkatës është e domosdoshme, veçanërisht, për fazën deri kur Shqipëria të bëhet anëtare e BE.

Në këto kushte, vlerësohet si përkatëse për këtë Komentar që të informohet se qendrat që janë planifikuar të themelohen nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas dhe donatorët OSFA dhe UNDP, janë si më poshtë:

- Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas: Është vendosur bashkëpunimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve me katër bashki Kukës, Kavajë, Gjirokastrë, Lushnjë, me qëllim ofrimin e zyrave për 4 qendra të ndihmës juridike që do të krijohen nga Ministria e Drejtësisë / Drejtoria e Ndhmës Juridike, dhe për vendosjen e kontakteve përmes adresës elektronike.

- UNDP: Rivitalizimi i tre qendrave në rrethet e Durrësit, Fierit dhe Lezhës, dhe pritjet që në këto rrethe qendrat të hapen së shpejti. Gjatë vitit 2020 do të punohet në qytetet Korçë, Berat, Sarandë, Pogradec dhe Kavajë.

- OSFA ka mundësuar grante në lidhje me mbështetjen financiare për Qendrën e Shërbimit të Ndhmës Parësore Ligjore në qytetin e Elbasanit dhe Tiranë.

Në lidhje me punonjësit me trajnim të posaçëm dhe qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore, shihni edhe komentet dhe shpjegimet e tjera përkatëse në këtë Komentar në lidhje me nenin 14 dhe nene të tjera përkatëse të Ligjit nr. 111/2017.

Organizatat jofitimprurëse të autorizuara

Në lidhje me operatorët organizata jofitimprurëse të autorizuar nga Ministri i Drejtësisë, Ligji 111/2017 nuk përmban një përkufizim të dedikuar, por parashikimet e mëposhtme të nenit 15 japin elementë kryesore jo vetëm përkufizues, por edhe mbi kriteret përkatëse, se cilat janë organizatat që mund të shërbejnë si operatorë të ndihmës juridike parësore pas marrjes së autorizimit nga Ministri i Drejtësisë: Organizatat jofitimprurëse që autorizohen nga Ministri i Drejtësisë për dhënien e shërbimeve të ndihmës juridike parësore duhet të plotësojnë të paktën këto kushte: a) të jenë të regjistruara në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizatat jofitimprurëse; dhe b) të kenë si objekt të veprimtarisë së tyre të parashikuar në statutin e organizatës, ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike.

Në lidhje me organizatat jofitimprurëse të autorizuar në dhënien e ndihmës juridike parësore, shihni edhe komentet dhe shpjegimet e tjera përkatëse në këtë Komentar në lidhje me nenin 15 dhe nene të tjera përkatëse të Ligjit nr. 111/2017.

Klinikat ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë

Neni 3 pika ‘ë’ e Ligjit përkufizon termin “Klinikë ligjore” si njësi përbërëse e një institucioni të arsimit të lartë, e organizuar dhe që funksionon sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë dhe që ofron ndihmë juridike parësore pa qëllim fitimi, sipas përcaktimeve në statutin e institucionit të arsimit të lartë.

Në lidhje me klinikat ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë të ndihmës juridike parësore, shihni edhe komentet dhe shpjegimet e tjera përkatëse në këtë Komentar në lidhje me nenin 16 dhe nene të tjera përkatëse të Ligjit nr. 111/2017.

Neni 14***Dhënia e ndihmës juridike parësore nga punonjësit me trajnim të posaçëm***

Ndihma juridike parësore jepet pranë qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore ose në ambiente të tjera të përshtatshme, sipas parashikimeve të këtij ligji, nga punonjësit me trajnim të posaçëm të punësuar pranë këtyre qendrave.

Neni 3, gërma ‘d’, përkufizon si “Qendër shërbimi e ndihmës juridike parësore” një njësi të specializuar për dhënien e ndihmës juridike parësore, e organizuar si “njësi e drejtpërdrejtë e ofrimit të shërbimeve”.

Në bazë të Ligjit nr. 111/2017 është parashikuar se ‘Qendra e shërbimit të ndihmës juridike parësore’ është një njësi e specializuar e cila ofron ndihmë juridike parësore nëpërmjet punonjësve me trajnim të posaçëm të punësuar pranë saj. Ato duhen konceptuar si qendra të ofrimit të drejtpërdrejtë të shërbimit të ndihmës ligjore, pra, si operatorë të shërbimit përkatës. Siç është përmendur më sipër në këtë Komentar, punonjës me trajnim të posaçëm është punonjësi, i diplomuar nga një program i ciklit të dytë të studimeve në drejtësi, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë dhe që i është nënshtruar një trajnimi të posaçëm. Trajnim i posaçëm është programi i trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm, i miratuar nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, për punonjësit që ofrojnë ndihmë juridike parësore në qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore (neni 3/d, ‘dh’, ‘e’)⁶². Sipas kuptimit të ligjit, vetëm këta punonjës mund të ofrojnë ndihmë juridike parësore në qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore. Ligji ka parashikuar sa më sipër për qëllime të standardeve dhe cilësive të cilat duhet të plotësojë ndihma juridike në përputhje me ato të parashikuara nga KEDNJ, Kushtetuta e Shqipërisë, Ligji nr. 111/2017 dhe aktet

nënligjore përkatëse, dispozitat ligjore përkatëse të tjera, si dhe Direktivat përkatëse të BE.

Pa kundërshtuar sa më sipër, në lidhje me qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore, të cilat duhet të financohen nga fonde publike, duhet mbajtur kujdes që puna e tyre duhet të orientohet nga kërkesa e kërkuarve të ndihmës juridike dhe interesi i tyre i cili duhet të mbizotërojë gjithnjë në punën e këtyre qendrave edhe kur ato financohen nga fonde publike. Përndryshe, puna e këtyre qendrave mund të konsiderohet në konflikt interesi.

Raportet e monitorimit të publikuara deri në datën e këtij Komentari tregojnë se edhe trajnimet e posaçme të personave të punësuar në qendrat e ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore, duhen orientuar kryesisht me njohjen e standardeve të efikasitetit dhe efektivitetit të kërkuara prej organeve të administratës publike kompetente për zbatimin e legjislacionit social-ekonomik⁶³.

Ky nen paraqet në mënyrë jo shumë të zgjeruar edhe standardin për domosdoshmërinë e dhënies së ndihmës juridike në mjedise të përshtatshme. Kjo duhet kuptuar, që mjediset fizike të mundësojnë mbi të gjitha respektimin e parimeve kryesore të dhënies së ndihmës ligjore, të tilla si, ruajtja e konfidencialitetit, etj.

Ligji nr. 111/2017 nuk ka përmendur shprehimisht ndihmën juridike parësore që ofrohet nga administrata gjyqësore dhe nga punonjësit e administratës publike krahas kryerjes së detyrave të tyre funksionale. Detyrimi për ofrimin e kësaj ndihme juridike nuk rrjedh nga Ligji nr. 111/2017 por, nga ligjet organike përkatëse. Veçanërisht, për administratën gjyqësore është kërkesë e standardit të maksimizimit të aksesit në drejtësi, si dhe e pavarësisë dhe paanësisë së sistemit gjyqësor që orienton dhënien e ndihmës juridike parësore nga punonjësit përkatës. Kufijtë e ndihmës juridike parësore orientohen dhe vendosen pikërisht duke respektuar këto standarde bazë. Tashmë është realitet, që Shkolla e Magjistraturës gjatë trajnimit të punonjësve të administratës gjyqësore i orienton ata nëpërmjet trajnimeve të specializuara mbi detyrën për të dhënë ndihmë juridike parësore dhe kufijtë e kësaj ndihmës juridike parësore në konkurrueshmërinë e parimit të maksimizimit të aksesit në drejtësi me parimin e pavarësisë dhe paanësisë së sistemit gjyqësor.

⁶² Raport monitorimi mbi ofrimin e ndihmës juridike parësore, Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe OSFA (viti 2019).

⁶³ Raport monitorimi mbi ofrimin e ndihmës juridike parësore, Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe OSFA (viti 2019).

Neni 15

Dhënia e ndihmës juridike parësore nga organizatat jofitimprurëse

1. Organizatat jofitimprurëse japin shërbime të ndihmës juridike parësore në përputhje me autorizimin e miratuar nga Ministri i Drejtësisë. Procedurat dhe dokumentacioni për autorizimin e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Organizatat jofitimprurëse që autorizohen për dhënien e shërbimeve të ndihmës juridike parësore duhet të përmbushin këto kritere:

a) të jenë të regjistruara në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizatat jofitimprurëse;

b) të kenë si objekt të veprimtarisë së tyre të parashikuar në statutin e organizatës ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike;

c) të kenë shlyer detyrimet tatimore në përputhje me legjislacionin në fuqi;

ç) të kenë përvojë në ofrimin e ndihmës juridike;

d) të mos jenë në proces falimentimi dhe/ose likuidimi;

dh) anëtarët e organit më të lartë vendimmarrës dhe të organit ekzekutiv të organizatës jofitimprurëse të mos jenë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje dhe që do të cenonte besimin e publikut dhe ofrimin e përshtatshëm të ndihmës juridike.

3. Organizatat jofitimprurëse të autorizuar për dhënien e ndihmës juridike parësore përfitojnë financime nga buxheti i shtetit, pas një procesi konkurrues dhe transparent përzgjedhjeje. Procedura, rregullat e përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse të autorizuar, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në këtë nen rregullohet, mbi të gjitha, ofrimi i ndihmës juridike parësore nga organizatat jofitimprurëse si operatorë të ndihmës juridike parësore. Fokusimi i punës së organizatave jo-fitimprurëse në ndihmën juridike parësore është risi e këtij ligji, nëse kuptojmë që me organizata jofitimprurëse që plotësojnë kriteret për ndihmën juridike parësore Ligji nr. 111/2017 nuk kupton organizatat jofitimprurëse të cilat nëpërmjet avokatëve të punësuar apo të kontraktuar me kontratë shërbimi japin shërbime ligjore, pra, shërbime të ndihmës juridike dytësore për publikun. Regjimi i këtyre të fundit në

lidhje me ndihmën juridike dytësore rregullohet sipas dispozitave të tjera të Ligjit nr. 111/2017 dhe akteve përkatëse nënligjore që kanë të bëjnë me ndihmën juridike dytësore, si dhe dispozitat e tjera ligjore të legjislacionit shqiptar që kanë të bëjnë me profesionin e avokatit.

Organizatat jofitimprurëse të krijuara dhe regjistruara sipas legjislacionit për organizatat jofitimprurëse, të cilat kanë në objektin e veprimtarisë së regjistruar ofrimin e ndihmës juridike parësore, të autorizuar rregullisht nga ana e Ministrit të Drejtësisë, janë parashikuar nga ana e Ligjit nr. 111/2017 si subjekte për të ofruar shërbime të ndihmës juridike parësore. Organizatat jofitimprurëse japin shërbime të ndihmës juridike parësore në përputhje me autorizimin e miratuar nga Ministri i Drejtësisë. Procedurat dhe dokumentacioni për autorizimin e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Organizatat jofitimprurëse të autorizuar për dhënien e ndihmës juridike parësore përfitojnë financime nga buxheti i shtetit, pas një procesi konkurrues dhe transparent përzgjedhjeje. Procedura, rregullat e përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse të autorizuar, që ofrojnë ndihmë juridike parësore dhe ato që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit për ndihmën juridike parësore dhe mënyra e financimit të tyre janë përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave (neni 15/1 dhe 15/3 i Ligjit nr. 111/2017).

Për qëllime të leximit dhe zbatimit të nenit 15 të Ligjit nr. 111/2017 mbajmë parasysh përkufizimin përkatës sipas nenit 3 gërma ‘b’ të Ligjit nr. 111/2017 për ndihmën juridike parësore⁶⁴, përmbajtje e autorizimit përkatës të lëshuar nga Ministri i Drejtësisë, si edhe disa orientime të dhëna në këtë Komentar në lidhje me ndihmën juridike parësore. Ky do të jetë objekti i veprimtarisë së këtyre organizatave në lidhje me llojin e shërbimeve të ndihmës juridike parësore. Objekti duhet përcaktuar qartë edhe duke iu referuar përkufizimit të ndihmës juridike dytësore në kushtet që neni 3 gërma ‘b’ e Ligjit 111/2017 përfshin edhe pikën e cila parashikon “vi) dhënia e të gjitha formave të tjera të mbështetjes së nevojshme juridike që nuk përbëjnë ndihmë juridike dytësore”. Në lidhje me fushat e së drejtës që do të mbulojë organizata përkatëse, lutem shih më poshtë në këtë seksion të Komentarit.

⁶⁴ Neni 3 pika b) e Ligjit 111/2017: “Ndihmë juridike parësore” është: i) dhënia e informacioneve në lidhje me sistemin ligjor të Republikës së Shqipërisë, aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor; ii) dhënia e këshillimit; iii) dhënia e këshillimit mbi procedurat e ndërmjetësimit dhe zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve; iv) dhënia e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore; v) përfaqësimi përpara organeve administrative; dhe vi) dhënia e të gjitha formave të tjera të mbështetjes së nevojshme juridike që nuk përbëjnë ndihmë juridike dytësore.

Aktet nënligjore në vijim, si (i) Vendimi nr.55, datë 06.02.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionin për autorizimin e organizatave jofitimprurëse, që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti”, (ii) Vendimi nr.110, datë 6.3.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit”, dhe (iii) Urdhri nr.266 datë 25.3.2019 “Për Miratimin e Kontratave të Ndhmës Juridike të garantuara nga Shteti”, janë të rëndësishëm në lidhje me nenin 15 të Ligjit. Me Urdhrin nr. 266 janë miratuar edhe dy kontratat tip me organizatat jofitimprurëse dhe avokatët përkatësisht për shërbimet e ndihmës juridike parësore dhe me avokatët për dhënien e shërbimeve të ndihmës juridike dytësore, në respektim të nenit 34, pika 2, të Ligjit nr. 111/2017.

Marrëdhënia midis organizatave jofitimprurëse dhe Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas do të rregullohet bazuar në kontratën standard tashmë të miratuar për ndihmën juridike parësore (shih Shtojcën 9 të këtij Komentari). Legjislacioni i miratuar deri në datën e këtij Komentari, nuk parashikon apo nuk përcakton shprehimisht mbi llojin e çështjeve apo fushave të së drejtës që duhet të mbulojnë organizatat jofitimprurëse gjatë ofrimit të ndihmës juridike parësore. Kjo do të përcaktohet në kontratën që do të nënshkruhet midis Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas dhe organizatës jofitimprurëse në rastet kur këto të fundit financohet nga fonde shtetërore. Deri më sot, organizatat jofitimprurëse kanë mbuluar çështje në lidhje me të drejtat e natyrës social-ekonomike, duke shtuar edhe ato të natyrës mjedisore, me impakt në të drejtën për kujdes shëndetësor, si fusha dhe veprimtaria më e gjerë që hulumtohet nga organizatat gjatë misionit dhe ushtrimit të veprimtarisë së tyre për dhënie ndihme juridike falas në format e parashikuara nga ligji dhe të emërtuara si shërbime paraligjore, forma këshillimi ose asistencë në institucionet e administratës publike. Anketimet dhe raportet përkatëse kanë treguar se nevojat për asistencë i përkasin kategorisë dhe legjislacionit që i përket garantimit të këtyre të drejtave⁶⁵.

Nëse i referohemi kontratës standard të miratuar vihet re se, gjatë negociimit midis palëve para nënshkrimit, kontrata standard duhet të pasurohet edhe me elementë të tjerë mbi detyrimet e organizatës, të lidhura me aspekte të tilla, si numri dhe niveli i stafit të organizatës që do të punojnë për dhënien e ndihmës ligjore, standarde në lidhje me mjediset ku do të jepet ndihma juridike e detyrime të tjera që i shërbejnë dhënies me cilësi, profesionalizëm, efektivitet dhe

eficiencë dhe duke zbatuar parimet e tjera të dhënies së ndihmës juridike. Me rëndësi është të parashikohet në kontratë edhe mënyra e monitorimit dhe kontrollit të dhënies së ndihmës juridike parësore nga ana e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas. Sigurisht disa elemente dhe informacione shkëmbehen zyrtarisht midis organizatës aplikante dhe Drejtorisë / Ministrit të Drejtësisë gjatë procesit të autorizimit të organizatës, por është e këshillueshme që detyrimet e organizatës gjatë kohëzgjatjes së kontratës të bëhen formalisht pjesë e kontratës që lidhet midis palëve. Në elementët e tjerë që duhet të ketë kontrata janë, por pa u kufizuar në to, edhe parashikimi me hollësi i kthimit të përfitimeve të ndihmës ligjore, si dhe të njoftimit në kohë nga ana e organizatës në rastet kur do të tërhiqet nga ndihma juridike parësore.

Bazuar edhe në përvojën para miratimit të Ligjit nr. 111/2017, përgjithësisht, organizatat jo-fitimprurëse ofrojnë shërbime të ndihmës juridike parësore me mbështetjen financiare të donatorëve vendas dhe ndërkombëtarë. Keshtu, OSFA në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë ka mbështetur Zyrën e Ndhmës Ligjore Falas pranë Ministrisë së Drejtësisë, si dhe klinikat dhe qendrave e ligjit të cilat operojnë në Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë, Elbasan, duke krijuar një rrjet zinxhir të ofrimit të ndihmës juridike falas në të gjithë rajonet kryesore të vendit.

Pavarësisht strategjisë që shteti do të ndjekë për të mundësuar funksionimin efektiv të organizatave që do të pranojnë mbështetje financiare nga buxheti shtetëror, në të njëjtën kohë është shumë e rëndësishme të njihet dhe të pranohet mbështetja që jep komuniteti i donatorëve për këto organizata si dhe vijueshmëria e kësaj mbështetje në plan afatgjatë. Kjo për qellime të garantimit të aksesit efektiv të individëve në skemën e ndihmës juridike falas parësore, akses i cila mundësohet kur ka mbështetjen e duhur me burime, përfshirë dhe pa u kufizuar edhe tek ato financiare.

Në aktet nënligjore përkatëse të miratuara tashmë, mbulohen çështje si më poshtë:

Vendimi nr. 55, datë 06.02.2019, parashikon rregulla të përgjithshme mbi kriteret ligjore që duhet të përmbushin organizatat jofitimprurëse, njoftimin për aplikim për autorizim, si edhe dokumentacioni që ato duhet të përmbushin në kuadër të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore. Kjo VKM parashikon listën e dokumentacionit që duhet të paraqesin organizatat me qëllimin pajisjen e tyre me autorizim nga Ministri i Drejtësisë për ofrimin e ndihmës juridike parësore, si dhe procedurën për marrjen e autorizimit. Këto dokumente duhet të provojnë përmbushjen e kriterëve profesionale

⁶⁵ Raport monitorimi mbi ofrimin e ndihmës juridike parësore, Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe OSFA (viti 2019).

dhe morale me qëllim që të kualifikohen për dhënien e ndihmës dhe vetëm ato organizata që garantojnë cilësi, profesionalizëm dhe reputacion të mirë në këtë fushë.

Pranimi i dokumentacionit, vlerësimi i përmbushjes së kushteve dhe verifikimi i dokumentacionit dhe relacioni përkatës, lidhjes me secilën organizatë aplikantë përgatitet nga Drejtoria e Ndihmës Juridike, e cila ia përcjell për vendimarrje Ministrin. Ministri bazuar mbi relacionin përkatës lëshon autorizimin, i cili është i vlefshëm për një periudhë 2 (dy) vjeçare. Në këtë VKM përcaktohet edhe mundësia që i ofrohet organizatave për plotësim dokumentacioni, kur konstatohet se pas dorëzimit ka mangësi, duke i lënë një afat prej 10 (dhjetë) ditësh. Vendimi parashikon se mosjellja e dokumentacionit plotësues brenda këtij afati passjell skualifikimin e organizatës aplikante për ndihmë juridike parësore. Në lidhje me plotësimin e kushtit të parashikuar nga gërma ‘d’ e nenit të Ligjit nr. 111/2017 që organizata aplikante “d) të mos jenë në proces falimentimi dhe/ose likuidimi”, për të shmangur çdo interpretim, qartësojmë që edhe organizatat jofitimprurëse të regjistruara në bazë të ligjit shqiptar mund të jenë subjekt i procedurave të likuidimit dhe falimentimit.

Në këtë VKM parashikohet se organizata jofitimprurëse aplikante ka të drejtën e ankimit brenda 5 (pesë) ditëve pranë Ministrin të Drejtësisë, për mosdhënien e autorizimit, duke paraqitur arsyet dhe dokumentacionin mbështetës. Ministri i Drejtësisë shqyrton ankesat dhe njofton organizatën jofitimprurëse lidhur me to brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e regjistrimit të ankimit pranë Ministrisë së Drejtësisë. Bazuar në këtë VKM, Ministria e Drejtësisë ka detyrimin të publikojë listën e organizatave jofitimprurëse të autorizuar.

Ministri i Drejtësisë, mund të revokojë autorizimin e dhënë një organizatë jofitimprurëse, kryesisht, apo bazuar në faktet e parashtruara në ankesat e paraqitura pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe informacionet e Drejtorisë së Ndihmës Juridike, për mospërmbushjen në mënyrë të përsëritur të ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore, në rast se janë paraqitur të dhëna të pasakta gjatë procesit të verifikimit të cilësisë së ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore, për mungesë të cilësisë së shërbimit të ndihmës juridike të ofruar, në rast se ndaj njërit prej anëtarëve të organit më të lartë vendimarrës dhe të organit ekzekutiv të organizatës përkatëse është caktuar masa ndaluese apo është dhënë vendim dënimi i formës së prerë për kryerjen e një krimi, që çënon integritetin. Revokimi i autorizimit i njoftohet organizatës jofitimprurëse përkatëse si dhe publikohet në faqen zyrtare të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatën administrative kompetente. Revokimi për

mungesë të cilësisë në ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore është parashikuar në ligj si një mjet për të siguruar zbatimin e parimit të profesionalizmit, cilësisë, efektivitetit dhe efijencës gjatë dhënies së ndihmës juridike falas.

VKM nr.55 parashikon detyrimin që ka Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, për të hedhur në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore, çdo të dhënë që lidhet me miratimin apo revokimin e autorizimit. Po kështu, në këtë VKM parashikohet detyrimi që ka organizata jofitimprurëse e autorizuar, që për arsye të caktuara dhe të justifikuara, ofrimi i shërbimit nga ana e saj bëhet i pamundur, duhet të njoftojë menjëherë Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas. Ky parashikim është bërë për të normuar rastet e veçanta dhe që Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të ketë mundësitë për të siguruar ofrim të pandërprerë për kërkuarit e ndihmës juridike.

Në VKM 110⁶⁶ në mënyrë të veçantë parashikohen parimet mbi bazën e të cilave bëhet përzgjedhja e organizatave të cilat përfitojnë financime nga shteti për dhënien e ndihmës juridike parësore. Procedurat e përfitimit të financimit të organizatave jofitimprurëse të autorizuar bëhen duke u bazuar në parimet e konkurrueshmërisë, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit të organizatave jofitimprurëse të autorizuar, aplikuese për përfitimin e financimit, transparencës në fazat që lidhen me shqyrtimin, vendimarrjen dhe përzgjedhjen e organizatave jofitimprurëse të autorizuar, kritere të mirëpërcaktuara dhe publike të cilat do të mundësojnë vlerësimin e propozimeve të organizatave jofitimprurëse të autorizuar në raport me objektivat dhe prioritetet e mbështetjes financiare, efektivitetit dhe ekonomizimit në shfrytëzimin e fondeve publike duke siguruar që të arrihen objektivat dhe prioritetet e përcaktuara me një kosto sa më të favorshme për realizimin e shërbimit të synuar, respektimit të plotë të parimeve të llogaridhënies dhe raportimit në përdorimet e fondeve publike, financimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore për kategoritë e përfituesve që janë me prioritet për Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas dhe në interes të përfituesve të ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, ruajtjes së pavarësisë së organizatës jofitimprurëse të autorizuar, parandalimit të konfliktit të interesit, si dhe të çdo aktiviteti tjetër që rrezikon ofrimin me integritet të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

⁶⁶ Vendim i Keshillit të Ministrave nr.110, datë 6.3.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit.

Neni 16***Dhënia e ndihmës juridike parësore nga klinikat ligjore***

1. Ndihma juridike parësore jepet nga klinikat ligjore të ngritura pranë institucioneve të arsimit të lartë.

2. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas bashkëpunon me klinikat ligjore, sipas kushteve dhe kritereve të parashikuara në marrëveshjet përkatëse të bashkëpunimit për trajnimin dhe përditësimin e njohurive të studentëve të përfshirë pranë këtyre klinikave, mbi çështjet e lidhura me ndihmën juridike parësore.

Sipas nenit 3 gërma ‘ë’ e Ligjit nr. 111/2017, “Klinikë ligjore” është njësia përbërëse e një institucioni të arsimit të lartë, e organizuar dhe që funksionon sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë⁶⁷ dhe që ofron ndihmë juridike parësore pa qëllim fitimi, sipas përcaktimeve në statutin e institucionit të arsimit të lartë.

Bazuar në nenin 22 të Ligjit nr. 80/2018 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, njësitë përbërëse të institucioneve të arsimit të lartë të cilat organizohen dhe funksionojnë në zbatim të këtij ligji janë: njësitë kryesore, njësitë bazë dhe njësi të tjera, sipas përcaktimeve në statutin e institucionit të arsimit të lartë. Njësitë kryesore janë fakultetet, institutet kërkimore-shkencore dhe kolegjet profesionale të larta, në rastet kur ngrihen pranë institucioneve të arsimit të lartë që kanë statusin e universiteteve dhe kolegjeve universitare. Njësitë bazë janë departamentet dhe qendrat kërkimore-shkencore⁶⁸. Pranë njësive kryesore krijohen njësitë bazë si departamentet. Departamenti është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore të fakultetit, i cili përfshin fusha kërkimi të përafërta dhe grupon disiplinat mësimore respektive⁶⁹. Ai është përgjegjës për programet e studimit që ofron dhe departamenti mund të organizohet në grupe mësimore dhe në grupe të përhershme ose të përkohshme me karakter kërkimor-shkencor, në përputhje me llojin dhe misionin e institucionit⁷⁰. Si shembull, bazuar në Statutin e Universitetit të Tiranës, departamenti si njësi bazë ushtron personalitetin juridik të mëvetësishëm në përputhje me legjislacionin në fuqi të zbatueshëm për arsimin e lartë⁷¹. Gjithashtu, departamenti mund të ofrojë shërbime për të tretë, si dhe të zhvillojë

veprimtari të tjera, sipas legjislacionit në fuqi⁷². Bazuar në sa më sipër, në lidhje me statusin ligjor të klinikave ligjore pranë Universitetit të Tiranës, interpretohet që klinikat ligjore janë njësi strukturore e njësive bazë në formën e departamentit sipas Ligjit nr. 80/2018. Baza ligjore më sipër dhe ky shembull orienton që klinikat ligjore pranë mund të kërkojë nëpërmjet fakulteteve përkatëse, si njësi themelore me personalitet juridik për të kontraktuar për qëllime akademike për nënshkrimin e marrëveshjeve me Drejtorinë e Ndihmës Juridike dhe vetëm për përfshirjen e klinikave në dhënien e ndihmës juridike parësore. Ndërkohë, për qëllime të marrjes së financimeve nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas për mbështetjen e veprimtarisë së klinikave ligjore me objektin për dhënie të shërbimeve të ndihmës juridike parësore, palë në këtë marrëveshjen me elemente të financimit duhet të dalë Rektorati UT. Në këto kushte, duhet të parashikohet që në kontratën/marrëveshjen midis klinikave ligjore dhe Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas për financimin nga shteti të dhënies së ndihmës juridike parësore, klinika ligjore të përfaqësohet nga Dekani i Fakultetit dhe Rektori i IAL. Pa kundërshtuar sa më sipër, konsultimi i statutit të IAL përkatës është domodoshmëri për qëllime të kontraktimit në fjalë.

Klinikat ligjore të ngritura pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL) japin ndihmë juridike parësore. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas bashkëpunon me klinikat ligjore, sipas kushteve dhe kritereve të parashikuara në marrëveshjet përkatëse të bashkëpunimit për trajnimin dhe përditësimin e njohurive të studentëve të përfshirë pranë këtyre klinikave, mbi çështjet e lidhura me ndihmën juridike parësore. Sipas nenit 16 të Ligjit nr. 111/2017, ofrimi i ndihmës juridike realizohet në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit të lidhura ndërmjet klinikave të ligjit dhe Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas. Kontrata standard për t'u lidhur midis Klinikave ligjore pranë IAL dhe Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas do të orientojë përkatësisht palët.

Për qëllime të leximit dhe zbatimit të nenit 16 të Ligjit nr. 111/2017 mbajmë parasysh përkufizimin përkatës sipas nenit 3 gërma ‘b’ të Ligjit 111/2017 për ndihmën juridike parësore⁷³ si edhe disa orientime të dhëna në këtë Komentar në lidhje me ndihmën juridike parësore. Ky do të jetë objekti i veprimtarisë së klinikave ligjore në lidhje me ndihmën juridike parësore. Objekti duhet

⁶⁷ Neni 25/9 i Ligjit nr.80/2015

⁷³ Neni 3 pika b) e Ligjit 111/2017: “Ndihmë juridike parësore” është: i) dhënia e informacioneve në lidhje me sistemin ligjor të Republikës së Shqipërisë, aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor; ii) dhënia e këshillimit; iii) dhënia e këshillimit mbi procedurat e ndërmjetësimit dhe zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve; iv) dhënia e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore; v) përfaqësimi përpara organeve administrative; dhe vi) dhënia e të gjitha formave të tjera të mbështetjes së nevojshme juridike që nuk përbëjnë ndihmë juridike dytësore.

⁶⁷ Ligji nr.80/2018 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”

⁶⁸ Neni 22 të Ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”

⁶⁹ Neni 25/1 e Ligjit nr.80/2015

⁷⁰ Neni 25/5 i Ligjit nr.80/2015

⁷¹ Neni 14/2 i Statutit të Universitetit të Tiranës, viti 2018

përcaktuar qartë edhe duke iu referuar përkufizimit të ndihmës juridike dytësore në kushtet që neni 3 gërma ‘b’ e Ligjit nr. 111/2017 përfshin edhe pikën e cila parashikon “vi) *dhënia e të gjitha formave të tjera të mbështetjes së nevojshme juridike që nuk përbëjnë ndihmë juridike dytësore*”.

Megjithatë, pa kundërshtuar sa më sipër, për qëllime të kontraktimit të klinikave ligjore me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas, vlen të qartësohet nëse vetë klinikat ligjore kanë personalitet juridik për të kontraktuar drejtpërdrejt me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas me qëllimin për të ofruar shërbimin e ndihmës juridike parësore dhe për të marrë financimet përkatëse nga kjo drejtori; shpjegimet në paragrafet e mësipërm në këtë seksion të Komentarit qartësojnë këtë çështje.

Shembuj të klinikave ligjore në Shqipëri, tashmë janë një realitet i mirë funksional. Klinikat ligjore, janë funksionale qysh para hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 111/2017 për ndihmën juridike të garantuar nga shteti. Disa prej tyre janë vendosur pranë universiteteve. Klinikat nuk janë mbështetur financiarisht nga shteti dhe disa prej tyre tashmë përfaqësojnë një përvojë disa vjeçare funksionimi. Megjithatë, klinikat e ligjit kanë shënuar rezultate pozitive në drejtim të ofrimit të shërbimeve ligjore falas për qytetarët në nevojë⁷⁴. Deri me sot, klinikat ligjore kanë mbuluar çështje në lidhje me të drejtat e natyrës social-ekonomike, duke shtuar edhe ato të natyrës mjedisore, me impakt në të drejtën për kujdes shëndetësor, si fusha dhe veprimtaria më e gjerë që hulumtohet nga klinikat e ligjit gjatë misionit dhe ushtrimit të veprimtarisë së tyre për dhënie ndihme juridike falas në format e parashikuara nga ligji dhe të emërtuara si shërbime paraligjore, forma këshillimi ose asistencë në institucionet e administratës publike. Por, edhe anketimet dhe raportet përkatëse kanë treguar se nevojat për asistencë i përkasin kategorisë dhe legjislacionit që i përket garantimit të këtyre të drejtave⁷⁵. Keshtu, Klinika e Ligjit pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, është parashikuar si pjesë e kurrikulave universitare përgjatë cikleve të studimit. Klinika e Ligjit është funksionale që nga viti 2011, ndonëse në kohëra të ndryshme, organizimi dhe funksionaliteti i klinikës është përceptuar dhe materializuar në një format ndryshe nga ai që ka sot. Klinika e Ligjit deri në vitin 2016 është mbështetur financiarisht nga OSBE dhe, më pas, nga USAID në kuadër të projektit “JUST”. Kjo klinikë si edhe klinikat ligjore të tjera duhet të mbështeten nga shteti për ofrimin e ndihmës juridike falas sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 111/2017. Disa nga veçoritë në këtë klinikë janë çështjet

e menaxhimit të saj. Me nënshkrimin e marrëveshjes me Drejtorinë për Ndhmën Juridike Falas, klinikat ligjore duhet të kenë pritshmëri lidhur me përfshirjen në më shumë aktivitete, si dhe mbulimin e mëtejshëm financiar, me qëllim vijueshmërinë e veprimtarisë së klinikës në përfitim të kërkuësve të ndihmës juridike.

Fushat prioritarë apo fushat e së drejtës që duhen mbuluar nga klinikat ligjore në ofrimin e ndihmës juridike parësore nuk janë përcaktuar shprehimisht në legjislacionin për ndihmën juridike të miratuar deri në datën e këtij Komentari. Gjithsesi, kjo mund të përcaktohet në kontratën që do të lidhet midis Drejtorisë së Ndhmës Juridike dhe klinikave ligjore përkatëse (shih më sipër mbi kontraktimin midis palëve përkatëse) në rastet kur këto të fundit do të financohen nga fondet shtetërore. Në rastet kur klinikat ligjore financohen me burime të tjera, fushat që ato mund të mbulojnë mund të orientohen nga kërkesa përkatëse e kërkuësve të ndihmës juridike. Pa kundërshtuar sa më sipër, në lidhje me klinikat ligjore, kur financohen nga fonde publike, orientimi nga kërkesa e kërkuësve të ndihmës juridike duhet të mbizotërojë në punën e këtyre klinikave kur ato financohen nga fonde publike.

Element i rëndësishëm i nenit 16 pika 2 e Ligjit nr. 111/2017 është trajnimi i studentëve nga Drejtoria e Ndhmës Juridike mbi ndihmën juridike parësore. Trajnimi i veçantë i studentëve duhet parë si domosdoshmëri dhe i lidhur ngushtësisht me parimin e profesionalizmit, cilësisë, efektivitetit dhe eficiencës në dhënien e ndihmës juridike. Duhet të sigurohet që ndihma juridike parësore të jepet vetëm nga studentët të cilët janë trajnuar sipas trajnimeve të miratuara nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas. Projektimi i trajnimeve⁷⁶ të studentëve mbi ndihmën juridike duhet të jetë i veçantë në raport me trajnimin që Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas zhvillon për punonjësit e qendrave të shërbimit të ndihmës juridike në bashkëpunim me Qendrën e Trajnimit të Administratës Publike.

Neni 17

Kërkesa dhe procedura e dhënies së ndihmës juridike parësore

1. *Kërkesa për dhënien e ndihmës juridike parësore bëhet me gojë ose me shkrim nga personi i interesuar pranë një qendre shërbimi për ndihmë juridike parësore ose një organizate jofitimprurëse të autorizuar.*

2. *Personi, i cili kërkon të përfitojë ndihmën juridike parësore, sipas pikës 1, të këtij neni, duhet të nënshkruajë një vetëdeklarim se përmbush kriteret e përcaktuara në këtë ligj, sipas formularit të vetëdeklarimit*

⁷⁴ Raport monitorimi mbi ofrimin e ndihmës juridike parësore, Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe OSFA (viti 2019).

⁷⁵ Raport monitorimi mbi ofrimin e ndihmës juridike parësore, Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe OSFA (viti 2019).

⁷⁶ Kjo duhet kuptuar si ‘training design’.

të miratuar nga Ministri i Drejtësisë, të shoqëruar me dokumentacionin justifikues. Lista e dokumenteve që shërbejnë për vërtetimin e përmbushjes së kriterëve përcaktohet me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

3. Ndihma juridike parësore ofrohet menjëherë me marrjen e kërkesës. Në rast se dhënia e menjëhershme e ndihmës juridike parësore është e pamundur, personi informohet menjëherë për datën dhe kohën e dhënies së shërbimit të kërkuar.

4. Një person ka të drejtën të marrë shërbimet e ndihmës juridike parësore për të njëjtën problematikë ose çështje vetëm një herë, me përjashtim të rasteve kur rrethana të reja të caktuara justifikojnë dhënien e shërbimeve të mëtejshme të ndihmës juridike parësore për të njëjtin person, rreth së njëjtës problematikë ose çështje.

5. Në rast se gjatë dhënies së shërbimeve të ndihmës juridike parësore konstatohet një konflikt interesi, ky shërbim ndërpritet menjëherë. Në rastin kur ndihma juridike parësore jepet nga një qendër shërbimi për ndihmë juridike parësore, çështja trajtohet në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative, për shmangien e konfliktit të interesit. Në rastin kur ndihma juridike parësore jepet nga një organizatë jofitimprurëse e autorizuar, kjo e fundit merr masa për shmangien e konfliktit të interesit, sipas dispozitave ligjore në fuqi, duke siguruar dhënien e shërbimeve të ndihmës juridike parësore për kërkuesin.

6. Në rast se gjatë dhënies së shërbimeve të ndihmës juridike parësore konstatohet se ekziston nevoja për dhënien e shërbimeve të ndihmës juridike dytësore, personi informohet menjëherë për kushtet e dhënies së ndihmës juridike dytësore dhe ndihmohet për plotësimin e kërkesës për dhënien e ndihmës juridike dytësore.

7. Gjatë ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore mbahet një procesverbal, i cili përmban:

a) emrin, mbiemrin dhe numrin e identifikimit personal të kërkuesit;

b) adresën e vendbanimit, të dhënat e kontaktit, gjendjen familjare, statusin e punësimit të kërkuesit;

c) një përshkrim të shkurtër të problematikës ose çështjes për të cilën janë kërkuar shërbimet e ndihmës juridike parësore;

ç) nëse është e mundur, kohëzgjatjen e takimit ose takimeve;

d) një përshkrim të shkurtër të dhënies së shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe rezultatin e këtij shërbimi;

dh) deklarimi se kërkuesi nuk ka përfituar më parë ndihmë juridike parësore për të njëjtën problematikë ose çështje;

e) të dhëna të tjera, sipas formularit të miratuar nga Ministri i Drejtësisë.

8. Ruajtja dhe përpunimi i të dhënave personale të kërkuesve të ndihmës juridike parësore bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 17 i Ligjit nr. 111/2017 parashikon mbi procedurën për t'u ndjekur nga kërkuesi i ndihmës juridike për të përfituar nga ndihma juridike parësore. Sipas dispozitës, kërkesa për dhënien e ndihmës juridike parësore bëhet me gojë ose me shkrim nga personi i interesuar pranë një operatori të ndihmës juridike parësore. Formalizimi i kërkesës, pavarësisht nëse është bërë me gojë apo me shkrim ndiqet me kërkesën dhe deklaratën përkatëse dhe regjistrimet në procesverbalin e hartuar sipas kërkesave të pikës 7 të nenit 17 (shih më poshtë shpjegimet përkatëse).

Formalizmi i kërkesës dhe dhënies së shërbimit të ndihmës juridike parësore, në fillim dhe gjatë procesit të dhënies së ndihmës juridike, është i rëndësishëm për qëllime të pasqyrimin të punës së kryer nga operatorët përkatës dhe për efekte të llogaridhënies para Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas. Mbi të gjitha, ai është i rëndësishëm për sigurinë mbi identitetin e subjektit kërkues dhe identifikimin nëse ai ka marrë më parë ndihme, dhe regjistrimin e çështjes, kohëzgjatjes së takimeve dhe rezultatet e çdo takimi janë të rëndësishme për strategjinë e çështjes dhe, kur është e nevojshme, për kalimin e një çështje lehtësisht nga një punonjës i ndihmës juridike në një punonjës tjetër, për të mos shkaktuar vonesa për përfituesin e ndihmës, por edhe për qëllime të llogaridhënies së operatorëve përkatës para subjekteve përfituese të ndihmës juridike falas.

Në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, janë publikuar aktet nënligjore të miratuara me shtojcat përkatëse, në të cilat gjenden edhe formularët në formën e skanuar. Në veçanti, formulari i kërkesës për ndihmë juridike parësore dhe formulari i vetëdeklarimit për ndihmë juridike parësore janë dy formularët kryesorë që mundësojnë që ndihma juridike parësore e kërkuar të jepet menjëherë, siç përcaktohet në pikën 3 të këtij neni.

Një parim tjetër që sanksionon ky nen në lidhje me ndihmën juridike parësore është se një ndihmë specifike jepet vetëm njëherë, përveçse kur ajo duhet të ndiqet nga shërbime të tjera të ndihmës juridike parësore ose me shërbime të ndihmës juridike dytësore (shih pika 4 e nenit 17).

Pika 5 e këtij neni parashikon mbi rastet kur ndihma juridike parësore jepet nga qendrat shtetërore të ndihmës juridike. Në këtë rast, Kodi i Procedurave Administrative rregullon veprimtarinë e qendrës dhe punën e punonjësve me trajnim të posaçëm dhe është i rëndësishëm për t'u respektuar veçanërisht në lidhje me shmangien e konfliktit të interesit. Në lidhje me detyrimet e organizatave jofitimprurëse që japin ndihmë juridike parësore, krahas ligjit dhe akteve nënligjore përkatëse, kontrata e lidhur midis organizatës përkatëse dhe Drejtorisë së Ndihmës Juridike rregullon detyrimet e organizatës për të respektuar rregullat dhe procedurat në lidhje me kërkesën dhe dhënien e ndihmës juridike parësore.

Pika 8 e nenit parashikon edhe për detyrimin në lidhje me ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale të kërkuësve të ndihmës juridike parësore sipas legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, detyrim i cili është i zbatueshem për çdo operator të ndihmës juridike parësore, qoftë qendrat shtetërore të shërbimit apo operatorët privatë të ndihmës juridike parësore.

Aktet nënligjore përkatëse në lidhje me kërkesën dhe dhënien e ndihmës juridike parësore, të cilat janë të rëndësishme, në veçanti për zbatimin e nenit 17, janë si më poshtë:

(i) Urdhëri nr.225, datë 25.03.2019, “Për miratimin e formularëve të ndihmës juridike të garantuar nga shteti”:

Shtojca I - formulari i kërkesës për ndihmë juridike parësore;

Shtojca IV - formulari i vetdeklarimit për të ardhurat e pakta;

Shtojca V - formulari i deklarimit për kategoritë e posaçme;

Shtojca VII - formati i regjistrimit të organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore.

(ii) Urdhëri nr.226, datë 25.03.2019 “Për miratimin e kontratave të ndihmës juridike të garantuar nga shteti” me Shtojcën I- kontrata tip me organizatat jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore.

KREU V

NDIHMA JURIDIKE DYTËSORE

Neni 18

Dhënia e ndihmës juridike dytësore

Ndihma juridike dytësore jepet nga avokatët që përfshihen në listën e miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, në bazë të kërkesës së personit që gëzon të drejtën për përfitimin e ndihmës juridike dytësore, sipas neneve 11 ose 12, të këtij ligji. Kërkesa hartohet sipas formularit të kërkesës, të miratuar nga Ministri i Drejtësisë.

Sipas këtij neni vetëm avokatët mund të japin ndihmën dytësore pra shërbimin juridik për përpilimin e akteve për të vënë në lëvizje gjykatën; ofrimin e këshillimit, përfaqësimit dhe mbrojtjes para gjykatës në çështjet administrative, civile dhe në çështjet penale.

Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë ka detyrimin ligjor të hartimit dhe miratimit të listave të avokatëve për ofrimin e ndihmës juridike dytësore. Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë kërkon fillimisht nga avokatët apo studiot e avokatisë, të paraqesin pranë saj shprehjen e interesit për ofrimin e një shërbimi të tillë. Kërkesa hartohet sipas formularit që shoqëron njoftimin dhe është e ndarë sipas specialiteteve. Çdo subjekt që shpreh interesin për ofrimin e ndihmës juridike ka të drejtë të zgjedhë pa kufizime kandidimin në specialitet si më poshtë:

- e drejta civile
- e drejta penale
- e drejta administrative
- drejtësia penale për të mitur. Tek kjo e fundit vetëm avokatët që janë duke u trajnuar në këtë fushë dhe që i plotësojnë kushtet për certifikim për këtë qëllim.

Aplikantët për kandidim, bashkë me formularin mund të paraqesin edhe dokumenta shtesë të specializimit në fushën që ata kërkojnë. Bashkë me dokumentat e mësipërme duhet të depozitohet edhe vërtetim që vërteton se aplikanti nuk ka detyrime tatimore, së bashku me deklaratë personale të gjendjes gjyqësore.

Dhënia e ndihmës juridike është e veçantë për çdo dhomë vendore avokatie dhe, për këtë shkak, aplikimi bëhet për çdo dhomë vendore. Nuk lejohet që një avokat i cili nuk është antar i një dhome vendore avokatie, të aplikojë pranë kësaj dhome për ofrimin e ndihmës juridike.

Sipas përcaktimeve të bëra në Kodin e Procedurës Penale mbrojtja e të pandehurit bëhet vetëm nëpërmjet avokatit (mbrojtësit për terminologjinë e përdorur në të), ndërkohë në Kodin e Procedurës Civile (neni 96), përfaqësuesi avokat i palës është vetëm një prej kategorive që realizojnë përfaqësimin në një gjyq civil. I njëjti zbatim si në Kodin e Procedurës Civile zbatohet edhe në rastin e gjykimit administrativ.

Sipas nenit 20 të ligjit nr. 55/2018 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë” të gjithë kandidatët për avokat, që plotësojnë kushtet e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d” dhe “dh”, të pikës 2, të nenit 13, të këtij ligji, kanë të drejtë të regjistrohen pranë Dhomës së Avokatisë të Shqipërisë për të kryer stazhin 1-vjeçar të kandidatit për avokat. *Kandidati për avokat ka të drejtë të përfaqësojë ose të mbrojë klientin në fazën hetimore, në gjykimin e kundërvajtjeve penale, me autorizimin dhe praninë e avokatit, si dhe kurdoherë me pëlqimin me shkrim të klientit.*

A mundet që një kandidat për avokat të ofrojë ndihmën juridike dytësore? Pavarësisht përcaktimeve që ka bërë ligji për profesionin e avokatit duke mundësuar për kandidatët për avokat që të mbrojnë një person në fazat hetimore apo gjykimin e kundërvajtjeve penale, (në praninë e avokatit), ata përderisa formalisht nuk kanë titullin avokat nuk mund ta ushtrojnë apo ofrojnë dhënien e ndihmës juridike dytësore sipas ligjit “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

Në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në këtë nen është miratuar nga Ministri i Drejtësisë edhe akti nënligjor, sipas formatit që i bashkëlidhet këtij Komentari. Teksti i këtij Formulari përmban pyetje dhe kërkon të dhëna, që duke mbajtur parasysh edhe nivelin e personave që përfitojnë këtë lloj ndihme juridike, janë në pamundësi ta plotësojnë atë siç duhet. Për këtë gjë ata kanë nevojë për asistencë, e cila rezulton se mund të jepet nga ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore, përderisa në fund të formularit edhe ata duhet të nënshkruajnë atë. Gjithsesi, nënshkrimi i këtij të fundit në Formular nuk është domosdoshmëri juridike. Një person që paraqet kërkesën për ndihmë juridike dytësore mund ta plotësojë dhe nënshkruajë edhe vetëm Formularin dhe ta paraqesë atë personalisht ose me postë në gjykatë. Për pasojë, nënshkrimi i Formularit edhe nga ana e punonjësit të ndihmës juridike parësore nuk përbën kusht të domosdoshëm për fillimin e shqyrtimit të saj nga gjykata.

Neni 19

Kërkesa për ndihmë juridike dytësore

1. Kërkesa për dhënien e ndihmës juridike dytësore paraqitet nga personi i interesuar personalisht ose me anë të shërbimit postar pranë gjykatës ose organit procedues që fillon hetimet, përpara fillimit të një procesi gjyqësor, në fillim të një procesi gjyqësor dhe/ose në çdo fazë të procesit gjyqësor, derisa nuk është deklaruar i mbyllur hetimi gjyqësor, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin procedural.

2. Personi që gëzon të drejtën për ndihmë juridike dytësore, mund ta paraqesë kërkesën e parashikuar në pikën 1, të këtij neni, nëpërmjet një përfaqësuesi ligjor apo të pajisur me prokurë, ose nëpërmjet bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es ose një të afërmi të shkallës së parë.

3. Kërkesa për ndihmë juridike dytësore përjashtohet nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore.

4. Personi, i cili kërkon të përfitojë ndihmë juridike dytësore, nënshkruan një vetëdeklarim se përmbush kriteret e përfitimit, të përcaktuara në këtë ligj, sipas formularit të vetëdeklarimit të miratuar nga Ministri i Drejtësisë, të shoqëruar me dokumentacionin justifikues. Lista e dokumenteve që shërbejnë për vërtetimin e përmbushjes së kriterëve përcaktohet me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

Dispozita e mësipërme paraqet modalitetet e paraqitjes së kërkesës për dhënien e ndihmës juridike dytësore. Kërkesa, siç parashikohet në 18, realizohet nëpërmjet një formulari, i cili paraqitet në gjykatë nga personi i interesuar personalisht apo edhe nëpërmjet shërbimit postar. Kërkesa nënshkruhet nga vetë personi apo përfaqësuesi i tij ligjor, përfaqësues me prokurë apo bashkëshorti/bashkëjetuesi apo apo fëmijët e përfituesit të ndihmës juridike dytësore.

Në paragrafin 3 të kësaj dispozite paraqitet fjala “shpenzimet”; është e paqartë se çfarë ka pasur parasysh Ligjvënësi me fjalën shpenzime gjyqësore dhe cili mund të jetë rrethi i situatave konkrete kur për kërkesën për ndihmë juridike dytësore nuk duhet të kryhen shpenzime gjyqësore, sipas përcaktimit që i bëjnë konceptit të shpenzimeve ligjet përkatëse procedurale.

Në rast se procesi gjyqësor ka nisur, kërkesa për ndihmën juridike dytësore paraqitet tek i njëjti gjyqtar apo kërkesa depozitohet në sekretari dhe gjyqtari që e shqyrton atë caktohet me short? Në disa raste të paraqitjes së kërkesës për ndihmën juridike dytësore,

kërkesa mund të paraqitet edhe veçmas. Psh për të hartuar kërkesë padinë personi që plotëson kushtet për të përfituar ndihmën juridike dytësore ka nevojë për asistencën e një avokati, ndaj edhe kërkesa paraqitet para depozitimit të kërkesëpadisë. Në rast se, për ndonjë arsye, procesi gjyqësor ka filluar atëherë është e këshillueshme që kërkesa për ndihmën juridike dytësore të paraqitet për vendimmarrje tek i njëjti gjyqtar që ka filluar shqyrtimin e çështjes, qoftë edhe në fazën e veprimeve përgatitore të kërkesë padisë.

Nisur nga praktika e deritanishme dhe me qëllim unifikimin e procedurës që duhet të ndiqet në të gjithë gjykatat është e nevojshme hartimi i një metodologjie sesi shqyrtohet kërkesa për ndihmën juridike dytësore, kur ajo paraqitet para hartimit të kërkesë padisë apo sipas rastit deklaratës së mbrojtjes, gjatë shqyrtimit gjyqësor të një kërkesëpadie deri në mbylljen e hetimit gjyqësor në gjykatë.

“Kërkesa për dhënien e ndihmës juridike dytësore paraqitet ..nga personi i interesuar personalisht ose me anë të shërbimit postar pranë organit procedues që fillon hetimet...,” Situata juridike e parashikuar në këtë nen është e ndryshme nga ajo që parashikohet në nenin 21 të ligjit kur përfituesi i ndihmës juridike dytësore që fillon merr statusin e të pandehurit.

Edhe personi që është nën hetim, sipas përcaktimeve që bën Kodi i Procedurës Penale, në rastet kur përmbush kërkesat e parashikuara në këtë ligj, është përfitues i ndihmës juridike dytësore. Në çështjen *Salduz v Turqisë*, vendim i Dhomës së Madhe të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, theksohet se: “Në këtë drejtim, Gjykata nënvizon rëndësinë e fazës së hetimit për përgatitjen e procedimit penal, pasi provat e marra gjatë kësaj faze përcaktojnë kornizën në të cilën vepra e ngarkuar do të shqyrtohet në gjykim (shih *Can v. Austrisë*, nr. 9300/81, raport i Komisionit i 12 korrikut 1984, § 50, Seria A nr. 96). Në të njëjtën kohë, i akuzuari shpesh e gjen veten në një pozitë veçanërisht vulnerabël në atë fazë të procedurës, efekti i tij është i shumëfishuar me faktin se legjislacioni mbi procedurën penale ka tendencë të bëhet gjithnjë e më kompleks, veçanërisht duke respektuar rregullat që përcaktojnë mbledhjen dhe përdorimin e provave. Në shumicën e rasteve, kjo cenueshmëri e veçantë mund të kompensohet siç duhet vetëm me ndihmën e një avokati, detyra e të cilit, ndër të tjera, është të ndihmojë për të siguruar respektimin e të drejtës së një të akuzuari për të mos inkriminuar veten e tij. ... 55. Përkundër këtij sfondi, Gjykata konstaton që në mënyrë që e drejta për një gjykim të drejtë të mbetet mjaftueshëm “praktike dhe efektive”, neni 6 § 1 kërkon që, si rregull, aksesin tek një avokat duhet të sigurohet që nga marrja më e parë

në pyetje e një të dyshuari nga policia, përveç nëse dëshmohet në dritën e rrethanave të veçanta të secilit rast se ekzistojnë arsye bindëse për të kufizuar këtë të drejtë. Edhe kur arsyet bindëse mund të justifikojnë në mënyrë të jashtëzakonshme mohimin e aksesit tek një avokat, një kufizim i tillë – cilido qoftë arsyetim i tij - nuk duhet të paragjykojë padrejtësisht të drejtat e të akuzuarit sipas nenit 6 (shiko, *mutatis mutandis*, *Magee*, cituar më lart, 44 §). Të drejtat e mbrojtjes, në parim, paragjykojnë në mënyrë të pakthyeshme, kur deklaratat inkriminuese të bëra gjatë marrjes në pyetje të policisë pa aksesin tek avokati janë përdorur për një dënim.”

Në çështjen *Aleksand Zaichenko kundër Rusisë*, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut ka theksuar se: “54. Duke pasur parasysh konceptin e drejtësisë në nenin 6, Gjykata konsideron se e drejta për të mos inkriminuar veten, në mënyrë të arsyeshme, nuk mund të kufizohet në deklaratat e pranimit të veprimeve keqbërëse ose në vërejtje që janë drejtpërdrejt inkriminuese (shiko *Saunders*, cituar më lart, § 71). Dëshmia e marrë nën detyrim, e cila paraqitet në pamjen e saj të një natyre jo-inkriminuese - siç janë vërejtjet ngacmuese ose informacione të thjeshta për çështje faktike - më vonë mund të vendosen në procedimet penale në mbështetje të çështjes penale, për shembull për të kundërshtuar ose hedhur dyshime mbi deklaratat e tjera të të akuzuarit ose provave të dhëna prej tij gjatë gjykimit ose ndryshe të nënvlerësojnë besueshmërinë e tij (po aty).”

Neni 109, paragrafi 3 i ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” përcakton se: “3. Personi i shoqëruar ka të drejtë të njoftohet menjëherë në gjuhën që ai kupton, për shkaqet e shoqërimit. Ai/ajo duhet të njoftohet se nuk ka asnjë detyrim të bëjë ndonjë deklaratë dhe ka të drejtë të komunikojë menjëherë me një person të besuar dhe avokatin.”

Ndërkohë sipas nenit 6, “Shoqërimi” është dërgimi i shtetasit në ambientet e policisë, në institucionet shëndetësore, në qendrat e rehabilitimit, te kujdestari ose personi përgjegjës, në institucionin urdhërdhënës ose në institucionet e tjera me ose pa vullnetin e tij, sipas përcaktimeve të bëra në nenet 109 dhe 122, pika 1, të këtij ligji.”

Neni 19 në situatën juridike që parashikon përcakton se ndihma juridike dytësore është e detyrueshme të ofrohet për personin që plotëson kushtet për ta përfituar atë, që nga momenti i shoqërimit deri në momentin (nëse vijojnë hetimet) kur personi merr statusin e të pandehurit sipas Kodit të Procedurës Penale. Kjo fazë, pra ofrimi i ndihmës juridike dytësore nga momenti i shoqërimit të personit në Policinë e Shtetit, rezulton

se është i pambuluar në kuptimin normativ nga asnjë akt nënligjor, i nxjerrë deri më tani në zbatim të ligjit “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”. Është e nevojshme që për zbatimin e plotë të ligjit për të cilit bëhet ky koment, jurisprudencës së Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe vetë përcaktimit të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, Ministri i Drejtësisë, Ministri i Brendshëm dhe Prokurori i Përgjithshëm të hartojnë një akt të përbashkët nënligjor për të rregulluar çështjen e ofrimit të ndihmës juridike dytësore për personat (që plotësojnë kushtet) që nga faza e shoqërimit të tij në Policinë e Shtetit dhe më tej kur është përsosur nën hetim, deri në momentin e marrjes si i pandehur, sipas Kodit të Procedurës Penale.

Neni 20

Paraqitja e kërkesës për ndihmë juridike dytësore dhe organi kompetent për shqyrtimin e saj

1. Kërkesa për ndihmë juridike dytësore paraqitet në gjykatën kompetente për shqyrtimin e çështjes në themel, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.
2. Kërkesa për ndihmë juridike dytësore e të pandehurit pa mjete të mjaftueshme financiare paraqitet pranë organit procedues që fillon hetimet, sipas nenit 21 të këtij ligji.

Në gjykatën kompetente që shqyrtohet themeli i çështjes civile, administrative apo penale paraqitet edhe kërkesa për ndihmën juridike dytësore. Në zbatimin në praktikë të ligjit krijon vështirësi “përcaktimi i gjykatës kompetente për shqyrtimin e çështjes në themel”. Kjo për faktin se në objektin e një kërkesëpadie mund të ketë më shumë sesa një kërkim, për të cilin mund të jenë kompetente për shqyrtimin e saj gjykata të juridiksioneve të ndryshme. Psh në rast kur në objektin e padisë është kërkitimi i shpalljes absolutisht të pavlefshme të lejes së legalizimit dhënë për një person të caktuar dhe pastaj kërkitimi tjetër është lirimi dhe dorëzimi i sendit tek paditësi prej ati që e posedon sipas lejes së legalizimit. Në rastin e shqyrtimit të pavlefshmërisë së lejes së legalizimit kompetente është gjykata administrative e shkallës së parë, ndërsa në rastin e shqyrtimit të kërkitimit për lirim dorëzim sendi kompetente është gjykata civile e vendit ku ndodhet sendi. Gjykimi administrativ zhvillohet i pari dhe pasi vendimi pozitiv për paditësin i gjykatës administrative merr formë të prerë fillon gjykimi i çështjes civile për lirim dhe dorëzim sendi. Në këtë rast personi që plotëson kushtet ligjore për të qënë përfitues i ndihmës juridike dytësore do të kërkojë në fillim ndihmën juridike në gjykatën administrative dhe më pas ajo do të jetë e vlefshme edhe për gjykimin civil? Duke qënë se kohëzgjatja e gjyqeve është e madhe dhe për më tepër kur gjyqi civil fillon pasi vendimi i gjykatës

administrative (në rast se është në favor të paditësit) merr formë të prerë, si kontrollohet se personi vijon ende të jetë përfitues i ndihmës juridike dytësore dhe psh nuk është më në kushtet ekonomike dhe ligjore kur duhet ta përfitojë atë? A duhet të marrë përsëri personi të kërkojë ndihmë juridike dytësore për zhvillimin e gjyqit civil, nëpërmjet një procedure *ex novo*?

Përgjigjet e këtyre pyetjeve nuk gjenden as në tekstin e ligjit dhe as në tekstin e ndonjë akti nënligjor të nxjerrë në zbatim të tij. Në mungesë të rregullimit të drejpërdrejtë ligjor vlerësojmë se aktet nënligjore mund dhe duhet të parashikojnë zbatimin e parimit bazë, atë që ndihma juridike dytësore jepet me vendim të gjykatës së shkallës së parë dhe ndihma juridike e ndjek personin përfitues edhe në shkallët e tjera të gjykitimit. Sigurisht, duke qënë se do të ekzistojë një kohë relativisht e madhe mes shqyrtimit në shkallë të parë dhe shqyrtimit gjyqësor në apel apo Gjykatë të Lartë, akti nënligjor mund të parashikojë që në këtë ndërkohë individit të nënshkruajë peridikisht deklarata/formularë me vlerë zyrtare që gjendja e tij financiare dhe rrethabat në të cilat ka përfituar ndihmën juridike dytësore për të dhe familjen e tij nuk kanë ndryshuar.

Pika 2 e këtij neni përmend shprehjen “*Të pandehurit pa mjete të mjaftueshme financiare*”. Termi mjete të pamjaftueshme financiare është një term i ri, i cili nuk është përkufizuar në nenin përkatës të përkufizimeve të ligjit. Gjithsesi, edhe në këtë rast, testi i cili duhet të plotësohet nga përfituesi i ndihmës juridike dytësore (i pandehuri) është i njëjtë me atë të parashikuar në nenin 12 të ligjit. I pandehuri duhet të provojë se nuk ka të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme për të përballuar shpenzimet për këshillim, përfaqësim dhe/ose mbrojtje në çështjet penale. Të ardhurat e një personi, i cili jeton në një familje, konsiderohen të pamjaftueshme, nëse të ardhurat në total të të gjithë pjesëtarëve të familjes, të pjesëtuara për numrin e anëtarëve të familjes, janë më të ulëta se 50 për qind e pagës minimale mujore të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi. Të ardhurat e një personi, i cili nuk jeton në një familje, konsiderohen të pamjaftueshme, nëse janë më të ulëta se niveli i pagës minimale mujore të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi. Pasuria e një personi konsiderohet e pamjaftueshme, nëse vlera e saj në total nuk tejkalon vlerën e 36 pagave minimale mujore sipas legjislacionit në fuqi.

Në zbatim të përcaktimeve që ka bërë Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut dhe jurisprudenca e zhvilluar prej Gjykatës së Strasburgut, por edhe nga fryma e ligjit “Për mbrojtjen juridike të garantuar nga shteti”, ndihmë juridike dytësore përveç rasteve të shqyrtimit të themelit të çështjes nga gjykata, zbatohet edhe në rastet e instituteve të tjera proceduriale të së

drejtës civile, administrative apo penale. Për shembull, një person që përmbush kushtet e përcaktuara në këtë ligj përfiton nga ndihma juridike dytësore në rastet e paraqitjes së kërkesës për rishikimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë, apo në rastet e kërkesës për rivendosje në afat, apo në rastin e kundërshtimit të veprimeve përmbartimore, etj.

Ndihma juridike dytësore është detyrim të jepet për personat që plotësojnë kushtet ligjore edhe në fazat e shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën e Lartë. Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr. 9, datë 29.02.2012, është shprehur se: “Gjykata rithekson se veçanërisht në procesin penal, barazia e armëve, kontradiktoriteti dhe, lidhur ngushtë me këto, realizimi i mbrojtjes së të pandehurit, garantuar shprehimisht në nenin 31 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të KEDNJ-së, përbëjnë në vetvete elementet më thelbësore të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Këto elemente thelbësorë të procesit të rregullt ligjor duhet të respektohen në të gjitha shkallët e gjykimit, duke përfshirë dhe atë në Gjykatë të Lartë. Në dallim nga procedurat strikte të gjykimit që zhvillohen në gjykatat e zakonshme, gjykimi në Gjykatën e Lartë, ka si veçori paraqitjen vetëm të argumenteve ligjore. Kompleksiteti i procedurave të gjykimit në Gjykatën e Lartë konfirmohet dhe nga dispozitat që sanksionojnë se palët duhet të përfaqësohen në këtë gjykim nga avokati. Prandaj, shqyrtimi në Gjykatën e Lartë kryesisht të çështjeve të ligjit, jo vetëm që justifikon plotësisht përfaqësimin me avokat në seancën dëgjimore, por për më tepër, bëhet i domosdoshëm për garantimin në favor të të pandehurit të një mbrojtjeje efektive dhe profesionale (shih vendimet nr.28, datë 02.10.2009, nr. 37, datë 24.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese).

Gjykata ka theksuar se interesat e drejtësisë kërkojnë detyrimisht realizimin e mbrojtjes, qoftë edhe me avokat të caktuar kryesisht, të të pandehurit që gjykohet nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë mbi bazën e rekursit të paraqitur nga prokurori, në të cilin, ndër të tjera, kërkohet një rëndim i pozitës së tij në krahasim me vendimin e dhënë për këtë çështje nga gjykata e apelit.”

Aktet nënligjore duhet të plotësojnë vakumin që ekziston nëse personi përfitues që ka marrë ndihmë juridike dytësore në shkallën e parë, ka të drejtë të vijojë me ndihmë juridike dytësore dhe me të njëjtin avokat si në gjykatën e apelit apo edhe gjykatën e lartë, apo duhet për çdo nivel gjykate të jepet një vendim i ri për ndihmën juridike dytësore? Në rast se duhet vendim i ri kërkesë për ndihmë juridike dytësore ku duhet të paraqitet, përsëri në shkallën e parë apo sipas rastit në Gjykatën e Lartë dhe në gjykatën e apelit ku zhvillohet gjyqi?

Neni 21

Procedura e dhënies së ndihmës juridike dytësore të pandehurit pa mjete të mjaftueshme financiare

1. Në rast se kërkesa për ndihmë juridike dytësore paraqitet nga i pandehuri pa mjete të mjaftueshme financiare, organi procedues që fillon hetimet shqyrton menjëherë nëse përmbushen kriteret e përcaktuara në nenin 12 të këtij ligji.

2. Nëse organi procedues që fillon hetimet vlerëson se kriteret janë përmbushur, cakton menjëherë një avokat mbrojtës nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore dhe njofton menjëherë personin, të cilit i ofrohet ndihmë juridike dytësore, si dhe avokatin e caktuar mbrojtës.

3. Vendimi për pranimin ose rrëzimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore jepet i arsyetuar dhe i njoftohet kërkuarit dhe Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.

4. Kërkuari mund ta kundërshtojë vendimin e organit procedues për rrëzimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore, me padi në gjykatën penale të shkallës së parë, kompetente për shqyrtimin e çështjes në themel, brenda 5 ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim.

5. Gjykata shqyrton çështjen me një gjyqtar, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin procedural, brenda 15 ditëve nga regjistrimi i çështjes. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi i veçantë në gjykatën e apelit brenda 5 ditëve nga marrja dijeni. Gjykata e apelit e shqyrton ankimin në dhomë këshillimi brenda 10 ditëve nga data e marrjes së akteve.

6. Këshilli i Lartë i Prokurorisë miraton rregullat dhe procedurat që ndiqen nga organi procedues që fillon hetimet, për caktimin mbi bazë të parimit të rotacionit të avokatit mbrojtës dhe zëvendësimin e tij nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore në procesin penal.

7. Rregulla të hollësishme që lidhen me garantimin e mbrojtjes së detyrueshme nga institucionet e parashikuara në këtë ligj, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale, miratohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

Neni 21 i ligjit “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” përcakton procedurën e dhënies së ndihmës juridike dytësore. Dhënia e ndihmës juridike dytësore nga organi procedues sipas këtij neni, duhet të paraqitet nga i pandehuri, dhe siç e kemi theksuar në komente e neneve të tjera kufizimi i dhënies së ndihmës juridike vetëm nga personi që ka statusin e të pandehurit është

në shkelje të nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Dhënia e ndihmës juridike dytësore mund dhe duhet t'u jepet edhe personave të tjerë që nuk e kanë këtë status juridik, pra që janë të përfshirë në rrethin e subjekteve që kanë një pozitë procedurale sipas Kodit të Procedurës Penale, duke filluar që nga momenti shoqërimit të detyrueshëm, ndalimit, personit nën hetim etj.

Vakumin e konstatuar në këtë nen dhe në nenet e tjera të këtij ligji për personat që nuk kanë cilësimin juridik si i pandehur, duhet të plotësohen me aktet nënligjore që duhet të nxirren në bazë dhe për zbatim të këtij ligji. Në një rast të tillë aktet nënligjore duhet të referojnë drejtpërdrejtë në parimet dhe modalitetet e përcaktuara në jurisprudencën e zhvilluar nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut.

Gjyqtari dhe prokurori duhet të vendosin për ndihmën juridike dytësore, vetëm pasi të jetë plotësuar i gjithë dokumentacioni i kërkuar nga ky ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij prej kërkuesit të kësaj ndihme. Plotësimi i formularëve përkatës për këtë ndihmë dhe vendimarrja në lidhje me to duhet të jetë pjesë e dosjes përkatëse gjyqësore ose hetimore.

Neni 49 i Kodit të Procedurës Penale përcakton se:

“2. Nëse ekzistojnë arsyet për mbrojtje të detyrueshme, sipas këtij neni, organi procedues i cakton menjëherë një mbrojtës të pandehurit. Mbrojtësi ndihmon të pandehurin në të gjitha fazat e procedimit, për aq kohë sa ekzistojnë kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

3. Mbrojtësi i caktuar, sipas këtij neni, zgjidhet nga organi procedues nga lista e vënë në dispozicion nga Dhoma e Avokatisë.

4. Gjykata, prokurori dhe policia gjyqësore, kur duhet të kryejnë një veprim për të cilin parashikohet ndihma e mbrojtësit dhe kur i pandehuri është pa mbrojtës, njoftojnë për këtë veprim mbrojtësin e caktuar.

6. Mbrojtësi i caktuar mund të zëvendësohet vetëm për shkaqe të përligjura. Ai i pushon funksionet kur i pandehuri zgjedh mbrojtësin e tij.

7. Kur mbrojtja nuk mund të sigurohet sipas kësaj dispozite dhe pikës 3, të nenit 49, mbrojtja garantohet nga institucionet që administrojnë ndihmën juridike falas, sipas legjislacionit në fuqi.”

Nga krahasimi i këtyre dy dispozitave, të cilat janë miratuar në kohë të ndryshme me njëra tjetrën, vërehet

se ato nuk janë të hamonizuara. Kontradiktat mes këtyre dy neneve nuk ka arritur t'i zgjidhë as edhe vendimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 231, datë 12.11.2019 “Për miratimin e Rregullores për rregullat e garantimit të mbrojtjes së detyrueshme dhe caktimin mbi bazën e parimit të rotacionit të avokatit mbrojtës nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmes juridike dytësore në procesin penal.”

Pika 3 e nenit 49 të Kodit të Procedurës Penale përcakton se lista e avokatëve mbrojtës duhet të vihet në dispozicion nga Dhoma e Avokatisë dhe nëse kjo gjë nuk është e mundur atëherë mbrojtja sigurohet nga avokatët që ushtrojnë ndihmën juridike dytësore në procesin penal. Pra, rezultojnë se sipas nenit 49 të KPP ka dy lista avokatësh për mbrojtjen e detyrueshme dhe mbrojtjen juridike dytësore, ndërkohë që ligji për ndihmën juridike në lidhje me këtë fazë të procedimit penal bën fjalë vetëm për një listë të avokatëve që ushtrojnë mbrojtjen ligjore falas. Një gjë e tillë bëhet e qartë edhe nga formulimi i ndryshëm që ka pika 6 e këtij neni me pikën 7 të tij, që përcakton se KLP duhet të miratojë dy akte nënligjore në zbatim të këtij neni.

Nga ana tjetër, në këtë nen, përdoret shprehja “Nëse organi procedues që fillon hetimet vlerëson se kriteret janë përmbushur...”, ndërkohë që pika 25 e vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë thekson se “Organi procedues i vë në dispozicion të ndaluarit/të arrestuarit/ të pandehurit për të plotësuar një formular sipas formatit të miratuar nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ku duhet të deklarojë gjendjen ekonomike dhe të shprehë vullnetin se kërkon të mbrohet me një avokat të caktuar nga shteti.” Dispozita ligjore përdor fjalën “vlerëson” pra një proces analize mbi bazën e të cilave duhet të marrë vendim organi procedues, ndërsa akti nënligjor i Këshillit të Lartë të Prokurorisë e anashkalon vlerësimin, sepse merr të mirëqënë me fuqi të plotë juridike nënshkrimin e formularit përkatës të miratuar nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas. Është e kuptueshme që ky formular duhet të jetë me një natyrë të ndryshme nga ai i zakonshmi dhe posaçërisht vetëm për këta persona sepse ata, në gjendjen ku janë, e kanë të pamundur të marrin dokumenta dhe/ose të vërtetojnë gjendjen e tyre ekonomike që i pamundëson mbrojtje me avokatin që dëshirojnë të kenë me zgjedhjen e tyre të lirë.

Pika 4 e këtij neni po ashtu rezultojnë se mund të jetë problematike gjatë zbatimit të saj në praktikë. Sipas kësaj pike “Kërkuesi mund ta kundërshtojë vendimin e organit procedues për rrëzimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore, me padi në gjykatën penale të shkallës së parë...” Kërkuesi në këtë rast psh mund të jetë në kushtet e masës së arrestit në burg (por edhe nëse ai është në gjendje të lirë) ankimi i një vendimi

gjyqësor është një element i cili në aftësitë e tij ai e ka të pamundur që ta hartojë për shkak të gjendjes/situatës në të cilën ndodhet. Pra, akti nënligjor duhet të ketë edhe zgjidhjen në rast se një person psh që është në paraburgim dhe nuk ka mjete financiare të mjaftueshme për të marrë mbrojtës ligjor, duhet të hartojë një kërkesë ankimore në gjykatën e apelit ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë me të cilin i është refuzuar kërkesa për të përfituar ndihmën juridike dytësore. Një zgjidhje mund të jetë që avokati që ka ndihmuar personin në hartimin e kërkesës duhet të ketë detyrimin të ndihmojë atë edhe në rastin e hartimit të kërkesës ankimore në gjykatën e apelit ose eventualisht Gjykatat duhet të kenë dhe përdorin formularë sa më të thjeshtë dhe të kuptueshëm për të mundësuar që ankimi të hartohet nga vetë personi.

Neni 22

Shqyrtimi i kërkesës për ndihmë juridike dytësore nga gjykata

1. Gjykata shqyrton kërkesën për ndihmën juridike dytësore në përputhje me parashikimet në legjislacionin procedural dhe, për aq sa është e mundur, me dispozitat e këtij ligji.

2. Vendimi në lidhje me kërkesën për ndihmë juridike dytësore merret nga gjykata kompetente:

a) brenda 5 ditëve nga data e regjistrimit të kërkesës, kur kërkesa paraqitet përpara fillimit të procesit gjyqësor;

b) gjatë veprimeve paraprake ose në seancën përgatitore përpara se të caktohet seanca gjyqësore, kur kërkesa për ndihmë juridike është paraqitur bashkë me kërkesë-padinë;

c) sipas parashikimeve të legjislacionit procedural dhe dispozitave të këtij ligji, kur kërkesa paraqitet gjatë shqyrtimit gjyqësor.

3. Në rastet kur kërkuesi deklaron pamundësinë për sigurimin e dokumentacionit, si dhe në çdo rast tjetër kur gjykata çmon se korrigjimi ose plotësimi i kërkesës mund të bëhet shkak për vonesa, të cilat cenojnë thelbin e të drejtave të kërkuesit, gjykata mund të urdhërojë dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm nga organet e administratës shtetërore që e disponojnë atë. Në këto raste kërkesa për ndihmë juridike dytësore quhet e paraqitur në përfundimin e afatit të vendosur nga gjykata për paraqitjen e dokumentacionit plotësues nga organet e administratës shtetërore.

4. Gjykata, në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe parashikimet në legjislacionin procedural, pas shqyrtimit të kërkesës vendos:

a) pranimin e kërkesës për dhënien e ndihmës juridike dytësore;

b) rrëzimin e kërkesës për dhënien e ndihmës juridike dytësore.

5. Kërkesa për ndihmë juridike dytësore rrëzohet vetëm në rastet kur:

a) nuk përmbushen kushtet e parashikuara në nenet 11 ose 12 të këtij ligji;

b) është dukshëm abuzive ose haptazi e pabazuar.

6. Vendimi për pranimin ose rrëzimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore jepet i arsyetuar.

7. Kundër vendimit të gjykatës për rrëzimin e kërkesës për ndihmën juridike dytësore mund të bëhet ankimi i veçantë. Ankimi i vendimit nuk pengon vazhdimin e shqyrtimit të çështjes. Ankimi bëhet sipas formularit tip të miratuar nga Ministri i Drejtësisë, i cili i jepet kërkuesit së bashku me vendimin për rrëzimin e kërkesës.

8. Gjykata e apelit shqyrton çështjen në dhomë këshillimi dhe merr vendim brenda 15 ditëve nga regjistrimi i çështjes. Kundër këtij vendimi nuk lejohet rekurs në Gjykatë të Lartë.

9. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas mund të ankimojë vendimin e gjykatës për pranimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore, nëse pretendon se kjo kërkesë është dukshëm abuzive ose haptazi e pabazuar. Në këtë rast zbatohen afatet dhe rregullat për ankimin e vendimeve përfundimtare, sipas dispozitave të legjislacionit procedural. Kundër vendimit të gjykatës së apelit nuk lejohet rekurs në Gjykatë të Lartë.

Kjo është një dispozitë me natyrë procedurale, e cila përcakton rregullat e shqyrtimit të kërkesës për ndihmë juridike dytësore nga gjykata dhe vendimarrjen përkatëse për këtë kërkesë.

Vendimi në lidhje me kërkesën për ndihmë juridike dytësore merret nga gjykata në këto tre raste dhe afate:

- brenda 5 ditëve kur kërkesa paraqitet përpara fillimit të procesit gjyqësor;

- gjatë veprimeve paraprake ose në seancën përgatitore para se të caktohet seanca gjyqësore, kur kërkesa për ndihmë juridike është paraqitur bashkë me kërkesë-padinë;

- sipas parashikimeve të legjislacionit procedural, pra në formën e një kërkesë të veçantë kur kërkesa paraqitet gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Në çështjen *Croissant v Germany*, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut ka vendosur se: “Duke marrë në konsideratë vendimet e fundit të Kryetarit të Gjykatës së Apelit të Shtutgartit dhe vendimin e gjyqësor të shkallës së parë, nuk ka dyshim se është ankimesi që duhet të paraqesë se ai nuk ka mundësitë paguajë pagesën e plotë, dhe atëherë legjisacioni përkatës dhe praktika duhet të zbatohen. Në këtë aspekt Gjykata konsideron se është e pranueshme sipas Konventës, se barra e provës për të provuar mungesën e mjeteve të mjaftueshme duhet të jetë tek personi që bën kërkesën.”

Nga ana tjetër, në çështjen *Pakelli v Gjermanisë*, Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut ka përcaktuar gjithashtu edhe rolin e gjykatës dhe thellësinë e shqyrtimit gjyqësor në rast se para saj paraqitet një kërkesë për ndihmë juridike dytësore. Sipas Gjykatës së Strasburgut “nuk është e nevojshme të provohet “përtej çdo dyshimi” se aplikanti është i varfër. Mjafton që të provohet “mungesa e mjeteve” në “mungesë të të dhënave të tjera që të vërtetojnë të kundërtën”.

Kundër vendimit të gjykatës për rrëzimin e kërkesës për ndihmën juridike dytësore mund të bëhet ankimi i veçantë dhe ankimi i vendimit nuk pengon vazhdimin e shqyrtimit të çështjes. Gjykata e Apelit shqyrton çështjen në dhomë këshillimi dhe merr vendim brenda 15 ditëve nga regjistrimi i çështjes. Ndaj këtij vendimi nuk lejohet të bëhet rekurs në Gjykatë të Lartë.

Në rast se Gjykata e Apelit rrëzon kërkesën për ndihmë juridike dytësore të paraqitur para saj, atëherë ndaj këtij vendimi nuk mund të bëhet ankimi i veçantë në Gjykatën e Lartë, por mund të bëhet rekurs, së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës së Apelit.

Sipas pikës 9 të këtij neni Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas mund të ankimojë vendimin e gjykatës për pranimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore, nëse pretendon se kërkesa e pranuar nga gjykata është dukshëm abuzive ose haptazi e pabazuar. Nga formulimi i kësaj dispozitë rezulton se Drejtoria mund të ankimojë vetëm vendimin e gjykatës së shkallës parë që ka miratuar kërkesën për ndihmën juridike dytësore, por jo vendimin e Gjykatës së Apelit apo të Gjykatës së Lartë kur para saj paraqiten kërkesa për ndihmë juridike dytësore. Nga ana tjetër, mbetet të shihet zbatimi i kësaj dispozite në praktikë sepse Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas në Ministrinë e Drejtësisë, nuk është palë në procesin gjyqësor që zhvillohet për miratimin ose jo të kërkesës së paraqitur. Ajo nuk është as në cilësinë e personit të tretë në këtë gjykim, ndaj në kuptim të legjisacionit procedural do të shihet në praktikë dhe në jurisprudencë se si do të zbatohet pika 9 e këtij neni.

Neni 23

Njoftimi i vendimit të gjykatës

Vendimi i gjykatës mbi kërkesën për ndihmë juridike dytësore i njoftohet menjëherë:

a) kërkuetit;

b) personit që ka dorëzuar kërkesën për ndihmë juridike dytësore, në rast se është një person i ndryshëm nga kërkueti;

c) organit procedues, nëse janë kushtet e nenit 21 të këtij ligji;

ç) Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas;

d) dhomës vendore të avokatisë, në rast se kërkesa për ndihmë juridike dytësore është miratuar.

Neni i mësipërm përcakton se kujt i njoftohet vendimi i gjykatës për miratimin ose refuzimin e kërkesës për dhënie të ndihmës juridike dytësore. Njoftimi i vendimit kryhet në përputhje me procedurën dhe me formën e përcaktuar në Kodin e Procedurës Civile.

Neni përcakton në fjalinë e parë të tij fjalën “menjëherë” dhe nuk përcakton nëse vendimi i gjykatës që njoftohet duhet të jetë i formë së prerë apo jo, pra është kaluar afati i ankimit ndaj tij dhe për të nuk është ushtruar ankimi, psh nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, apo Gjykata e Apelit, në rast ankimi, ka lënë në fuqi apo ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë. “Interesat” e të njoftuarve për vendimin e gjykatës në lidhje me kërkesën për ndihmën juridike në këtë aspekt janë të ndryshme. Psh Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas duhet të njoftohet menjëherë në mënyrë që të ketë mundësinë të ushtrojë ankimi sipas përcaktimit të bërë në nenin 22 të ligjit. Ndërkohë, dhoma vendore e avokatisë për interesin e zhvillimit të procedurës së saj e ka të domosdoshme të marrë vendimin në formë të prerë të gjykatës.

Në këtë këndvështrim me akt nënligjor të Ministrit të Drejtësisë është e nevojshme të përcaktohet ose njoftimi të bëhet dy herë, një herë pasi gjykata jep vendimin dhe herën e dytë kur vendimi i gjykatës merr formë të prerë, ose të bëhet një kategorizim i njoftuesve, dmth atyre të njoftuarve që i dërgohet vendimi i gjykatës menjëherë pas marrjes së tij dhe vendimi i gjykatës kur ky i fundit merr formë të prerë.

Nga ana tjetër, fakti që vendimi gjyqësor i dërgohet subjekteve të cituara në këtë nen nuk do të thotë që ata kanë një pozitë procedurale në procesin gjyqësor,

pra, ata duhet të jenë palë ose duhet ftohen të jenë palë në procesin gjyqësor. Palë në procesin gjyqësor është vetëm kërkuesi për përfitimin e ndihmës juridike dytësore, ndërsa të gjithë subjekteve të tjera vendimi gjyqësor i njoftohet.

Neni 24

Dhënia e ndihmës juridike dytësore nga avokatët

1. Avokatët që japin shërbimet e ndihmës juridike dytësore plotësojnë këto kushte:

a) kanë aplikuar në Dhomën Kombëtare të Avokatisë dhe janë përfshirë në listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore;

b) kanë lidhur një kontratë vjetore shërbimi me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas;

c) janë caktuar për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike dytësore nga organi procedues ose dhoma vendore e avokatisë;

ç) janë të specializuar në fusha të së drejtës, kur specializimi është i nevojshëm, si në rastin e përfaqësimit të të miturve, të viktimave dhe në raste të tjera të parashikuara me ligj.

2. Në rast të pranimit të kërkesës për ndihmë juridike dytësore veprohet sipas rregullave të mëposhtme:

a) dhoma vendore e avokatisë cakton një avokat nga lista e avokatëve që japin shërbimet e ndihmës juridike dytësore, sipas parimit të rotacionit;

b) dhoma vendore e avokatisë përcjell vendimin e gjykatës kompetente, së bashku me vendimin e saj mbi caktimin e avokatit, këtij të fundit dhe personit të cilit i është pranuar kërkesa për ndihmën juridike dytësore.

3. Parashikimet e pikës 2, të këtij neni, nuk zbatohen në rastin kur kërkesa për ndihmë juridike dytësore është paraqitur nga i pandehuri pa mjete të mjaftueshme financiare tek organi procedues që fillon hetimin.

4. Avokati i caktuar, menjëherë pasi njihet me vendimin e gjykatës kompetente dhe vendimin e dhomës vendore të avokatisë ose me vendimin e organit procedues mbi caktimin e tij si avokat për dhënien e ndihmës juridike dytësore, hyn në marrëdhënie me personin, të cilit i është pranuar kërkesa për ndihmë juridike dytësore dhe fillon dhënien e shërbimeve të kërkuara.

5. Avokati i caktuar zëvendësohet nga një avokat tjetër, nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës

juridike dytësore, vetëm në rast se konstatohet një konflikt interesi midis avokatit dhe personit, të cilit i është pranuar kërkesa për ndihmën juridike dytësore.

6. Vendimi për zëvendësimin e avokatit të caktuar nga një avokat tjetër nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore merret nga:

a) organi procedues, në rast se avokati që do të zëvendësohet është caktuar nga ky organ;

b) dhoma vendore e avokatisë, në rast se avokati që do të zëvendësohet është caktuar prej saj.

Ndihma juridike dytësore jepet vetëm nga avokatët dhe që përmbushin paraprakisht kërkesat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni. Ky nen përmban një parim të rëndësishëm të ofrimit të ndihmës juridike dytësore, parimin e rotacionit për ofrimin e ndihmës juridike dytësore, zbatimi i të cilit i është besuar si detyrë dhomës vendore të avokatisë.

Gjithsesi, zbatimi i parimit të shpërndarjes së barabartë të çështjeve mes avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore (parimi i rotacionit) nuk duhet të jetë qëllim në vetvete, sepse mekanizmi i ofrimit të ndihmes juridike dytësore duhet të udhëhiqet më shumë nga interesi më i lartë i përfituesit apo përfitueses të saj, sesa nga preokupimi i shpërndarjes së ngarkesës së barabartë së çështjeve mes avokatëve. Për pasojë, në këtë aspekt, dhoma vendore e avokatisë dhe Dhoma Kombëtare e Avokatisë kanë një rol thelbësor për të luajtur në zbatimin e kësaj dispozite e parë e lidhur ngushte me këtë parim. Këto dy instrumenta me aktet e tyre të brendshme mund dhe duhet të mudësojnë një balancë të drejtë mes parimit të shërbimit më të mirë dhe mbrojtjes së interesave të përfituesit/përfitueses të ndihmës dhe prokupimit për të mos lejuar përqëndrimin vetëm në disa avokatë të shërbimit të ndihmës juridike dytësore.

Sistemi i ndihmës juridike i vendosur me këtë ligj nuk parashikon të drejtën e personit që përfiton ndihmën juridike të zgjedhë avokatin e tij mbrojtës, kur ky i fundit zgjidhet nga mekanizmi i ndihmës juridike falas. Sistemi aktual i ndihmës juridike ndjek parimin e rotacionit të caktimit të mbrojtësve ligjorë. Është me shumë rëndësi që në kontratën përkëtasë të ofrimit të shërbimit dhe zbatimit të saj në praktikë, - kjo është e rëndësishme të ndiqet me detaje si nga dhoma e avokatisë ashtu edhe nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas - se baza ligjore në fuqi mundëson dhe garanton që ofruesit e ndihmës juridike dytësore (avokatët) të krijojnë dhe mbajnë në vazhdimësi një marrëdhënie besimi me klientët e tyre përfitues të ndihmës juridike dytësore. Kjo është

e vetmja mënyrë që të arrihet një nivel i arsyeshëm i cilësisë së mbrojtjes juridike. Standartet e cilësisë, dhe kontrata e lidhur me avokatit dhe Drejtorisë duhet të parashikojë një marrëdhënie besimi dhe konfidencialiteti avokat-klient, e shtrirë në kohë, dhe që duhet të fillojë të veprojë menjëherë pas emërimit si avokat për të mbrojtur një përfitues të caktuar të ndihmës juridike dytësore.

Pika 6 e këtij neni duhet të interpretohet në mënyrë sa më të zgjeruar, gjë e cila do të thotë që ofrimi i një mbrojtje cilësore, është pjesë e rëndësishme e detyrimeve kontraktuale të avokatit mbrojtës, ndaj personit që përfiton ndihmën juridike dytësore. Kur shkelet ky detyrim kontraktual atëherë pasoja e mënjëhershme duhet të jetë zgjidhja e saj dhe për pasojë edhe zëvendësimi, sa më parë që të jetë e mundur, i avokatit mbrojtës, sipas të njëjtës procedurë me atë që parashikohet në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 6 të këtij neni.

Nuk ka asnjë standard ndërkombëtar sesi duhet skicuar sistemi i pagesave për avokatët që ofrojnë ndihmën juridike dytësore. Një gjë e tillë iu është lënë vetë shteteve në diskrecionin e tyre të plotë ta përcaktojnë. Sidoqoftë, shtetet nuk kanë një hapësirë vlerësimi të pakufizuar vlerësimi për krijimin e sistemit të pagesave. Është e rëndësishme që tarifat dhe / ose rimbursimi i kostove që lidhen me sigurimin e ndihmës juridike dytësore të jenë të arsyeshme për të motivuar dhe mundësuar për avokatët për të siguruar mbrojtje të përshtatshme për klientët e ndihmës juridike, përfshirë edhe mbledhjen e provave.

Sistemi i pagesave për ndihmën juridike është dhe gjithnjë do të jetë objekt diskutimi. Burimet e një qeverie janë përherë të kufizuara për ta përballuar atë sa më mirë dhe njëkohësisht avokatët dhe OJQ-të kryesisht kërkojnë shpërblim më të mirë. Nuk është e thjeshtë të krijosh një sistem që mban ekuilibrin e personave më të paguar për të gjithë palët e interesuara dhe që gjithashtu garanton që numri i ofruesve të ndihmës juridike është i mjaftueshëm për nevojën e përfituesve të saj, që tarifat janë të arsyeshme dhe që kostot janë të përballueshme për qeverinë dhe taksapaguesit.

Në vitet e fundit një numër i madh i juridiksioneve janë zhvendosur në një skemë të tarifave fikse. Skema e tarifave fikse është zhvilluar kryesisht në bazë të një numri të madh të çështjeve të mbyllura - me një përfundim që siguron që pagesa do të bëhet në një numër mesatar të orëve të shpenzuara për një rast të konkret të klasifikuar (p.sh. hartimi i kërkesëpadisë, rastet e përfaqësimit në gjykatat e shkallës të parë, të apelit, çështje gjyqësore divorci, etj.) Qëllimi i kësaj lloji

skeme është që një ofrues i ndihmës juridike dytësore ndihmës juridike të marrë një pagesë të arsyeshme dhe që përballon një numër të arsyeshëm çështjesh. Skema e financimit me tarifa fiske të avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore stimulon këta të fundit të investojnë në shërbimin e ndihmës juridike, mund të zvogëlojë ngarkesat administrative për Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas siç është numri i kontrolleve të kërkuara, dhe gjithashtu mund të stimulojë specializimin e avokatëve. Në çdo rast duhet, sigurisht, një sistem kontrolli dhe ekuilibri, përfshirë një sistem të sigurimit të cilësisë së mbrojtjes.

KREU VI

PËRJASHTIMI NGA PAGIMI I TARIFAVE GJYQËSORE, SHPENZIMEVE GJYQËSORE DHE NGA DETYRIMI PËR PARAPAGIM TË TARIFAVE TË VËNIES NË EKZEKUTIM TË URDHRI TË EKZEKUTIMIT

Neni 25 Përfituesit

Personat, të cilët kanë të drejtën për të marrë ndihmë juridike dytësore, sipas neneve 11 ose 12, të këtij ligji, gëzojnë të drejtën për përjashtim nga:

a) pagimi i tarifave të përgjithshme dhe të veçanta, sipas përcaktimeve të ligjit për tarifat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë;

b) pagimi i shpenzimeve gjyqësore (shpenzimet për dëshmitarët, ekspertët, përkthyesit dhe për këqyrjen e sendeve ose këqyrjen në vend), sipas përcaktimeve të legjislacionit procedural;

c) detyrimi për të parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrit të ekzekutimit pranë shërbimit përmbartimor gjyqësor shtetëror.

Gjykata Kushtetuese në shqyrtimin e çështjes së përjashtimit nga pagimi i tarifave gjyqësore ka theksuar me vendimin nr. 7, datë 27.02.2013 se: “26. Çdo individ që i drejtohet me padi gjykatës, është i detyruar të parapagujë taksën mbi aktet (ose “tarifën për shërbime gjyqësore”, sipas udhëzimit nr. 13/2009, supra), e cila caktohet mbi bazën e vlerës së padisë. Megjithatë, Gjykata vlerëson se, në vështrim të neneve të sipërcituara të KPC-së, gjyqtari i zakonshëm nuk pengohet të hetojë dhe të përjashtojë paditësin nga pagesa e kësaj tarife, në rastet kur ndodhet përpara pamundësisë financiare të tij për të bërë këtë pagesë.

Gjyqtari i zakonshëm ka hapësirë për të vlerësuar plotësimin e këtij kriteri procedural për ngritjen e padisë dhe për të bërë përjashtimet rast pas rasti, në mënyrë që të mos pengojë realizimin e të drejtës së aksesit në gjykatë. Sipas dispozitave procedurale civile, në rastet e përjashtimit të individit nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore, ku përfshihet edhe taksa mbi aktet, këto shpenzime përballohen nga fondi përkatës i parashikuar në Buxhetin e Shtetit (neni 105/b). Nga ana tjetër, ligji nr. 10 039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”, ka përcaktuar një organ shtetëror kolegjal, Komisionin Shtetëror për Ndihmën Juridike, detyra kryesore e të cilit është t’u ofrojë ndihmë juridike kategorive të caktuara të individëve, duke kryer shpenzimet përkatëse (nenet 10 dhe 14 të ligjit).

27. Nëpërmjet interpretimit sistematik të dispozitave të mësipërme të KPC-së si dhe analogjisë me ligjin nr. 10 039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike” (përkatësisht nenet 2,10,13,14), arrihet qartësisht në përfundimin se qëllimi i këtij kuadri ligjor është të garantojë aksesin në gjykatë për të gjithë individët që i drejtohen gjykatës. Në funksion të këtij garantimi, si dhe të frymës që ligjvënësi ka dashur të përçojë në këtë kontekst ligjor, Gjykata thekson se i takon gjyqtarit të hetojë, mbi bazën e dokumentacionit provues të pamundësisë ekonomike të paraqitur nga paditësi, dhe të vlerësojë, duke iu referuar legjislacionit procedural civil dhe rregullimeve ligjore përkatëse, nëse është rasti për përjashtimin e paditësit nga pagesa e tarifës për shërbime gjyqësore.”

Në çështjen *Kreuz v Polonisë*, Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut ka theksuar se: “60. Prandaj, Gjykata vlerëson se kërkesa për pagimin e tarifave në gjykatat civile në lidhje me pretendimet për të cilat atyre u kërkohet të vendosin, nuk mund konsiderohet si kufizim i së drejtës së aksesit në gjykatë në vetvepte dhe që është i papajtueshëm me nenin 6 § 1 të Konventës. Ajo riheson megjithatë, se shuma e tarifave të vlerësuara në dritën e rrethanat e veçanta të një çështje të caktuar, përfshirë aftësinë e kërkuesit që t’i paguaj ato, dhe fazën e procedurave në të cilat ky kufizim i është imponuar, janë faktorë të cilët janë thelbësorë në përcaktimin nëse personi gëzonte të drejtën e aksesit dhe kishte një të drejtë “për t’u degjuar nga [një] gjykatë” (shiko *Tolstoy-Miloslavsky*, cituar më lart, dhe *Ait-Mouhoub*, cituar më lart, f. 80-81....).

Në një çështje tjetër domethënëse *Weisman* dhe të tjerët kundër Rumanisë, Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut ka theksuar se: “38. Në çështjen në fjalë, Gjykata vëren se mos pagimi i 323.264 eurove për shkak të detyrimit të pagesës së pullës për ngritjen e procedurës rezultoi në anulimin e veprimit.

39. Më tej Gjykata vëren se shuma në fjalë, e cila është

padyshim shumë e lartë për çdo paditës të zakonshëm, nuk është e justifikuar as nga rrethanat e veçanta të çështjes, as nga pozicioni financiar i aplikantëve dhe është llogaritur në bazë të një përqindje të caktuar, të përcaktuar nga ligji, të shumës në fjalë në procedurë. Edhe pse shuma e pretenduar nga aplikantët në lidhje me humbjen e fitimeve që rrjedhin nga të ardhurat nga qiraja e marrë nga Shteti është si e konsiderueshme, Gjykata konsideron, për shkak të vlerës së pasurisë, se nuk është e paarsyeshme ose me themel.

40. Në të kundërt, Gjykata vlerëson se shuma e pretenduar nga ankuesit për të paraqitur veprimin e tyre është e tepërt. Si rezultat, ata në mënyrë implicite ishin të detyruar të braktisin veprimin, duke i privuar ata nga e drejta që çështja e tyre të dëgjohej nga një gjykatë.

41. Për sa i përket opsionit që aplikantët të aplikojnë për përjashtim nga detyrimi i pagesës së pullës, Gjykata vëren se argumenti i qeverisë, bazuar në mosveprimin e pretenduar të aplikantëve, është i ngjashëm me një kundërshtim që ata nuk arritën të shterojnë mjetet e brendshme. Gjykata vëren se një kundërshtim i ngjashëm është hedhur poshtë në fazën e shqyrtimit të pranueshmërisë së kërkesës. Sidoqoftë, Gjykata vëren se Qeveria nuk ka paraqitur asnjë çështje gjyqësore nga gjykatat vendase që do të demonstronte efektivitetin e një kërkesë të tillë, në kuptimin e nenit 35 § 1 të Konventës.

42. Duke pasur parasysh rrethanat e çështjes, dhe veçanërisht për faktin se ky kufizim i imponuar në një fazë fillestare të procedurës, Gjykata konsideron se është joproporcionale dhe kështu dëmtoi vetë thelbin e së drejtës së aksesit në gjykatë (shiko, *mutatis mutandis*, *TeltronicCATV kundër Polonisë*, nr. 48140/99, 10 janar 2006).

43. Prandaj, Gjykata konkludon se Shteti nuk arriti të sigurojë një ekuilibër të drejtë, nga nga njëra anë, interesin e tij për të rikuperuar kostot e procedurave dhe, nga ana tjetër, interesin e aplikantëve për shqyrtimin e kërkesave të tyre nga gjykatat.

44. Rrjedhimisht, ka pasur një shkelje të nenit 6 1 të Konventës.”

Neni 26

Kërkesa për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore

1. Përjashtimi nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore jepet në bazë të një kërkesë që hartohet sipas formularit të kërkesës së miratuar nga Ministri i Drejtësisë.

2. Kërkesa për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore mund të paraqitet:

- a) së bashku me kërkesën për ndihmë juridike dytësore;
- b) bashkëlidhur kërkesëpadisë, në përputhje me parashikimet e legjislacionit procedural;
- c) në çdo fazë të procesit, derisa nuk është deklaruar i mbyllur hetimi gjyqësor.

3. Në kërkesën për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore mund të kërkohej përjashtimi nga pagimi i një, disa ose të gjitha tarifave gjyqësore dhe/ose i shpenzimeve gjyqësore, sipas përcaktimeve të nenit 25 të këtij ligji.

4. Kërkesa për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore mund të paraqitet nga personi, i cili gëzon të drejtën për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore, nga një përfaqësues ligjor apo i pajisur me prokurë, ose nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja ose i afërm i shkallës së parë.

5. Kërkesa për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore mund të paraqitet personalisht ose nëpërmjet shërbimit postar.

Neni 26 qartëson anën teknike dhe praktike të zbatimit të nenit 25 të këtij ligji. Përjashtimi nga pagimi i tarifave gjyqësore bazohet në një kërkesë, e cila është në formën e formularit dhe që është miratuar nga Ministri i Drejtësisë. Kërkesa për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore (i të gjithave ose disa prej tyre) mund të bëhet së bashku me kërkesën për përfitimin e ndihmës juridike dytësore, dhe sipas praktikës së Gjykatës së Tiranës, mund të paraqitet paraprakisht edhe para paraqitjes së kërkesëpadisë ose deklaratës së mbrojtjes në gjykatë, ose edhe para gjyqtarit që shqytron çështjen gjyqësore në të cilën është palë ndërgjyqëse (i paditur ose paditës) përfituesi i ndihmës juridike dytësore.

Në vendimin e gjykatës për përjashtimin nga pagesa e tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore ajo duhet të shprehet edhe për tarifën e paraqitjes së ankimit në një gjykatë të nivelit më të lartë, nëse ky është rasti. Në rast se personi përfitues i ndihmës juridike dytësore paraqet në Gjykatën e Apelit kërkesën për riceljen e hetimit gjyqësor psh duke kërkuar edhe ribërje të ekspertimit, atëherë kërkesa për përjashtim nga pagesa e këtij shpenzimi gjyqësor duhet të paraqitet para trupës gjyqësore të Gjykatës së Apelit, e cila merr vendim në lidhje me të.

Neni 27

Procedura e shqyrtimit të kërkesës

1. Kërkesa për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore paraqitet në gjykatën kompetente për shqyrtimin e çështjes në themel.

2. Gjykata shqyrton kërkesën në përputhje me parashikimet në legjislacionin procedural dhe, për aq sa është e mundur, me parashikimet e nenit 22 të këtij ligji.

3. Gjykata, në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe parashikimet në legjislacionin procedural, pas shqyrtimit të kërkesës vendos:

a) pranimin e kërkesës për përjashtimin nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore;

b) rrëzimin e kërkesës për përjashtimin nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore.

4. Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim në gjykatën e apelit, sipas parashikimeve të nenit 22 të këtij ligji.

5. Vendimi i pranimit të kërkesës për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore i njoftohet menjëherë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.

Kjo dispozitë ka natyrë procedurale duke përcaktuar disa norma bazë të veprimtarisë së gjykatës në shqyrtimin e kërkesës për përjashtimin nga pagimi i tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore. Paragrafi i parë i këtij neni përcakton se gjykata kompetente që shqyrton themelin e çështjes gjyqësore është ajo që duhet të marrë vendimin edhe për përjashtimin. Çështja e gjyktës kompetente dhe përcaktimi i saj në situatat juridike të ndryshme, sic përshkruhet në komentin e nenit 22 të këtij ligji, është njëlloj i vlefshëm edhe për formulimin e pikës së parë të nenit 27.

Ky nen, në pikën 3 të tij, përcakton se gjykata ka vetëm dy opsione në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të kërkesës: atë të pranimit për përjashtimin nga pagimi i një ose të gjithë tarifave dhe/ose shpenzimeve gjyqësore ose rrëzimin e kërkesës. Gjykata nuk ka opsion e tretë, sikundër parashikohet në legjislacionin procedural, atë të pranimit të pjesshëm të kërkesës për përjashtim nga pagimi i taksave dhe/ose shpenzimeve gjyqësore. Duke qënë se ligji “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” është lex specialis atëherë, pavarësisht se ekziston edhe një opsion tjetër për gjykatën sipas Kodit të Procedurës Civile, një gjë e tillë është e pamundur sepse formulimi i pikës 3 të këtij neni nuk e lejon pranimin e pjesshëm të kërkesës.

Pika 4 e këtij neni përcakton se vendimi i pranimit nga ana e gjykatës të kërkesës për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore, i njoftohet Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas. Në rast se vendimi i rrëzimit të kërkesës nga gjykata e shkallës së parë ankimohet dhe Gjykata e Apelit vendos prishjen e vendimit të shkallës së parë dhe pranimin e kërkesës, atëherë ky vendim i gjykatës së apelit duhet t'i njoftohet menjëherë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.

Ligji nuk parashikon të drejtën e ankimit të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas ndaj vendimit të miratimit të kërkesës, edhe në qoftë se evidentohet qartazi se vendimi është dhënë në shkelje flagrante të ligjit ose kërkesa është haptazi e pabazuar apo kur kërkuuesi nuk përmbush kriteret ligjore për ta përfituar përjashtimin nga pagimi i tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore.

Neni 28 **Zbatimi i vendimit**

1. Vendimi gjyqësor për përjashtimin nga pagimi i tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në përputhje me parashikimet e legjislacionit procedural.

2. Pagesa e shpenzimeve gjyqësore, për të cilat është vendosur përjashtimi, përballohet nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Drejtësisë dhe paguhet nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas.

3. Pagesat që kryhen nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, sipas pikës 2, të këtij neni, nuk mund të tejkalojnë masën e shpërblimit për ekspertët dhe dëshmitarët në një proces gjyqësor, të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave.

4. Rregullat dhe procedurat e kryerjes së pagesave, sipas pikës 2, të këtij neni, përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Drejtësisë, pas marrjes së mendimit nga ministria përgjegjëse për financat.

Vendimi gjyqësor për përjashtimin nga pagimi i tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore nëpërmjet këtij neni konsiderohet si titull ekzekutiv. Në kuptimin juridik, titulli ekzekutiv është akti përfundimtar që përmban njohjen e detyrimit të plotë, të saktë, të përcaktuar të një personi apo subjekti kundrejt një tjetri sipas parashikimeve të ligjit. Në këtë rast detyrimi i plotë dhe i saktë është përcaktuar me vendim gjykate dhe ‘debitor’ është organi shtetëror, Ministria e Drejtësisë dhe më konkretisht njësia përbërëse e saj Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas.

Ekzekutimi i vendimit të Gjykatës përse kohë është titull ekzekutiv bëhet në përputhje me Pjesën e Kartërt të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast për ekzekutimin e vendimit të gjykatës, e cfarëdo lloji juridiksioni qoftë ajo, nuk është e nevojshme nxjerrja e urdherit të ekzekutimit. Mjafton për qëllim të ekzekutimit të vendimit shprehja standarte se në rast se nuk përmbushet vullnetarit detyrimi nga ana e institucioneve shtetërore, atëherë ngarkohet përmbaruesi me ekzekutimin e vendimit gjyqësor.

Rregullat dhe procedurat e kryerjes së pagesave të shpenzimeve gjyqësore për të cilat është vendosur përjashtimi në rastin e dhënies së ndihmës juridike janë të përcaktuara nga Udhëzimi nr. 6, datë 20.08.2019 i Ministrit të Drejtësisë. Sias përcaktimit të këtij Udhëzimi brenda 15 ditësh nga data e shpalljes së vendimit nga gjykata për përjashtimin nga pagesat e shpenzimeve gjyqësore, dëshmitari, eksperti dhe përkthyesi paraqesin prapa Drejtorisë së ndihmës juridike dokumente tatimore për shërbimet e ofruar dhe sipas rastit.

Dokumentacioni vërtetues si vijon:

- dokumentin tatimor për shpenzimet e transportit;
- dokumentin tatimor për shpenzimet e fjetjes;
- dokumentin me karakter vërtetues të vendit të punës dhe vlerës së pagës;
- vërtetimin bankar nga një bankë e nivelit të dytë për deklarimin e numrit të llogarisë në lekë.

Në praktikë do të ishte më e plotë që Udhëzimi i sipërcituar të parashikonte edhe procedurën sesi dëshmitari, eksperti apo përkthyesi do të paraqisnin dokumentacionin pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike. Psh Udhëzimi mund të plotësohej me mënyrën e komunikimit të një eksperti që kryen një akt ekspertize në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe për të cilën është marrë vendim nga gjykata se pala përjashtohet nga pagimi i këtij akti ekspertize.

Neni 29 **E drejta për të mos parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrin të ekzekutimit**

Personat, të cilët kanë përfituar ndihmë juridike dytësore, sipas parashikimeve të këtij ligji, gëzojnë të drejtën për të mos parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrin të ekzekutimit pranë shërbimit përmbarimor gjyqësor shtetëror.

E drejta për proces të rregullt gjyqësor përfshin edhe ekzekutimin e vendimit të gjykatës. Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut në çështjen Cufaj v Shqipërisë ka theksuar se: “38. Gjykata pohon se neni 6 § 1

i siguron çdokujt të drejtën për t'u ankuar në gjykatë në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij civile; pra në këtë mënyrë mishëron “të drejtën për proces të rregullt”, - ku e drejta për akses- që është e drejta për të filluar një proces gjyqësor për çështje civile- është njëri prej aspekteve të saj. Megjithatë, kjo e drejtë do të ishte iluzionare, nëse një sistem ligjor i brendshëm i një shteti anëtar, do të lejonte që një vendim gjyqësor i formës së prerë, të mbetej joveprues në dëm të një pale. Do të ishte e pakonceptueshme që neni 6 § 1 të përshkruajë në detaje garancitë procedurale të njohura palëve në procesin gjyqësor- procedime që duhet të jenë të ndershme, publike dhe të shpejta- pa mbrojtur ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Interpretimi i nenit 6, si një nen që ka të bëjë ekskluzivisht me të drejtën e aksesit në gjykatë dhe me zhvillimin e procedurave, do të çonte në situata të papajtueshme me parimin e shtetit të së drejtës, të cilin shtetet anëtare u angazhuan për ta respektuar, kur ratifikuan Konventën. Ekzekutimi i një vendimi të dhënë nga një gjykatë duhet të konsiderohet si pjesë përbërëse e “procesit të rregullt” sipas qëllimit të nenit 6. Autoritetet shtetërore nuk mund të përmendin mungesën e fondeve si justifikim për të mos respektuar një detyrim financiar që vjen nga një vendim gjyqësor.”

Për këtë arsye duke qenë se shërbimi përmbarimor gjyqësor ka të përcaktura tarifa fikese apo me përqindje mbi vlerën e detyrimit që duhet të paguhen paraprakisht nga gjyqafituesi, neni 29 përcakton se ky i fundit për shkak se ka përfituar ndihmë juridike dytësore përjashtohet nga parapagimi i këtyre tarifave. Përjashtimi nga pagimi i traifës të shërbimit përmbarimor në këtë rast duhet të dokumentohet nga ana e përmbaruesit gjyqësor, sipas procedurave të zakonshme të veprimtarisë së tij.

KREU VII

RIMBURSIMI

Neni 30

Detyrimet e palës gjyqëmbësore në çështjet civile ose administrative

1. Kur pala që është përjashtuar nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore, sipas parashikimeve të këtij ligji, fiton me vendim gjyqësor të formës së prerë çështjen, për të cilën është dhënë ndihma juridike dytësore dhe/ose përjashtimi nga tarifat gjyqësore dhe shpenzimet gjyqësore, pala tjetër gjyqëmbësore, së cilës i ngarkohen pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore, sipas vendimit gjyqësor, detyrohet të kalojë këtë shumë menjëherë për llogari të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas.

2. Në rast se vendimi nuk ekzekutohet vullnetarisht, me kërkesë të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, shërbimi përmbarimor gjyqësor fillon procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm, sipas legjislacionit në fuqi.

Kreu VII i dedikohet çështjes së rimbursimit të tarifave, shpenzimeve gjyqësore dhe të përfaqësimit që janë bërë në favor të përfituesit të ndihmës juridike dytësore. Ndhma juridike dytësore në një mënyrë mund të konsiderohet si “huadhënie” nga ana e shtetit për individët që kanë nevojë ta përfitojnë atë dhe që përmbushin kriteret e përcaktuara në ligj. Në rast se përfituesi i ndihmës juridike del gjyqfites në përfundim të procesit gjyqësor atëherë çdo shpenzim i buxhetit të shtetit i harxhuar për të duhet të rikthehet në buxhetin e shtetit sepse atë e paguan pala gjyqëmbësore.

Përcaktimet e bëra në këtë nen janë të rëndësishme për gjyqtarët. Kjo për shkak se në një pjesë të veçantë të vendimit gjyqësor gjyqtarit i duhet të shprehet qartë se në rast se përfituesi i ndihmës juridike është gjyqfites, duhet të përcaktojë konkretisht cilat shpenzimet apo tarifat gjyqësore dhe shuma e ndihmës të përfaqësimit në gjyq, të cilat duhet t'i ngarkohen për t'u paguar prej palës gjyqëmbësore.

Po ashtu është me rëndësi të theksohet se në vendimin e gjykatës duhet të urdhërohet si një paragraf i vecantë edhe kalimi i këtyre të hollave të llogaritura të paguhen prej gjyqëmbësorit tek llogaria e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas. Është e kuptueshme që ky vendim gjyqësor, pavarësisht se ka marrë formë të prerë ose jo, duhet t'i njoftohet Drejtorisë së Ndhmës Juridike. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas në Ministrinë e Drejtësisë e ka të nevojshme njoftimin për shkak të zbatimit të paragrafit të dytë të këtij neni, me qëllim që të bëjë të ekzekutueshëm vendimin gjyqësor nëpërmjet shërbimit përmbarimor.

Në këtë rast Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas është e përjashtuar nga pagimi i tarifave përkatëse për shërbimin përmbarimor gjyqësor.

Neni 31

Rastet e kthimit të përfitimeve

1. Në rast se një person, të cilit i është pranuar kërkesa për ndihmë juridike dytësore dhe/ose përjashtimin nga tarifat gjyqësore dhe shpenzimet gjyqësore, i kanë ndryshuar rrethanat në një mënyrë të tillë që nuk plotëson kriteret ligjore për të qenë subjekt përfitues i ndihmës juridike dytësore, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas i njofton përfituesit të ndihmës juridike detyrimin për kthimin vullnetar të shpenzimeve të kryera, shumën konkrete dhe afatin për përmbushjen e këtij detyrimi.

Procedura, periodiciteti dhe rregullat e verifikimit të ndryshimit të rrethanave përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Drejtësisë.

2. Në rast të mosekzekutimit vullnetar të detyrimit për kthimin e shpenzimeve brenda afatit të caktuar, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas paraqet kërkesëpadi në gjykatë, duke kërkuar kthimin e shumës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Parashikimet e pikave 1 dhe 2, të këtij neni, do të zbatohen dhe në rastin kur personi, të cilit i është pranuar kërkesa për ndihmë juridike dytësore dhe/ose përjashtimi nga tarifat gjyqësore dhe shpenzimet gjyqësore ose avokati i caktuar:

a) nuk e ka paraqitur kërkesëpadinë në gjykatë, pas kalimit të një afati tremujor nga data kur vendimi i gjykatës për pranimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore ka marrë formë të prerë;

b) ka hequr dorë nga gjykimi i padisë, nga e drejta e padisë, nga ankimi dhe rekursi apo nga ekzekutimi i urdhrat të ekzekutimit.

Neni 31 i ligjit parashikon kthimin e përfitimeve të personit të cilit i është pranuar kërkesa për ndihmë juridike dytësore dhe/ose përjashtimin nga tarifat gjyqësore dhe shpenzimet gjyqësore, në dy raste:

a) përfituesit i kanë ndryshuar rrethanat ekonomike dhe për pasojë nuk plotëson më kërkesat për të qënë përfitues i ndihmës juridike dytësore;

b) pavarësisht se ka bërë kërkesën dhe ka përfituar ndihmën juridike dytësore, para paraqitjes së kërkesëpadisë, nuk e ka bërë një gjë të tillë brenda 3 muajve kur vendimi përkatës i gjykatës ka marrë formë të prerë, ose në fazën e gjykimit ka hequr dorë nga gjykimi i padisë, ankimi, rekursi ose ekzekutimi i vendimit të gjykatës.

Pavarësisht se ky nen paraqet vetëm përfituesin e ndihmës juridike në rolin e tij si paditës, të njëjtat rrethana dhe kushte janë të zbatueshme edhe në rastin kur përfituesi i ndihmës juridike është i paditur në një proces gjyqësor.

Ky nen parashikon nxjerrjen e një akti nënligjor të rëndësishëm dhe më konkretisht aktin që do të përcaktojë procedurat, periodicitetin dhe rregullat e verifikimit të ndryshimit të rrethanave. Akti nënligjor i sipërcituar miratohet nga Ministri i Drejtësisë dhe i jep “jetë” zbatimit në praktikë të këtij neni.

Zbatimi përcaktimeve të bëra në këtë nen përbëjnë një sfidë të vërtetë për Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas. Për të zbatuar drejt dhe në mënyrë të shpejtë kërkesat e përcaktuara në këtë nen, kjo Drejtoria e ka të domosdoshme pasjen në kohë të informacionit real për çdo përfitues të ndihmës juridike dytësore. Suksesi i zbatimit të kësaj dispozite do të varet plotësisht nga marrja e këtij informacioni dhe për pasojë edhe vendimarrja përkatëse në bazë të tij. Një rol të rëndësishëm në këtë aspekt të paktën për veprimtarinë gjyqësore vlerësojmë se duhet të luajnë kancelarët e gjykatave të rretheve gjyqësore dhe të apelit, të cilët, sipas hierarkisë juridike dhe marrdhënieve me Ministrinë e Drejtësisë duhet të informojnë këtë Drejtori me Informacionin e poseduar nga gjykatat. Nga ana tjetër, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas është e nevojshme të ketë edhe akses në një sërë regjistrash publikë (psh kadastër, mjetet e transportit, etj.) në mënyrë që të ketë mundësi të verifikojë gjendjen financiare dhe ekonomike të përfituesve të ndihmës juridike dhe mosndryshimit të saj gjatë shqyrtimit të çështjes së tyre në gjykatë.

Neni 32

Rimbursimi në rastin e dhënies së informacioneve të rreme ose të pavërteta

1. Kërkuesi që ka përfituar ndihmë juridike dytësore dhe/ose përjashtim nga tarifat gjyqësore dhe shpenzimet gjyqësore, duke paraqitur të dhëna të pavërteta ose të pasakta, është i detyruar të rimbursojë shpenzimet për avokatin që ka dhënë shërbimet e ndihmës juridike dytësore dhe/ose shpenzimet gjyqësore. Pavarësisht nga rimbursimi i këtyre shpenzimeve, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas bën kallëzim penal, kur konstaton se ka elemente të veprës penale.

2. Në rast se kërkesa për ndihmë juridike dytësore dhe/ose përjashtim nga tarifat gjyqësore dhe shpenzimet gjyqësore, që përmban informacione të rreme ose të pavërteta, është dorëzuar nga një person tjetër i ndryshëm nga personi të cilit i është pranuar kërkesa për ndihmë juridike dytësore dhe/ose përjashtimi nga tarifat gjyqësore dhe shpenzimet gjyqësore, dorëzuesi dhe përfituesi janë solidarisht përgjegjës për rimbursimin e shpenzimeve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

3 Rimbursimi i shpenzimeve, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij neni, bëhet sipas kërkesës së Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas. Në rast të mosekzekutimit vullnetar, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas paraqet kërkesëpadi në gjykatë, duke kërkuar kthimin e shumës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

I gjithë informacioni që paraqet dhe depoziton personi që përfiton ndihmën juridike dytësore dhe/ose përjashtimin nga tarifat apo shpenzimet gjyqësore nëpërmjet formularëve të aplikimit për çdo rast, duhet të jetë i vertetë dhe i sakte. Dhenia e nje informacioni, deklarimi te pasakte apo te pavertete apo dhenia e dokumentave false përbën shkak të ligjshëm që personi, sipas përcaktimeve të bëra në këtë nen, të detyrohet dhe të realizojë rimbursimin e të gjithë fondeve të përfituara në kuptim të këtij ligji, dhe nga ana tjetër, të mbajë edhe përgjegjësi penale për shkak se formularët dhe deklaratimet që nënshkruan janë akte zyrtare dhe përfituesi është paralajmëruar me shkrim paraprakisht për detyrimin e vërtetësisë së informacionit që jep.

Në ato raste kur aplikimi për ndihmën juridike është bërë jo nga vetë personi që e përfiton atë, por nga subjekte që parashikohen nga neni 19 i këtij ligji, atëherë edhe këta persona janë përgjegjës solidarë për rimbursimin e ndihmës së përfituar padrejtësisht. Drejtoria Juridike e Ndihmës Juridike Falas, në emër të shtetit, është në statusin e kreditorit që kërkon pagimin e borxhit nga çdo debitor. Detyrimi në këtë rast për rimbursimin është i përcaktueshëm sipas përcaktimit në ligj. Përgjegjësia solidarë nënkupton të drejtën e kreditorit {Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas} të kërkojë përmbushjen e detyrimit në tërësi, pavarësisht nga shkalla e pjesëmarrjes në shkaktimin e dëmit, nga cilido nga debitorët (personi që ka përfituar padrejtësisht ndihmën juridike, dhe nëse është rasti, edhe personi që e kanë kërkuar atë për llogari të tij).

KREU VIII

DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 33

Buxheti

1. Shpenzimet për ndihmën juridike të garantuar nga shteti, në të gjitha format e saj, mbulohen nga buxheti i shtetit dhe nga burime të tjera të ligjshme.

2. Fondet për ndihmën juridike të garantuar nga shteti përbëjnë zë të veçantë në buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë.

Të gjithë shpenzimet për ndihmën juridike, në formën e ndihmës juridike parësore, ndihmë juridike dytësore, përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore, dhe përjashtim nga detyrimi për të parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrat të ekzekutimit përballohen nga buxheti i shtetit,

përsa kohë sipas përcaktimeve të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konvetës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ndihma juridike ndaj kategorive përfituese të saj, sipas kriterëve të këtij ligji, është detyrim pozitiv i shtetit. Fondet janë pjesë e buxhetit të shtetit për çdo vit, por njëkohësisht në funksion të saj mund të vendosen fonde të tjera të ligjshme që përfitohen, sikunder mund të jenë donacionet, marrëveshjet e bashkëpunimit mes përfaqësuesve të shtetit (në rastin konkret Ministrisë së Drejtësisë) dhe organizatave apo financimeve ndërkombetare.

Ndërsa përgjegjësia për ofrimin e ndihmës juridike, në të gjitha format e saj, është përgjegjësi e shtetit dhe mungesa e burimeve të mjaftueshme financiare nuk përbën justifikim për mosofrimin e saj apo ofrimin me cilësi të dobët, shoqëria civile ka një rol kresor gjithashtu në ofrimin e këtij shërbimi. Në shumë raste praktikata e bashkëpunimit mes institucioneve shtetërore dhe organizatave të shoqërisë civile në fushën e ndihmës juridike kanë qënë të suksesshme për të përballuar kërkesën e popullsisë për ndihmë juridike dhe njëkohësisht kursim dhe efikasitet të fondeve buxhetore të dedikuara për këtë qëllim.

Neni 34

Akte nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të nenit 15, pikat 1 dhe 3, dhe nenit 28, pika 3, të këtij ligji.

2. Ngarkohet Ministri i Drejtësisë që, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të nenit 7, shkronjat “d”, “e”, “ë”, “f”, “gj” dhe “i”; nenit 17, pika 2; nenit 19, pika 4; nenit 28, pika 4, dhe nenit 31, pika 1, të këtij ligji.

3. Ngarkohet Ministri i Drejtësisë dhe Kryetari i Dhomës Kombëtare të Avokatisë që, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojnë aktin nënligjor në zbatim të nenit 9, shkronja “b”, të këtij ligji.

4. Ngarkohet titullari i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe Kryetari i Dhomës Kombëtare të Avokatisë që, brenda një muaji nga krijimi i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, të miratojnë aktin nënligjor në zbatim të nenit 9, shkronja “a”, të këtij ligji.

5. Ngarkohet Ministri i Drejtësisë dhe ministri përgjegjës për financat që, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojnë aktin nënligjor në zbatim të nenit 7, shkronja “g”, të këtij ligji.

6. Ngarkohet Këshilli i Lartë i Prokurorisë që, brenda 3 muajve nga krijimi, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të nenit 21, pikat 6 dhe 7, të këtij ligji.

7. Aktet nënligjore të miratuara në zbatim të këtij ligji publikohen edhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas dhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë, si dhe me anë të mjeteve të tjera të përshtatshme.

Neni 35 Publikime

Formularët e paraqitjes së kërkesave dhe vetëdeklarimit, të parashikuara nga neni 7, shkronja “d”, i këtij ligji, publikohen në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas.

Ky nen përforcon parimin e publicitetit dhe transparencës së miratimit të akteve nënligjore, sepse formularët dhe vetëdeklarimet janë të tilla. Gjithsesi, në kohën e hartimit të këtij komentari nuk ka faqe interneti të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas dhe ketë formularë apo aktet e tjera nënligjore nuk shfaqen në ëbsite-in e Dhomës Kombëtare të Avokatisë. Ato shfaqen vetëm në ëbsite-in zyrtar të Minsitrisë së Drejtësisë. Është e rëndësishme gjithashtu që në këto ëbsite, të gjitha aktet nënligjore të jenë të shfaqura në mënyrën friendly use dhe të aksesueshme dhe kuptueshme lehtësisht nga çdo përdorues, përfshirë edhe ata që janë përfutues të ndihmës juridike.

Neni 36 Dispozitë kalimtare

1. Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike pushon së ekzistuari me ngritjen e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas.

2. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ngrihet brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

3. Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore ngrihen brenda tre muajve nga krijimi i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas.

4. Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike përfundon shqyrtimin e të gjithë kërkesave të paraqitura për ndihmë juridike brenda datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, sipas parashikimeve të ligjit nr. 10039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”.

5. Kërkesat për ndihmë juridike dytësore, që janë paraqitur përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që nuk janë shqyrtuar nga Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, trajtohen sipas rregullave të parashikuara nga ky ligj.

6. Për nëpunësit civilë ekzistues të sekretariatit të Komisionit Shtetëror për Ndhmën Juridike zbatohen dispozitat e legjisllacionit në fuqi për nëpunësin civil në rastin e mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit.

7. Punonjësit administrativë të Komisionit Shtetëror për Ndhmën Juridike trajtohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.

8. Të gjitha të drejtat, detyrimet, qendrat ekzistuese të shërbimit të ndihmës juridike, buxheti, si dhe dokumentacioni administrativ dhe financiar i Komisionit Shtetëror për Ndhmën Juridike, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, i kalojnë dhe administrohen nga aparati i Ministrisë së Drejtësisë.

9. Deri në krijimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë detyrat e parashikuara nga ky ligj për këtë organ kryhen nga Ministri i Drejtësisë.

10. Aktet nënligjore, të nxjerra në zbatim të ligjit nr. 10039, datë 22.12.2008, “Për ndihmën juridike”, të ndryshuar, mbeten në fuqi deri në miratimin e akteve të reja nënligjore, në zbatim të këtij ligji, për sa kohë nuk bien në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji.

Dispozitat kalimtare përcaktojnë procedurën për kalimin nga regjimi i mëparshëm ligjor në regjimin e ri. Kjo është një dispozitë e cila në përbajtjen e saj ka një sërë komponentësh që kanë nevojë.

Të parashikohen si të tilla në një ligj. Në përbajtjen e saj rregullohen çështje funksionale dhe administrative si psh të gjitha të drejtat, detyrimet, qendrat ekzistuese të shërbimit të ndihmës juridike, buxheti, si dhe dokumentacioni administrativ dhe financiar i Komisionit Shtetëror për Ndhmën Juridike, i kalojnë dhe administrohen nga aparati i Ministrisë së Drejtësisë; çështje të rregullimeve ligjore për burimet njerëzore si psh punonjësit administrativë të Komisionit Shtetëror për Ndhmën Juridike trajtohen sipas dispozitave të Kodit të Punës, ndërsa për nëpunësit civilë ekzistues të sekretariatit të Komisionit Shtetëror për Ndhmën Juridike zbatohen dispozitat e legjisllacionit në fuqi për nëpunësin civil në rastin e mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit.

Dispozita përmban edhe përcaktime ligjore të një natyre të pastër juridike, tipike për një formulim të tillë në ligj si psh deri në krijimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë detyrat e parashikuara nga ky ligj për këtë organ kryhen nga Ministri i Drejtësisë, apo aktet nënligjore, të nxjerra në zbatim të ligjit nr. 10039, datë 22.12.2008, “Për ndihmën juridike”, të ndryshuar, mbeten në fuqi deri në miratimin e akteve të reja nënligjore, në zbatim të këtij ligji, për sa kohë nuk bien në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji.

Në kohën e hartimit të këtij Komentari kjo dispozitë e ka kryer funksionin e saj kalimtar për shkak se regjimi i ri juridik me ligjin “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” ka hyrë në fuqi, janë ngritur strukturat e reja administrative dhe janë miratuar aktet nënligjore në zbatim të tij.

Neni 37 Shfuqizime

Ligji nr. 10039, datë 22.12.2008, “Për ndihmën juridike”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 38 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi më 1 qershor 2018.

**KRYETAR
Gramoz Ruçi**

TARIFAT GJYQËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Ligji nr. 98/2017 “Për tarifat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë” përcakton tarifat gjyqësore në gjykimin e çështjeve civile, administrative dhe në gjykimin në Gjykatën Kushtetuese.

Ligji përcakton tre lloje të tarifave gjyqësore:

a) tarifa gjyqësore të përgjithshme për paraqitjen e çështjeve në gjykata:

Tarifa gjyqësore e përgjithshme përlogaritët mbi bazën e vlerës së padisë për çështje gjyqësore civile dhe administrative. Masa e tarifave gjyqësore të përgjithshme, është jo më e ulët se 1 000 (një mijë) lekë dhe jo më e lartë se 20 000 000 (njëzet milionë) lekë.

Masa e tarifave gjyqësore të përgjithshme për gjykimet në gjykatat e apelit dhe Gjykatën e Lartë është jo më e ulët se 2 000 (dy mijë) lekë dhe jo më e lartë se 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

Tarifa gjyqësore e përgjithshme për paraqitjen e kërkesave në Gjykatën Kushtetuese është 5 000 (pesë mijë) lekë, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 9 të ligjit.

Përcaktimi i vlerës së padisë bëhet nga personi, i cili ka ngritur padinë përpara gjykatës. Në rast se përlogaritja e vlerës së padisë mungon ose nuk është llogaritur në mënyrë të saktë, veprohet në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.

Tarifa gjyqësore e përgjithshme paguhet në momentin e paraqitjes së padisë, të ankimit, të ankimit të veçantë ose të rekursit në gjykatë, përveçse kur ligji parashikon ndryshe. Nëse tarifa gjyqësore e përgjithshme nuk është paguar në momentin e paraqitjes gjykata vepron në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.

Tarifa gjyqësore e përgjithshme paguhet gjatë gjykimit ose përpara dhënies së vendimit përfundimtar vetëm kur: në rastet e mëposhtme:

- çështja gjyqësore ka për objekt dhënien e pensionit ushqimor;
- për paditë për marrëdhëniet e punës në vlerë deri në 700 000 (shtatëqind mijë) lekë.

Llojet dhe masat përkatëse të tarifave gjyqësore të përgjithshme për çdo shkallë gjykimi, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për

drejtësinë dhe ministrit përgjegjës për financat, me propozimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, mbi bazën e natyrës së çështjes, parimeve të proporcionalitetit dhe progresivitetit.

b) tarifa gjyqësore të veçanta, për kryerjen e veprimeve procedurale në gjykata dhe shërbimet e administratës gjyqësore;

Tarifa gjyqësore e veçantë caktohet për shqyrtimin e kërkesave të veçanta procedurale gjatë zhvillimit të gjykimit në të gjitha shkallët e gjykimit dhe në të gjitha juridiksionet gjyqësore, si dhe për shërbime të administratës gjyqësore. Tarifa gjyqësore e veçantë paguhet në kohën e paraqitjes së kërkesës në gjykatë.

Tarifat gjyqësore të veçanta janë jo më e ulëta se 50 (pesëdhjetë) lekë dhe jo më të larta se 2 500 (dy mijë e pesëqind) lekë.

Masa për llojet e tarifave gjyqësore të veçanta përcaktohet me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për drejtësinë dhe ministrit përgjegjës për financat, me propozimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas parimeve të proporcionalitetit dhe progresivitetit.

c) tarifa gjyqësore shtesë, në funksion të administrimit korrekt të procesit gjyqësor.

Tarifa gjyqësore shtesë caktohet në rastet kur pala ndërgjyqëse ose përfaqësuesi i saj ka shkaktuar pa shkaqe të arsyeshme vonesa në gjykim e çështjes. Tarifa gjyqësore shtesë paguhet brenda 21 ditëve kalendarike nga data e njoftimit të vendimit të gjykatës. Tarifa gjyqësore shtesë është tarifë fikse dhe përcaktohet me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për drejtësinë dhe ministrit përgjegjës për financat, me propozimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, në proporcion me tarifat gjyqësore të përgjithshme, sipas nenit 5 të këtij ligji.

Palët ndërgjyqëse përjashtohen nga detyrimi për të paguar tarifë gjyqësore ose shpenzimet e tjera gjyqësore kur është bërë kërkesë prej tyre, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për ndihmën juridike.

Sigurisht, që tarifat gjyqësore ndihmojnë në administrimin eficient të sistemit të drejtësisë (psh nëpërmjet tyre mund të parandalohet mbingarkesa e gjykatës me kërkesa/padi abuzive ose të reduktohen në një masë të madhe kostot e shërbimit të drejtësisë), por nga ana tjetër ato njëkohësisht mund të kufizojnë aksesin e individëve në sistemin e drejtësisë. Një sistem tarifash jo realist dhe i ekzgjerruar i pengon

individët që to drejtohen gjykatave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që ta kanë, dhe për pasojë të përbëj shkelje të nenit 6 (1) të Konventës Europiane për të Drejtën e Njeriut, (çështja *Kreuz v Polonisë*, vendim i datës 19 qershor 2001, para 61-67).

E drejta për akses në gjykatë e individëve, e garantuar nga neni 6 (1) i Konventës, nuk është absolute, por mund të jetë subjekt i kufizimeve duke pranuar se vendosja e tarifave gjyqësore ose shpenzimeve të lidhura me të nuk përbën në parim dhe në vetvete një shkelje të Nenit 6. Megjithatë kjo Gjykatë ka bërë gjithashtu të qartë se kufizime të tilla nuk duhet të pengojnë padrejtësisht aksesin e individit në gjykatë. Këto kufizime duhet të jenë në mbështetje të një objekti legjitim dhe duhet të ekzistojë një marrëdhënie e arsyeshme e proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit legjitim që kërkohet të arrihet.

Tarifat duhet të vlerësohen në dritën e rrethanave të veçanta të çështjes konkrete - përfshirë aftësinë e individit për të paguar - për të përcaktuar nëse individit ende gëzon të drejtën e aksesit në gjykatë. Kjo e drejtë mund të shkelet nga refuzimi për të rimbursuar kostot e palës gjyqësore. (*Stankiewicz kundër Polonisë*, vendim i datës 6 Prill 2006, para. 60 dhe 75.)

Është me vend të evidentohet se ende nuk janë miratuar aktet nënligjore të ligjit “Për tarifën gjyqësore në Republikën e Shqipërisë” pavarësisht se është tejkaluar ndjeshëm afati i përcaktuar me këtë ligj për miratimin e këtyre akteve nënligjore. Pavarësisht se nuk krijohet vakum për shkak se deri në zbatimin e tarifave të reja gjyqësore zbatohen ato ekzistuese, është e rëndësishme që aktet nënligjore që duhet të hartohen të jenë në përputhje me frymën dhe jurisprudencën e Gjykatës Europiane për të Drejtën e Njeriut.

SHTOJCA 1

VENDIM I KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.55, DATË 06.02.2019

“PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE DHE DOKUMENTACIONIT PËR AUTORIZIMIN E ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE, QË OFROJNË NDIHMË JURIDIKE PARËSORE TË GARANTUAR NGA SHETI”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 15, të Ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse, që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti, sipas parashikimeve të këtij vendimi.
2. Organizatat jofitimprurëse japin shërbime të ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, në përputhje me autorizimin e miratuar nga Ministri i Drejtësisë.
3. Kriteret ligjore, që duhet të përmbushin organizatat jofitimprurëse që autorizohen për dhënien e shërbimeve të ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, janë ato të përcaktuara në nenin 15 të Ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.
4. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas bën publik njoftimin për aplikim, i cili përmban adresat e komunikimit, dokumentacionin që duhet të depozitohet, afatin, i cili duhet të jetë jo më pak se 30 (tridhjetë) ditë nga data e njoftimit, dhe vendin e dorëzimit të tyre, si dhe të dhëna të tjera të nevojshme për aplikimin për autorizim. Ky njoftim publikohet në faqen zyrtare të këtij institucioni, të Ministrisë së Drejtësisë dhe në Buletinën e Njoftimeve Zyrtare.
5. Dokumentacioni që duhet të depozitohet nga organizatat jofitimprurëse, që aplikojnë për marrjen e autorizimit që lëshohet nga Ministri i Drejtësisë, për të ofruar shërbime të ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, përmban:
 - a) aktin e regjistrimit në gjykatë;
 - b) kopjen e statutit, ku specifikohet si pjesë e veprimtarisë ofrimi i ndihmës juridike;

c) dokumentacionin që provon përvojë në ofrimin e ndihmës juridike parësore, të paktën në 3(tre) vite të veprimtarisë së tyre, duke përfshirë, si më poshtë vijon:

i. listën e plotë të projekteve të ndihmës juridike parësore të zhvilluara nga organizata gjatë 3 (tre) viteve dhe të dhëna statistikore për përfituesit e ndihmës parësore;

ii. raportet përfundimtare për secilin nga projektet e listuara, si dhe pasqyrat financiare;

iii. buxhetin total të secilit projekt, donatorët përkatës, si dhe listën e ekspertëve të brendshëm dhe të jashtëm të përfshirë në këto projekte; iv. letra vlerësimi nga të paktën 2 (dy) subjekte përfituese;

ç) vërtetimin nga organet tatimore që i ka përmbushur në mënyrë të rregullt detyrimet;

d) vërtetim nga gjykata se nuk është në procedurë falimenti dhe/ose likuidimi;

dh) vërtetim nga prokuroria dhe gjykata se anëtarët e organit më të lartë vendimmarrës dhe të organit ekzekutiv nuk janë në proces hetimi apo gjykimi për çështje që cenojnë besimin e publikut dhe ofrimin e përshtatshëm të ndihmës juridike;

e) formularin e gjendjes gjyqësore të anëtarëve të organit më të lartë vendimmarrës dhe të organitekzekutiv.

6. Aplikimi për autorizim i shoqëruar me dokumentacionin e përcaktuar në pikën 5 të këtij vendimi dorëzohet pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, e cila vlerëson nëse aplikimi është kryer brenda afatit të caktuar në njoftim, shqyrton përmbushjen e kriterëve ligjore dhe verifikon dokumentacionin e dorëzuar.

7. Aplikimet e paraqitura jashtë afatit nuk kualifikohen. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas njofton aplikuesit nëpërmjet postës elektronike lidhur me këtë disponim.

8. Në rast të konstatimit të mungesës së dokumentacionit, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas njofton aplikuesin për dorëzimin e dokumentacionit plotësues brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e njoftimit. Mossjellja e dokumentacionit plotësues brenda këtij afati passjell skualifikimin.

9. Procedura e verifikimit të kriterëve ligjore dhe e vlerësimit të aplikimit për autorizim bëhet nëpërputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative. Procedura e shqyrtimit të aplikimit zhvillohet brenda një afati të arsyeshëm, por, në çdo rast, jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga data e përfundimit të afatit të njoftimit, sipas pikës 4 të këtij vendimi.

10. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas verifikon dokumentacionin e paraqitur nga aplikuesit për marrjen e autorizimit dhe, në përfundim, përgatit një relacion vlerësues për secilën organizatë jofitimprurëse që ka aplikuar. Relacioni përmban të dhënat e dokumentacionit të paraqitur, vlerësimin mbi përmbushjen ose jo të kriterëve ligjore dhe propozimin përkatës.

11. Propozimi i shoqëruar me relacionin vlerësues i paraqitet ministrit të Drejtësisë, i cili, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e përfundimit të procedurës së verifikimit dhe vlerësimit të aplikimit, miraton ose jo dhënien e autorizimit.

12. Aplikimi për autorizim nuk miratohet kur organizata jofitimprurëse nuk plotëson kriteret ligjore të përcaktuara në nenin 15 të ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”. Me kërkesën e saj, organizatës jofitimprurëse i njoftohen shkaqet e skualifikimit.

13. Organizata jofitimprurëse që ngre pretendime për plotësimin e kriterëve ligjore ka të drejtën e ankimit pranë Ministrit të Drejtësisë, duke paraqitur arësyet dhe dokumentacionin mbështetës brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e njoftimit. Ky afat mund të zgjatet për rrethana të arsyeshme, të cilat nuk lidhen me disponueshmërinë e organizatës jofitimprurëse. Ministri i Drejtësisë shqyrton ankesat dhe njofton organizatën jofitimprurëse lidhur me to brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e regjistrimit të ankimit pranë Ministrisë së Drejtësisë. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatën administrative kompetente.

14. Autorizimi i dhënë nga Ministri i Drejtësisë është i vlefshëm për një periudhë dyvjeçare.

15. Ministria e Drejtësisë publikon listën e organizatave jofitimprurëse të autorizuar që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike parësore në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, listë e cila hartohet dhe përditësohet nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas mbi bazën e të dhënave të regjistrimit që mban kjo drejtori.

16. Ministri i Drejtësisë, me propozimin e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, mund të revokojë autorizimin e dhënë një organizate jofitimprurëse në rast se vërteton, kryesisht, apo bazuar në faktet e parashtruara në ankesat e paraqitura pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe informacionet e Drejtorisë së Ndihmës Juridike:

a) mospërmbushjen në mënyrë të përsëritur të ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore;

b) paraqitjen me qëllim të të dhënave të pasakta gjatë procesit të verifikimit të cilësisë së ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore;

c) mungesën e respektimit të standardeve dhe cilësisë së shërbimit të ndihmës juridike të ofruar;

ç) se anëtarët e organit më të lartë vendimmarrës dhe të organit ekzekutiv të organizatës jofitimprurëse nuk janë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje dhe që do të cenonte besimin e publikut dhe ofrimin e përshtatshëm të ndihmës juridike.

17. Revokimi i autorizimit i njoftohet organizatës jofitimprurëse, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatën administrative kompetente.

18. Çdo e dhënë lidhur me miratimin apo revokimin e autorizimit të organizatës jofitimprurëseregjistrohet në regjistrin e organizatave jofitimprurëse, të cilat ofrojnë ndihmë juridike parësore që administrojnë Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas.

19. Organizata jofitimprurëse e autorizuar për dhënien e shërbimeve të ndihmës juridike parësorenjofton menjëherë Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas për ekzistencën e rrethanave dhe fakteve, të cilat e bëjnë të pamundur ose e vështirësojnë ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, me qëllim që kjo e fundit të marrë masa për të siguruar një ofrim të pandërprerë të shërbimit të ndihmës juridike parësore.

20. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

SHTOJCA 2

VENDIM I KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.110, DATË 06.03.2019

“PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE DHE TË RREGULLAVE TË PËRZGJEDHJES SË ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE, TË AUTORIZUARA PËR OFRIMIN ENDIHMËS JURIDIKE PARËSORE TË GARANTUAR NGA SHTETI, QË PËRFITOJNË FINANCIME NGA BUXHETI I SHTETIT DHE MËNYRA E FINANCIMIT TË TYRE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 15, të Ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Organizatat jofitimprurëse, të autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar ngashteti (në vijim “organizata jofitimprurëse të autorizuar”) përfitojnë financime nga buxheti i shtetit, pas një procesi konkurrues dhe transparent përzgjedhjeje, bazuar në procedurat dhe rregullat e përcaktuara në këtë vendim.

2. Procedurat e përfitimit të financimit të organizatave jofitimprurëse të autorizuar bëhen duke ubazuar në parimet e mëposhtme:

a) konkurrueshmërisë;

b) trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit të organizatave jofitimprurëse të autorizuar, aplikuese për përfitimin e financimit;

c) transparencës të të gjitha fazave që lidhen me shqyrtimin, vendimmarrjen dhe përzgjedhjen e organizatave jofitimprurëse të autorizuar;

ç) kritereve të mirëpërcaktuara dhe publike, të cilat do të mundësojnë vlerësimin e propozimeve të organizatave jofitimprurëse të autorizuar në raport me objektivat dhe prioritetet e mbështetjes financiare;

d) efektivitetit dhe ekonomizimit në shfrytëzimin e fondeve publike, duke siguruar që të arrihen objektivat dhe prioritetet e përcaktuara me një kosto sa më të favorshme për realizimin e shërbimit të synuar;

dh) respektimit të plotë të parimeve të llogaridhënies dhe raportimit në përdorimet e fondeve publike;

e) financimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore për kategoritë e përfituesve që janë meprioritet për Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas dhe në interes të përfituesve të ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti;

ë) ruajtjes së pavarësisë së organizatës jofitimprurëse të autorizuar;

f) parandalimit të konfliktit të interesit, si dhe të çdo aktiviteti tjetër që rrezikon ofrimin me integritet të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

3. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas planifikon në buxhetin e saj një zë të veçantë për financimin e organizatave jofitimprurëse të autorizuar dhe harton, në bazë të shumës së miratuar, planin vjetor të financimit.

4. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, brenda 1 muaji nga miratimi i buxhetit, bën publike në faqen zyrtare të saj planin vjetor të financimit që përmban:

a) shumën e përfitimit financiar për vitin fiskal;

b) objektivat e përfitimit financiar, sipas nevojave të identifikuara;

c) numrin e përafërt të organizatave jofitimprurëse të autorizuar që mund të përfshihen në procesin e përzgjedhjes;

ç) kohën e hapjes së thirrjes për aplikime; dhe

d) kohën e fillimit të zbatimit të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti.

5. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas njofton, në faqen zyrtare të institucionit dhe pranë Buletinit të Njoftimeve Zyrtare, çdo fillim viti kalendarik, thirrje të përgjithshme ose gjatë vitit, në raste të veçanta ose të paparashikuara, për përmbushjen e nevojave të kategorive të caktuara të popullsisë për ndihmë juridike parësore, duke caktuar:

a) shumën e fondeve financiare në dispozicion;

b) numrin e organizatave jofitimprurëse të autorizuar që mund të përfitojnë financimin e caktuar;

c) kriteret e përgjithshme dhe të veçanta që duhet të plotësojnë organizatat jofitimprurëse të autorizuar;

ç) listën e dokumenteve të nevojshme për t'u paraqitur;

d) afatin e përfundimit të thirrjes;

dh) të dhëna për mënyrën e dorëzimit të aplikimeve;

e) udhëzime të tjera të nevojshme për plotësimin e aplikimit, të cilat përcaktohen me urdhër të drejtorit të Ndihmës Juridike Falas dhe që publikohet së bashku me thirrjen.

6. Për t'u kualifikuar për të përfituar financime, organizatat jofitimprurëse të autorizuar duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, si më poshtë vijon:

a) Kriteret e përgjithshme:

i) të kenë marrë autorizimin nga ministri i Drejtësisë për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti;

ii) të mos kenë dy burime të njëjta financimi për të njëjtin aktivitet;

iii) të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi që cenon zhvillimin e drejtë të procesit të përzgjedhjes me drejtorin e Ndihmës Juridike Falas.

b) Kriteret e veçanta:

i) projektpropozimin, i cili përmban të dhënat teknike-financiare për ofrimin e shërbimit, qëllimin, objektivat specifike, aktivitetet, kalendarin e realizimit, rezultatet e synuara, përfituesit e drejtpërdrejtë;

ii) të dhëna për personelin, duke specifikuar detyrat dhe siguruar jetëshkrimin e tyre;

iii) të dëshmojnë se kanë përvojë në realizimin e shërbimeve të ngjashme, duke siguruar dokumente dhe të dhëna të realizimit të shërbimeve të ngjashme në të kaluarën, nëse kjo është e domosdoshme, sipas thirrjes përkatëse;

iv) kërkesa të tjera specifike që mund të jenë të nevojshme për ofrimin e ndihmës juridike parësore, sipas thirrjes publike të veçantë.

7. Dokumentacioni për vërtetimin e plotësimit të kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta depozitohet pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas. Organizata jofitimprurëse e autorizuar duhet të dëshmojë se i plotëson kriteret e veçanta duke dorëzuar dokumentet përkatëse sipas pikës 6, të këtij vendimi, dhe thirrjes publike. Në rast të mosplotësimit të një prej kriterëve të veçanta, aplikimi konsiderohet i paplotë dhe, si i tillë, nuk kualifikohet për përfitimin financiar.

8. Pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas ngrihet dhe funksionon, me kohë të pjesshme:

a) komisioni vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve për financim të organizatave jofitimprurëse të autorizuar;

b) komisioni i ankimit për shqyrtimin e ankesave për shkelje të qëllimshme të procedurës së shqyrtimit, të vendimeve për përzgjedhjen e organizatave jofitimprurëse të autorizuar që përfitojnë financim, si edhe të masës së financimit.

9. Komisioni vlerësues përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, si më poshtë vijon:

a) 2 (dy) përfaqësues nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, që mbulojnë çështjet juridike;

b) 1 (një) përfaqësues nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, që mbulon çështjet e financës dhe buxhetit;

c) (një) përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, që mbulon çështjet e të miturve;

ç) 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, që mbulon çështjet e financës dhe të buxhetit.

10. Komisioni i ankimit përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, prej të cilëve 1 (një) përfaqësues nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas dhe 2 (dy) përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë. Në komisionin e ankimit nuk mund të marrin pjesë anëtarët të cilët kanë marrë pjesë në shqyrtimin e aplikimeve, në kuadër të komisionit vlerësues.

11. Komisioni vlerësues dhe komisioni i ankimit krijohen gjatë kohës që thirrja publike për aplikim është e hapur dhe emrat e anëtarëve nuk bëhen publikë deri para shpalljes së rezultateve të shqyrtimit të ankesave. Në komisione nuk mund të marrin pjesë subjekte që gëzojnë statusin e funksionarit politik.

12. Për të siguruar nevojat administrative dhe mbështetjen organizative për veprimtarinë e komisionit vlerësues dhe të komisionit të ankimit, me urdhër të drejtorit të Ndhmës Juridike Falas, ngrihet sekretariati teknik, i përbërë nga përfaqësues të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas.

13. Rregulla më të hollësishme për organizimin dhe funksionimin e komisionit vlerësues dhe komisionit të ankimit përcaktohen në rregulloren e brendshme të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, që miratohet me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

14. Komisioni vlerësues shqyrton aplikimet dhe vlerëson përmbushjen e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta, si dhe cakton masën financiare përfituese brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e mbylljes së thirrjes publike.

15. Rezultatet e verifikimit publikohen në faqen zyrtare të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, brenda 3 (tre)

ditëve nga dita e përfundimit të procesit të shqyrtimit.

16. Vendimi i komisionit vlerësues mund të ankimohet pranë komisionit të ankimit, brenda 5 (pesë) ditëve nga njoftimi i rezultateve për shkelje të procedurave, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

17. Ankesa shqyrtohet nga komisioni i ankimeve, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e paraqitjes.

18. Komisioni i ankimit nxjerr vendim të arsyetuar për pranimin ose mospranimin e ankesës. Vendim i arsyetuar i komisionit të ankimit i njoftohet organizatës jofitimprurëse të autorizuar që ka bërë ankimin, jo më vonë se 2 (dy) ditë nga marrja e vendimit dhe publikohet në faqen zyrtare të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në gjykatën administrative kompetente, sipas legjislacionit në fuqi.

19. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas lidh kontratën e shërbimit të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore me organizatën jofitimprurëse të autorizuar të përzgjedhur, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga përfundimi i procesit të përzgjedhjes.

20. Kontrata e shërbimit lidhet për një periudhë 1 (një)-vjeçare dhe përmban:

a) të dhëna lidhur me vlerën e financimit të përfituar;
b) shtrirjen territoriale të shërbimit të ofruar të ndihmës juridike parësore;

c) target-grupet e përfituesve të ndihmës juridike të synuar;

ç) mënyrën dhe mekanizmat e monitorimit të zbatimit të kontratës së shërbimit;

d) përcaktime të qarta lidhur me:

i) qëllimin e përfitimit financiar dhe ndalimin e përdorimit të vlerës së përfituar për qëllime të tjerash të kontekstit të ndihmës juridike parësore;

ii) mënyrën e kryerjes së pagesës dhe të transaksioneve financiare nëpërmjet institucioneve bankare, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi;

iii) shmangien e konfliktit të interesit gjatë përdorimit të masës financiare të përfituar.

dh) rastet kur kontrata e shërbimit mund të zgjidhet para përfundimit të saj;

e) mënyrën e kthimit të vlerës financiare në rast të ndërprerjes së kontratës së shërbimit për shkakë që lidhen me mospërmbushjen e detyrimeve nga

organizata jofitimprurëse e autorizuar.

21. Çdo organizatë jofitimprurëse e autorizuar e përzgjedhur nuk mund të përfitojë më shumë se 20% të buxhetit të planifikuar për financimin e dhënies së ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti nga organizatat jofitimprurëse.

22. Organizata jofitimprurëse e autorizuar, përfituese e financimit, raporton pranë Drejtësisë së Ndhmës Juridike Falas periodikisht çdo 3 (tre) muaj mbi përdorimin e fondeve të financuara dhe përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në kontratën e shërbimit.

23. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas kryen mbikëqyrje nëpërmjet vizitës në terren të paktën 1 (një) herë në vit gjatë kohëzgjatjes së kontratës së shërbimit për të verifikuar standardet e shërbimit të ofruar nga organizata jofitimprurëse e autorizuar, përfituese e financimit.

24. Në rast të konstatimit të shkeljes së kontratës së shërbimit nga organizata jofitimprurëse e autorizuar, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas verifikon rastin dhe merr masa në raport me shkeljen e kryer, duke urdhëruar deri në zgjidhjen e parakohshme të kontratës së shërbimit dhe revokimin e autorizimit nga Ministri i Drejtësisë.

25. Në përfundim të zbatimit të kontratës së shërbimit për ofrimin e ndihmës juridike parësore, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas harton raportin e monitorimit të përdorimit të fondeve nga organizata jofitimprurëse gjatë periudhës 1-vjeçare. Raporti i monitorimit i përcillet Ministrit të Drejtësisë dhe përmban:

a) të dhënat e organizatës jofitimprurëse të autorizuar që ka përfituar financim;

b) masën financiare të përfituar;

c) mënyrën e alokimit të masës financiare të përfituar;

ç) kohëzgjatjen dhe statusin e zbatimit të kontratës së shërbimit;

d) shërbimet e ndihmës juridike parësore të ofruara;

dh) numrin dhe kategorinë e përfituesve të shërbimeve të ofruara;

e) shtirjen gjeografike/territoriale të shërbimeve të ofruara;

ë) rezultatet e arritura përmes shërbimeve të ofruara;

f) ndikimet në përmirësimin e trajtimit të përfituesve nga ndihma juridike parësore e ofruar. Format i raportit të monitorimit miratohet me urdhër të drejtorit të Ndhmës Juridike Falas.

26. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

SHTOJCA 3

UDHËZIM I KËSHILLIT TË MINSITRAVE NR.1, DATË 6.3.2019

“PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR.4, DATË 12.12.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR ÇAKTIMIN E MASËS SË SHPENZIMEVE DHE PAGESAVE TË EKSPERTËVE DHE DËSHMITARËVE GJATË PROCESIT GJYQËSOR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 105/a të Ligjit nr.8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në udhëzimin nr. 4, datë 12.12.2012, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në ndarjen I, pikat 2, 3 dhe 4 ndryshohen me këtë përmbajtje:

“2.Gjykata thërret ekspertë që ofrojnë ekspertizë në një proces gjyqësor, mbështetur në të dhënat e Regjistrat Elektronik të Ekspertëve, që administron dhe vë në dispozicion Ministria e Drejtësisë.

3. Gjykata, pa cenuar administrimin e drejtësisë, bën përzgjedhjen e ekspertëve në mënyrë të drejtë dhe transparente, duke konsideruar që çdo eksperti nuk mund t'i caktohet për të ofruar ekspertizën e tij më shumë se 30% e numrit të çështjeve gjyqësore për të cilat është kërkuar e njëjta lloj ekspertize, brenda një viti kalendarik. Kjo mënyrë caktimi nga gjykata siguron një nivel transparence të përshtatshme lidhur me përzgjedhjen e ekspertëve përmes mjeteve informatike.

4. Gjykata thërret një ekspert jashtë Regjistrat Elektronik të Ekspertëve, vetëm kur, për nevoja të procesit, eksperti nevojitet nga fusha të veçanta ekspertize, për të cilat ligji nuk parashikon licencimin e tyre”.

2. Në ndarjen V, pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1.Pagesat për ekspertët dhe dëshmitarët, në rastet kur gjykata ka vendosur përjashtimin nga pagesa e shpenzimeve gjyqësore në kuptim të Ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, kryhen nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, sipas rregullave dhe procedurës së përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Drejtësisë.”

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.


SHTOJCA 4**URDHËR I KRYEMINISTRIT NR.59 DATË 25.03.2019****“Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas”**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 7 të Ligjit nr.152/2013 “Për nënpunësin civil”, të ndryshuar, dhe të nenit 10 të Ligjit nr.9000 datë 30.01.2013 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të nenit 21 të Ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Struktura e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas të jetë sipas skemës 1 që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Organika e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas të jetë sipas skemës 2 që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Numri i punonjësve të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas të jetë gjithsej 25 veta.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

STRUKTURA E DREJTORISË SË NDIHMËS JURIDIKE

ORGANIKA E DREJTORISË SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS

POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
DREJTOR I PËRGJITHSHËM	II-b	1
DREJTORIA E ZBATIMIT TË POLITIKAVE DHE ADMINISTRIMIT TË NDIHMËS PARËSORE		5
DREJTOR	III-a 1	
SPECIALIST	IV-a	4
DREJTORIA E MBIKËQYRJES SË STANDARTEVE TE ORFIMIT TË SHËRBIMEVE TË NDIHMËS JURIDIKE		6
DREJTOR	III-a	1
SPECIALIST	IV-a	5
DREJTORIA E FINANCËS, ARKIVIT DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE		5
DREJTOR	III-a	1
SPECIALIST (FINANCË/BUXHET)	IV-a	1
SPECIALIST (BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIME)	IV-a	1
SPECIALIST (ARKIV-PROTOKOLL DHE SEKRETARI)	IV-a	1
MAGAZINIER	IV-a	1
QËNDRA E SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE		8
SPECIALIST (PUNONJËS ME TRAJNIM TË POSACËM)	IV-a	8

PUNONJËS GJITHSEJ: 25

SHTOJCA 5

UDHËZIM NR.1 DATË 08.03.2019

“PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE PËR MBLEDHJEN, PLOTËSIMIN DHE ADMINISTRIMIN E TË DHËNAVE TË REGJISTRAVE”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të Ligjit nr.8678 datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe të nenit 7 shkronja i) të Ligjit nr.111/2017, datë 14.12.2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”,

UDHËZOJ:

I. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas mban, mbledh, plotëson dhe administron:

a) të dhënat e regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve përfituese të ndihmës juridike të garantuar nga shteti;
b) të dhënat e regjistrit të organizatave jofitimprurese që ofrojnë ndihmë juridike parësore.

2. Të dhënat e regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve përfituese të ndihmës juridike të garantuar nga shteti mbledhen në bazë të kërkesës për ndihmë juridike, vetëdeklarimit dhe çdo dokumentacioni tjetër të depozituar nga kërkuesi për këtë qëllim.

3. Çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti i dërgon periodikisht çdo muaj Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, të dhënat e kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve kërkuese të paraqitura për të përfituar ndihmë juridike të garantuar nga shteti. Të dhënat dërgohen brenda 5 (pesë) ditëve të para të muajit pasardhës të muajit referues.

4. Plotësimi dhe përditësimi i regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve përfituese të ndihmës juridike të garantuar nga shteti kryhet brenda 5 (pesë) ditëve pune nga momenti i depozitimit të informacionit pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, sipas pikës 3 të këtij udhëzimi.

5. Regjistri i organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore plotësohet dhe përditësohet me të dhëna nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, brenda 24 orëve nga koha e kryerjes së një veprimi apo marrjes së një informacioni që lidhet me veprimtarinë e tyre.

6. Në regjistrimin e kërkesave dhe vetëdeklarimeve për ndihmë juridike parësore, për cdo kërkues, përfshihen të dhënat e mëposhtme:

- i. emri, atësia, mbiemri
- ii. gjinia
- iii. datëlindja
- iv. shtetësia
- v. gjendja familjare (numri i pjesëtarëve në familje)
- vi. gjendja e punësimit
- vii. adresa dhe të dhëna të tjera kontakti
- viii. vetëdeklarimi në lidhje me të ardhurat dhe pasuritë
- ix. nëse kërkesa për ndihmë është pranuar apo refuzuar, si dhe arsyen e refuzimit
- x. natyra e çështjes/ve juridike për të cilën është kërkuar ndihmë (civile, administrative, penale)
- xi. të dhënat e ofruesit të shërbimit që ka dhënë ndihmë juridike parësore.

7. Në regjistrimin e kërkesave dhe vetëdeklarimeve për ndihmë juridike dytësore, për cdo kërkues, përfshihen të dhënat e mëposhtme:

- i. emri, atësia, mbiemri
- ii. gjinia
- iii. datëlindja
- iv. shtetësia
- v. gjendja familjare (numri i pjesëtarëve në familje)
- vi. gjendja e punësimit
- vii. adresa dhe të dhëna të tjera kontakti
- viii. gjykata ose organi procedues pranë të cilit është dorëzuar kërkesa
- ix. lloji i vetëdeklarimit në lidhje me të ardhurat dhe pasuritë
- x. lloji i ndihmës dytësore të kërkuar:
 - (i) përfaqësim;
 - (ii) përjashtim nga pagimi tarifave gjyqësore;
 - (iii) përjashtim nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore; dhe/ose
 - (iv) përjashtim nga tarifa e urdhërit të ekzekutimit;
 - (xi) natyra e çështjes/ve juridike për të cilën është kërkuar ndihmë (civile, administrative, penale);
 - (xii) nëse kërkesa për ndihmë është pranuar apo refuzuar nga gjykata/organi procedues, plotësisht apo pjesërisht;
 - (xiii) data dhe numri i vendimit përkatës dhe nëse vendimi është apeluar (në gjykatë të shkallës së parë ose të apelit, respektivisht, dhe pala ankimuese);
 - (xiv) të dhëna mbi vendimin mbi ankimin kundër refuzimit të ndihmës juridike, sipas rastit
 - (xv) të dhënat e avokatit të caktuar për dhënien e ndihmës juridike dytësore;
 - (xvi) pagesat e përfituara nga avokati;
 - (xvii) rimbursimi i pagesave nga pala gjyqëmbëse ose nga përfituesi i ndihmes juridike, sipas rastit.

8. Në regjistrimin e organizatave jofitimprurese ofrojnë ndihmë juridike parësore regjistrohen, përfshihen të dhënat e mëposhtme:

- i. emërtimi i organizatës jofitimprurëse, përfaqësuesit të saj ligjor dhe të dhënat e kontaktit;
- ii. të dhëna mbi vendimin e Ministrit të Drejtësisë për autorizimin e organizatës jofitimprurëse;
- iii. juridiksioni ose zona gjeografike ku organizata jofitimprurese është autorizuar të japë ndihmë juridike parësore, si dhe specifikime të tjera mbi llojin e ndihmës parësore për të cilën është autorizuar
- iv. të dhëna mbi kontratën e financimit për ofrimin e ndihmës juridike parësore, nëse ka lidhur një kontratë të tillë;
- v. të dhëna për revokimin e autorizimit të lëshuar nga Ministri i Drejtësisë, sipas rastit.

9. Regjistri i kërkesave dhe vetdeklarimeve të subjekteve përfituese dhe i organizatave jofitimprurëse ofrojnë ndihmë juridike falas (në vijim “Regjistrat”) mbahet në formë elektronike.

10. Regjistrat bëhen publike nëpërmjet faqes elektronike të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, në përputhje me rregullat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

11. Regjistrat me të dhënat e plota, sipas këtij udhëzimi, mbahen pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas. Të dhënat e plota të Regjistrave u vihen në dispozicion institucioneve të drejtësisë dhe palëve të interesuara, pasi vlerësohet qëllimi i kërkesës dhe në përputhje me kriteret dhe kufizimet e parashikuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

12. Regjistrat plotësohen dhe përditësohen nga punonjësi i autorizuar me shkrim nga Drejtori i Ndhmës Juridike Falas.

13. Punonjësi i autorizuar është përgjegjës përsaktësinë dhe përditësimin e të dhënave të hedhura prej tij.

14. Punonjësi i autorizuar nuk mund të ndërhyjë dhe të ndryshojë rubrikat e Regjistrit/ave. Në rast se bëhen gabime materiale në hedhjen e informacionit në Regjistër, punonjësi i autorizuar ben korrigjimin dhe shkruan informacionin e saktë.

15. Regjistrat administrohen nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas dhe për ruajtjen dhe asgjësimin e tyre zbatohen rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për arkivat.

16. Punonjësi i autorizuar plotëson dhe përditëson Regjistrat me të dhëna, duke filluar nga dita e parë e ofrimit të shërbimit të dhënies së ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

17. Ngarkohet Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas.

SHTOJCA 6

UDHËZIM I MINISTRIT TË DREJTËSISË NR.2 DATË 25.03.2019

”PËR PROCEDURAT, PERIODICITETIN DHE RREGULLAT PËR VERIFIKIMIN E RRETHANAVE PËR KTHIMIN E PËRFITIMEVE”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të Ligjit nr.8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë,” i ndryshuar, si dhe të nenit 31 pika I të Ligjit nr.111/2017 datë 14.12.2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”,

UDHËZOJ:

I. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas verifikon në mënyrë periodike, çdo vit, gjendjen ekonomike dhe financiare të subjekteve përfituese të ndihmës juridike, si dhe fazën në të cilën ndodhet gjykimi me palë subjektin përfitues.

2. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas mund të kryejë verifikim nën kohë në rast se ka të dhëna apo indicie për ndryshimin e rrethanave.

3. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, pas miratimit të ndihmës juridike, u kërkon subjekteve përfituese të nënshkruajnë një deklaratë në të cilën ata marrin përsipër detyrimin për të njoftuar për ndryshimin e rrethanave financiare ose për rastet kur nuk dëshirojnë të ndjekin me tej rrugën gjyqësore, duke pranuar kthimin vullnetar të shumës së përfituar për këtë qëllim.

4. Subjektet përfituese të ndihmës juridike kanë detyrimin që të paraqesin prane Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas kopje të vendimit gjyqësor të formës së prerë dhe të urdhrit për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit gjyqësor.

5. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas me qëllim mbledhjen e të dhënave i kërkon informacion subjekteve përfituese dhe institucioneve publike dhe jo publike që mund të kenë dijeni lidhur me situatën në të cilën ndodhet subjekti përfitues.

6. Subjekti përfitues konsiderohet se nuk i plotëson me kriteret ligjore për përfitimin e ndihmës juridike me qëllim kthimin e shumës së përfituar në rastet kur:

a) të ardhurat financiare janë të tilla që nuk e përfshijnë atë në asnjë nga kategoritë e nenit 12 të Ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”;

b) nuk e ka paraqitur kërkesë-padinë në gjykatë brënda 3 (tre) muajve nga data kur vendimi i gjykatës për pranimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore ka marrë formë të prerë;

c) ka hequr dorë nga gjykimi i padisë, nga e drejta e padisë, nga ankimi dhe rekursi apo nga ekzekutimi i urdhrit të ekzekutimit;

q) ka paraqitur të dhëna të pavërteta ose të pasakta.

7. Në rastet kur Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas konstaton se ndodhet para njëres prej situatave të parashikuara në pikën 6 të këtij udhëzimi merr vendim të arsyetuar, në të cilin pasqyron:

a) të dhënat e mbledhura prej saj;

b) shumën e përlogarit saktë që duhet të kthehet nga subjekti dhe

c) afatin brenda të cilit duhet të kthehet shuma e përfituar, i cili në cdo rast nuk duhet të tejkalojë afatin prej 6 (gjashtë) muaj nga data e konstatimit të rrethanës ndryshuese.

8. Në rast se subjekti përfitues refuzon me veprim ose mosveprim kthimin e shumës së përfituar, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas i drejtohet me kërkesë gjyqësore që ka vendosur për dhënien e ndihmës juridike, duke i kërkuar kthimin e shumës së përfituar nga subjekti. Kthimi i shumës së përfituar dhe afati i kthimit të tyre, bëhet sipas vendimit të shpallur nga gjykata që përbën titull ekzekutiv.

Ngarkohet Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

SHTOJCA 7

UDHËZIM I MINISTRIT TË DREJTËSISË NR.6 DATË 20.02.2019

“PËRRREGULLAT DHE PROCEDURAT E KRYERJES SË PAGESAVE TË SHPENZIMEVE GJYQËSORE, PËR TË CILAT ËSHTË VENDOSUR PËRJASHTIMI NË RASTIN E DHËNIES SË NDIHMËS JURIDIKE”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, në zbatim të nenit 7, germa “gj” dhe nenit 28, pika 4, të Ligjit nr.111/2017, datë 14.12.2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, Ministri i Drejtësisë

UDHËZON:

I . Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të kryerjes së pagesave të shpenzimeve gjyqësore, për të cilat është vendosur përjashtimi, në kuptim të Ligjit nr.111/2017, datë 14.12.2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

2. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas kryen pagesat e shpenzimeve për dëshmitarët, ekspertët, përkthyesit dhe për këqyrjen e sendeve ose këqyrjen në vend, sipas përcaktimeve të legjislacionit procedural, për të cilat gjykata ka vendosur përjashtimin nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore.

3. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas kryen pagesat bazuar në vendimin gjyqësor, sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr.4 datë 12.12.2012 të Këshillit të Ministrave “Për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve gjatë procesit gjyqësor”, i ndryshuar.

4. Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e shpalljes të vendimit nga gjykata për përjashtimin nga pagesat e shpenzimeve gjyqësore, dëshmitari, eksperti dhe përkthyesi paraqesin pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dokumente tatimore për shërbimet e ofruara dhe, sipas rastit, dokumentacionin vërtetues, si vijon:

- a) dokumentin tatimor për shpenzimet e transportit;
- b) dokumentin tatimor për shpenzimet e fjetjes;
- c) dokumentin me karakter vërtetues të vendit të punës dhe vlerës së pagës;
- d) vërtetim bankar nga një bankë e nivelit të dytë për deklarimin e numrit të llogarisë në lekë.

5. Mosparaqitja e dokumentit tatimor nga ana e dëshmitarit, ekspertit dhe përkthyesit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për tatimet përben shkak për moskryerjen e pagesave për shërbimet e ofruara dhe për të cilat është vendosur përjashtimi nga shpenzimet gjyqësore.

6. Në fund të çdo muaji Drejtoria e Ndihmës Juridike Falasharton një raport mbi vendimet gjyqësore të njoftuara (dokumentet tatimore të paraqitura për secilin vendim), përlogaritjen e Ndihmës Juridike Falas, kryen pagesat e shpenzimeve gjyqësore, sipas radhës kronologjike të vendimeve gjyqësore të lidhura dhe me dokumentacionin përkatës.

7. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas njofton dëshmitarin, ekspertin, përkthyesin, gjykatën që ka dhënë vendimin dhe përfaqësuesin e ndihmës juridike dytësore të garantuar nga shteti, të cilit i është pranuar kërkesa për përjashtimin nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore, për kryerjen e pagesës së shpenzimeve gjyqësore.

Njoftimi shoqërohet me një kopje të vërtetimit të dhënë nga banka që vërteton kryerjen e pagesës.

Njoftimi bëhet brenda 5 (pesë) ditëve nga kryerja e pagesës, ne rrugë postare, elektronike si dhe me çdo mënyrë tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

8. Në rastin kur limiti mujor është i pamjaftueshëm për likuidimin e plotë të shpenzimeve gjyqësore, likuidimi shtyhet në muajin pasardhës, sipas radhës kronologjike të vendimeve gjyqësore të njoftuara dhe të plotësuara me dokumentacionin tatimor provues.

9. Në rast të mungesës së fondeve buxhetore për pagesën e të gjitha shpenzimeve gjyqësore të përlogaritura, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas duhet të kontabilizojë çdo detyrim të mbartur, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe të planifikojë fondet e nevojshme për shlyerjen e këtyre detyrimeve, për periudhat e ardhshme buxhetore.

10. Ngarkohet Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

SHTOJCA 8

URDHËR NR.226 DATË 25.03.2019

“PËRMIRATIMIN E KONTRATAVE TË NDIHMËS JURIDIKE TË GARANTUAR NGA SHETI”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 7 të Ligjit nr.8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “e” dhe “ë”, të nenit 7, të Ligjit nr.111, datë 14.12.2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e kontratave TIP të ndihmës juridike të garantuar nga shteti (sipas shtojcave), bashkëlidhur këtij urdhri dhe që janë pjesë përbërëse e tij.

Shtojca I: miraton kontratën tip me organizatat jofitimprurëse për shërbimet e ndihmës juridike parësore, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Shtojca II: miraton kontratën tip me avokatët për dhënien e shërbimeve të ndihmës juridike dytësore.

2. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

3. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për njoftimin e këtij urdhri.

4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KONTRATË SHËRBIMI PËR OFRIMIN E NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE

E lidhur sot në datë..... në Tiranë, ndërmjet palëve kontraktuese si më poshtë:

1. Drejtorisë së Ndhmës Juridike, me adresë: Blv. Zogu I, pranë Ministrisë së Drejtësisë, përfaqësuar nga Drejtori

2. Organizata Jofitimprurëse -----, me adresë, përfaqësuar nga:

Palët në këtë kontratë bien dakord si më poshtë:

Neni 1 Baza Ligjore

Kjo kontratë bazohet në Kodin Civil, kreu Kontratat, Ligjin nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, Vendimin nr.__datë__ “Për rregullat e autorizimit dhe te përzgjedhjes së ofr-ve që ofrojnë ndihmë juridike parësore”.

Neni 2 Objekti

Objekti i kësaj kontrate është ofrimi i shërbimit të ndihmës juridike parësore sipas termave të përcaktuara në këtë kontratë.

Neni 3 Përcaktimi i objektit tëshërbimit

Ofruesi i shërbimit do të ofrojë shërbimet për ndihmë juridike që përfshijnë:

a) Dhënien e informacioneve në lidhje me sistemin ligjor të Republikës së Shqipërisë, aktet normative në fuqi, te drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor;

b) Dhënien e këshillimit për çështje të ndryshme juridike që nuk janë duke u shqyrtuar nga institucione gjyqësore, ndërmjetësimi ose arbitrazhi;

c) Dhënien e informacionit dhe këshillimit mbi rregullat dhe procedurat që lidhen me ndërmjetësimin dhe zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve;

d) Dhënien e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumentet të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore;

e) Dhënien e ndihmës për të plotësuar dokumentacionin lidhur me kërkesën për ndihmë juridike parësore;

f) Përfaqësimin përpara organeve administrative;

g) Dhënien e të gjitha formave të tjera të mbështetjes së nevojshme juridike për sa kohë që çështja nuk është objekt shqyrtimi gjyqësor.

Neni 4 **Detyrimet e ofruesit të shërbimit**

Ofruesi i shërbimit detyrohet:

a) Të regjistrojë çdo person që i drejtohet me një kërkesë për ndihmë juridike;

b) Të ndihmojë kërkuesin e ndihmës juridike që të plotësojë formularin për kërkimin e ndihmës juridike parësore;

c) Të ofrojë shërbimin e ndihmës juridike me cilësi sipas standardeve të përcaktuara nga Ministri i Drejtësisë me Udhëzimin Nr... , datë “Për kriteret dhe metodologjinë e vlerësimit të cilësisë në ofrimin e ndihmës juridike”;

d) Të raportojë një herë në 3 muaj ose me kërkesë të DNJ lidhur me rastet dhe ecuritë e ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike, duke i bashkëlidhur edhe dokumentacionin përkatës që provon kryerjen e shërbimeve të ofruara;

e) Të bashkëpunojë me DNJ për mbikëqyrjen e cilësisë dhe efektivitetit të shërbimit të ofruar përfituesve të ndihmës juridike;

f) Të respektojë etikën dhe komunikimin me subjektet që u ofron shërbimin klientët e ndihmës juridike për të krijuar një marrëdhënie besimi me ta;

g) Të kryejë shërbimin e plotë të ndihmës juridike dhe të mos heqë dorë nga ofrimi i shërbimit përveç rasteve të konfliktit të interesit apo për shkaqe të tjera të arsyeshme. Nëse ka shkaqe për mosofrim ose ndërprerje të shërbimit, ai njofton menjëherë DNJ, e cila merr masa për një ofertues alternativ për çdo rast.

Neni 5 **Detyrimet e DNJ**

DNJ ka detyrimin që brenda 10 ditëve nga raportimi periodik i ofruesit të shërbimit të shoqëruar me dokumentacionin përkatës të kryejë pagesën e shpërblimit të ofruesit të shërbimit.

Neni 6 **Përfundimi i kontratës**

1. Kontrata lidhet për një afat 1 (një) vjeçar.

2. Kontrata përfundon para afatit nëse ofruesi i shërbimit heq dorë nga shërbimi. Në këtë rast ai njofton menjëherë DNJ. Të dyja palët kanë detyrimin, që të garantojnë transferimin e kërkesave për ndihmë juridike, të depozituara tashmë pranë organizatës jofitimprurëse që është tërhequr, pranë një tjetër subjekti të autorizuar për të dhënë ndihmë juridike parësore, duke garantuar kështu vazhdimësinë e trajtimit të çështjeve të kërkuesve.

3. Kontrata përfundon para afatit nëse DNJ nuk kryen pagesën pas ofrimit të shërbimit pa shkaqe të arsyeshme.

4. Në rast të mos përbushjes së detyrimeve do të zbatohen dispozitat e parashikuara në Kodin Civil.

Neni 7 **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Palët do të përpiqen t’i zgjidhin me mirëkuptim të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë zbatimit të kësaj kontrate. Nëse kjo nuk është e mundur kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 8 **Hyrja në fuqi**

Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj.

Kontratë nënshkruhet në 2 (dy) kopje, nga një kopje për secilën palë.

PALËT:

Drejtori i DNJ

Organizata Jofitimprurëse

KONTRATË PËR OFRIMIN E SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE DYTËSORE

Kjo Kontratë për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike dytësore ("Kontrata") lidhet sot në datë....., nga dhe ndërmjet palëve si më poshtë:

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS,
përfaqësuar nga z/znj. _____
(këtu e më poshtë referuar si "Kontraktori")

Dhe

Z/Znj shtetas lindur më _____identifikuar
me me Letërnjoftimin/Pasaportën me numër
personal _____banues në _____
(këtu e më poshtë referuar si 'Ofruesi i Shërbimit')

Palët në këtë Kontratë do të referohen veçmas si "Pala"
ose së bashku si 'Palët'.

NENI 1 OBJEKTI I KONTRATËS

1.1. Objekti i kësaj Kontratë është ofrimi i shërbimit të Ndihmës Juridike Dytësore nga Ofruesi i Shërbimit, në favor të personave që kanë përfituar sipas një vendimi të formes së prerë të gjykatës kompetente, të drejtën e përfutimit të kësaj ndihme falas, sipas përcaktimeve të Ligjit 111/2017.

NENI 2 HYRJA NE FUQI DHE KOHEZGJATJA

2.1. Kjo Kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga të dyja Palët dhe është e vlefshme për një afat 1 (një) vjeçar nga data e nënshkrimit, por në çdo rast deri në miratimin e listës së re dhe lidhjes së kontratave të reja.

2.2. Afati i kësaj Kontrate mund të rinovohet me marrëveshje me shkëmbim mes Palëve.

2.3. Përfundimi i Kontratës 1- vjeçare nuk e pengon ofruesin e shërbimit të përfaqësuesit përfituesin den në zgjidhjen përfundimtare të çështjes, përveç kur ekzistojnë rrethanat për zëvendësimin e tij.

NENI 3 PARIMET E OFRIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE DYTËSORE

3.1. Dhënia e Ndihmës Juridike Dytësore nga Ofruesi i Shërbimit, bazohet veçanërisht mbi parimet e mëposhtme:

- a) aksesit i barabartë i individëve në ndihmën juridike;
- b) barazia dhe mosdiskriminimi i individëve që gëzojnë të drejtën për ndihmë juridike;
- c) profesionalizmi në dhënien e shërbimit të ndihmës juridike;
- q) cilësia, eficaenca dhe efikasiteti në kosto për shërbimet e ofruara të ndihmës juridike;
- d) ruajtja e konfidencialitetit;
- dh) shmangia dhe parandalimi i konfliktit të interesit;
- c) mbrojtja e të drejtave të personave vulnerabël.

3.2. Përveç sa më sipër, dhënia e ndihmës juridike dytësore nga Ofruesi i Shërbimit bazohet mbi parimet e Kodit Etik të Avokatit.

3.3. Shkelja e parimeve të përcaktuara në këtë nen, përbën shkelje tërëndë të kësaj Kontrate dhe pasqell aplikimin e sanksioneve dhe masave disiplinore, sipas parashikimeve të Ligjit për Avokatinë apo çdo ligji tjetër të aplikueshëm.

NENI 4 TARIFA E SHËRBIMIT DHE MËNYRA E PAGESËS

4.1. Tarifa e ofrimit të Ndihmës Juridike Dytësore nga Ofruesi i Shërbimit, përcaktohet sipas tarifave në Aneksin bashkëlidhur kësaj Kontrate ("Tarifa e Shërbimit").

4.2. Kontraktori do të paguajë Tarifën e Shërbimit, në llogarinë bankare të Ofruesit të Shërbimit me të dhëna si më poshtë:

Përfituesi:

Banka:.....

SWIFT:.....

IBAN:.....

NENI 5 DETYRIMET DHE GARANCITE E PALËVE

5.1. Në kuptim të Ligjit 111/2017, shërbimet e Ndihmës Juridike Dytësore që Ofruesi i Shërbimit detyrohet të kryejë, përfshijnë por pa u kufizuar:

-Përpilimi i akteve të nevojshme për të vënë në lëvizje gjykatën, kërkesa, kërkesë padi ose të çdo kërkesë procedurale që rezultojnë e nevojshme gjatë procesit gjyqësor; Përpilimi i akteve të mbrojtjes, për personat kundër të cilëve ka nisur një proces gjyqësor civil apo administrativ;

- Mbledhja dhe përgatitja e dokumentacionit provues;
 - këshillimi mbi procesin gjyqësor civil ose administrativ;
 - Përfaqësimi dhe mbrojtja para gjykatës në çështjet administrative dhe civile;
 - Përgatitja e kërkesave ankimore, rekurseve kundër vendimeve gjyqësore, apo arbitrazhit;
 - Përgatitjen e çdo lloj kërkesë drejtuar çdo gjykate në Republikën e Shqipërisë, përfshirë Gjykatën Kushtetuese, si dhe gjykatat ndërkombëtare dhe çdo organizëm në të cilat aderon Republika e Shqipërisë, lidhur me çështjen për të cilën ofron Ndihmë Juridike Dytësore, në favor të Përfituesit;
 - Përveç sa parashikohet më sipër, Ofruesi i Shërbimit do të kryejë çdo dhe të gjitha veprimet në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në Ligjin për Avokatinë, në kuptim të Ndihmës Juridike Dytësore, në Ligjin nr.111/2017 si dhe në këtë Kontratë.
- 5.2. Ofruesi i Shërbimit deklaron dhe garanton se:
- I. Gëzon të gjitha cilësitë profesionale dhe kualifikimet e nevojshme, për të marrë përsipër detyrimet sipas kësaj Kontratë;
 - II. Do të ofrojë Shërbimet e Ndihmës Juridike Dytësore, me standartet me të larta profesionale, si dhe në përputhje me parimet e përcaktuara në nenin 3 të kësaj Kontrate;
 - III. Do të veprojë në kohë dhe pa shkakuar asnjë vonesë në ofrimin e Ndihmës Juridike Dytësore, menjëherë me marrjen e njoftimit nga dhoma vendore e avokatisë, mbi vendimin e gjykatës e cila ka pranuar kërkesën për dhënien e Ndihmës Juridike Dytësore ndaj Përfituesit.
 - IV. Nuk do të heqë dorë nga dhënia e Ndihmës Juridike Dytësore, përveç kur janë rastet e heqjes dorë të përcaktuara nga Ligji për Avokatinë, përfshirë por pa u kufizuar në rastin e konfliktit të interesit.
 - V. Në çdo rast të detyrimit për të hequr dorë, Ofruesi i Shërbimit do të informojë menjëherë dhomën vendore të avokatasë, me qëllim zëvendësimin e tij. Në këtë rast, Ofruesi i Shërbimit, do të vazhdojë të ofrojë Ndihmën Juridike Dytësore, deri në zëvendësimin e tij, sipas parashikimeve të Ligjit për Avokatinë si dhe do të zbatojë çdo dhe të gjitha detyrimet e parashikuara në Ligjin për Avokatinë;
 - VI. Do të ofrojë Ndihmën Juridike Dytësore në favor

të Përfituesit, vetëm kundrejt Tarifës së Shërbimit, pa pasur të drejtën e përfitimeve të tjera përveç Tarifës së Shërbimit;

VII. Do të sigurojë përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj Kontrate duke mbajtur të padëmtuar Kontraktorin nga çdo veprim i kundërt i tij. Do të mbajë kontakte të rregullta dhe të vazhdueshme me Përfituesin, me qëllim informimin e tij të vazhdueshëm mbi çështjen për të cilën ofron Ndihmën Juridike Dytësore;

VIII. Do të paraqesë një raport në përfundim të punës, sipas formatit të miratuar nga Ministria e Drejtësisë.

5.3. Kontraktori deklaron dhe garanton se:

I. Do t'i paguajë Ofruesit të Shërbimit Tarifën e Shërbimit, pa vonesa, në përputhje me këtë Kontratë.

II. Të kryejë çdo dhe të gjitha veprimet dhe të zbatojë çdo detyrim sipas Ligjit 111/2017, për të mundësuar dhënien e Ndihmës Juridike Dytësore në favor të Përfituesit.

NENI 6

KLAUZOLA ANTI-KORRUPSION

6.1. Në lidhje me këtë Kontratë, përveç Tarifës së Shërbimit të parashikuar në Nenin 4 me sipër, Ofruesi i Shërbimit nuk do të përfitojë, kërkojë apo pranojë, nga Përfituesi apo palë të tjera të përfshira në konflikt me të, asnjë pagesë, premtim për pagesë, përfitim, dhuratë apo shpërblim, drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë.

6.2. Përveç sa me sipër, Ofruesi i Shërbimit nuk do të ofrojë, apo të premtojë, vetë apo nëpërmjet personave të trete, në favor të Palëve apo subjekteve të përfshira në procesin gjyqësor, ku Ofruesi i Shërbimit jep Ndihmë Juridike Dytësore, asnjë pagesë, përfitim, dhuratë apo shpërblim.

6.3. Çdo shkelje e parashikimeve sipas paragrafëve 6.1. dhe 6.2. më sipër, do të përbëjë vepër penale në kuptim të legjislacionit penal në fuqi dhe Ofruesi i Shërbimit, do të jetë subjekt procedimi sipas legjislacionit procedural penal dhe subjekt i procedimit etik, sipas legjislacionit për profesionin e avokatit.

NENI 7

KONTRAKTUESI I PAVARUAR

7.1. Palët e kësaj Kontrate bien dakord që Ofruesi i Shërbimit është kontraktues i pavaruar në raport me Kontraktorin dhe për asnjë arsye ose shkak nuk do të konsiderohet si punëmarrës i tij.

NENI 8**PARIMI I MIRËBESIMIT DHE KONFIDENCIALITETIT**

8.1. Palët nuk do të dëmtojnë interesat e njëra-tjetrës, reputacionin dhe imazhin. Ato do të veprojnë në mirëbesim ndaj njëra tjetrës dhe do të respektojnë të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara nga kjo Kontratë, ligji dhe konventat ndërkombëtare.

8.2. Palët do të veprojnë në mirëbesim, duke kryer çdo dhe të gjitha veprimet e nevojshme, për mbrojtjen e Interesave të ligjshëm të secilës Palë.

8.3. Palët janë të detyruar të mbajnë rreptësisht konfidenciale këtë Kontratë, përmbajtjen e saj, të dhënat personale respektive si dhe çdo të dhënë tjetër pa asnjë kufizim.

8.4. Asnjë prej Palëve nuk do të konsiderohet se është në shkelje të këtij detyrimi nëse përhapja apo transferimi i informacioneve e të dhënave të mësipërme buron nga një detyrim ligjor duke përfshirë por pa u kufizuar në përmbushjen e detyrimeve të vendosura nga Ligji nr.9887 datë 10.03.18 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, legjislacioni tatumor në fuqi në Republikën e Shqipërisë apo nga vendimet dhe urdhrat e Prokurorisë apo Gjykatave.

NENI 9**PËRFUNDIMI I KONTRATËS**

9.1. Kjo Kontratë përfundon rregullisht në datën e përcaktuar në Nenin 2 më sipër.

9.2. Kontraktori mund të zgjidhë menjëherë këtë Kontratë, në rast se Ofruesi i Shërbimit shkel ndonjë prej detyrimeve të parashikuara në këtë Kontratë, apo në Ligjin 111/2017.

9.3. Ofruesi i Shërbimit mund të zgjidhë këtë Kontratë, duke njoftuar paraprakisht dhomën vendore të avokatisë. Në këtë rast, Ofruesi i Shërbimit, do të vazhdojë të ofrojë Ndihmë Juridike Dytësore ndaj Përfituesit deri në zëvendësimin e tij nga dhoma vendore e avokatisë.

NENI 10**TË NDRYSHME**

10.1. Kjo Kontratë përbën të gjithë marrëveshjen dhe mirëkuptimin mes Palëve dhe shfuqizon çdo marrëveshje tjetër të mëparshme ndërmjet Palëve në lidhje me objektin e saj.

10.2. Asnjë ndryshim, modifikim, përfundim, heqje dorë nga çdo pikë e kësaj Kontratë nuk do të ketë efekt nëse

nuk është me shkrim dhe e nënshkruar nga të dy Palët.

10.3. Mos ushtrimi apo vonesa në ushtrimin e një të drejte ose dëmshpërblimi të përcaktuar në këtë Marrëveshje ose në ligj nuk përbën heqje dorë nga e drejta ose dëmshpërblimi, apo heqje dorë nga te drejta ose dëmshpërblime të tjera. Asnjë ushtrim pjesor apo i plotë i së drejtës ose dëmshpërblimit të parashikuar në këtë Kontratë, nuk ndalon ushtrimin e mëtejshëm të së drejtave ose dëmshpërblimeve të tjera.

10.4. Kjo Kontratë do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me Legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

10.5. Palët do të përpiqen t'i zgjidhin me mirëkuptim të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë zbatimit të kontratës. Nëse kjo nuk është e mundur, juridiksioni kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve burojnë nga ekzekutimi i kësaj Kontratë është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

PALËT

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

OFRUESI I SHËRBIMIT Përfaqësuar nga:

SHTOJCA 9

URDHËR NR.225 DATË 25.03.2019

“PËR MIRATIMIN E FORMULARËVE TË NDIHMËS JURIDIKE TË GARANTUAR NGA SHETI”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 7 të Ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “d”, të nenit 7, nenit 17 dhe 19 të Ligjit nr.111, datë 14.12.2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”,

URDHËROJ:

I. Miratimin e formularëve të ndihmës juridike të garantuar nga shteti (sipas shtojcave), bashkëlidhur këtij urdhri dhe që janë pjesë përbërëse e tij:

Shtojca I: Formulari i kërkesës dhe i vetëdeklarimit për ndihmë juridike parësore;

Shtojca II: Formulari i kërkesës për ndihmë juridike dytësore;

Shtojca III: Formulari i kërkesës për përjashtimin nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe i shpenzimeve gjyqësore;

Shtojca IV: Formulari i vetëdeklarimit për të ardhurat dhe pasuritë;

Shtojca V: Formulari i vetëdeklarimit për kategoritë e veçanta;

Shtojca VI: Format i regjistrimit për regjistrimin e kërkesave dhe vetëdeklarimeve sipas formularëve;

Shtojca VII: Format i regjistrimit të organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore;

Shtojca VIII: Formulari i ankimit ndaj vendimit të rrëzimit të kërkesës për ndihmë juridike dytësore.

2. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ngarkohet Sektori i Arkivës protokollit për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



FORMULAR APLIKIMI PËR PËRFITIMIN E NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE

Rrezervuar për institucionin/organizatën ku paraqitet kërkesa

Qendra pranë:

Referenca:

Numër protokoli:

Qyteti:

RUBRIKA 1: TË DHËNAT E APLIKANTIT:

- a) Emër-Atësi-Mbiemër:
- b) Datëlindja:Vendlindja:
- c) Gjendja civile (i/e martuar-i/e beqar/divorcuar):.....
- d) Shtetësia:
- e) Qëndrimi në Shqipëri (lejeqëndrimi- i përkohshëm):
- ① Nëse nuk ka shtetësi shqiptare.....
- f) Vendbanimi (Adresa):
- (Kodi postar/Qyteti/Shteti):.....
- g) Adresa për korrespondencë: (nëse është e ndryshme nga më sipër).....
- h) Kontaktet:
- Telefon:
- Email:

RUBRIKA 2: PSE PO APLIKOJ PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS?

2.1. Në bazë të shkronjës b) pika i, neni 3 i ligjit 111/2017 kërkoj “thjesht një informim”.

2.2. LLoji i çështjes për të cilën kërkoni Ndhmë Juridike Parësore:

Civile ☐ Penale ☐ Administrative ☐

Ju lutem jepni disa të dhëna lidhur me çështjen për të cilën kërkoni shërbime ligjore, për shembull:

- për të Drejtën Familjare: kërkoj të keshillohem për zgjidhje martesë, arritjen e një marrëveshje për kujdestarinë e fëmijës, etj.

2.3. Ju lutem jepni të dhëna rreth çështjes për të cilën kërkoni Ndhmë Juridike Parësore

Fokusohuni veçanërisht:

- Për çfarë ju duhet ndihma juridike?

- Çfarë ka ndodhur?
- Rrethana plotësuese me rëndësi për çështjen?

.....

.....

.....

.....

.....

 - Nëse hapësira e mësipërme nuk mjafton, ju lutem vijoni në faqen në fund të këtij formulari.

2.4. A keni paraqitur ndonjë kërkesë pranë ndonjë institucioni shtetëror lidhur me çështjen?

☐ Po

☐ Jo

Nëse PO, specifikoni më poshtë:

.....

.....

.....

2.5. A i jeni drejtuar më parë ndonjë organizatë jofitimprurëse që ofron shërbime të ndihmës juridike falas, lidhur me çështjen?

☐ Po

☐ Jo

RUBRIKA 3: CILËSIA E PËRFITUESIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE

3.1. A bëni pjesë në një prej kategorive të veçanta të përfituesve të ndihmës juridike?

☐ Po

☐ Jo

Nëse po, citoni kategorinë:

 (plotëso dhe bashkëlidh Formularin e Vetëdeklarimit për Kategoritë e Veçanta).

3.2. A bëni pjesë të përfituesit për shkak të të ardhurave dhe pasurive të pamjaftueshme?

☐ Po

☐ Jo

Nëse po, deklaroni të ardhurat dhe pasuritë tuaja:

 (plotëso dhe bashkëlidh Formularin e Vetëdeklarimit të të Ardhurave dhe Pasurive).

3.3.1 Për aplikantin që jeton vetëm:

- Të ardhurat e mia janë nën vlerën e pagës minimale mujore të përcaktuar me ligj.
- Pasuritë e mia janë nën vlerën e 36 pagave minimale mujore të përcaktuar me ligj.

3.3.2 Për aplikantin që jeton në një familje:

- Të ardhurat e familjes janë më të ulëta se 50% e pagës minimal emujore të përcaktuar me ligj.
- Pasuritë e familjes janë nën vlerën e 36 pagave minimale mujore të përcaktuar me ligj.

Përgjashtimisht, lidhur me subjektet e përcaktuara në shkronjën ç) pika 1 neni 10 për çdo aplikim do të kërkohej bashkëpunimi me autoritetin përgjegjës për azilin dhe refugjatët për të përcjellë dokumentacionin e nevojshëm për përfitimin e ndihmës juridike falas.

RUBRIKA 4: DEKLARIME

① *Ju lutem lexoni me vëmendje përpara se të nënshkruani!*

1. Deklaroj se i gjithë informacioni që kam vënë në dispozicion, përmes këtij aplikimi, është i vërtetë dhe i saktë. Jam i informuar se përbën shkelje në kuptim të legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë:
 - a. Dhënia e një informacioni/deklarimi të pasaktë/ të pavërtetë;
 - b. Dhënia e dokumentave false;
2. Deklaroj dhe pranoj se, nëse vërtetohet pasaktësia / falsiteti i një informacioni dhe/ose një dokumenti, ndaj meje mund të ndërmerren masat e nevojshme të përgjegjësisë për çdo kosto të shkaktuar si rezultat i përfitimit pa të drejtë të ndihmës juridike për shkak të pasaktësisë/pavërtetësisë apo falsitetit të provuar.
3. Deklaroj dhe pranoj se të gjitha të dhënat e vëna në dispozicion nga unë, mund të verifikohen për efekt të saktësisë, vërtetësisë dhe efektshmërisë së tyre lidhur me aplikimin tim dhe se ky deklaram mund të shërbejë si autorizim për qendrën/klinikën për të ndërmarrë çdo veprim me qëllim verifikimin e të dhënave të këtij formulari.
4. Deklaroj dhe pranoj se në vijim do të informoj mbi çdo informacion shtesë që do të ndryshojë statusin tim si përfitues i ndihmës juridike falas.

RUBRIKA 5: DOKUMENTACIONI SHOQËRUES

Ky aplikim shoqërohet nga dokumentat si më poshtë:

A. Dokumenta Identifikimi të Aplikantit;

.....;

.....;

.....;

.....;

B. Formulari i Vetëdeklarimit për Kategoritë e Veçanta (shoqëruar me dokumentat bashkëlidhur); dhe/ose Formulari i Vetëdeklarimit të të Ardhurave dhe Pasurive (shoqëruar me dokumentat bashkëlidhur);

C. Dokumenta të tjera:

çertifikatë familjare;

vërtetim papaunësie;

vërtetim që trajtohet me ndihmë ekonomike;

vërtetim që trajtohet me KEMP;

vërtetimmbipasuritë e paluajtshmeqëdisponon;

vërtetim page bruto dhe neto;

vërtetim nga sigurimet shoqërore në rast të pagesës që kryhet prej këtyre institucioneve (sikurse mund të jetë pensioni i pleqërisë);

Nënshkrimi i Aplikantit

Nënshkrimi i punonjësit të klinikës/qendrës:

Z/Znj. _____

Z/Znj. _____

(emër-mbiemër-nënshkrim)

emër-mbiemër-nënshkrim)

Në _____

Datë: ____ . ____ . 20 ____

(qyteti)

Informacioni si më sipër, do të trajtohet në përputhje me Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe çdo disponim i këtyre të dhënave do të kryhet në përputhje me Ligjin 1191201 “Për të Drejtën e Informimit”.



FORMULAR APLIKIMI PËR PËRFITIMIN E NDIHMËS JURIDIKE DYTËSORE

Rrezervuar për institucionin/organizatën ku paraqitet kërkesa

Gjykata:

Referenca:

Numër protokoli:

Qyteti:

RUBRIKA 1: TË DHËNAT E APLIKANTIT:

- a) **Emër-Atësi-Mbiemër:**
- b) **Datëlindja:** **Vendlindja:**
- c) **Gjendja civile** (i/e martuar-i/e beqar divorcuar):
- d) **Shtetësia:**
- e) **Qëndrimi në Shqipëri** (lejeqëndrimi- i përkohshëm):
- ① Nëse nuk ka shtetësi shqiptare:
- f) **Vendbanimi (Adresa):**
- (Kodi postar/Qyteti/Shteti):
- g) **Adresa për korrespondencë:** (nëse është e ndryshme nga më sipër)
- h) **Kontaktet:**
- **Telefon:**
- **Email:**

TË DHËNAT E PËRFAQËSUESIT TË APLIKANTIT (nëse aplikimi nuk kryhet personalisht):

a) Emër -Atësi - Mbiemër:

b) Adresa për korrespondencë: (nëse është e ndryshme nga më sipër)

c) Kontaktet:

Telefon:

Email:

RUBRIKA 2: CILËSIA E PËRFITUESIT TË NOIHMËS JURIDIKE DYTËSORE?

2.1. A bëni pjesë në një prej kategorive të vecanta të pëfituesve të ndihmës juridike?

☐ Po

☐ Jo

Nëse po, citoni kategorinë:

(Plotëso dhe bashkëlidh Formularin e Vetëdeklarimit për Kategoritë e Veçanta).

2.2. A bëni pjesë te përfituesit për shkak të të ardhurave dhe pasurive të pamjaftueshme?

☐ Po

☐ Jo

Nëse po, deklaroni të ardhurat dhe pasuritë tuaja:

(Plotëso dhe bashkëlidh Formularin e Vetëdeklarimit të të Ardhurave dhe Pasurive.

2.2.1 Për aplikantin që jeton vetëm:

- Të ardhurat e mia janë nën vlerën e pagës minimale mujore të përcaktuar me ligj.
- Pasuritë e mia janë nën vlerën e 36 pagave minimale mujore të përcaktuar me ligj.

2.2.2 Për aplikantin që jeton në një familje:

- Të ardhurat e familjes në total të pjesetuara për numrin e anëtareve të familjes janë më të ulëta se 50% e pag. minimale mujore të përcaktuar me ligj.
- Pasuritë e familjes janë nën vlerën e 36 pagave minimale mujore të përcaktuar me ligj.

Përgjashtimisht, lidhur me subjektet e përcaktuara në shkronjën c) pika I neni 10 i Ligjit 111/2017, për çdo aplikim do të kërkohet, bashkëpunimi me autoritetin përgjegjës për azilin dhe refugjatet për të përcjell dokumentacionin e nevojshëm për përfitimin e ndihmës, juridike falas.

RUBRIKA 3: PSE PO APLIKOJ PËR NDIHMË JURIDIKE DYTËSORE?

Kjo kërkesë për ndihmë juridike, paraqitet:

1.1. PARA FILLIMIT TE PROCESIT GJYQESOR ☐

1.1.1. Në këtë fazë, ndihma Juridike Dytësore, ju duhet për: ☐

1. Këshillim lidhur me zgjidhjen gjyqësive të problemit?

2. Përgatitjen dhe paraqitjen e një kërkesë, kërkesë padie, deklaratës së mbrojtjes ndaj paditësit? ☐

1.1.2. Lloji i çështjes për të cilën kërkoni Ndihmë Juridike Parësore:

Civile

☐

Penale

☐

Administrative

☐

1.1.3. Ju lutem jepni të dhëna rreth çështjes për të cilën kërkoni shërbime ligjore:

Fokusohuni veçanërisht:

- Çfare ka ndodhur?
- Cilat janë palët/personat e përfshirë në konflikt me ju?
- Rrethana plotësuese me rëndësi për çështjen?

 - Nëse hapësira e mësipërme nuk mjafton, ju lutem vijoni në faqen në fund të këtij formulari.

3.2 SË BASHKU ME KËRKESË PADINË ☐

3.2.1. Në këtë fazë, Ndihma Juridike Dytësore, ju duhet për:

1. Këshillim lidhur me zgjidhjen gjyqësisht të problemit? ☐

2. Përgatitjen e akteve të mbrojtjes dhe dokumentacionit provues për gjykatën? ☐

3. Përfaqësimin gjatë shqyrtimit gjyqësor? ☐

3.2.2 Lloji i çështjes për të cilën kërkoni Ndhimë Juridike Parësore:

Civile ☐

Penale ☐

Administrative ☐

Familjare ☐

3.2.3 A keni angazhuar një avokat për ofrimin e shërbimeve ligjore lidhur me çështjen?

☐ Po

☐ Jo

3.2.4 Ju lutem jepni të dhëna rreth bazueshmërisë së kërkesës suaj:

 - Nëse hapësira e mësipërme nuk mjafton, ju lutem vijoni në faqen në fund të këtij formulari.

3.3. GJATË SHQYRTIMIT GJYQËSOR (përpara përfundimit të hetimit gjyqësor) ☐

3.3.1 Lloji i çështjes për të cilën kërkon Ndhmë Juridike Parësore:

Civile ☐ Penale ☐ Administrative ☐ Familjare ☐

3.3.2 Në këtë proces, ju jeni në cilësinë e:

- Paditësit ☐
- Të paditurit ☐
- Person i tretë ☐
- Nuk e di ☐

3.3.3. Në këtë fazë, Ndhma Juridike Dytësore, ju duhet për:

1. Këshillim lidhur me vijimin e shqyrtimit gjyqësor?
2. Përgatitjen e akteve të mbrojtjes dhe dokumentacionit provues për gjykatën?
3. Përfaqësimin gjatë shqyrtimit gjyqësor?

3.3.4 A keni angazhuar një avokat për ofrimin e shërbimeve ligjore lidhur me çështjen?

3.3.5 Ju lutem jepni të dhëna rreth bazueshmërisë së kërkesës suaj:

.....

.....

.....

.....

.....

 - Nëse hapësira e mësipërme nuk mjafton, ju lutem vijoni në faqen në fund të këtij formulari.

RUBRIKA 4: DEKLARIME

① *Ju lutem lexoni me vëmendje përpara se të nënshkruani!*

1. Deklaroj se i gjithë informacioni që kam vënë në dispozicion, përmes këtij aplikimi, është i vërtetë dhe i saktë. Jam informuar se përbën shkelje në kuptim të nenit 32 të Ligjit nr.111/2017 dhe të legjislationit penal të Republikës së Shqipërisë:
 - a. Dhënia e një informacioni/deklarimi të pasaktë/ të pavërtetë;
 - b. Dhënia e dokumentave false.
2. Deklaroj dhe pranoj se, nëse vërtetohet pasaktësia / falsiteti i një informacioni dhe/ose një dokumenti, ndaj meje mund të ndërmerren masat e nevojshme të përgjegjësisë për çdo kosto të shkaktuar si rezultat i përfitimit pa të drejtë të ndihmës juridike për shkak të pasaktësisë/pavërtetësisë apo falsitetit të provuar. Konkretisht, përmes këtij deklarimi, pranoj se në rast pasaktësie dhe/ose falsiteti të një informacioni ose dokumenti, do jem i detyruar të rimbursoj shpenzimet për avokatin që ka ofruar ndihmën juridike si dhe çdo shpenzim apo kosto tjetër që do të rezultojë nga përfitimi pa të drejtë i ndihmës juridike falas.

3. Deklaroj dhe pranoj se të gjitha të dhënat e vëna në dispozicion nga unë, mund të verifikohen për efekt të saktësisë, vërtetësisë dhe efektshmërisë së tyre lidhur me aplikimin tim dhe se ky deklaram mund të shërbejë si autorizim për qendrën/klinikën për të ndërmarrë çdo veprim me qëllim verifikimin e të dhënave të këtij formulari.
4. Deklaroj dhe pranoj se në vijim do të informoj mbi çdo informacion shtesë që do të ndryshojë statusin tim si përfitues i ndihmës juridike falas.

RUBRIKA 5: Lista e dokumentave

Ky aplikim shoqërohet nga dokumentat si më poshtë:

A. Dokumenta Identifikimi të Aplikantit:

.....;

.....;

.....;

.....;

B. Dokumenti i autorizimit për përfaqësuesin e Aplikantit:

C. Formulari i Vetëdeklarimit për Kategoritë e Veçanta (shoqëruar me dokumentat bashkëlidhur); dhe/ose Formulari i Vetëdeklarimit të të Ardhurave dhe Pasurive (shoqëruar me dokumentat bashkëlidhur);

D. Dokumenta të tjera:

çertifikatë familjare;

vërtetim papaunësie;

vërtetim që trajtoresh me ndihmë ekonomike;

vërtetim që trajtoresh me KEMP;

vërtetim mbi pasuritë e paluajtshme që disponon;

vërtetim page bruto dhe neto;

vërtetim nga sigurimet shoqërore në rast të pagesës që kryhet prej këtyre institucioneve (sikurse mund të jetë pensioni i pleqërisë).

Nënshkrimi i Aplikantit

Nënshkrimi i punonjësit të klinikës/qendrës:

Z/Znj. _____

Z/Znj. _____

(emër-mbiemër-nënshkrim)

(emër-mbiemër-nënshkrim)

Në _____

Datë: _____. _____. 20 ____

(qyteti)

① Informacioni si më sipër, do të trajtohet në përputhje me Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe çdo disponim i këtyre të dhënave do të kryhet në përputhje me Ligjin 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.



FORMULAR APLIKIMI

PËR PËRJASHTIMIN NGA PAGIMI I TARIFAVE DHE SHPENZIMEVE GJYQËSORE

Rezervuar për institucionin/organizatën ku paraqitet kërkesa

Gjykata :
Referenca:
Numër protokollit:
Qyteti:

RUBRIKA 1: TË DHËNAT E APLIKANTIT:

- a) Emër-Atësi-Mbiemër:.....
b) Datëlindja: Vendlindja:
c) Gjendja civile (i/e martuar-i/e ve-beqar-divorcuar):
d) Shtetësia
e) Qëndrimi në Shqipëri (me leje qëndrimi- i përkohshëm):
① Nëse nuk ka shtetësi shqiptare.
f) Vendbanimi(Adresa):
(Kodipostar/Qyteti/Shteti):.....
g) Adresa për korrespondencë: (nëse është e ndryshme nga më sipër).....
– Kontaktet:
– Telefon:
– Email:

TË DHËNAT E PËRFAQËSUESIT TË APLIKANTIT (nëse aplikimi nuk kryhet personalisht):

- a) Emër -Atësi - Mbiemër:
b) Adresa për korrespondencë: (nëse është e ndryshme nga më sipër).....
c) Kontaktet:
– Telefon:
– Email:

A 2: CILËSIA E PËRFITUESIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE

A bëni pjesë në një prej kategorive të veçanta të pëfituesve të ndihmës juridike?

☐ Po

☐ Jo

Nëse po, citoni kategorinë:

📎 (plotëso dhe bashkëlidh Formularin e Vetëdeklarimit për Kategoritë e Veçanta).

2.2. A bëni pjesë të përfituesit për shkak të të ardhurave dhe pasurive të pamjaftueshme?

☐ Po

☐ Jo

2.2.1 Për aplikantin që jeton vetëm:

- Të ardhurat e mia janë nën vlerën e pagës minimale mujore të përcaktuar me ligj.
- Pasuritë e mia janë nën vlerën e 36 pagave minimale mujore të përcaktuar me ligj.

2.2.2 Për aplikantin që jeton në një familje:

- Të ardhurat e familjes janë me të uleta se 50% e pagës minimale mujore të përcaktuar me ligj.
- Pasuritë e familjes janë nën vlerën e 36 pagave minimale mujore të përcaktuar me ligj.

Deklaroni të ardhurat dhe pasuritë tuaja:

 (plotëso dhe bashkëlidh Formularin e Vetëdeklarimit të të Ardhurave dhe Pasurive).

RUBRIKA 3: PSE PO APLIKOJ PËR PËRFITIMIN E NDIHMËS JURIDIKE SIPAS KËTIJ FORMULARI ?

3.1. Kjo kërkesë për ndihmë juridike, paraqitet:

a) së bashku me kërkesën për ndihmë juridike dytësore

☐

b) së bashku me kërkesë padinë

☐

c) gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes (para përfundimit të hetimit gjyqësor)

☐

3.2. Më anë të kësaj kërkesë kërkohet:

a) përjashtimi nga të gjitha tarifat dhe shpenzimet gjyqësore

☐

b) përjashtimin nga një ose disa prej tarifave dhe/ose shpenzimeve gjyqësore

☐

(cilësoni me poshtë tarifën/at dhe/ose shpenzimin/shpenzimet për të cilat kërkon përjashtimin nga detyrimi për të paguar)

- Përjashtimin nga tarifa gjyqësore e përgjithshme

☐

- Përjashtimin nga tarifa gjyqësore e veçantë

☐

- Përjashtimin nga tarifa gjyqësore shtesë

☐

- Përjashtimin nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore lidhur me:

• Shpenzimet për dëshimtare

☐

• Shpenzimet për përmbaues

☐

• Shpenzimet për ekspertë

☐

• Shpenzimet për përkthyes

☐

• Shpenzimet për këqyrjen e sendeve/këqyrjen në vend

☐

- Përjashtimin nga parapagimi i tarifës së vënies në ekzekutim të urdhrit të ekzekutimit

☐

RUBRIKA 4: DEKLARIME

① *Ju lutem lexoni me vëmendje përpara se të nënshkruani!*

5. Deklaroj se i gjithë informacioni që kam vënë në dispozicion, përmes këtij aplikimi, është i vërtetë dhe i saktë. Jam i informuar se përbën shkelje në kuptim të nenit 32 të Ligjit nr.111/2017 dhe të legjislacionit penal të Republikës së Shqipërisë:
 - Dhënia e një informacioni/deklarimi të pasaktë/ të pavërtetë;
 - Dhënia e dokumentave false.
6. Deklaroj dhe pranoj se, nëse vërtetohet pasaktësia / falsiteti i një informacioni dhe/ose një dokumenti, ndaj meje mund të ndërmerren masat e nevojshme të përgjegjësisë për çdo kosto të shkaktuar si rezultat i përfitimit pa të drejtë të ndihmës juridike për shkak të pasaktësisë/pavërtetësisë apo falsitetit të provuar. Konkretisht, përmes këtij deklarimi, pranoj se në rast pasaktësie dhe/ose falsiteti të një informacioni ose dokumenti, do jem i detyruar të rimburoj shpenzimet për avokatin që ka ofruar ndihmën juridike si dhe cdo shpenzim apo kosto tjetër që do të rezultojë nga përfitimi pa të drejtë i ndihmës juridike falas.
7. Deklaroj dhe pranoj se të gjitha të dhënat e vëna në dispozicion nga unë, mund të verifikohen për efekt të saktësisë, vërtetësisë dhe efektshmërisë së tyre lidhur me aplikimin tim dhe se ky deklarim mund të shërbejë si autorizim për qendrën/klinikën për të ndërmarrë çdo veprim me qëllim verifikimin e të dhënave të këtij formulari.
8. Deklaroj dhe pranoj se në vijim do të informoj mbi çdo informacion shtesë që do të ndryshojë statusin tim si përfitues i ndihmës juridike falas.

RUBRIKA 5: DOKUMENTACIONI SHOQËRUES

Ky aplikim shoqërohet nga dokumentat si më poshtë:

A. Dokumenta Identifikimi të Aplikantit;

.....;

.....;

.....;

.....;

B. Dokumenti i autorizimit për përfaqësuesin e Aplikantit;

C. Formulari i Vetëdeklarimit për Kategoritë e Veçanta (shoqëruar me dokumentat bashkëlidhur); dhe/ose Formulari i Vetëdeklarimit të të Ardhurave dhe Pasurive (shoqëruar me dokumentat bashkëlidhur);

D. Dokumenta të tjera:

.....;

.....;

.....;

.....;

Nënshkrimi i Aplikantit

Nënshkrimi i punonjësit të klinikës/qendrës:

Z/Znj. _____

Z/Znj. _____

(emër-mbiemër-nënshkrim)

(emër-mbiemër-nënshkrim)

Në _____ Datë: _____._____. 20

(qyteti)

① Informacioni si më sipër, do të trajtohet në përputhje me Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe çdo disponim i këtyre të dhënave do të kryhet në përputhje me Ligjin 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.



FORMULAR VETËDEKLARIMI

PËR TË ARDHURAT DHE PASURITË PËR PËRFITIMIN
E NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE DHE DYTËSORE

RUBRIKA 1: TË DHËNAT E APLIKANTIT:

- a) Emër -Atësi - Mbiemër:.....
- b) Datëlindja:Vendlindja:
- c) Gjendja civile (i/e martuar-i/e ve-beqar-divorcuar):
- d) Shtetësia
- e) Qëndrimi në Shqipëri (leje qëndrimi- i përkohshëm):.....
① Nëse nuk ka shtetësi shqiptare.
- f) Vendbanimi (Adresa) :
(Kodipostar/Qyteti/Shteti):
- g) Adresa për korrespondencë: (nëse është e ndryshme nga me sipër):.....
- h) Kontaktet:
- Telefon:
- Email:

RUBRIKA 2: VETËDEKLARIMI I TË ARDHURAVE DHE PASURIVE

2.1. Vetëdeklarim i Aplikantit që jeton vetëm:

2.1.1 Të ardhurat e Aplikantit:

- a. Të ardhura nga paga ☐ / pensioni ☐ në shumën Lekë/muaj.
- b. Të ardhura nga qiraja e pasurisë së paluajtshme në shumënLekë/muaj;
- c. Të ardhura nga interesa huaje / interesa të depozitave bankare në shumënLekë/muaj.
- d. Të tjera (specifiko burimet dhe shumat e përfituara):
-
-

TË ARDHURAT TOTALE TË APLIKANTIT JANË NË VLERËN LEKË/MUAJ

2.1.2 Pasuritë e Aplikantit

Pasuri të luajtshme

(Psh. makina; kuota/aksione në shoqëri tregtare; depozita bankare; etj.)

	Pasuria	Vlera e pasurisë
1		
2		
3		
4		
5		
6		
7		

Pasuri të paluajtshme

(Përveç banesës ku jeton aplikanti)

	Pasuria	Vlera e pasurisë
1		
2		
3		
4		
5		
6		
7		

e. PASURITË E APLIKANTIT JANË NË VLERËNLEKË.

2.1.3 Shpenzime / kosto / detyrime të aplikantit

- f. Kosto banimi (qira) në shumënLekë/muaj;
- g. Detyrim ushqimor në shumënLekë/muaj;
- h. Pagesë e kredisë bankare në shumënLekë/muaj;
- i. Të tjera (specifiko):
-
-
-

 - Nëse hapësira e mësipërme nuk mjafton, ju lutem vijoni në faqen në fund të këtij formulari.
2.2 Vetdeklarim i aplikantit që jeton me familjen

(të ardhurat; pasuritë dhe shpenzimet më poshtë do të konsiderohen të përbashkëta të aplikantit dhe familjes).

2.2.1 Të ardhurat Familjes:Familja përbëhet nga ☐ persona, që përfitojnë të ardhura si më poshtë:

j. Të ardhura nga paga / pensione:

1., në cilësinë e, i cili është ☐ i punësuar / në pension me të ardhura në shumën.....Lekë
☐ i papunë
2., në cilësinë e, i cili është ☐ i punësuar / në pension me të ardhura në shumën.....Lekë
☐ i papunë.
3., në cilësinë e, i cili është ☐ i punësuar / në pension me të ardhura në shumën.....Lekë
☐ i papunë.
4., në cilësinë e, i cili është ☐ i punësuar / në pension me të ardhura në shumën.....Lekë
☐ i papunë.
5., në cilësinë e, i cili është ☐ i punësuar / në pension me të ardhura në shumën.....Lekë
☐ i papunë.

- k. Të ardhura nga qiraja e pasurisë së paluajtshme në shumënLekë/muaj;
- l. Të ardhura nga interesa huaje / interesa të depozitave bankare në shumënLekë/muaj.
- m. Të tjera (specifiko burimet dhe shumat e përfituara):
-
-
-
-

 - Nëse hapësira e mësipërme nuk mjafton, ju lutem vijoni në faqen në fund të këtij formulari.

- **TË ARDHURAT TOTALE TË FAMILJES JANË NË VLERËN LEKË/MUAJ**

2.2.2 Pasuritë e Familjes

Pasuri të luajtshme

(Psh. makina; kuota/aksione në shoqëri tregtare; depozita bankare etj.)

	Pasuria	Vlera e pasurisë
1		
2		
3		
4		
5		
6		
7		

Pasuri të paluajtshme

(Përveç banesës ku jeton familja)

	Pasuria	Vlera e pasurisë
1		
2		
3		
4		
5		
6		
7		

n. **PASURITË E FAMILJES JANË NË VLERËNLEKË.**

2.1.3 Shpenzime / kosto / detyrime të familjes

- o. Kosto banimi (qira) në shumënLekë/muaj;
- p. Detyrim ushqimor në shumënLekë/muaj;
- q. Pagesë e kredisë bankare në shumënLekë/muaj;
- r. Të tjera (specifiko):
-
-
-

 - Nëse hapësira e mësipërme nuk mjafton, ju lutem vijoni në faqen në fund të këtij formulari.

DETYRIMET TOTALE TË FAMILJES JANË NË VLERËN.....LEKË/MUAJ.

RUBRIKA 3: DEKLARIME

① Ju lutem lexoni me vëmendje përpara së të nënshkruani!

9. Deklaroj se i gjithë informacioni që kam vënë në dispozicion, përmes këtij aplikimi, është i vërtetë dhe i saktë. Jam i informuar se përbën shkelje në kuptim të nenit 32 të Ligjit nr.111/2017 dhe të legjislacionit penal të Republikës së Shqipërisë:
 - s. Dhënia e një informacioni/deklarimi të pasaktë/ të pavërtetë;
 - t. Dhënia e dokumentave false.
10. Deklaroj dhe pranoj se, nëse vërtetohet pasaktësia / falsiteti i një informacioni dhe/ose një dokumenti, ndaj meje mund të ndërmerren masat e nevojshme të përgjegjësisë për çdo kosto të shkaktuar si rezultat i përfitimit pa të drejtë të ndihmës juridike për shkak të pasaktësisë/pavërtetësisë apo falsitetit të provuar. Konkretisht, përmes këtij deklarimi, pranoj se në rast pasaktësie dhe/ose falsiteti të një informacioni ose dokumenti, do jem i detyruar të rimburoj shpenzimet për avokatin që ka ofruar ndihmën juridike si dhe çdo shpenzim apo kosto tjetër që do të rezultojë nga përfitimi pa të drejtë i ndihmës juridike falas.
11. Deklaroj dhe pranoj se të gjitha të dhënat e vëna në dispozicion nga unë, mund të verifikohen për efekt të saktësisë, vërtetësisë dhe efektshmërisë së tyre lidhur me aplikimin tim dhe se ky deklarim mund të shërbejë si autorizim për qendrën/klinikën për të ndërmarrë çdo veprim me qëllim verifikimin e të dhënave të këtij formulari.
12. Deklaroj dhe pranoj se në vijim do të informoj mbi çdo informacion shtesë që do të ndryshojë statusin tim si përfitues i ndihmës juridike falas.

RUBRIKA 4: DOKUMENTACIONI SHOQËRUES

Ky aplikim shoqërohet nga dokumentat si më poshtë:

A. Dokumenta Identifikimi të Aplikantit;

.....;

.....;

.....;

.....;

B. Dokumenta që vërtetojnë të ardhurat, pasuritë dhe shpenzimet:

.....;

.....;

.....;

.....;

C. Dokumenta të tjera:

.....;
.....;
.....;
.....

Nënshkrimi i Aplikantit

Z/Znj. _____

(emër-mbiemër-nënshkrim)

Nënshkrimi i punonjësit të klinikës/qendrës:

Z/Znj. _____

(emër-mbiemër-nënshkrim)

Në _____ Datë: __ __. __ __. 20__ __

(qyteti)

① Informacioni si më sipër, do të trajtohet në përputhje me Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe çdo disponim i këtyre të dhënave do të kryhet në përputhje me Ligjin 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.



ANKIM KUNDËR VENDIMIT TË GJYKATËS PËR RRËZIMIN E KËRKESËS PËR NDIHMË JURIDIKE DYTËSORE

Rrezervuar për institucionin/organizatën ku paraqitet kërkesa

Gjykata:
Referenca:
Numër protokolli:
Qyteti:

RUBRIKA 1: TË DHËNAT E ANKUESIT:

- a) Emër-Atësi-Mbiemër:
b) Datëlindja: Vendlindja:
c) Gjendja civile (i/e martuar-i/e beqar divorcuar):
d) Shtetësia:
e) Qëndrimi në Shqipëri (lejqëndrimi- i përkohshëm):
① Nëse nuk ka shtetësi shqiptare.
f) Vendbanimi (Adresa):
(Kodi postar/Qyteti/Shteti):
g) Adresa për korrespondencë: (nëse është e ndryshme nga më sipër)
h) Kontaktet:
– Telefon:
– Email:

TË DHËNAT E PËRFAQËSUESIT TË ANKUESIT (nëse aplikimi nuk kryhet personalisht):

- a) Emër -Atësi - Mbiemër:
b) Adresa për korrespondencë: (nëse është e ndryshme nga më sipër)
.....
c) Kontaktet:
Telefon:
Email:

RUBRIKA 2: VENDIMI KUNDËR TË CILIT DEPOZITOHET ANKIMI

2.1. Të dhënat e vendimit që kundërshtohet

Vendimi Nr.

Datë.....

Gjykata.....

2.2. Lidhur me kërkesën, gjykata ka vendosur (cito nga dispozitivi i vendimit):

.....

☐ Po

☐ Jo

RUBRIKA 3: SHKAQET LIGJORE TË ANKIMIT KUNDËR VENDIMIT PËR RRËZIMIN E KËRKESËS PËR NDIHMËN JURIDIKE DYTËSORE

3.1. Plotësohen kushtet e përfitimit të Ndhmës Juridike Dytësore (Sipas neneve 10, II dhe 12 të Ligjit 111/2017)

Konkretisht: Ankuesi ka kërkuar të përfitojë Ndhmë Juridike Dytësore në cilësinë e:

- Personit që bën pjesë në një prej kategorive të vecanta të përfituesve të ndihmës juridike

Nëse po, citoni kategorinë:

Dhe/ose

- personit me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme

☐ Po

☐ Jo

3.1.2 **Vendimi i rrezimit të kërkesës është i pambështetur në prova dhe në ligj, për sa më poshtë:**

(Duhet kundërshtuar shkaqet e rrezimit të kërkesës, referuar arsytimit të vendimit nga gjykata)

Arsyeja e këtij Ankimi, mbështetet në faktin se Gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesës për shkakun se Ankuesi është gjendur:

- a) me të ardhura të mjaftueshme (fikso rastin) dhe/ose;
- b) me pasuri të mjaftueshme (fikso rastin).

Unë ankuesi pretendoj se:

Gjykata ka përlogaritur në mënyrë të gabuar të ardhurat e mija (qarko situatën):

- a) si person që jetoj në një familje.
- b) si person që nuk jetoj në një familje

Nëse hapësira e mësipërme nuk mjafton, ju lutem vijoni në faqen në fund të këtij formulari

1.1.4. Nëpërmjet ankimit kërkoj nga Gjykata e Apelit të vendosë:

- Ndryshimin e Vendimit Nr.Datë....., të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor duke vendosur pranimin e kërkesës për dhënien e ndihmës Juridike Dytësore;

Nënshkrimi i Ankuesit

Z/Znj.

(emër-mbiemër-nënshkrim)

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE VETËDEKLARIMEVE PËR NDIHMË JURIDIKE PARËSORE

NR.	Emri Atësia Mbiemri	Gjinia	Datëlindja	Shtetësia	Gjendja Familjare (Nr i pjestarëve)	Gjendja e punësimit	Adresa dhe të dhënat e kontaktit	Vetdeklarimi në lidhje me të ardhurat dhe pasuritë	Pranuar apo refuzuar kërkesa dhe arsyet	Natyra e çështjes civile penale administrati ve	Të dhënat e ofruesit
01											
02											
03											
04											
05											
06											
07											
08											
09											
10											
11											
12											
13											
14											
15											
16											
17											
18											
19											
20											
21											
22											
23											

REGJISTRI I ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE QË OFROJNË NDIHMË JURIDIKE PARËSORE

NR.	Emërtimi i OJF-së	Nr dhe Data e Vendimit të MD-së për dhënen e autorizimit	Jurisdiksioni/zona gjeografike ku OJF është e autorizuar për të dhënë shërbim	Specifikime të llojit të ndihmës juridike parësore, nëse ka	Të dhëna mbi kontratën e financimit, nëse ka përfutur	Të dhëna për revokimin e autorizimit, sipas rastit
01						
02						
03						
04						
05						
06						
07						
08						
09						
10						
11						
12						
13						
14						
15						
16						
17						
18						
19						
20						
21						
22						
23						



FORMULAR VETËDEKLARIMI PËR KATEGORITË E VEÇANTA TË PËRFITUESVE

RUBRIKA 1: TË DHËNAT E APLIKANTIT:

- a) Emër-Atësi-Mbiemër:.....
- b) Datëlindja: Vendlindja:
- c) Gjendja civile (i/e martuar-i/e ve-beqar-divorcuar):
- d) Shtetësia
- e) Qëndrimi në Shqipëri (me leje qëndrimi- i përkohshëm):
① Nëse nuk ka shtetësi shqiptare.
- f) Vendbanimi(Adresa):
(Kodipostar/Qyteti/Shteti):.....
- g) Adresa për korrespondencë:(nëse është e ndryshme nga më sipër).....
- h) Kontaktet:
- Telefon:
- Email:

RUBRIKA 2: VETËDEKLARIM I KATEGORIVE TË VEÇANTA TË PËRFITUESIT

A bëni pjesë në një prej kategorive të veçanta të përfituesve të ndihmës juridike?

Nëse po, përzgjidhni më poshtë kategorinë ku bëni pjesë.

Kategoritë e veçanta:

- a) Viktimë e dhunës në familje
☐ Po ☐ Jo
- b) Viktimë e abuzimit seksual dhe/ose trafikimit të qenieve njerëzore
☐ Po ☐ Jo
- c) Viktimë e mitur dhe/ose në konflikt me ligjin
☐ Po ☐ Jo
- ç) Fëmijë që jeton në institucionet e përkujdesit shoqëror
☐ Po ☐ Jo
- d) Fëmijë nën kujdestari, që kërkon të nisë një proces pa miratimin e kujdestarit ligjor dhe/ose kundër kujdestarit ligjor
☐ Po ☐ Jo
- dh) Person që përfiton nga pagesa për aftësinë e kufizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, duke përfshirë edhe personat që përfitojnë nga statusi i të verbrit
☐ Po ☐ Jo

- e) Person, nën trajtim të pavullnetshëm në një nga institucionet e shërbimit të shëndetit mendor
☐ Po ☐ Jo
- ë) Person, nën trajtim vullnetar në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor për sëmundjet e rënda mendore
☐ Po ☐ Jo
- f) Person, ndaj të cilit kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar
☐ Po ☐ Jo
- g) Person të cilit i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, që kërkon të nisë një proces kundër kujdestarit ligjor, për rifitim të zotësisë për të vepruar, pa miratimin e kujdestarit ligjor
☐ Po ☐ Jo
- gj) Person i cili përfiton nga skemat e mbrojtjes sociale
☐ Po ☐ Jo
- h) Person të cilit i është cënuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent
☐ Po ☐ Jo

RUBRIKA 3: DEKLARIME

① *Ju lutem lexoni me vëmendje përpara se të nënshkruani!*

13. Deklaroj se i gjithë informacioni që kam vënë në dispozicion, përmes këtij aplikimi, është i vërtetë dhe i saktë. Jam i informuar se përben shkelje në kuptim të nenit 32 të Ligjit nr.111/2017 dhe të legjislacionit penal të Republikës së Shqipërisë:
 - a. Dhënia e një informacioni/deklarimi të pasaktë/ të pavërtetë;
 - b. Dhënia e dokumentave false.
14. Deklaroj dhe pranoj se, nëse vërtetohet pasaktësia / falsiteti i një informacioni dhe/ose një dokumenti, ndaj meje mund të ndërmerren masat e nevojshme të përgjegjësisë për çdo kosto të shkaktuar si rezultat i përfitimit pa të drejtë të ndihmës juridike për shkak të pasaktësisë/pavërtetësisë apo falsitetit të provuar. Konkretisht, përmes këtij deklarimi, pranoj se në rast pasaktësie dhe/ose falsiteti të një informacioni ose dokumenti, do jem i detyruar të rimbursoj shpenzimet për avokatin që ka ofruar ndihmën juridike si dhe çdo shpenzim apo kosto tjetër që do të rezultojë nga përfitimi pa të drejtë të ndihmës juridike falas.
15. Deklaroj dhe pranoj se të gjitha të dhënat e vëna në dispozicion nga unë, mund të verifikohen për efekt të saktësisë, vërtetësisë dhe efektshmërisë së tyre lidhur me aplikimin tim dhe se ky deklaram mund të shërbejë si autorizim për qendrën/klinikën për të ndërmarrë çdo veprim me qëllim verifikimin e të dhënave të këtij formulari.
16. Deklaroj dhe pranoj se në vijim do të informoj mbi çdo informacion shtesë që do të ndryshojë statusin tim si përfitues i ndihmës juridike falas.

RUBRIKA 4: DOKUMENTACIONI SHOQERUES

Ky aplikim shoqërohet nga dokumentat si më poshtë:

A. Dokumenta Identifikimi të Aplikantit:

.....;
.....;
.....;
.....

B. Dokumenta që vërtetojnë statusin e kategorisë së veçantë:

.....;
.....;
.....;
.....

C. Dokumenta të tjera:

.....;
.....;
.....;
.....

Nënshkrimi i Aplikantit

Z/Znj. _____
(emër-mbiemër-nënshkrim)

Nënshkrimi i punonjësit të klinikës/qendrës:

Z/Znj. _____
(emër-mbiemër-nënshkrim)

Në _____
(qyteti)

Datë: ____ . ____ . 20 ____

① Informacioni si më sipër, do të trajtohet në përputhje me Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe çdo disponim i këtyre të dhënave do të kryhet në përputhje me Ligjin 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

SHTOJCA 10

VENDIM i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr.231 datë 12.11.2019 për “Rregullat e garantimit të mbrojtjes së detyrueshme dhe caktimin mbi bazën e parimit të rotacionit të avokatit mbrojtës nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore në procesin penal”

https://klp.al/wp-content/uploads/2019/12/Vendim-nr-231-datë-12.11.2019_compressed.pdf

SHTOJCA 11

URDHER nr.531 datë 25.11.2019 “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjinë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga drejtoria e ndihmës juridike falas të shërbimeve të ndihmës juridike”

<https://ndihmajuridike.gov.al/wp-content/uploads/2020/08/Kriteret-dhe-Metodologjia-per-Vleresimin-e-Cilesise-se-Ofrimit-te-Sherbimeve-te-Ndihmes-Juridike-dhe-Procedurat-e-Mbikeqyrjes-se-Sherbimeve-te-Ndihmes-Juridike-nga-DNJF.pdf>



TLAS
www.tlas.org.al

TLAS (Shërbimi Ligjor Falas Tiranë) është një nga organizatat e pakta në Shqipëri që po luan rol aktiv në trajtimin, mbështetjen dhe ofrimin e shërbimeve ligjore falas për personat interseks dhe familjet e tyre. Misioni i TLAS është përmbushja e nevojave ligjore dhe sociale e të varfërve, edukimi dhe sensibilizimi i shoqërisë shqiptare mbi sundimin e ligjit dhe të drejtat e njeriut, ndërmarrja e nismave për përmirësimin e sistemit ligjor, zhvillimin e komunitetit dhe forcimin e demokracisë në Shqipëri.

Objektivat e TLAS janë:

- Ofrimi i shërbimeve ligjore për njerëzit dhe grupet në nevojë;
- Ndërgjegjësimi i shtresave në nevojë dhe publikimi i informacioneve për çështje të rëndësishme ligjore dhe të të drejtave të njeriut;
- Ndërmarrja e nismave për përmirësime të legjislacionit, për rritjen e aksesit në drejtësi dhe përfshirjen sociale të njerëzve në nevojë.

Adresa e TLAS:

Bulevardi "Bajram Curri", p. "Agimi", shk. 18, ap.322, Tiranë, Shqipëri.
Tel: +355 04 258442;
Cel: 0692093731;
email: tlas@tlas.org.al.

Përgatitur nga:
Shërbimi Ligjor Falas, Tiranë
Tirana Legal Aid Society, TLAS

www.tlas.org.al
tlas@tlas.org.al